

Public Disclosure Authorized

Raport Nr. 26213

## Shqipëria: Një vlerësim i varfërisë

5 nëntor 2003

Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor  
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore



Public Disclosure Authorized

**Dokument i Bankës Botërore**

---

**Barazvlerësi i monedhës**  
(Norma e këmbimit në fuqi më 30 prill 2002)

monedha vendase = Lek  
1 Lek = 0.007 US\$  
1 US\$ = 145 Lek

**VITI FISKAL i QEVERISË**

1 janar - 31 dhjetor

**SHKURTIME DHE INICIALE**

CAS	Strategjia e Ndihmës për Vendin
CBN	Kosto e nevojave bazë
ECA	Evropa dhe Azia Qendrore
ESW	Puna ekonomike dhe sektoriale
BE	Bashkimi Evropian
PBB	Produkti brendshëm bruto
SREUV	Strategjia për Rritjen Ekonomike dhe Uljen e Varfërisë (dokument i qeverisë për uljen e varfërisë)
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IDA	Banka Ndërkombëtare për Asocim
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
VKJ	Vëzhgimi për Kushtet e Jetesës
LFP	Pjesëmarrja e krahut të punës
LSMS	Vëzhgimi i Matjes së Standarteve të Jetesës
MOA	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
MOES	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MOF	Ministria e Fiinancës
MOH	Ministria e Shëndetësisë
MOLG	Ministria e Pushtetit Vendor
MOLSA	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
MTEF	Programi Buxhetor Afatmesëm
NES	Shërbimi Kombëtar i Punës
NFRE	Ndërmarrje fshatare jobujqësore
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social ( <i>aka</i> SREUV)
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PRSC	Kredia në Mbështetje të Uljes së Varfërisë
PRSP	Dokumenti Strategjik për Uljen e Varfërisë
UBN	Nevoja bazë të paplotësuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar

N/president:	Johannes Linn
Drejtori për vendin:	Orsalio Kalantzopoulos
Drejtori i sektorit:	Annette Dixon, Armin Fidler
Menaxher sektori:	Mamta Murthi, Arup Banerji
Kryetare e ekipit:	Mukesh Chawla

## Tryeza e lendës

<b>FALENDERIME</b> .....	<b>XI</b>
<b>NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM</b> .....	<b>XII</b>
<b>KREU I: HYRJE</b> .....	<b>24</b>
1. <b>PAK HISTORI: PËRSE KY VLERËSIM I VARFËRISË PËR SHQIPËRINË?</b> .....	<b>24</b>
2. <b>KONTEKSTI EKONOMIK</b> .....	<b>26</b>
3. <b>MATJA E VARFËRISË NË SHQIPËRI</b> .....	<b>30</b>
4. <b>STRUKTURA E KËTIJ RAPORTI</b> .....	<b>32</b>
<b>KREU II: VARFËRIA NË SHQIPËRI</b> .....	<b>34</b>
1. <b>HYRJE</b> .....	<b>34</b>
2. <b>VARFËRIA E TË ARDHURAVE</b> .....	<b>34</b>
3. <b>DIMENSIONET E VARFËRISË QË NUK KANË LIDHJE ME TË ARDHURAT</b> ..	<b>39</b>
4. <b>VARFËRIA SUBJEKTIVE</b> .....	<b>49</b>
5. <b>NJË PROFIL I VARFËRISË</b> .....	<b>51</b>
6. <b>ZBRËTHIMI E PABARAZISË SË TË ARDHURAVE</b> .....	<b>61</b>
7. <b>MODELET E KONSUMIT</b> .....	<b>63</b>
8. <b>PËRCAKTUESIT E VARFËRISË</b> .....	<b>64</b>
9. <b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR POLITIKA</b> .....	<b>66</b>
<b>KREU III: DIMENSIONET HAPËSINORE TË VARFËRISË</b> .....	<b>69</b>
1. <b>PAMJE E PËRGJITHSHME</b> .....	<b>69</b>
2. <b>VARFËRIA NËPËR RAJONE</b> .....	<b>70</b>
3. <b>VARFËRIA FSHATARE</b> .....	<b>71</b>
4. <b>ZONAT FSHATARE DHE MALORE – XHEPA TË VARFËRISË SË TEJSKAJSHME</b> <b>74</b>	
5. <b>VARFËRIA NË ZONAT PERIUBANE</b> .....	<b>77</b>
6. <b>HARTAT E VARFËRISË DHE PABARAZISË</b> .....	<b>79</b>
<b>KREU IV: ZHVILLIMET E TREGUT TË PUNËS DHE VARFËRIA</b> .....	<b>86</b>
1. <b>PAMJE E PËRGJITHSHME</b> .....	<b>86</b>
2. <b>PUNËSIMI</b> .....	<b>89</b>
3. <b>PAPUNËSIA</b> .....	<b>95</b>
4. <b>ZHVILLIMET E PAGAVE</b> .....	<b>99</b>
5. <b>TREGU I PUNËS DHE VARFËRIA</b> .....	<b>103</b>

6.	<b>KOMENTE PËRMBYLLËSE DHE PASOJAT PËR POLITIKAT</b> .....	106
	<b>KREU V: SHENDETESIA</b> .....	108
1.	<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	108
2.	<b>SITUATA SHËNDETËSORE E POPULLSISË</b> .....	110
3.	<b>SIGURIMET SHËNDETËSORE</b> .....	112
4.	<b>SHFRYTËZIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR</b> .....	114
5.	<b>SHPENZIMET PËR SHËNDETËSINË</b> .....	120
6.	<b>SHPENZIMET KATASTROFIKE PËR SHËNDETSINË DHE VARFËRIA</b> 126	
7.	<b>FAKTORËT PËRCAKTUES TË KËRKESËS PËR KUJDES SHËNDETËSOR</b> 128	
8.	<b>KOMENTE PËRMBYLLËSE DHE NDIKIMET TEK POLITIKAT</b> .....	128
	<b>KAPITULLI VI: ARSIMI</b> .....	133
1.	<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	133
2.	<b>ARRITJET NË ARSIM</b> .....	134
3.	<b>ARSYET E REGJISTRIMEVE TË ULËTA</b> .....	144
4.	<b>SHPENZIMET NË ARSIM</b> .....	145
5.	<b>ARSIMI DHE TREGJET E PUNËS</b> .....	148
6.	<b>KONKLUZIONET DHE SUGJERIME PËR POLITIKAT</b> .....	151
	<b>KREU VII: PËRBALLIMI I VARFËRISË – ROLI I PROGRAMEVE TË MBROJTJES SOCIALE</b> .....	153
1.	<b>HYRJE</b> .....	153
2.	<b>IMPAKTI I PROGRAMEVE TË MBROJTJES SOCIALE NË NDIHMË NË PARA NË SHQIPËRI</b> .....	158
	<b>TRANSFERTA PËR LEJE LINDJEJE</b> .....	162
	<b>VLERËSIMI I NDIKIMIT TË TRANSFERTAVE PUBLIKE TEK PËRQINDJA E VARFËRISË</b> .....	167
3.	<b>LLOJET E MIGRIMIT</b> .....	179
	<b>TË ARDHURAT NGA MIGRIMI</b> .....	188
	<b>VËREJTJE PËRMBYLLËSE DHE SUGJERIME PËR POLITIKAT QE DUHET TE NDIQEN</b> .....	191
	<b>KAPITULLI IX: PAMJA PER TE ARDHMEN</b> .....	194
1.	<b>ULJA E VARFËRISË</b> .....	194
2.	<b>FUSHAT E KËRKIMEVE NË TË ARDHMEN</b> .....	201

## Lista e tabelave

Tabela 1. 1: Treguesit Makroekonomik, 1998-2002.....	26
Tabela 1. 2: PBB dhe rritja sektorale .....	27
Tabela 1. 3: Eksportet dhe Importet (përqindje e totalit).....	27
Tabela 1. 4: Punësimi dhe papunësia ('000 me përjashtim të rasteve kur tregohet ndryshe) .....	28
Tabela 2. 1: Varfëria dhe pabarazia në Shqipëri.....	36
Tabela 2. 2: Krahasimi i kufijve të varfërisë.....	37
Tabela 2. 3: Ndjeshmëria e numrave total ndaj ndryshimeve të kufirit të varfërisë .....	37
Tabela 2. 4: Normat e varfërisë në disa vende të rajoni ECA .....	38
Tabela 2. 5: Vetëvlerësimi i cilësisë së ujit.....	40
Tabela 2. 6: Energjia elektrike.....	40
Tabela 2. 7: Nevojat Bazë të Papatësuar.....	42
Tabela 2. 8: Shkrimi dhe leximi sipas grupmoshave dhe vendodhjes.....	43
Tabela 2. 9: Arritja arsimore .....	43
Tabela 2. 10: Normat e rregjistrimit sipas vendodhjes.....	44
Tabela 2. 11: Kequshqyerja e moderuar dhe e rëndë tek fëmijët nën pesë vjeç.....	44
Tabela 2. 12: Kujdesi prenatal gjatë shtatzanisë.....	45
Tabela 2. 13: Pjesëmarrja e krahut të punës të popullsisë që është në moshë pune, sipas gjinive (mosha > 14).....	47
Tabela 2. 14: Pjesëmarrja e krahut të punës: dallimet midis gjinive sipas rajonit (mosha > 14) .....	47
Tabela 2. 15: Pronësia dhe madhësia e tokës bujqësore.....	48
Tabela 2. 16: Pronësia e gjësë së gjallë tek familjet që merren me bujqësi.....	48
Tabela 2. 17: Vlera e mallrave jetëgjata sipas vendodhjes .....	48
Tabela 2. 18: Vlera e mallrave jetëgjata sipas gjendjes ekonomike .....	48
Tabela 2. 19: Kënaqësia me gjëndjen financiare dhe konsumin mesatar për frymë.....	49
Tabela 2. 20: Krahasimi i varfërisë objektive me atë subjektive.....	50
Tabela 2. 21: Tiparet kryesore të të varfërve .....	52
Tabela 2. 22: Matjet dhe përqindjet e varfërisë sipas grupmoshave dhe vendodhjeve .....	53
Tabela 2. 23: Varfëria, kushtet e jetesës dhe mundësia e përdorimit të shërbimeve .....	53
Tabela 2. 24: Rregjistrimi neto sipas gjendjes ekonomike .....	55
Tabela 2. 25: Matjet e varfërisë dhe përqindjet sipas rezultateve shkollore dhe vendodhjes .....	57
Tabela 2. 26: Varfëria dhe kequshqyerja e fëmijëve.....	58
Tabela 2. 27: Pjesëmarrja e krahut të punës për të varfërit dhe jo të varfërit (mosha > 14) .....	59
Tabela 2. 28: Matjet e varfërisë sipas gjendjes së punësimit të kryefamiljarit .....	59
Tabela 2. 29: Normat e varfërisë sipas numrit të personave të punësuar dhe vendodhjes .....	60
Tabela 2. 30: Përqindjet e të ardhurave sipas gjendjes së varfërisë.....	60
Tabela 2. 31: Përqindja e varfërisë sipas burimit kryesor të të ardhurave (të paktën 50%) .....	61
Tabela 2. 32: Zbërthimi Gini sipas burimit të të ardhurave .....	62
Tabela 2. 33: Zbërthimi Gini sipas burimit të ardhurave (të ardhurat jo bujqësore presupuzohen të jenë zero).....	63
Tabela 2. 34: Pjesët kryesore të buxhetit sipas vendodhjes .....	63

Tabela 2. 35: Burimet e konsumit sipas vendodhjes.....	63
Tabela 2. 36: Pjesët kryesore të buxhetit sipas gjëndjes ekonomike .....	64
Tabela 2. 37: Modelet e shpenzimeve ushqimore sipas vendodhjes.....	64
Tabela 3. 1: Normat e varfërisë sipas rajoneve .....	70
Tabela 3. 2: Burimet e të ardhurave sipas zonave fshatare/qytetëse dhe sipas pesëshoreve fshatare (në përqind) .....	72
Tabela 3. 3: Vlera mesatare e të ardhurave familjare në muaj sipas burimit (Lekë).....	72
Tabela 3. 4: Pronësia e tokës bujqësore (përqind) .....	73
Tabela 3. 5: Shpërndarja e tokës, sipa madhësisë së tokës dhe rajonit, pesëshore dhe të varfër/jo të varfër (përqind).....	73
Tabela 3. 6: Treguesit e varfërisë dhe pabarazisë (%)......	80
Tabela 3. 7: Indekset e varfërisë dhe të pabarazisë sipas prefekturave (%).....	81
Tabela 3. 8: Indekset e varfërisë dhe të pabarazisë sipas rretheve (%) .....	81
Tabela 3. 9: Indekset e varfërisë dhe pabarazisë sipas minibashkive të qytetit të Tiranës (%).....	83
Tabela 4. 1: Pjesëmarrja e krahut të punës sipas gjinisë dhe arsimit (popullsia në moshë pune, mosha 14+).....	88
Tabela 4. 2: Pjesëmarrja e krahut të punës sipas rajoneve (Popullsisë në moshë pune, mosha 14+) .....	88
Tabela 4. 3: Punësimi sipas sektorëve (fund-periodhe).....	90
Tabela 4. 4: Punësimi sipas gjinisë dhe arsimit (përqind e popullsisë në moshë pune, mosha 15-64) ....	90
Tabela 4. 5: Punësimi sipas rajoneve (përqind e popullsisë në moshë pune, mosha 14+) .....	91
Tabela 4. 6: Kohëzgjatja e punësimit me pagë.....	91
Tabela 4. 7: Lloji i punësimit sipas punëdhënësve .....	92
Tabela 4. 8: Të dhënat e punësimit në Shqipëri, 2002 .....	93
Tabela 4. 9: Ndërmarrjet familjare jobujqësore sipas industrive.....	95
Tabela 4. 10: Forca e krahut të punës dhe papunësia, 1991-2001 (në mijë).....	95
Tabela 4. 11: Papunësia sipas gjinisë dhe arsimit (përqind) .....	97
Tabela 4. 12: Forca e krahut të punës dhe papunësia sipas gjinive dhe arsimit (përqind e popullsisë në moshë pune, mosha 14+).....	97
Tabela 4. 13: Forca e krahut të punës dhe papunësia sipas rajoneve (përqind e popullsisë në moshë pune, mosha 14+).....	98
Tabela 4. 14: Paga mesatare sipas industrive, sektorit publik dhe sektorit privat .....	100
Tabela 4. 15: Paga mesatare mujore sipas punëdhënësit sipa rajoneve (në lekë).....	100
Tabela 4. 16: Paga mesatare mujore sipas sektorit dhe arsimit (Lek).....	101
Tabela 4. 17: Pagat mesatare mujore të raportuara sipas industrive, 2002.....	101
Tabela 4. 18: Diferenciali page private/publike sipas rezultateve arsimore .....	102
Tabela 4. 19: Niveli i varfërisë sipas numrit të pjesëtarëve të punësuar në një familje.....	103
Tabela 4. 20: Karakteristika të tregut të punës (përqindja e popullsisë në moshë pune 14+).....	105
Tabela 4. 21: Paga mesatare mujore sipas statusit të varfërisë .....	105
Tabela 5. 1: Shërbime shëndetësore.....	108
Tabela 5. 2: Jetëgjatësia në lindje .....	110
Tabela 5. 3: Shkaqet e vdekshmërisë sipas grupeve të sëmundjeve (për 100,000 banorë) .....	111
Tabela 5. 4: Sëmundshmëria e vetë-raportuar sipas gjinisë, rajoneve dhe nivelit të varfërisë ...	112

Tabela 5. 5: Shfrytëzimi i shërbimit ambulator (përqindja e të sëmurëve) .....	115
Tabela 5. 6: Personeli mjeksor për 1000 banorë sipas rretheve.....	116
Tabela 5. 7: Përqindja e shfrytëzimit të shërbimit ambulator midis personave që deklarojnë sëmundje sipas nivelit të varfërisë dhe moshës .....	117
Tabela 5. 8: Kujdesi paralindjes sipas nivelit të varfërisë dhe rajoneve .....	118
Tabela 5. 9: Ndihma gjatë lindjes sipas llojit të personelit sipas rajoneve dhe nivelit të varfërisë (përqindjet).....	118
Tabela 5. 10: Shpenzimet publike për shëndetësinë .....	120
Tabela 5. 11: Shpenzimet për shërbimin ambulator sipas rajoneve.....	121
Tabela 5. 12: Totali vjetor i shpenzimeve spitalore.....	122
Tabela 5. 13: Pagesat informale mesatare në shërbimin ambulator midis atyre që bëjnë pagesat informale .....	123
Tabela 5. 14: Shpenzimet mujore shëndetsore për frymë dhe përqindja që zënë shpenzimet shëndetsore në shpenzimet totale familjare për frymë nëpër pesëshoret e konsumit .....	125
Tabela 5. 15: Përqindja e individëve shpenzime katastrofike shëndetsore.....	126
Tabela 5. 16: Përqindja katastrofike dhe matjet e tepricave katastrofike për shpenzimet shëndetsore.....	127
Tabela 5. 17:Matjet e varfërisë përpara dhe pas pagesave për kujdesin shëndetsor.....	127
Tabela 5.A. 1: Sëmundjet kronike të deklaruara sipas statusit të varfërisë .....	131
Tabela 5.A. 2: Sëmundjet e raportuara në katër javët e fundit përpara zondazhit, sipas gjëndjes së varfërisë, përqindje .....	131
Tabela 5.A. 3: shfrytëzimi i kujdesit shëndetësor sipas gjinisë, zonës së banimit, nivelit të varfërisë, dhe faktit nëse personi ka ose jo librezë shëndetësore ( me përqindje).....	132
Tabela 5.A. 4: Përqindja e individëve që i drejtohen kujdesit shëndetësor sipas rajoneve dhe grup-moshave.....	132
Tabela 5.A. 5: Konsultime shtatzanie sipas personelit që e ofron sipas rajoneve dhe nivelit të varfërisë (përqindjet).....	132
Tabela 6. 1: Diploma me e lartë e marrë për gjithë rajonin.....	135
Tabela 6. 2: Përqindjet neto të regjistrimit për të gjitha gjinitë, rajonet, dhe nivelet e të ardhurave .....	137
Tabela 6. 3: Përqindjet gros të regjistrimit në shkollat e mesme .....	140
Tabela 6. 4: Raporti i atyre që kanë mbaruar arsimin bazë tetëvjeçar dhe vazhdojnë arsimin e mesëm .....	142
Tabela 6. 5: Arsyet e mos frekuentuar kopshtet për rajone, propocioni i moshave 3-5 vjeç.....	144
Tabela 6. 6: Arsyet për mos regjistrimin në radhët e 14-17 vjeçarëve (raportet) .....	145
Tabela 6. 7: Shpenzimet publike në arsim si përqindje e PBB dhe shpenzimeve publike totale	145
Tabela 6. 8: Totali i shpenzimeve familjare në arsim për të gjitha nivelet dhe kuintilet e konsumit .....	146
Tabela 6. 9: Shpenzimet totale personale në arsim sipas nivelit të shkollimit dhe të ardhurave	146
Tabela 6. 10: Statusi i fuqisë punëtore të meshkujve shqipëtar për të gjitha nivelet e arsimit, përqindje .....	148
Tabela 6. 11: Pjesmarrja e fuqisë punëtore femra për të gjitha nivelet e arsimit dhe moshës....	149

Tabela 6. 12: Të ardhurat mujore e punëtorëve të paguar sipas niveleve të arsimit, gjinisë dhe moshës.....	150
Tabela 7. 1: Burimet e të ardhurave (Të ardhura mesatare; Lek në muaj) .....	159
Tabela 7. 2: Struktura e të ardhurave të familjeve shqiptare sipas burimit, vendbanimit, dhe pesëshores së të ardhurave sipas vendndodhjes (Përqindja e totalit të të ardhurave për kategorinë e familjes).....	161
Tabela 7. 3: Shpërndarja e të ardhurave nga transfertat sipas familjeve që siguronin të adhura nga transfertat nga ai burim (përqindja e familjeve që përfitojnë nga ky burim të ardhurash) .....	162
Tabela 7. 4: Përqindja tek Familjet e marrjes së të ardhurave nga transfertat, sipas peëshoreve, gjëndjes së varfërisë, zones së banimit dhe burimit të të ardhurave nga transfertat (përqindja familjeve brenda kategorive) .....	164
Tabela 8. 1: Lëvizshmëria e brendshme: anëtarët e familjeve që kanë lindur në bashkinë aktuale .....	179
Tabela 8. 2: Lëvizja e kryefamiljarëve në vitet nëntëdhjetë .....	180
Tabela 8. 3: Karakteristikat e familjes së mërguesve të përkohshëm të kohëve të fundit .....	184
Tabela 8. 4: Karakteristikat individuale dhe familjare të fëmijëve që janë larguar nga shtëpia .....	187
Tabela 8. 5: Vendndodhja e dërguesve dhe e marrësve të dërgesave .....	189
Tabela 9. 1: Sasia e të ardhurave sipas burimeve të të ardhurave (në përqindje, vetëm popullsia fshatare).....	198



## Lista e figurave

Figura 2.1: Funksionet kumulative të dendësisë sipas vendodhjes.....	12
Figura 2.2: Mundësia e përdorimit të ujit.....	15
Figura 2.3: Kanalizimet .....	15
Figura 2.4: Rregjistrimi sipas gjinisë.....	20
Figura 2.5: Kënaqësia me gjëndjen aktuale financiare.....	23
Figura 2.6: Kërkesat për nevojat bazë familjare.....	23
Figura 2.7: Normat e varfërisë sipas madhësisë dhe vendodhjes së familjes.....	25
Figura 2.8: Rregjistrimi në shkollë dhe varfëria.....	28
Figura 2.9: Rezultatet arsimore sipas gjëndjes ekonomike dhe vendodhjes.....	29
Figura 2.10: Rezultatet arsimore të të varfërve sipas gjinisë .....	30
Figura 3.1: Funksionet e akumulara të të ardhurave sipas rajonit.....	41
Figura 3.2: Përqindja e varfërisë sipas prefekturave sipas rretheve.....	54
Figura 3.3: Konsumi për frymë .....	54
Figura 3.4: Përqindja e varfërisë sipas komunave dhe bashkive .....	54
Figura 4.1: Normat e pjesëmarrjes së krahut të punës në Shqipëri, 1993-2001.....	55
Figura 4.2: Normat e punësimit në Shqipëri, 1991-2001.....	57
Figura 4.3: Kohëzgjatja e punësimit në sektorin informal (si përqindje e punësimit total).....	61
Figura 4.4: Përbërja e të papunëve .....	64
Figura 4.5: Zhvillimi i pages reale, 1993-2001.....	65
Figura 4.6: Pagat mujore mesatare sipas sektorit dhe gjinisë (në lekë).....	68
Figura 5.1: Popullsia e personave me librezë shëndetësore.....	77
Figura 6.1: Rezultatet arsimore (grupmosha 16-35).....	92
Figura 6.2: Përqindja e studentave që marrin mësim .....	100
Figura 7.1: Shpërndarja e të ardhurave familjare nga transfertat (nga të gjitha burimet, sipas burimeve).....	113
Figura 7.2: Shpërndarja e të ardhurave familjare të jo të varfërve nga transfertat (nga të gjitha burimet, sipas burimeve).....	113
Figura 7.3: Shpërndarja e të ardhurave familjare të të varfërve nga transfertat (nga të gjitha burimet, sipas burimeve).....	114
Figura 7.4: Shpërndarja e të ardhurave familjare të tejet të varfërve nga transfertat (nga të gjitha burimet, sipas burimeve).....	114
Figura 8.1: Lëvizshmëria e brendshme e kryefamiljarëve.....	125
Figura 8.2: Emigrimi sipas rretheve .....	126
Figura 8.3: Imigrimi sipas rretheve .....	126
Figura 8.4: Migrimi neto sipas rretheve .....	127
Figura 8.5: Migrimi i përkohshëm i jashtëm .....	129
Figura 8.6: Transfertat private dhe PBB.....	131

## Lista e kutive

Kutia 2.1: Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.....	16
Kutia 2.2: Të mungon telefoni? Është Vodafoni!.....	27
Kutia 4.1: Përkufizimet e tregut të punës.....	57
Kutia 4.2: Përse është kaq e lartë norma e papunësisë në Tiranë?.....	65
Kutia 5.1: Pagesat informale për kujdesin shëndetsor, në zonat periurbane të Tiranës dhe Durrësit....	84
Kutia 6.1: Mundësia e shfrytëzimit të shkollës në zonat periurbane të Tiranës dhe Durrësit.....	94
Kutia 6.2: Përcaktorët e rregjistrimit në shkollat e mesme.....	95
Kutia 6.3: Pagesat informale në arsim .....	100
Kutia 7.1: Shpenzimet për mbrojtjen sociale, 1998.....	107
Kutia 7.2: Proqramet e transfertave në para.....	118
Kutia 7.3: Eficienca e synimit .....	118
Kutia 9.1: Klima e investimeve në Shqipëri.....	136
Kutia 9.2: Korrupsioni në administratën shqiptare.....	137

## FALENDERIME

Dokumenti “Një vlerësim i varfërisë në Shqipëri” është një punë e përbashkët e një ekipi të kryesuar nga Mukesh Chawla (ECSHD). Ky ekip shumësektorial përbëhej nga: Gero Carletto (profile i varfësisë dhe migrimi), María Eugenia Bonilla Chacín (arsimi dhe shëndetësia), William M. Tracy (analiza cilësore dhe sasiore), Moukim Temourov (tregu i punës), Verdon Staines (mbrojtja sociale), Mansour Farsad (analiza makroekonomike), Frauke Jungbluth dhe Julia Bucknall (zhvillimi fshatar), Lorena Kostallari, Meritxell Martinez, dhe Nicole La Borde (asistentë të programit) të gjithë nga Banka Botërore, Instituti i Statistikës, INSTAT (profili i varfërisë), Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, MPCŞ (përhapja e varfërisë), dhe konsulentët, Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor dhe Andrew Mast (analiza cilësore). Maureen Lewis dhe Jean-Jacques Dethier kanë ofruar opionencën për këtë material. Orsalio Kalantzopoulos, Drejtori për vendin, Shqipëri, Annette Dixon, Drejtoreshë ECSHD (në kohën e përgatitjes së këtij materiali), dhe Mansoor Rashid e Mamta Murthi, menaxherë sektori të komanduar, HDE, ECSHD (në kohën e përgatitjes së këtij materiali) na kanë ofruar udhërrëfim dhe mbështetje të vyer. Shumë persona të tjerë kanë dhënë kontributin e tyre duke na ofruar vërejtje dhe sugjerime mbi versione të ndryshme paraprake të këtij materiali si edhe duke na siguruar me bujari informacione: Kathryn Funk, Asad Alam, Ruslan Yemtsov, Edmundo Murrugarra, Cem Mete, Radwan Ali Shaban, Akiko Maeda, Nora Dudwick, Jan Rutkowski, Philip Goldman, David Hotchkiss, Linda Piccinino, Hermine de Soto, Mansour Farsad, Pierella Paci dhe Alexandre Marc.

Përgatitja e vlerësimit të varfërisë nuk do të kishte qënë e mundur pa bashkëpunim intensive me Institutin Shqiptar të Statistikës (INSTAT). Stafi i këtij institute jo vetëm që na ka dhënë të dhënat mbi raundin e parë të Studimit të Matjes së Standartit të Jetesës në Shqipëri në vitin 2002, por gjithashtu kanë punuar së bashku me ekipin e vlerësimit të varfërisë në lidhje me nxjerrjen e një profili të varfërisë. Ky ekip i detyrohet me ndjenjë të thellë mirënjohjeje INSTAT-it për bashkëpunimin dhe gatishmërinë bujare për shkëmbimin e informacionit.

Ky relacion ka përfutuar shumë nga bashkëpunimi me dikastere të tjera si edhe me bashkësinë e donatorëve të pranishëm në vend. Evidentimi i shpërndarjes së varfërisë, e përdorur si document mbështetës për këtë vlerësim, është financuar nga Ministria Shqiptare e Punës dhe Çështjeve Sociale, e cila ka ofruar gjithashtu asistencë për programin LSMS. Ky ekip i është mirënjohës bashkësisë së donatorëve të cilët kanë dhënë mendimin e tyre gjatë faces së konceptimit të vlerësimit të varfërisë. Pikëpamjet e tyre në lidhje me çështje kritike të lidhura me varfërinë në Shqipëri na kanë ndihmuar për të evidentuar dhe për t’u përqëndruar në aspekte të rëndësishme të varfërisë të cilat janë analizuar në këtë relacion.

## NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Gjatë pesë viteve të fundit Shqipëria ka pasur një ecuri ekonomike të fuqishme, duke u rritur me më shumë se 7 përqind në vit gjatë pjesës më të madhe të kësaj periudhe. Inflacioni ka mbetur në nivelet e 4 përqind ose më pak, eksportet dhe importet janë rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe si llogaria qarkulluese ashtu edhe defiqiti fiskal i financuar nga brenda janë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme. Gjatë pesë viteve të fundit janë zbatuar disa reforma strukturore, ndër të cilat mund të përmendim reformën e sistemit bankar, atë të tokës dhe privatizimin. Pothuajse të gjitha ndërmarrjet e vogla e të mesme janë privatizuar dhe në privatizimin e sektorëve strategjikë, si telekomunikacionet, janë bërë hapa të ndjeshëm përpara. Rregullimi i sektorit financiar si edhe funksioneve thelbësore të sektorit publik është fuqizuar dhe qeveria ka miratuar një ligj të ri mbi falimentimin dhe një skemë të sigurimeve të depozitave. Hapa të rëndësishëm janë bërë në fushën e administratës publike dhe është miratuar një ligj i gjithanshëm mbi shërbimin civil. Janë fuqizuar kapacitetet ligjore dhe juridike, rregullat e llogaridhënies janë forcuar dhe po zbatohet një plan-veprimi kundra korrupsionit.

Megjithatë, përkundër performances mbresëlënëse të ekonomisë, në Shqipëri varfëria ka mbetur e lartë dhe të ardhurat për frymë, rreth 1.230 dollarë në vitin 2002, janë ndër më të ulëtat ndër ekonomitë në tranzicion. Gjatë një përpjekjeje për të miratuar politika dhe masa për të shpërndarë përfitimet e rritjes ekonomike dhe për të ulur varfërinë, Qeveria e Shqipërisë ka hartuar një strategji për zbutjen e varfërisë në formën e Dokumentit të Ndërmjetëm të Strategjisë për Uljen e Varfërisë (2000), të cilën e zhvilloi pas dy vjetësh me më shumë hollësi në Strategjinë e Rritjes Ekonomike dhe Uljes së Varfërisë (SREUV), pasardhëse e së cilës është dokumenti aktual, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES). Megjithatë, gjatë hapave të parë të zhvillimit, SKZHES ishte e kufizuar nga disponibiliteti i të dhënave mbi varfërinë dhe ndërkohë që i shfrytëzoi mirë informacionet ekzistuese sasiore dhe cilësore, nuk kishte në dispozicion një përlllogaritje të saktë e të plotë të varfërisë. Duke pranuar kufizimet e të dhënave, në vitin 2002 nisi raundi i parë i Studimit të Matjes së Standartit të Jetesës (LSMS). Ky studim jep informacion të vlefshëm mbi një shumëllojshmëri çështjesh që lidhen me kushtet e jetesës së popullit në Shqipëri, duke përfshirë edhe hollësi mbi dimensionet e varfërisë që kanë lidhje me të ardhurat ose jo dhe format e bazave ku është mbështetur ky vlerësim i varfërisë në Shqipëri.

### **Kufiri i varfërisë**

Kufiri i varfërisë i përdorur në këtë vlerësim është i pari kufi absolut i varfërisë i mbështetur në të dhënat për shpenzimet në nivel përfaqësues familje që janë matur ndonjëherë në Shqipëri dhe mbështetet në shportën reale të konsumit të një popullate me zgjedhje të marrë nga një studim, çka pastaj është konvertuar në një masë monetare duke përdorur metodikën e kostos së nevojave bazë. Kjo ka çuar në zgjedhjen e një kufiri varfërie absolut prej 4.891 Lek për frymë në muaj. Mbështetur në këtë masë, një e katërta e popullsisë në Shqipëri, ose përndryshe gati 780.000 vetë, bien nën kufirin e varfërisë. Varfëria e tejskajshme prek rreth 150.000 vetë, ose më pak se 5 përqind e popullsisë, të cilët nuk kishin mundësi të plotësojnë qoftë edhe kërkesat për ushqime bazë. Një numër i madh personash janë përqendruar përreth kufijve të varfërisë. Ngritja e kufirit të varfërisë me 10 përqind e rrit përqindjen e personave të varfër me 25 deri në 50 përqind, në varësi të kufirit të përdorur të varfërisë. Kjo mund të thuhet gjithashtu edhe për lëvizjet negative të kufirit të varfërisë.

Varfëria në Shqipëri ka shënuar dimensione hapësinore dhe rajonale, ku zonat fshatare dhe krahina malore janë vazhdimisht më të varfëra se pjesa tjetër e vendit, sipas të gjitha përkufizimeve të varfërisë. Numri i personave të varfër në zonat fshatare është 66 përqind më i lartë se në Tiranë dhe 50 përqind më i lartë se në zona të tjera qytetëse. Konsumi për frymë në zonat fshatare, në masën 7.224 Lek, është gati sa katër të pestat e niveleve të konsumit në zonat qytetëse. Familjet në rrethet më të largëta në krahinën malore në veri dhe verilindje të vendit nuk kanë ecuri të mirë përpara i përket varfërisë dhe pothuajse gati

gjysma e banorëve në këtë zonë janë të varfër dhe më shumë se një e pesta jetojnë në varfëri të tejskajshme. Gjithashtu, thellësia e varfërisë në këtë zonë është më e theksuar se në çdo zonë të krahinave të tjera, me një indeks të hendekut të varfërisë prej më shumë se 11 përqind. Konsumi mesatar në rajonet malore është sa dy të tretat e niveleve të konsumit në Tiranë dhe rreth 20-30 përqind më i ulët se në pjesën tjetër të vendit. Normat dhe thellësia e varfërisë në të gjithë rajonet e tjera janë rreth ose nën mesataret kombëtare.

### Varfëria në Shqipëri

	Tiranë		Qytetet e tjera		Rurale		Totali	
	Të varfër	Tejet të varfër	Të varfër	Tejet të varfër	Të varfër	Tejet të varfër	Të varfër	Tejet të varfër
Numri i personave (%)	17,8	2,3	20,1	4,8	29,6	5,2	25,4	4,7
Mesatarja e konsumit për kokë (Lek)	9.043		8.468		7.212		7.801	

### Varfëria fshatare

66 përqind e pjesës më të varfër dhe 61 përqind e pjesës më pak të varfër janë familje fshatare. Në total, 34,8 përqind e popullsisë fshatare janë të varfër (të varfër 29,6 përqind dhe tejet të varfër 5,2 përqind). Një sasi e madhe konsumi (më shumë se 30 përqind) në zonat fshatare vjen nga prodhimi vetiak, çka tregon rëndësinë që ka prodhimi bujqësor i një madhësie të vogël për sigurimin e ushqimit dhe mbajtjen e niveleve minimale të konsumit. Zonat fshatare mbështeten shumë tek bujqësia si burimi i tyre kryesor për të ardhurat (44 përqind), që ndiqet pastaj nga punësimi (19 përqind), transfertat publike (17,8 përqind), transfertat private (12,6 përqind) dhe prodhimi jo bujqësor (5,9 përqind). Krahasuar me zonat qytetëse, pjesa e të gjitha burimeve jo-bujqësore të të ardhurave është më e ulët në zonat fshatare. Familjet qytetëse mbështeten tek transfertat publike dhe private për 41,5 përqind të të ardhurave të tyre, ndërkohë që në zonat fshatare vetëm 30,4 përqind të të ardhurave vjen nga këto burime.

Pothuajse 90 përqind e popullsisë fshatare ka në pronësi dhe përdor tokë bujqësore. Rrallë ndërmerret aktiviteti i marrjes me qera të tokës bujqësore. Madhësia mesatare në pronësi të një familjeje është rreth 0,72 hektarë, çka tregon se ka shumë pak mundësi për të rritur aktivitetet bujqësore. E parë nga një këndvështrim ndërkombëtar, të dhënat e ofruara konfirmojnë mendimin se Shqipëria është njëri prej vendeve më të varfëra në Europë. Normat e varfërisë PPP të paraqitura (2 dhe 4 dollarë në ditë) janë më të larta se ato të vendeve fqinje dhe e vendosin Shqipërinë pak a shuimë në të njëjtin vend me vendet e Kaukazit si Gjeorgjia, dhe pak më lart se Azerbajxhani. Përkundër shqetësimeve në rritje në lidhje me pabarazitë e përhapura midis vendeve në tranzicion, pabarazia në këtë rast është e moderuar, me një indeks Gini të mbështetur mbi konsumin prej 0,28. Raporti 90/10, një tjetër matje e pabarazisë, është i butë, në masën 3,6.

Burimi kryesor i të ardhurave për familjet e varfëra është aktiviteti bujqësor (37 përqind), i ndjekur nga punësimi me pagë (27 përqind). Për familjet jo të varfëra punësimi është i vetmi burim më i rëndësishëm (35 përqind), i ndjekur nga bujqësia (25 përqind) dhe nga transfertat (14 përqind). Biznesi jo bujqësor jep rreth 6 përqind të të ardhurave të familjeve të varfëra, diçka më pak se transfertat (8 përqind) dhe ndihma ekonomike (7 përqind). Krahasuar me familjet e varfëra, familjet jo të varfëra nxjerrin një pjesë më të madhe të të ardhurave nga transfertat. Për të dy grupet, pensionet japin rreth 14 përqind të totalit. Po kështu, nuk mund të vihet re asnjë ndryshim tek pjesa e të ardhurave që vjen nga asistenca për papunësinë (që është më pak se 1 përqind), transfertat e lejes së lindjes, kujdesit social dhe transferta të tjera më pak të rëndësishme si edhe burime të tjera (që të dyja më pak se 1 përqind).

Zonat fshatare të Shqipërisë, sidomos në zonat malore të veriut, janë nga më të varfërat. Shkaktarët e problemeve për shqiptarët që jetojnë në këto zona është klima e ashpër dhe gjeografia malore e sertë. Shumica e banorëve e nxjerrin jetesën me bujqësi dhe blegtori minimale, çka përbën një burim të rëndësishëm të konsumit ushqimor ditor të familjeve fshatare. Megjithatë, shumica nuk kanë tokë të mjaftueshme për të pasur një shumëllojshmëri të mjaftueshme të produkteve dhe shumica mbështeten tek një grup i vogël prodhimesh kryesore bujqësore dhe blegtorale për t'u ushqyer.

### **Përcaktuesit e varfërisë**

Ndërkohë që madhësia e familjes është një tregues i varfërisë, nivelet e ulëta të arsimimit dhe papunësia janë ndoshta faktorët kryesorë demografikë që karakterizojnë varfërinë. Nivelet e rregjistrimit në arsimin fillor janë më të ulëta mes të varfërve dhe më të ultat fare tek tejet të varfërit. Kjo dukuri është shumë më e theksuar tek nivelet e rregjistrimit në arsimin e mesëm. Përqindja e varfërisë tek të rriturit që kanë një dëftesë të shkollës fillore është dyfishi i përqindjes së varfërisë tek ata që kanë një diplomë shkolle profesionale. Më shumë se 80 përqind e të varfërve nuk a kanë mbaruar nivelin e dytë arsimor ose kanë diplomë profesionale.

Vetëm 33 përqind e individëve të moshës 15-vjeçare e lart kanë një vend pune, ndërkohë që 21 përqind të tjerë punëjnë me orar të pjesshëm (31 përqind në zonat fshatare), duke e çuar numrin total të atyre që punojnë në 53,9 përqind. Rreth gjysma e punëtorëve fshatarë punojnë vetëm me orar të pjesshëm dhe një pjesë e madhe e tyre thonë se punojnë vetëm disa orë në javë. Pavarësisht si përkufizohet punësimi, të varfërit shfaqin norma shumë më të larta të papunësisë, krahasuar me jo të varfërit. Norma e papunësisë midis të varfërve mbështetur në përkufizimin standart të ILO-s (në 14,2 përqind) është pothuajse dyfishi i normës midis jo të varfërve. Midis tejet të varfërve norma e papunësisë është gati trefishi, po të përdorim përkufizimet më pak të shtrënguara, norma e papunësisë tek tejet të varfërit është mbi 30 përqind. Një pjesë shumë më e madhe e punëtorëve marzhinalë (ata që kategorizohen si të papërkrahur, sezonal dhe të shkurtuar) gjenden mes të varfërve.

Rezultatet e analizave me shumë ndryshore konfirmojnë korrelacionin e fortë dhe negativ midis arsimimit dhe varfërisë. Si në zonat qytetëse ashtu edhe në ato fshatare, familjet me pjesën më të madhe të anëtarëve me arsim të nivelit të mesëm e më të lartë kanë më pak gjasa të jenë të varfër. Siç pritej, ndikimi i arsimit të lartë është më i madh se ai i arsimit të nivelit të mesëm. Varfëria ka më shumë gjasa të gjendet tek familjet e mëdha: probabiliteti i një familjeje për të qënë e varfër rritet me rritjen e madhësisë së familjes. Familjet me një numër më të madh fëmijësh kanë gjithashtu më shumë gjasa për të qënë të varfëra. Edhe gjendja e punësimit ka rëndësi dhe kur një numër më i madh i anëtarëve të familjes janë të papunë atëherë familjeje ka shumë më shumë gjasa për të qënë e varfër.

### **Karakteristikat kryesore të familjeve të varfëra**

	Të varfëra	Jo të varfëra	Totali
Madhësia mesatare e familjes	5,7	4	4,3
Përqind 60 dhe mbi	10,2	19,7	17,8
Numri i anëtarëve nën 15 vjeç	2,1	1	1,2
Raporti i varësisë	1,12	0,77	0,84
Përqindja e familjeve me kryetar femër	9,3	13,1	12,4
Mosha e kryetarit të familjes	48,2	51,8	51,1
Vitet e arsimimit (kryetari i familjes)	6,2	7,9	7,4
Numri i mesatar i punonjësve për familje	1,9	1,6	1,6
Përqindja e familjeve me ujë të rrjedhshëm brenda	32,7	55,7	49,8

Përqindja e familjeve me WC brenda	41,4	68	61,2
Përqindja e familjeve që janë 30 minuta ose më pak larg një qendres shëndetsore	78,3	88	85,5

### **Karakteristikat e tregut të punës të të varfërve**

Shqipëria ka një normë të lartë të pjesëmarrjes së krahut të punës (66 përqind), por niveli i aftësive të punës është i ulët, dhe pothuajse dy të tretat e krahut të punës kanë arsim bazë ose më të ulët se bazë. Pothuajse dy të tretat e popullsisë të aftë për punë ose janë të vetëpunësuar ose bëjnë punë të papaguar në sipërmarrje bujqësore ose jobujqësore. Shumica e të vetëpunësuarve janë në bujqësi dhe vetëm një e treta e të punësuarve marrin paga. Rreth dhjetë përqind e të punësuarve në Shqipëri punojnë në sektorin informal. Ka prova të punësimit afatgjatë në sektorin informal, me gati 75 përqind të individëve të angazhuar në aktivitete informale për më shumë se tre vjet dhe gati 10 përqind që punojnë në sektorin informal më shumë se 10 vjet.

Papunësia mbetet e përhapur dhe norma e papunësisë është veçanërisht e lartë në zonat qytetëse. Mbretëron papunësia afatgjatë; mesatarisht duhet më shumë se një vit kohë të gjesh punë. Tirana ka pjesëmarrjen më të ulët të krahut të punës dhe normën më të lartë të papunësisë krahasuar me zonat e tjera gjeografike të vendit.

Pas rënive të ndjeshme në fillim dhe në fund të viteve 90, pagat reale në Shqipëri po rriten përsëri. Gjatë periudhës 1999-2001, pagat reale u rritën, mesatarisht, me 10 përqind në vit. Megjithatë, pagat në Shqipëri janë shumë të ulta: gjatë vitit 2002, rroga mesatare mujore ishte 18.680 Leks (rreth 133 \$US), dhe gati 50 përqind e të punësuarve me pagë fitonin më pak se 100 USD në muaj. Pagesa e ulët shoqërohet kryesisht me nivelin e ulët arsimor dhe gjithashtu me të punuarit në industri që paguajnë pak e ku vendet e punës nuk janë të sigurta, si psh shërbimet, bujqësia dhe sektori social. Femrat fitojnë shumë më pak se burrat me të njëjtin nivel kualifikimi. Fitimet në sektorin privat janë më të larta se ato të sektorit publik dhe dallimi i pagave rritet me rritjen e nivelit të arsimimit.

### **Dimensionet e varfërisë që nuk kanë të bëjnë me të ardhurat**

Dimensionet jo financiare të deprivimit përbëjnë varfërinë që lidhet me të ardhurat dhe pabarazitë në kushtet e jetesës janë më të theksuara sesa duken kur shikon vetëm dimensionin e të ardhurave. Modernizimi i vendit u ka ofruar përfitime zonave ekzistuese qytetëse, sidomos Tiranës, me një ritëm shumë më të madh se zonat fshatare. Mbulimi me shërbime të infrastrukturës bazë është pothuajse universal në zonat ekzistuese qytetëse, por shumë më pak në zonat fshatare dhe periurbane, edhe pse zonat ekzistuese qytetëse përballen me çështje serioze të cilësisë dhe qëndrueshmërisë.

### **Shëndetësia**

Ka shumë pabarazi të mëdha rajonale dhe në të ardhura përsa i takon gjëndjes shëndetsore dhe shërbimeve të kujdesit shëndetsor. Ka dallime të mëdha midis zonave fshatare dhe atyre qytetëse përsa i përket mundësisë për të pasur lidhje me ujë të rrjedhshëm dhe kanalizimet e ujrave të zeza, dhe ndërkohë që të gjithë banorët qytetës kanë lidhje me shërbimet e kanalizimeve të ujrave të zeza në shtëpitë e tyre, vetëm gjysma e familjeve që jetojnë në zonat fshatare kanë lidhje me kanalizimet e ujrave të zeza. Gjithashtu ka edhe shumë ndryshime të të ardhurave përsa i takon përqindjes së njerëzve që shkojnë për t'u vizituar në një ofruar të shërbimeve jospitalore dhe ndërkohë që të varfërit dhe ata që jetojnë jashtë Qarkut të Tiranës kanë më shumë gjasa të raportojnë një sëmundje sesa jo të varfërit, ata kanë më pak gjasa të kërkojnë kujdes shëndetsor kur sëmuren. Nga ana tjetër, vetëm banorët e Qarkut të Tiranës kanë më pak gjasa të raportojnë një sëmundje, por kanë më shumë gjasa të kërkojnë kujdes shëndetsor kur sëmuren. Në përgjithësi, vetëm 58 përqind e njerëzve që raportojnë sëmundje apo lëndim kërkojnë kujdes shëndetsor jospitalor. Gjithashtu ka edhe dallime të mëdha rajonale përsa i përket përdorimit të kujdesit spitalor.

Pothuajse të gjitha femrat përfitojnë nga kujdesi për nënat shtatzanë, dhe një personel i kualifikuar asiston pothuajse gjithmonë nënat gjatë lindjes. megjithatë, ka dallime të mëdha të ardhurash dhe rajonale në numrin e konsultave të shtatzanisë dhe në llojin e ofruesve të shërbimeve të lindjes. Po të bëjmë një krahasim, femrat në zonat malore kanë më pak gjasa nga të gjitha të përfitojnë nga shërbimet e kujdesit të shtatzanisë dhe përfitojnë numrin më të vogël të konsultave klinike. Në kontrast me to, femrat në Tiranë përfitojnë dy herë më shumë konsulta të shtatzanisë se femrat që jetojnë në pjesë të tjera të vendit.

Ka dallime të mëdha përsa i takon shpenzimeve të kujdesit shëndetsor që përballohen drejtpërdrejt nga xhepi. Shpenzimet për barnat përfaqësojnë pjesën më të madhe të këtyre lloj shpenzimeve. Janë të përhapura pagesat informale, sidomos në kujdesin spitalor ku 60 përqind e njerëzve raportojnë se bëjnë pagesa nën tryezë. Këto pagesa përfaqësojnë gjithashtu një pjesë të rëndësishme të totalit shpenzimeve, që është gati një e katërta e shpenzimeve të shërbimeve spitalore.

Shpenzimet e kujdesit shëndetsor përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të totalit të shpenzimeve mujore të një familjeje dhe ndryshojnë sipas nivelit të të ardhurave të familjes. Edhe pse të varfërit paguajnë më pak në shifra absolute, në shifra relative ata shpenzojnë një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre për kujdesin shëndetsor sesa të pasurit. Familjet e varfëra jo vetëm që kanë më shumë gjasa të përballen me shpenzime katastrofike për shëndetin, por ato kanë edhe më shumë gjasa për të bërë teprime më të mëdha në pagesat për shëndetsinë mbi pragun katastrofik.

### **Arsimi**

Ka pabarazi të mëdha të ardhurash dhe rajonale në përfitimin nga shërbimet arsimore dhe rezultatet e arsimimit. Ndërkohë që shqiptarët 21 vjeç e më të mëdhenj kanë bërë mesatarisht 8,5 vjet arsimim, ka një ndryshueshmëri të madhe sipas të ardhurave dhe vendbanimit dhe një adult që jeton në një familje të varfër, mesatarisht, ka dy vjet arsimim më pak se një që jeton në një familje më në gjendje. Në mënyrë të ngjashme, adultët që jetojnë në Tiranë kanë rreth 3,5 vjet arsimim formal më shumë se ata që jetojnë zonat fshatare. Po ashtu ka ndryshueshmëri të madhe përsa i takon numrit total të viteve të mbaruar të shkollës sipas të ardhurave dhe vendbanimit dhe edhe pse përqindja e atyre që mbarojnë arsimin bazë është i lartë, ka një ulje të madhe të numrit të studentëve që vazhdojnë shkollimin përtej nivelit bazë. Ka gjithashtu dallime të mëdha midis zonave fshatare dhe qytetëse dhe ndërkohë që këto dallime janë të vogla përsa i takon arsimin fillor, ato rriten kur kalohet në nivelin e shkollës së mesme.

Ka ndryshime të mëdha përsa i takon përqindjes së regjistrimit në të gjitha nivelet e arsimin midis qarqeve dhe niveleve të të ardhurave. Përqindjet e regjistrimit për të varfërit dhe sidomos për tejet të varfërit janë shumë më të ulëta se ato të jo të varfërve; në mënyrë të ngjashme, përqindjet e regjistrimit në zonat fshatare janë shumë më të ulëta se në zonat qytetëse. Regjistrimi në arsimin parashkollor ka rënë shumë gjatë periudhës së tranzicionit, nga më shumë se një në dy fëmijë midis moshave 3 dhe 5 vjeç në vitin 1990 në më pak se një në tre në vitin 2002. Arsyeja kryesore për regjistrimin e ulët në nivelin parashkollor duket se është mungesa e institucioneve parashkollore, numri i të cilave ka rënë me një të tretat gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Përqindjet e regjistrimit në shkollat e mesme janë të ulta dhe kanë rënë gjatë viteve të tranzicionit në rreth një të dytën e niveleve të vitit 1990. Përqindjet e regjistrimit në shkollat tetëvjeçare gjithashtu ndryshojnë shumë sipas të ardhurave dhe qarkut dhe regjistrimi neto në ciklin e lartë tetëvjeçar tek fëmijët e varfër është më pak se gjysma e përqindjes tek fëmijët jo të varfër. Nëpër qarqe, ndërkohë që 70 përqind e fëmijëve të grupmoshës respektive janë të regjistruar në Tiranë dhe afro 60 përqind në zonat e tjera qytetëse, vetëm një e katërta e fëmijëve të moshës së ciklit të lartë tetëvjeçar shkojnë në shkollë. Arsytet për mosvajtjen në shkollë në ciklin e lartë tetëvjeçar përsëri të jenë ekonomike dhe shumë nxënës e lënë shkollën për të punuar pasi kryejnë arsimin bazë.



Shpenzimet publike për arsimin kanë rënë në nivele që janë gati sa gjysma e atyre të vitit 1990. Ulja e shpenzimeve publike për arsimin është ekuilibruar me rritjen e shpenzimeve private, të cilat mesatarisht përfaqësojnë gati 1,4 përqind të shpenzimeve totale mujore për frymë të një familjeje (gati 2,5 përqind për familjet me nxënës). Familjet në kategoritë më të larta të shpërndarjes së të ardhurave paguajnë mesatarisht rreth 2,5 herë më shumë se ato që bien në brezin e familjeve të varfëra. Megjithatë, si një përqindje të shpenzimeve totale mujore, familjet e varfra paguajnë një përqindje të ngjashme ose edhe më të lartë të shpenzimeve totale familjare (megjithëse ky dallim nuk ka rëndësi nga ana statistikore). Pagesat nformale janë të përhapura dhe si në shkollat fillore ashtu edhe në ato tetëvjeçare më shumë se 40 përqind e nxënësve raportojnë se u bëjnë pagesa të tilla shkollës dhe mësuesve.

### **Përballimi i problemit të varfërisë; roli i transfertave sociale**

Mbrojtja sociale në Shqipëri sot konsiston në tre grupe kryesore programesh publike, plus transfertat private midis familjeve dhe brenda tyre. Programet publike konsistojnë në një sistem të gjerë të sigurimeve shoqërore, programet e mbështetjes sociale dhe politikat e tregut të punës. Më poshtë diskutohen më me hollësi këto programe.

Sistemi i sigurimeve shoqërore ofron një mbrojtje të gjerë kundra humbjes së të ardhurave për shkak të moshës së vjetër, paaftësisë, humbjes së një rrogëtari kryesor, vdekjes, papunësisë, sëmundjeve të përgjithshme, lëndimit në punë dhe sëmundjeve profesionale, lindjes së fëmijëve dhe lejet e lindjes. Programet e mbështetjes sociale konsistojnë në tre programe të mbështetjes sociale në para: një asistencë në para për të varfërit (e quajtur ndihma ekonomike, që ofron një përfitim për ato familje të cilat kanë shumë pak ose aspak të ardhura); një asistencë e rregullt në para çdo muaj për ata që kanë ngelur me paaftësi qysh fëmijë; dhe një kompensim për çmimet që u jepet pensionistëve dhe familjeve të tyre, dhe një program shërbimesh të kujdesit social për fëmijët e ngelur jetim, të paaftët dhe për personat e moshuar. Në një kuptim më të gjerë, programet aktuale të mbështetjes sociale kanë zëvendësuar një strategji të trashëguar të mbrojtjes sociale në të cilën njerëzit ishin të sigurtë që u garantohej punësimi me paga të ulta në kooperativa dhe ndërmarrje shtetërore, ndërkohë që një sistem i vendosjes së çmimeve brenda ekonomisë së mbyllur i mbante çmimet për mallrat kryesore të konsumit në nivele po aq të ulta.

Gjatë vitit 2002, mesatarisht në të gjitha familjet, transfertat publike përfaqësonin 21,3 përqind të të ardhurave familjare. Transfertat private përfaqësonin një tjetër 14,4 përqindësh. Kështu që së bashku, këto transferta të raportuara ofronin më shumë se një lek në tre. Kjo i bënte një burim edhe më të rëndësishëm të të ardhurave familjare, mesatarisht, sesa të ardhurat nga punësimi (31,5 përqind) ose bujqësia (25,0 përqind). Për popullsinë si e tërë, burimet e të ardhurave nga transfertat që ishin të rëndësishme nga ana sasiore si një pjesë e të ardhurave familjare (dmth ato që kontribonin më shumë se 2 përqind) konsistonin në të gjitha kategoritë e pensioneve [pensionet qytetëse të pleqërisë (10,5 përqind), pensionet fshatare të pleqërisë (3,8 përqind), dhe pensione të tjera (2,4 përqind)], Ndihma Ekonomike (3,1 përqind), dhe transferta nga të afërmit që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit (12,8 përqind). Shkurtimisht, kanë dominuar pensionet publike dhe transfertat private nga të afërmit shqiptar jashtë shtetit, ndërsa ndihma ekonomike ka kontribuar shumë më pak.

Midis të gjitha familjeve shqiptare, norma e përgjithshme e varfërisë prej 25,4 përqind në vitin 2002 do të kishte qënë 11,8 pikë përqindjeje më e lartë – dmth, 37,2 përqind – po të mos kishte pasur asnjë program të transfertave publike. Lidhur me këtë nivel më të lartë të nënkuptuar të varfërisë përpara transfertave publike, programet e mbështetjes sociale e kanë ulur numrin e familjeve të varfëra me gati një të tretat. Kontributet kryesore kanë ardhur nga pensionet qytetëse, fshatare, dhe pensionet e tjera si edhe ndihma ekonomike, sipas renditjes këtu. Programet e tjera të transfertave publike kanë dhënë kontribute modeste shtesë. Në mënyrë të ngjashme, norma e varfërisë së tejskajshme do të kishte qënë 11,2 përqind, 6,46 pikë përqindjeje më e lartë se norma aktuale prej 4,74 përqind. Kështu, lidhur me këtë nivel më të lartë të nënkuptuar të varfërisë së tejskajshme përpara transfertave publike, programet e mbështetjes sociale e kanë ulur numrin e familjeve tejet të varfëra me 58 përqind. Programet individuale kanë të njëjtën rëndësi

relative për të çuar në këtë ulje siç kanë bërë me normën e përgjithshme të varfërisë. Këto përllogaritje presupozojnë që të gjitha transfertat kanë shkuar 100 përqind për konsumin shtesë.

Transfertat nga jashtë përbëjnë një tipar dallues të skemës së transfertave në Shqipëri. Mesatarisht, një lek të ardhurash familjare nga tetë kanë ardhur nga ky burim. Megjithatë, mes 22 përqind të familjeve të marrin transfertat të tilla, shuma e tyre mesatare ishte 13.600 lekë në muaj. Kjo shumë është barazvlerëse me 47 përqind të të ardhurave mesatare familjare mujore në vend. Për më tepër, transfertat private nga jashtë shtetit kanë pasur më shumë gjasa të merren nga familjet jo të varfëra (23,5 përqind) sesa nga familjet e varfëra (16,8 përqind) ose familjet tejet të varfëra (10,1 përqind). Në mënyrë të ngjashme, kur janë marrë këto transfertat, kanë qënë mesatarisht thelbësisht më të mëdha për familjet jo të varfëra (14.400 Lekë në muaj) sesa për familjet e varfëra (8.900 Lekë në muaj) apo familjet tejet të varfëra (6.100 Lekë në muaj). Ky vëzhgim garantohet deri në shkallën që marrja e transfertave nga jashtë ka qënë në vetvete i mjaftueshëm për t'i nxjerrë familjet nga varfëria për t'i zhvendosur në brezat me të ardhura më të mëdha.

Nga familjet që marrin Ndhimë Ekonomike, 76 përqind kanë qënë të varfër dhe vetëm 24 përqind kanë qënë jo të varfër. Për më tepër, 43 përqind e të gjitha familjeve që marrin kontribute të Ndhimës Ekonomike kanë qënë në brezat më të ulët, të cilat përmbajnë katër nga pesë familje. 24 përqind të tjera kanë qënë në brezin e dytë, i cili përmban familjet e tjera të varfëra. Vetëm 12 përqind të përfituesve të ndihmës ekonomike kanë qënë në dy brezat e sipërm. Megjithatë, varfëria nuk ka siguruar përfitim nga ndihma ekonomike. Vetëm një e katërta e të gjitha familjeve të varfëra kanë marrë ndihmë ekonomike; dhe këto familje përfaqësojnë tre të katërtat e të gjitha familjeve që kanë përfituar nga ndihma. Plot 69 përqind e familjeve në varfëri të tejskajshme dhe 75 përqind e të gjitha familjeve nuk kanë marrë Ndhimë Ekonomike. (Disa prej tyre, sigurisht, ka të ngjarë të mos kenë plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, si psh titujt e pronave dhe përbërja familjare).

Pensionet dhe transfertat nga të afërmit shqiptarë janë burimet më të mëdha të të ardhurave nga transfertat. Pensionet qytetëse të pleqërisë janë marrë në mënyrë jo proporcionale nga dy brezat e sipërm; por 25 përqind familjet që janë të varfëra përfaqësojnë 37 përqind të përfituesve të pensioneve qytetëse. Pensionet fshatare të pleqërisë përfitojnë në mënyrë joproporcionale nga dy brezat më të ulët dhe të varfërit. Është e dukshme që familjet e varfëra marrin një pjesë më shumë se proporcionale nga secila formë e ndryshme e të ardhurave të transfertave të ekzaminuara.

### **Përballimi i problemit të varfërisë – Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm**

Migrimi është ndoshta fenomeni i vetëm politik, social dhe ekonomik më i rëndësishëm në Shqipërinë postkomuniste dhe ka qënë një fakt dominues në jetën e përditshme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Prej vitit 1990, përafërsisht një e pesta e popullsisë totale të vendit janë larguar për të jetuar jashtë shtetit dhe ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë nga zonat fshatare në ato qytetëse. Migrimi, qoftë në drejtim të zonave qytetëse dhe qoftë jashtë shtetit, në Itali apo Greqi, është ndoshta më i rëndësishmi mjet jetese për të luftuar varfërinë që përdoret nga familjet fshatare dhe shërben si një valvol e rëndësishme shkarkimi për papunësinë dhe probleme të tjera ekonomike. Përllogaritjet zyrtare i vlerësojnë transfertat nga jashtë si burimin kryesor të shkëmbimit valutor, më të madh sesa vlera e kombinuar e eksporteve dhe investimeve të huaja të drejtpërdrejta, që aktualisht përbëjnë 14 përqind të PBB.

Në dhjetëvjeçarin e fundit Shqipëria ka përjetuar një lëvizje demografike nga fshatare në qytetëse dhe nga malet verilindore në drejtim të rretheve të Bregut dhe të Tiranës. Tirana është destinacioni kryesor i migruerëve të brendshëm, një proces që duket se është përshpejtuar dhe është përqëndruar gjithnjë e më shumë në gjysmën e dytë të viteve 90. Migrimi në drejtim të Tiranës është më i ndjeshëm në drejtim të zonave më të varfëra periurbane, duke e forcuar rethin vicioz të varfërisë dhe duke shtuar presionin mbi shërbimet bashkiake që edhe kështu janë në limitet e tyre. Për më tepër, ka prova për një migrim vendor nga fshati në qytet brenda vetë rajonit verilindor. Nëse këto qëndra qytetëse janë vetëm një stacion i

ndërmjetëm gjatë rrugës për një migrim më të largët dhe më fitimprurës për këto familje, kjo mbetet e paqartë, megjithëse numri i madh i migruesve nga këto qendra provinciale qytetëse të veriut në drejtim të Tiranës sugjeron se në të vërtetë shumë prej tyre e vazhdojnë migrimin. Duke pasur parasysh edhe migrimin e brendshëm në drejtim të zonave qytetëse të Bregut si edhe migrimin vendor fshat-qytet, krijimi i mundësive ekonomike në zonat qytetëse përtej Tiranës do të mund të ndihmonte në krijimin e një rrjedhe më të qëndrueshme fshat-qytet, meqënëse Tirana është e vetmja që mbetet të luftojë problemin e strehimit dhe të shërbimit për numrin e madh e në rritje të migruesve që kanë mbushur lagjet e saj më të varfëra.

Pjesa më e madhe e migruesve të përkohshëm, kryesisht nga zonat fshatare të Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Verilindjes, udhëtojnë për në Greqi në kërkim të mundësive të punësimit afatshkurtër për të plotësuar të ardhurat e pakta që marrin nga aktivitetet bujqësore. Përkundër kostove të larta të transaksionit, gjatë viteve të fundit rrjedha e migruesve të përkohshëm në drejtim të destinacioneve më të largëta si psh Italia dhe Gjermania është rritur në mënyrë të dukshme. Të dhënat tregojnë se midis jomigruesve, një pjesë e madhe e ka shkuar ndër mend mundësinë e migrimit dhe shumë prej tyre e kanë provuar dhe nuk ia kanë dalë dot mbanë.

Rreth 458.000 shqiptarë jetojnë aktualisht jashtë kufijve të vendit të tyre. Informacionet nga Greqia dhe Italia, dy vendet kryesore ku shkojnë migruesit, e vlerësojnë numrin e banorëve të ligjshëm në këto vende afërsisht 600.000 gjatë 2000-2001, ose një e gjashta e popullsisë së Shqipërisë. Një shifër mbresëlënëse prej 35 përqind e fëmijëve të anëtarëve të familjeve jetojnë momentalisht jashtë shtetit. Për fëmijët që janë larguar nga shtëpia gjatë viteve 90, kjo pjesë arrin përmasat e një eksodi, ku raporti është një fëmijë nga dy jeton momentalisht jashtë shtetit. Numri i personave të varfër për familjet me fëmijë jashtë shtetit është dukshëm më i ulët (12-18 përqind, në varësi të destinacionit), nëse krahasohet me familjet me fëmijë në Shqipëri (31 përqind). Shuma e transfertave nga fëmijët që jetojnë jashtë shtetit përlllogarit të jetë mbi 200 milionë USD. Gati një e dyta e familjeve shqiptare kanë mundësi lidhjeje me rrjetet e migrimit, qoftë përmes migrimit të drejtpërdrejtë të bërë prej një anëtari të familjes, qoftë përmes fëmijëve të tyre që jetojnë jashtë shtetit. Ka më shumë gjasa që kjo të jetë një nënvlerësim i situatës reale dhe është e krahaseshme me një vend si Meksika, vend i cili ka një traditë dhe përvojë migrimi njëqindvjeçare, krahasuar vetëm me një periudhë prej diçka më shumë se dhjetë vjet për Shqipërinë.

Megjithatë, migrimi është një thikë me dy presa dhe ndërkohë që në të shkuarën migrimi për të lëvizur nga zonat fshatare ka qënë perceptuar si një zgjidhje e mundshme për problemin e varfërisë fshatare në Shqipëri, ajo ka dhënë gjithashtu kontributin e vet në zhvendosjet sociale, shkurtimin e krahut bujqësor të punës dhe përkeqësimin e vullshëm të cilësisë së shërbimeve në zonat qytetëse. Për më tepër, migrimi i madh i ligjshëm dhe i paligjshëm i shqiptarëve në vendet e tjera të Europës përbën një sfidë të rëndësishme politike dhe sociale për qeveritë dhe qytetarët e Bashkimit Europian. Ligje më të rrepta për migrimin, kostot e rritura dhe rreziqet e shoqëruara gjithashtu e bëjnë migrimin një zgjidhje më pak ekonomike, sidomos për familjet me mundësi më të pakta. Dhe së fundmi, megjithëse migrimi dhe transfertat që vijnë prej tij kanë gjasa të vazhdojnë të jenë një përbërës i domosdoshëm i recetës shqiptare për zhvillimin fshatar, nevoja dhe domosdoshmëria për të hartuar strategji më të përshtatshme dhe të qëndrueshme për të nxjerrë familjet fshatare nga varfëria dhe për të nxitur rritjen e vendit janë më aktuale se kurrë.

### **Zonat periurbane**

Zonat periurbane shtrihen në periferi të qendrave qytetëse dhe shpesh gjenden ose mbi ose pranë burimeve me ujë (lumenj, përronj, puse). Këto zona përbëhen kryesisht nga qendra banimi dhe struktura informale dhe shpesh nuk kanë lidhje me rrjetet e shërbimeve bazë (ujësjellës, energji, kanalizime). Shumica e banorëve në zonat periurbane kanë ardhur rishitazi nga zona të tjera të Shqipërisë duke migruar në drejtim të qendrave qytetëse me shpresë për një vend pune dhe një jetë më të mirë për veten dhe familjen e tyre. Duke qënë kështu, popullsia e zonave periurbane është e paqëndrueshme dhe e vështirë

për t'u monitoruar. Shpeshherë këta banorë kanë migruar nga zona të tjera të Shqipërisë në masë dhe kanë përfunduar në bashkësi që cilat pasqyrojnë bashkësitë e vendndodhjes së tyre të mëparshme dhe përbëhen kryesisht nga familje të mëdha (bashkëjetesë në fis – *shën i përkth*).

Një problem i madh në zonat periurbane është mungesa e shërbimeve bazë. Kryesisht mes këtyre është paaftësia e qeverisë për të ofruar ujë të rrjedhshëm për shumë familje. Shumë familje janë të detyruara ta marrin ujin që përdorin nga ndonjë pus i afërt ose nga ndonjë burim uji të rrjedhshëm që nuk ndodhet pranë vendbanimit të tyre. Për shkak të një mungese korresponduese të sistemeve të heqjes së mbeturinave në këto zona periurbane, shumë familje e marrin ujin që përdorin në burime që ndodhen pranë vendeve ku hedhin mbeturinat e tyre (qoftë ujra të zeza ashtu edhe plehra). Shumë prej të njëjtave probleme qëndrojnë edhe për sigurimin e shërbimeve të energjisë elektrike. Shumë vendbanime janë të lidhura me tela elektrike, por shumica tregojnë se shërbimi është me shpëputje (rasti më i mirë) dhe se energjia elektrike është e pamjaftueshme për të përdorur pajisjet bazë elektroshtëpiake.

Familjet që zhvendosen në drejtim të zonave qytetëse kanë shërbyer vetëm për t'i mbipopulluar sistemet arsimore që edhe pa to kanë qënë të pamjaftueshme. Numri i nxënësve për klasë është rritur në mënyrë drastike në zonat periurbane dhe shumë shkolla kanë filluar të operojnë me turne (një grup klasash gjysmën e ditës, ndërsa gjysmën tjetër një grup tjetër klasash) duke u përpjekur të lehtësojnë ngarkesën e mësuesve dhe ambienteve. Kjo ka çuar që shumë nxënës të vijnë në shkollë vetëm disa orë çdo ditë. Mundësitë e përdorimit të shërbimeve shëndetsore në zonat periurbane është shumë e kufizuar dhe në zonat periurbane të Tiranës nuk ka ende një rrjet qendrash shëndetsore që do të përputheshin me numrin e banorëve.

### **Transporti dhe infrastruktura**

Nevoja për të përmirësuar transportin dhe infrastrukturën rrugore është më se aktuale. Siç është përmendur më lart, ka dallime të rëndësishme në nivelet e varfërisë mes qarqeve dhe mes dimensioneve fshatare-qytetëse, ku qarqet malore janë gjithnjë më të varfëra se pjesa tjetër e vendit sipas të gjitha përkufizimeve të varfërisë. Në këtë gjëndje, përmirësimi i mundësisë për të përdorur inputet bujqësore, përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale dhe ulja e izolimit nëpër të gjitha dimensionet do të kërkonte se s'bën një përmirësim të ndjeshëm të transporteve. Gjithashtu, duke pasur parasysh që rritja e sektorit të prodhimit është thelbësore për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe investimet në të gjithë nënsektorët prodhues kandidatë mbështetet në lidhje të qëndrueshme transporti për lëvizjen e materialeve të para dhe mallrave, përtej kufijve dhe brenda vendit, është domosdoshmëri që transporti dhe infrastruktura rrugore të fuqizohen. Po kështu, përfitimi nga afërsia me shërbimet ekzistuese të shëndetsisë dhe arimit brenda zonave të tanishme qytetëse mund të zgjerohet deri në zonat periurbane përmes infrastrukturës rrugore bazë që funksionon në të gjitha kushtet e motit. Duke pasur parasysh vëllimin e madh të migrimit nga zonat fshatare, përmirësimi i rrugëve mund të ishte më i parapëlqyer se ndërtimi i objekteve të reja të shërbimieve publike në zonat periurbane dhe fshatare.

### **Strategjitë e uljes së varfërisë**

Një fushë që garanton përparësinë është krijimi i vendeve të reja të punës, meqenëse ekziston një lidhje e fortë midis papunësisë dhe varfërisë. Çështja predominuese e tregut të punës dhe varfërisë në Shqipëri është si të merremi me problemin e trepricës së madhe të ofertës së krahut të punës, duke pasur parasysh mekanizmat e kufizuar të tregut. Qeveria nuk ka më mundësi të mbajë të fryrë në mënyrë artificiale kërkesën për krah pune dhe mekanizmat e krijuar rishtazi të tregut janë tepër të dobët për të neutralizuar humbjet e vendeve të punës. Oferta e tepërt e krahut të punës ka shkaktuar norma të larta të papunësisë, papunësi të fshehur dhe në përgjithësi një sektor informal minimalist. Si rrjedhim, segmente të mëdha të krahut të punës, si psh të rinjtë, të sapodiplomuarit, femrat dhe ata që janë në prag të moshës së pensionit nuk marrin pjesë në tregun e punës. SKZHES e miratuar kohët e fundit e konsideron zhvillimin e tregut të punës dhe nxitjen e punësimit si njërin prej prebërësve kryesorë të politikave për uljen e varfërisë. Ky dokument parashikon përgatitjen e një legjislacioni përkatës për tregun e punës për të siguruar ofrimin e

kualifikimit profesional dhe zhvillimin e krahut të punës, formalizimin e tregut të punës dhe nxitjen e punësimit.

Një parakusht për suksesshmërinë e çdo lloj programi për tregun e punës është një mjedis i favorshëm biznesi dhe një treg pune arsyeshmërisht fleksibël. Zhvillimi i sektorit privat është kritik për mbështetjen e rritjes ekonomike në Shqipëri dhe sigurimin e punësimit. Si rrjedhim, krijimi i një mjedisi biznesi të favorshëm për rritjen e sektorit privat duhet të jetë një përparësi e qeverisë, e cila lipset të marrë masa për të shndërruar bizneset informale në biznese formale, për të rritur nivelin e konkurrencës së ekonomisë, për të fuqizuar kuadrin ligjor dhe institucional dhe për të inkurajuar futjen e kapitalit në ekonomi.

Një studim i realizuar kohët e fundit në lidhje me klimën e investimeve në Shqipëri ka nxjerrë në pah pengesat burokratike, zbatimin e dobët të ligjit dhe korrupsionin e fuqishëm si pengesa kryesore për rritjen e investimeve private dhe e vë theksin tek nevoja për heqjen e barrierave administrative si një zgjidhje kyçe për inkurajimin e investimeve të reja. Ky studim ka zbuluar se procedurat e investimit në Shqipëri kanë të meta serioze dhe karakterizohen nga mbindërlíkueshmëria, mungesa e qartësisë dhe transparencës dhe trajtimi i keq i investuesve. Bizneset private përballen me vonesa burokratike, trajtim arbitrar dhe sipas qejfit dhe kosto të larta, duke përfshirë edhe “pagesat jozyrtare”, të cilat të gjitha së bashku rrisin kostot e investimit.

Në praktikë, qeveria lipset të marrë masa për të hequr kufizimet ekzistuese në drejtim të krijimit dhe rritjes së firmave. Shumica e pengesave të zakonshme ndaj biznesit privat në Shqipëri kanë korrupsioni, zbatimin e dobët të ligjit, të drejtat të pasigurta mbi pronën, pengesa burokratike ndaj firmave të vogla (kontrolle të shpeshta, revizionime të shpeshta, etj.) dhe procedura të tjera të stërgjatura administrative dhe regullatore.

Ashtu sikurse ekonomitë e tjera në tranzicion, Shqipëria ka trashëguar institucione dhe rregullore të tregut të punës të zhvilluara brenda ekonomisë së centralizuar, të cilat kanë dalë se nuk janë të përshtatshme për nevojat e ekonomisë së tregut. Kjo trashëgimi rregulloresh të rrepta e ka penguar shumë performancën e tregut të punës në vend. Reformat e tregut të punës në Shqipëri duhet (a) të përmirësojnë fleksibilitetin e punësimit përmes zvogëlimit të kostove të heqjes nga puna (psh duke ulur pagesën kompensuese që i jepet punonjësit për zgjidhjen e kontratës së punës, futja e kontratave të punësimit të përkohshëm); (b) të përmirësojë fleksibilitetin e orarit të punës (psh përmes parashikimit të rirregullimit të orarit të punës); (c) të rrisë fleksibilitetin e pagave (psh përmes eliminimit të skemave rixhide të pagave); dhe (d) të ulë disa prej përfitimeve që nuk jepen me para në dorë. Në të njëjtën kohë me derregullimin e marrëdhëneve të krahut të punës reformat duhet të mbështesin delegimin e pushtetit të tyre përmes pjesëmarrjes së rritur të bashkimeve profesionale dhe organizatave të punëdhënësve në bisedimet kolektive për pagat.

Rezultatet e kësaj analize e vënë gishtin tek tre fusha që kanë përparësi për politikëbërësit që janë të interesuar për të përmirësuar mundësinë përdorimit të shërbimeve të kujdesit shëndetsor dhe rritjen e efektivitetit të tyre. Së pari, mbulimi me siguracione shëndetësore duhet të rritet, si përsa i takon numrit të personave të mbuluar ashtu edhe numrit të shërbimeve që ofrohen nga mbulimi. Siguracioni shëndetsor jo vetëm që është i rëndësishëm si një burim financimi për këtë sektor por ofron edhe mbrojtje financiare për të siguruarit nga shpenzimet shëndetsore katastrofike. Në veçanti, të varfërit dhe grupet më të brishta të popullsisë, të cilët janë të ekspozuar ndaj rrezikut të prekjes nga varfëria për shkak të një rasti të vetëm sëmundjeje, duhet të mbulohen nga sigurimet shëndetsore. Në fakt, edhe pse të varfërit dhe të brishtet janë ata që kanë më shumë gjasa të mbulohen nga sigurimet shëndetsore tani për tani, prapëseprapë mbeten grupe të mëdha të varfërish apo të brishtësh të cilët në të vërtetë nuk janë të mbuluar. Gjithashtu, sigurimet shëndetsore mbulojnë vetëm shërbimet e ofruara nga mjeku i përgjithshëm ose mjeku i familjes dhe nuk ofrojnë asnjë lloj mbrojtjeje kundër shpenzimeve shëndetsore katastrofike. Në Tiranë, sigurimet shëndetsore mbulojnë të gjithë kujdesin shëndetsor jospitalor dhe nuk është çudi që banorët e këtij qarku

shpenzojnë më pak për kujdesin jospitalor krahasur me pjesën tjetër të popullsisë në vend. Në të vërtetë, ka shumë vend për të rritur numrin e shërbimeve të ofruara.

Një fushë tjetër që ka nevojë për vëmendje të menjëhershme është ajo e pagesave informale, zhdukja e të cilave do të kishte ndikime pozitive për mundësinë e përfitimit nga shërbimet shëndetsore. Pagesat informale në kujdesin jospitalor përfaqësojnë rreth 11 përqind të shpenzimeve totale, në kontrast me kujdesin spitalor, ku ato përfaqësojnë afro 25 përqind të shpenzimeve totale. Mesatarisht, shqiptarët shpenzojnë pothuajse 700 lekë për frymë në muaj për kujdesin shëndetsor, çka është e barabartë me rreth 18 përqind të konsumit mesatar për frymë të një familjeje të varfër. Megjithatë, ka dallime të mëdha përsa i përket shumave që shpenzojnë familjet e brezave të ndryshëm të konsumit. Familjet që i përkasit një të pestës më të varfër të shpërndarjes së konsumit shpenzojnë mesatarisht rreth një të dytën e asaj që shpenzojnë për shëndetin familjet që përbëjnë një të pestën më të pasur. Si përqindje e konsumit total, familjet që përbëjnë një të pestën më të varfër të shpërndarjes së të ardhurave shpenzojnë pothuajse 10 përqind të konsumit të tyre mujor për frymë për shëndetin. Përveç rritjes së barrës së shpenzimeve nga xhepi për shëndetin, sidomos për të varfërit, pagesat informale i pengojnë seriozisht të gjitha përpjekjet për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e këtij sektori.

Evidenca gojore gjithashtu tregon se cilësia e kujdesit ka rënë, sidomos ajo e kujdesit jospitalor jashtë Tiranës, ku një numër i madh njerëzish preferojnë ti anashkalojnë këto shërbime dhe t'i drejtohen spitaleve drejtpërdrejt. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit jospitalor është i nevojshëm për të rritur fushën dhe përdorimin shërbimeve shëndetsore, në mënyrë që ato të mund të përdoren jo vetëm sa për të marrë receta.

Përsa i takon arsimin, duhet të rritet pjesëmarrja në ciklin e shkollave të mesme dhe të përmirësohet cilësia e arsimit në këtë nivel. Shkollat e mesme duhet të ofrojnë aftësi praktike dhe kualifikim sipas nevojave të tregut, duke e vënë theksin tek fleksibiliteti, përshtatshmëria dhe aftësitë praktike analitike duke shmangur programet e hartuara në mënyrë rixhide. Duhet të futen programet e reja profesionale, në përputhje me kërkesën potenciale për krah pune të specializuar, për të përgatitur nxënës për tregun e punës. Nevojiten sidomos programe të reja për shkollat e mesme në zonat fshatare, ku mungesa e këtyre programeve është njëri prej shkaqeve kryesore të pjesëmarrjes së vogël të nxënësve në shkollë.

Një fushë tjetër që ka nevojë për vëmendje të menjëhershme është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës bazë, duke përfshirë edhe mundësinë për të përdorur shërbime cilësore shëndetsore dhe arsimore si edhe shërbime bazë të kanalizimeve. Ka gjasa që për shumë familje përjashtimi social, mungesa e mundësisë për të përdorur shërbimet dhe infrastrukturën bazë dhe arsimin e mesëm dhe atë më të lartë janë faktorë që pengojnë aftësinë e tyre për të dalë mbi kufirin e varfërisë. Qeveria ka premtuar të bëjë përpjekje të reja në drejtim të përmirësimeve të infrastrukturës publike, sidomos përsa i përket afrimit të tyre tek më të varfërit dhe është e domosdoshme që këto përpjekje të fokusohen tek qarqet fshatare dhe ato të largëta ku janë evidentuar edhe kushtet më të këqija të shërbimeve bazë.

Meqënëse një numër i madh të varfërish jetojnë në zonat e fshatare, është e domosdoshme që qeveria të hartojë një strategji për zhvillimin e zonave fshatare e cila të fokusohet tek ulja e varërisë në periudhën afatshkurtër. Një pjesë e madhe e popullsisë merret me bujqësi, por madhësitë e fermave, në shumë raste, janë tepër të vogla për të ofruar mundësi tregtare apo qoftë edhe për t'i ofruar një familjeje mundësinë për t'iu larguar varfërisë. Meqënëse sektori bujqësor ofron pjesën më të madhe të të ardhurave për të varfërit fshatarë, marrja me faktorët e zhvillimit të këtij sektori duhet të jetë një përbërës i çdo përzierje politikash që ka si synim uljen e varfërisë fshatare.

Bujqësia është aktiviteti kryesor që sjell të ardhura në zonat fshatare dhe madje edhe familjet më të pasura mbështeten shumë tek bujqësia si burim kryesor për të ardhurat e tyre. Shitjet e gjësë së gjallë janë më të rëndësishmet për familjet e varfëra dhe familjet që jetojnë në zonat malore. Masat për të ofruar mundësinë

për një përpunim më të mirë në shkallë të vogël do të mund të ndihmonin të varfërit dhe fermerët më të izoluar dhe do të rrisnin të ardhurat e tyre nga gjëja e gjallë.

Një shërbim fleksibël dhe i përshtatur sipas zonës do të bënte shumë për të përmirësuar modelet aktuale të prodhimit. Fermerët më të varfër kanë kosto më të larta dhe më pak të ardhura. Ata nuk janë shumë të diversifikuar dhe prirjen të merren më pak me përpunim. Të gjitha këto çështje mund të zgjidhen përmes shërbimeve të përhapura të cilat marrin parasysh kushtet vendore dhe i këshillojnë fermerët sipas mundësive të tregut. Cilësia dhe sasi e rritura do të mund të përdoren nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat nisin aktivitetet përpunimi në zonat fshatare dhe mund të jenë kështu një mundësi zgjidhjeje për fermerët e varfër.

Përsa i takon rritjes në të ardhmen, vëmendja duhet të kalojë medoemos në drejtim të sektorit prodhues, i cili aktualisht jep vetëm 11,6 përqind të PBB në vend dhe punëson vetëm 4 përqind të krahut të punës në vend, duke qënë punëdhënësi i katërt për nga madhësia, pas bujqësisë, tregtisë së vogël dhe riparimeve dhe ndërtimit. Sektorit i bujqësisë punëson më shumë se një të dytën e krahut të punës, por shumica janë të paftësuar ose pak të aftësuar dhe mbi 15 përqind janë të punësuar me orar të pjesshëm. Nuk kuptohet mirë shtrirja e punësimit të maskuar në bujqësi, por ekziston gjithmonë mundësia që bashkimi i ngastrave dhe teknologjia do të mund të nxirrin një numër të madh të personave të paftësuar nga sektori i bujqësisë. Siç qëndrojnë gjërat tani, migrimi është duke dërguar në mënyrë efektive një numër të madh personash nga zonat fshatare në zonat qytetëse dhe periurbane të vendit. Punësimi në ndërtim është që tani shumë i lartë. Në të njëjtën kohë, ekziston një kufi përse i takon shtrirjes së aktiviteteve të ndërtimit që priten të rriten dhe nuk duket se ka gjasa që sektori i ndërtimit të shërbejë si një katalizator për krijimin e aktiviteteve të reja për gjenerimin e të ardhurave.

Nxijtja e sektorit të prodhimit do të mund të krijonte disa mundësi punësimi. Brenda sektorit të prodhimit, ekzistojnë disa industri që do të mund të ofronin mundësi të ndryshme punësimi dhe do të ishte e mundur që synoheshin industritë me potencialin më të madh të rritjes. Kini parasysh, për shembull, prodhimin e tekstileve, i cili është punësuesi më i madh brenda sektorit të prodhimit, por që ka nga ana tjetër rrogat më të ulta. Një sektor tjetër është ai i prodhimeve të lëkurës, po të kemi parasysh afërsinë e Shqipërisë me Italinë dhe njohurinë e përgjithshme të gjuhës italiane, e kombinuar kjo me prirjet e fundit në prodhimin e shpërndarë (procese të ndryshme të prodhimit të realizuara në vende të ndryshme – *shën i përkt*), mund t'i ofronin Shqipërisë mundësinë për të kaluar me lehtësi në drejtim të prodhimit. Kjo do të hapte mundësi intriguose, dhe do të ishte një fushë që ka nevojë të eksplorohej me imtësi.

Një fushë tjetër që meriton vëmendje më të madhe është turizmi. Shqipëria është një vend me bukuri të mëdha natyrore, me male në veri dhe detin në perëndim. Në të njëjtën kohë, Shqipëria është afër me Greqinë dhe Italinë, vende të cilat tërheqin shumë turistë nga Europa dhe vende të tjera. Zhvillimi i turizmit brenda vetë Shqipërisë prezantohet si një mundësi interesante, një mundësi që lipset të eksplorohej dhe të shfrytëzohet me më shumë agresivitet.

Nuk ka dyshim që programet e shumta të qeverisë të evidentuara më lart do të çonin në përfitime më të larta për shtetasit, por duhet të pranohen nga ana tjetër edhe kufizimet e burimeve. Megjithatë, po të kemi parasysh kufizimet e përgjithshme të financimit qoftë edhe për programet ekzistuese, nuk është shumë e qartë se si do të mund të financoheshin programet e reja. Kjo e bën edhe më të vështirë detyrën e uljes së varfërisë dhe nënvizon nevojën për një kuptim më të mirë të kompromiseve mes zërave të ndryshëm të shpenzimeve qeveritare.

## KREU I: HYRJJE

### 1. Pak histori: përse ky vlerësim i varfërisë për Shqipërinë?

Shqipëria i është nënshtruar një procesi ndryshimesh të mëdha ekonomike dhe sociale gjatë dhjetë vjetëve të fundit, pas rënies së rregjimit komunist. Në frontin ekonomik, menjëherë pas një tkurrjeje të madhe gjatë viteve të para të tranzicionit (1991-92), PBB u rrit me rreth 9 përqind në vit në terma realë midis viteve 1993 dhe 1996, kohë gjatë së cilës inflacioni u ul në mënyrë thelbësore dhe si gjendja e llogarisë rrjedhëse ashtu edhe defiqiti fiskal u përmirësuan në mënyrë të dukshme. Megjithatë, me rënien e skemave të mëdha piramidale në vitin 1997 edhe rritja ekonomike kaloi në shifra negative, duke shënuar një rritje negative prej 7 përqind në terma reale në vitin 1997. Nga qeveria u nis një program rimëkëmbjeje menjëherë pas pasojave të krizës, program i cili dha rezultate të shpejta dhe ekonomia u rikthye si më parë me një normë rritjeje prej 7 përqind në tre vjetët që pasuan. Gjatë vitit 1999, influksi i rrefugjatëve kosovarë ushtroi një presion të madh mbi mundësitë ekonomike dhe administrative të Shqipërisë. Megjithatë, ekonomia ia doli mbanë ta përballojë këtë gjendje të vështirë me mbështetjen e fuqishme të bashkësisë së donatorëve. Nga fundi i viteve 90, Shqipëria pati arritur nivelin e PBB që kish pasur në vitin 1990, inflacioni ishte nën kontrol dhe llogaria rrjedhëse dhe defiqiti fiskal i mbuluar nga brenda qenë përmirësuar në mënyrë të dukshme.<sup>1</sup>

Treguesit e mirë makroekonomikë vazhduan edhe gjatë vitit 2000 dhe PBB shënoi një rritje prej 7,3 përqind gjatë atij viti. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2001 rritja e PBB ra disi, kryesisht për shkak të kufizimeve të furnizimit me energji elektrike dhe ngadalësimit të ekonomisë botërore pas 11 shtatorit. Ky ngadalësim vazhdoi edhe gjatë vitit 2002 dhe rritja e PBB ra në 4,7 përqind për shkak të rënies së investimeve publike, vazhdimit të krizës energjitike, situatës së paqartë politike dhe një ngadalësimi të reformave, sidomos të reformës së privatizimit të ndërmarrjeve.<sup>2</sup> Faktorët e kostove të rritura ushtruan një presion nga poshtë-lart mbi çmimet qysh nga mesi i vitit 2001 dhe inflacioni mesatar, i cili ishte 3,1 përqind gjatë vitit 2001, u rrit në 5,4 përqind gjatë vitit 2002 për shkak të çmimeve më të larta të lëndëve djegëse dhe të disa artikujve ushqimorë. Inflacioni ra në 3 përqind gjatë viti 2003 dhe pritet të qëndrojë në të njëjtin nivel gjatë gjithë vitit. Edhe rritja pritet të rikthehet në rreth 6 përqind për vitin 2003.

Gjithashtu qysh nga fundi i viteve 90 janë kryer disa reforma strukturore, ndërmjet të tjerash në sektorin bankar, reformat e tokës dhe privatizimin. Pothuajse të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë privatizuar dhe është bërë një ecuri e dukshme me privatizimin e sektorëve strategjikë, si psh telekomunikacionet. Rregullimi i sektorit financiar si edhe i funksioneve të rëndësishme thelbësore të sektorit publik është fuqizuar dhe qeveria ka miratuar një ligj të ri mbi falimentimin dhe një skemë të sigurimit të depozitave. Është krijuar rregjistri i pasurive të luajtshme dhe është shënuar ecuri në zhvillimin e një tregu të tokës. Janë ndërmarrë gjithashtu hapa të dukshëm në fushën e administrimit publik: është miratuar një ligj i gjerë mbi shërbimin civil; është zhvilluar një strukturë pagash; është vendosur një program buxhetor afatmesëm; janë

---

<sup>1</sup> Për një trajtim të hollësishëm të ekonomisë shqiptare gjatë viteve të para të tranzicionit shih “*Shqipëria përtej krizës*,” Memorandumi Ekonomik i Vëndit (CEM), dhjetor 1998. “Shpenzimet Publike dhe Rishikimi Insitucional”, prill 2001, merret me zhvillimet më të fundit fiskale në ekonomi.

<sup>2</sup> Shifrat e PBB të Shqipërisë duhet të merren me rezerva; ato nuk mbështeten në asnjë llogari kombëtare dhe nuk ka të dhëna të besueshme në lidhje me aktivitetin e sektorit privat. Qeveria ka ndryshuar kohët e fundit metodikën e saj për llogaritjen e PBB, dhe ndërkohë që prodhimi bujqësor përllogaritet drejtpërdrejt, rritja e sektorëve të tjerë matet në bazë të një indeksi të ri të çmimeve, të cilit i shtohen edhe treguesit spcifikë për sektorë të ndryshëm (psh energjia elektrike).



fuqizuar kapacitetet ligjore dhe gjyqësore; janë shtrënguar rregullat e llogaridhënies; si edhe është rishikuar dhe është duke u zbatuar plan-veprimi antikorrupsion.

Përkundër ecurisë mbresëlënëse të ekonomisë, prapëseprapë, varfëria në Shqipëri ka mbetur në nivele të larta dhe të ardhurat për frymë, rreth 1,230 USD gjatë vitit 2002, kanë mbetur më të ultat midis vendeve në tranzicion. Pjesërisht si një pasqyrim i kushteve të vështira në Shqipëri në fillim të tranzicionit dhe pjesërisht si një pasqyrim i rënies së hershme ekonomike të vitit 1991 dhe të trazirave civile të vitit 1997, të ardhurat për frymë nuk kanë shënuar ndonjë rritje pozitive edhe pse ekonomia ka shënuar norma të larta rritjeje prej 9 përqind në vit gjatë periudhës 1993-96 dhe 7 përqind gjatë periudhës 1998-2001.

Në një përpjekje për të miratuar politika dhe masa për t'i shpërndarë gjerësisht përfitimet që vijnë nga rritja ekonomike dhe ulja e varfërisë, qeveria e Shqipërisë ka hartuar një strategji për zbutjen e varfërisë në formën e Dokumentit të Ndërmjetëm të Strategjisë për Uljen e Varfërisë (2000), të cilën e zhvilloi pas dy vjetësh me më shumë hollësi në Strategjinë e Rritjes Ekonomike dhe Uljes së Varfërisë (SREUV), pasardhëse e së cilës është dokumenti aktual, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES). SKZHES është një program i gjerë i cili ka si synim zgjidhjen e problemit të varfërisë përmes reformave sistematike të cilat përfshijnë krijimin e një mjedisi biznesi të orientuar nga rritja, që do të thithë investimet dhe do të krijojë vende pune për të varfërit, përmirësimin e kapitalit njerëzor përmes përmirësimit të cilësisë dhe mundësisë për të përdorur shërbimet sociale si psh shëndetësia dhe arsimit, dhe fuqizimin e të varfërve përmes llogaridhënies më të fortë publike dhe pjesëmarrjes së rritur në vendimmarrje. Kjo strategji nënvizon rëndësinë e arritjes së qëndrueshmërisë makroekonomike dhe të arritjes së një rrjeti adekuat mbrojtjeje sociale si parakushte për rritjen ekonomike dhe uljen të varfërisë. Përveç dhënies përparësi arsimit, shëndetësisë, mbështetjes sociale, mirëqeverisjes dhe infrastrukturës, objektivat e vendosur nga SKZHES janë: (i) të rritet PBB reale me 25 përqind; (ii) të ulët numri i njerëzve që jetojnë në varfëri; (iii) të përmirësohen infrastrukturat e ujësjellësave, kanalizimeve dhe energjisë; (iv) të ulen normat e vdekshmërisë foshnjore dhe të nënave dhe përqindja e sëmundshmërisë; dhe (v) të rriten normat e frekuentimit të arsimit fillor dhe të mesëm si edhe vjetët mesatarë të arsimit. Së fundmi, dhe duke pasur parasysh fushën e gjerë të problematikës së qeverisë, SKZHES gjithashtu nënvizon rëndësinë e monitorimit dhe analizës së zbatimit të saj.

Sidoqoftë, në fazat e para të hartimit SKZHES – apo SREUV, siç quhej atëherë – u kufizua nga mungesa e të dhënave të varfërisë dhe ndërkohë që përdori mirë informacionet ekzistuese sasiore dhe cilësore, nuk kishte në dispozicion të saj një vlerësim të saktë dhe të plotë të varfërisë. Problemet ndërlikoheshin edhe më, për shkak të rritjes prej 10 përqind të popullsisë (qysh prej rregjistrimit të fundit të popullsisë) që kishte ndodhur në Shqipëri gjatë dhjetë vjetëve të fundit, e shoqëruar kjo edhe me zhvendosje të mëdha të popullsisë nga zonat fshatare në ato periurbane, çka çuan të gjitha në ndryshime gjigande ekonomike, demografike dhe sociale. Përlllogaritja sasiore dhe analiza e varfërisë në Shqipëri u pranuan si një domosdoshmëri e ngutshme që ishte e nevojshme qoftë për të dokumentuar gjerësisht gjëndjen e varfërisë qoftë për të ndërtuar një përgjigje të arsyeshme për këtë problem.

Duke pranuar kufizimet e të dhënave, SREUV e ndihmoi qeverinë që, *inter alia*, të plotësonte ranudin e parë të një programi pesëvjeçar të Matjes së Standarteve të Jetesës (LSMS) gjatë vitit 2002 dhe të kryente një rregjistrim të popullsisë në vitin 2001, të cilat ofruan zberthime të të dhënave sipas moshës dhe qarqeve. Ky studim dha një informacion të vlefshëm mbi një shumëllojshmëri çështjesh që kanë lidhje me kushtet e jetesës të njerëzve në Shqipëri, duke përfshirë edhe hollësi mbi dimensionet e varfërisë që kanë lidhje me të ardhurat dhe ato dimensionet që nuk lidhen me të ardhurat dhe formon bazën kryesore të këtij vlerësimi të varfërisë në Shqipëri. Si prioritet të parë, u përlllogaritën shifrat e hollësishme të varfërisë dhe u ngrit një

profil i varfërisë, të cilat janë përdorur gjerësisht qysh atëherë për të pasur një informacion të saktë dhe të plotë për hartimin e mëtejshëm të SKZHES. Ky vlerësi i tanishëm i varfërisë e çon analizën edhe një hap më tutje dhe trajton më me hollësi një sërë çështjesh kryesore.

IDA ka ndihmuar në zbatimin e SKZHES përmes veprimeve programatike. Kredia në Mbështetje të Uljes së Varfërisë I (PRSC-I) ishte i pari veprim i tillë me synimin për të mbështetur fazën e parë të strategjisë. Kjo është ndjekur nga Kredia në Mbështetje të Uljes së Varfërisë II (PRSC-II), veprimi i dytë programatik, e cila vazhdon të mbështesë qeverinë shqiptare për problematikën e saj të reformatve. Një veprim i tretë programatik, PRSC-III, është duke u përgatitur.

SKZHES dhe PRSC-I kanë shënuar një sukses mbresëlënës në një sërë frontesh. Së pari, Shqipëria ka ruajtur një kuadër të kënaqshëm makro; qysh nga viti 1997 ekonomia është në rritje dhe inflacioni është mbajtur nën kontroll. Së dyti, është krijuar një program reforme për pensionet; kjo reformë ka si synim të ulë deficietin e pensioneve në 1,2 përqind të PBB në vit. Së treti, strategjia ka forcuar kapacitetet e qeverisë për monitorim dhe vlerësim; janë kryer një regjistrim i popullsisë dhe raundi i parë i Matjes së Standarteve të Jetesës, rezultatet e të cilave janë duke u analizuar. Dhe së katërti, janë fuqizuar llogaridhënia dhe transparenca e sektorit publik.

Faza e dytë e Strategjisë Shqiptare për Uljen e Varfërisë sapo ka filluar. SKZHES do të vazhdojë ta vërë theksin tek ofrimi i shërbimeve sociale dhe monitorimi dhe vlerësimi i politikave. Kjo fazë e re do të thellojë gjithashtu fokusin e saj tek zhvillimi i sektorit fshatar dhe privat. Po kështu, PRSC-II është ndërtuar rreth përbërësve të mëposhtëm: (i) nxitja e rritjes së qëndrueshme dhe mbështetja e zhvillimit të sektorit privat; (ii) forcimi i kapaciteteve të qeverisë për të monitoruar dhe vlerësuar problematikën e politikave; (iii) përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe efektivitetit të rrjetit social; dhe (iv) përmirësimi i funksioneve thelbësore publike dhe organizimit institucional.

Pjesa tjetër e këtij kapitulli është organizuar si më poshtë. Seksioni 2 paraqet kuadrin makroekonomik dhe ofron një ide të përgjithshme të ecurisë ekonomike dhe parashikimit makroekonomik. Seksioni 3 diskuton matjen e varfërisë në Shqipëri dhe jep një histori të shkurtër mbi përpjekjet e mëparshme. Seksioni 4 ofron një pamje të përgjithshme për kapitujt e tjerë të këtij vlerësimi të varfërisë.

## 2. Konteksti ekonomik

Ecuria ekonomike ka qënë e fortë gjatë pesë vjetëve të fundit, sidomos pas krizës së vitit 1997 dhe rritja ka qënë mesatarisht rreth 7 përqind çdo vit. Siç e tregon edhe tabela 1.1, inflacioni është mbajtur në nivele të ulëta. Si eksportet ashtu edhe importet janë rritur në mënyrë të qëndrueshme, duke çuar në një rritje të bilancit të llogarisë rrjedhëse. Rezervat e valutsë së huaj kanë qënë të qëndrueshme dhe borxhi i jashtëm ka qëndruar rreth shifrës 0,8 miliardë USD gjatë kësaj periudhe.

**Tabela 1. 1: Treguesit Makroekonomik, 1998-2002**

	1998	1999	2000	2001	2002
PBB me çmimet aktuale (miliardë Lek)	460.6	506.2	539.2	590.2	663
PBB (miliardë US\$)	3.1	3.7	3.8	4.1	4.7
Rritja reale e PBB (përqind)	8	7.3	7.3	7.6	4.7
Inflacioni i çmimeve konsumatore (përqind; mesatarisht)	20.6	0.4	00	3.1	5.4

Popullsia (milion; mes viti, parashikime)	3.8	3.1	3.1	3.1	3.1
Eksportet e mallrave fob (m US\$)	208	275	255.7	304.6	340
Importet e mallrave fob (m US\$)	-811.7	-938	-1,070.0	-1,331.5	-1,500.0
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (m US\$)	-65.1	-155.4	-156.3	-218.5	-370
Rezervat e valutës së huaj (me përjashtim të arit; m US\$)	348.5	369.1	352.2	362.5	
Transfertat Private (m US\$)	440	327	439	543	
Totali i borxhit të jashtëm (miliardë US\$)	0.6	0.7	0.8	0.8	
Raporti borxh-shlyerje, i paguar (përqind)	2.4	2.4	2	2.4	
Norma e këmbimit (Lk për US\$; mesatarisht)	150.63	137.69	143.71	143.49	140.74

*Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti statistikor mujor; FMN, Statistikat Financiale Ndërlombëtare.*

Transfertat private luajnë dhe do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm për të mbështetur rritjen. Gjatë vitit 2000 transfertat private përfaqësuan afro një të pestën e PBB totale, më shumë se dyfishi i të ardhurave fiskale nga eksportet.<sup>3</sup> Kjo rrjedhë e madhe e transfertave private ka mbuluar pjesërisht deficitin e llogarisë rrjedhëse, i cili për vitin 2002 ishte i barabartë me 8.7 përqind të PBB.<sup>4</sup>

Bujqësia zë pjesën më të madhe të PBB dhe siç duket edhe në tabelën 1.2 rritja e saj ka rënë vetëm shumë pak nga 35.9 përqind e PBB në vitin 2000 në 34.2 përqind në vitin 2001. Industria zë rreth 13 përqind të PBB, e ndjekur nga ndërtimi dhe transporti, të cilat të dyja zënë rreth 10 përqind të PBB. Megjithatë, këta dy sektorë kanë shënuar norma të larta rritjeje prej më shumë se 14 përqind gjatë vjetëve të fundit, më shumë se dyfishi i normës së rritjes prej 6.5 përqind të industrisë dhe dhjetë herë më shumë se lëvizjet shumë të ngadalta të bujqësisë.

**Tabela 1. 2: PBB dhe rritja sektorale**

	Ndryshimi real në përqindje, vit pas viti		Përqindja e totalit të PBB	
	2000	2001	2000	2001
Industria	5	6.5	13.2	13.2
Bujqësia	4	1.4	35.9	34.2
Ndërtimi	17	14	9.7	10.3
Transporti	14	13	9.5	10.1
Shërbime të tjera	9	8	31.8	32.2
PBB	7.8	6.5	100	100

*Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor, prill 2002*

Siç e tregon edhe tabela 1.3 tekstilet janë eksporti kryesor i Shqipërisë dhe zënë mbi 65 përqind të të gjitha eksporteve. Ushqimet e pijet dhe materialet e ndërtimit (që të dy këta zëra rreth 9 përqind) zënë kategorinë tjetër më të madhe të eksporteve. Makineritë zënë pothuajse një të katërtën e të gjitha importeve, të ndjekura nga afër nga ushqimet dhe pijet (19.6 përqind), tekstilet (14 përqind), mineralet dhe lëndët djegëse (13.7 përqind) dhe materialet e ndërtimit (12.4 përqind). Italia thith mbi 70 përqind të të gjitha eksporteve, e ndjekur nga Greqia (12.1 përqind e të gjitha eksporteve) dhe Gjermania (6.8 përqind). Italia gjithashtu zë shumicën e importeve (36.2 përqind), e ndjekur nga Greqia (27.6 përqind).

**Tabela 1. 3: Eksportet dhe Importet (përqindje e totalit)**

Eksportet kryesore 2001	Përqind	Importet kryesore 2001	Përqind
-------------------------	---------	------------------------	---------

<sup>3</sup> PNUD (2000).

<sup>4</sup> Banka Botërore (2002b).

Tekstile	65.6	Makineri	23.6
Ushqime, pije dhe duhan	9.0	Ushqime, pije dhe duhan	19.6
Materiale ndërtimi	8.6	Tekstile	14.0
Artikuj lëkure	3.5	Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike	13.7
Dru	3.4	Materiale ndërtimi	12.4
Destinacionet kryesore të eksporteve 2001	Perqind	Origjina kryesore e importeve 2000	Perqind
Itali	71.2	Itali	36.2
Greqi	12.1	Greqi	27.6
Gjermani	6.8	Gjermani	5.5
Jugosllavi	2.8	Turqi	5.4
Danimarkë	1.1	Bullgari	2.4

Burimi: Instat, Gjendja e tregëtisë së jashtme

Sektori privat fshatar është punëdhënësi më i madh, duke zënë mbi 760,000 njerëz me punë, ose mbi 60 përqind të krahut të punës. Sektori shtetëror është punëdhënsi i dytë më i madh, me rreth 190,000 njerëz, ose rreth 15 përqind të krahut të punës. Numri i njerëzve të papunë ka rënë gjatë vitit të fundit, nga 192,000 në tremujorin e dytë të vitit 2001 në 176,000 në tremujorin e dytë të vitit 2002, me një normë papunësie prej 14.2 përqind gjatë vitit 2002 (Tabela 1.4).

**Tabela 1. 4: Punësimi dhe papunësia ('000 me përjashtim të rasteve kur tregohet ndryshe)**

	2001			2002	
	3-m II	3-m III	3-m IV	3-m I	3-m II
Krahu i punës	1,263	1,256	1,247	1,241	1,238
Të punësuar	1,071	1,069	1,065	1,063	1,062
Sektori shtetëror	194	192	191	189	188
Sektori privat, qytet	116	116	113	113	113
Sektori privat, fshat	761	761	761	761	761
Të papunë	192	187	182	178	176
Që marrim përfitime	18	16	15	13	13
Norma e papunësisë ( përqind)	15.2	14.9	14.6	14.3	14.2

Burimi: INSTAT, Konjunktura.

Defiçiti fiskal dhe oferta e parasë janë mbajtur mirë brenda synimeve monetare dhe buxhetore për të cilët është rënë dakort edhe me FMN gjatë viteve të fundit. Përkundër të metave gjatë mbledhjes së të ardhurave fiskale dhe defiçiteve në faturat e privatizimit, defiçiti i përgjithshëm fiskal ka qënë në rënie nga 9 përqind të PBB gjatë vitit 2000 në 6.6 përqind gjatë 2002. Si rrjedhim, huamarrja e brendshme është mbajtur brenda shifrës 3 përqind të PBB. Defiçiti i përgjithshëm fiskal pritet të bjerë më tutje në 6.2 përqind të PBB gjatë vitit 2003. Përsa i takon sektorit të jashtëm, më të fuqishme nga ç'pritej, importet (e lëndës djegëse dhe të gjeneratorëve) kanë çuar në përkeqësimin e bilancit të llogarisë rrjedhëse gjatë dy vjetëve të fundit. Megjithatë, përkeqësimi i bilancit të llogarisë rrjedhëse është zbutur pjesërisht nga transfertat private jashtëzakonisht të larta të stimuluar nga hyrja e parave nga zona e euros të mbajtura nga shqiptarët që punojnë jashtë vendit të tyre. me transfertat të parashikuara në një nivel normal, defiçiti i llogarisë rrjedhëse përlllogaritët në rreth 8 përqind gjatë vitit 2003.

Njëri prej aspekteve kryesore të politikës ekonomike në Shqipëri ka qënë ruajtja e rreptë e disiplinës fiskale qysh prej gjysmës së dytë të viteve 90.<sup>5</sup> Si rrjedhojë, defiçiti fiskal është ulur dhe ka pasur një rënie të dukshme të nivelit të financimit të brendshëm të defiçiti buxhetor, që ka ardhur nga një rritje e moderuar në të ardhurat dhe kufizime të rrepta në shpenzime. Përkundër këtyre përmirësimeve, mbeten një sërë sfidash fiskale. Tatimet e drejtpërdrejta përbëjnë një pjesë të vogël të tatimeve vendore dhe mbledhja e VAT ka rënë poshtë potencialit që ka. Të ardhurat totale si pjesë e PBB mbeten dukshëm më të ulëta në Shqipëri se në shumicën e ekonomive të tjera të tranzicionit, përkundër normave të krahasueshme tatimore. Kjo është një pasqyrim i administrimit të dobët të tatimeve dhe evazionit të madh fiskal. Shpenzimet totale janë rritur, por cilësia e shpenzimeve, sidomos e atyre që mbështesin uljen e varfërisë, ka nevojë për një përmirësim të dukshëm. Pagesat e interesit të borxhit të brendshëm, megjithë rënien e qëndrueshme, përbëjnë ende një pjesë të madhe (14.5 përqind) të shpenzimeve rrjedhëse.<sup>6</sup>

Shqipëria lypset të ruajë qëndrueshmëri fiskale për të siguruar rritje të vazhduar dhe rënie të qëndrueshme të varfërisë. Shtrëngimi i vazhduar i disiplinës fiskale për të ulur më tutje defiçitin buxhetor është i nevojshëm gjatë viteve në vazhdim. Vështirësia është të ruhet një defiçit fiskal që është i përputhshëm me nivelet e ulëta të inflacionit dhe të borxhit publik ndërkohë që krijohen mundësi për financimin e nevojshëm për zëra shpenzimesh për investime, shërbime sociale dhe mbështetje të synuar për të varfërit dhe të dobëtit. Për të siguruar qëndrueshmërinë fiskale dhe atë të borxhit, ekziston nevoja për të ulur më tutje mbështetjen e buxhetit në huamarrjen e brendshme në mënyrë që të ulët barra e lartë e borxhit të brendshëm. Shpenzimet e ulura të interesit do të ofrojnë burime shtesë për fushat prioritare pa rritur totalin e shpenzimeve. Kjo do të kërkojë përpjekje të forta për të ardhurat fiskale si edhe të hyra nga asistencë e huaj për të mbështetur nevojat e Shqipërisë për investime publike. Qëndrueshmëria fiskale kërkon gjithashtu hartimin dhe zbatimin e një programi reforme të gjerë për pensionet në mënyrë që të ulët mbështetja e tyre tek transfertat buxhetore. Një raund i dytë i reformës së pensioneve filloi në vitin 2002 me objektivin për të zgjidhur problemet afatgjata të mbulimit, përballueshmërisë, barazisë dhe përshtatshmërisë. Këto do të kërkonin masa adekuate për të përmirësuar efikasitetin e operacioneve të institucioneve që merren me pensionet publike, për të futur ndryshime në strukturën e pensioneve fshatare dhe për të krijuar stimuj për organizatat private që ofrojnë pensione vullnetare dhe suplementare.

Disiplina e rreptë fiskale lypset të kombinohet me një shpërndarje më të mirë dhe me më shumë efikasitet të shpenzimeve publike. Brenda zarfit total të burimeve, shpërndarja e shpenzimeve lypset të përmirësohet në përputhje me objektivat strategjike të identifikuar në SKZHES. Programi Buxhetor Afatmesëm (MTEF), i miratuar në vitin 2000, i cili synon të përmirësojë shpërndarjen strategjike të burimeve dhe efikasitetin e përdorimit të shpenzimeve publike, lypset të jetë tërësisht e integruar me procesin e SKZHES dhe nisma të tjera, si psh procesi i stabilizimit asociativ dhe decentralizimit fiskal. Përpjekje duhet të bëhen në drejtim të përmirësimit të lëvrimin të shërbimeve dhe në drejtim të evidentimit dhe orientimit të shpenzimeve publike për nga prioritetet e SKZHES. Ndërkohë që duhet t'u jepet përparësi shpenzimeve për arsimin dhe kujdesin shëndetsor, transfertat e mbrojtjes sociale kanë nevojë të racionalizohen për të siguruar realizimin e asistencës efektive sociale përmes programeve të ndihmës në para dhe punë në komunitet.

---

<sup>5</sup> Për një analizë të hollësishme të zhvillimeve fiskale gjatë viteve 90, shih "*Shqipëria-Shpenzimet publike dhe rishikimi institucional*" Banka Botërore, prill 2001.

<sup>6</sup> Gjatë vitit 2002 pjesa e shpenzimeve për interesin në shpenzimet rrjedhëse ra në 15.3 përqind, pasi ishte mesatarisht më shumë se 25 përqind gjatë periudhës 1997-2000. Kjo rënie ka ndodhur kryesisht për shkak të normave më të ulëta të interesit mbi bonot e thesarit.

Bashkë me këto masa, kapacitetet për hartim dhe monitorim të politikave duhet të të fuqizohen për të përmirësuar vlerësimin e politikave, ndërkohë që duhet të zhvillohen dhe të fuqizohen lidhje më të ngushta midis objektivave të politikave dhe shpenzimeve. Mekanizmat e llogaridhënies duhet të fuqizohen më tutje për t'i dhënë mundësi Shqipërisë të luftojë korrupsionin, të inkurajohen nivele të larta të investimeve, sidomos investimet e huaja të drejtpërdrejta, të ruhet disiplina fiskale dhe të sigurohet që burimet përdoren me efektivitet dhe transparence. Arritja e këtyre objektivave do të ishte e rëndësishme jo vetëm për të mbështetur rritjen dhe uljen e varfërisë por edhe për të lehtësuar integrimin në ekonominë europiane.

Prospektet e Shqipërisë për rritje, zhvillim dhe ulje të varfërisë janë të mira, sidomos po të kemi parasysh një klimë më të favorshme dhe më të qëndrueshme politike në Europën Juglindore dhe perspektivat më të mira për një shoqërim më të ngushtë me Bashkimin Europian. Në periudhën afatmesme, rritja ekonomike parashikohet të qëndrojë e fortë, me PBB në rritje rreth 5 përqind në vit. Rritjet e eksporteve dhe aktiviteteve të sektorit privat janë të rëndësishme për të arritur këtë rritje ekonomike. Perspektivat e rritjes ekonomike dhe uljes së varfërisë gjithashtu varen në mënyrë kritike nga zgjidhja e problemeve të sektorit të energjitikës, zbatimit të reformave strukturore, sidomos të atyre që janë në drejtim të përmirësimit të mjedisit konkurrues, uljes së pengesave ndaj bizneseve, fuqizimit të sektorit financiar dhe kujdesit për aktivitetet e sektorit privat.

### **3. Matja e varfërisë në Shqipëri**

Mbledhja e mëparshme e të dhënave për matjen e varfërisë dhe pabarazisë në Shqipërinë post-komuniste ka qënë sporadike, jokonseguente dhe shumë pak e krahasueshme në kohë. Sasia shumë e vogël e të dhënave statistikore në nivel familjeje ka qënë një faktor kryesor kufizues për qeverinë gjatë përgatitjes së SKZHES.

Një prej përpjekjeve të para për të matur varfërinë në Shqipëri ka qënë një studim i kryer nga Banka Botërore në vitin 1996 që përdorte të dhënat e një Vëzhgimi të Buxhetit Familjar të kryer në Tiranë gjatë viteve 1993 dhe 1994 me asistencë financiale nga PNUD dhe asistencë teknike nga Instituti Kombëtar i Statistikave dhe Studimeve Ekonomike të Francës (INSEE). VBF futi një metodikë të re në Shqipëri, meqënëse ky vëzhgim ishte një kombinim i buxhetit familjar me vëzhgimet shumëtematike. U mblodh një informacion nga një numër total prej 3,179 familjesh, duke përdorur intervista të drejtpërdrejta si edhe një rregjistrim katërmbëdhjetëditor i të gjitha shpenzimeve të shpeshta. Është e rëndësishme të theksohet që ky vëzhgim mbulonte vetëm zonën qytetëse të Tiranës dhe nuk synonte të përfaqësonte pjesën tjetër të vendit.

VBF i kryer në Tiranë në 1993-94 u ndoq nga LSMS e vitit 1996, e kryer në të gjithë vendin me përjashtim të Tiranës, me një grup zgjedhjeje prej rreth 1,500 familjesh. Rezultatet e këtij vëzhgimi sugjerojnë se varfëria në vitin 1996 ka qënë një fenomen fshatar me pothuajse 90 përqind të të varfërve banorë të zonave fshatare dhe 60 përqind të krerëve të familjeve të varfëra të vetëpunësuar në bujqësi. Përqindja e varfërisë fshatare ishte pesë herë më e madhe se varfëria qytetëse dhe ishte më e lartë në veri të Shqipërisë, ku një pjesë e madhe familjeve kishin në pronësi më pak se 0.5 hektarë tokë. Shumë familje në këto rajone kërkojnë grurë të subvencionuar dhe ndihmë në para për të kaluar dimrin. Mundësia e kufizuar për të përdorur shërbimet publike, shpesh e rënduar nga infrastruktura e dobët fshatare, sidomos rrugët, ka qënë një faktor që ka kontribuar në varfërinë fshatare.

Përpara vitit 2002, shumica e informacioneve më të fundit mbi varfërinë dhe standartet e jetesës vijnë nga Vëzhgimi i Kushteve të Jetesës (VKJ) i kryer nga INSTAT në vitin 1998 si pjesë e programit PHARE. VKJ ka qënë përpjekja e parë në vend për matur varfërinë mbështetur në një grup zgjedhje përfaqësues kombëtar nga kuadër zgjedhjeje të ndërtuar nga INSTAT. Vëzhgimi VKJ u hartua për pasur shumë qëllime: objektivat e tij qënë të jepte një pamje globale të structures së kushteve të jetesës në vend dhe një grup të dhënash për një analizë shumëqëllimëshe në fushën e zhvillimit social, llogarive kombëtare, varfërisë dhe çmimeve. Ky vëzhgim u hartua duke adoptuar metodikën e Panelit të Komunitetit European për Familjet (ECHP). U krye në vjeshtë të vitit 1998 me një grup zgjedhjeje përfaqësues prej 11,523 familje si nga zonat qytetëse ashtu ehd engu ato fshatare, të përzgjedhura nga kudari i grupit të zgjedhjes të INSTAT.

VKJ jep informacion mbi nivelin dhe burimet e të ardhurave familjare, duke përfshirë të ardhurat nga puna si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, vetëpunësimi, sektori i bujqësisë, pagesat e asistencës sociale, si edhe të ardhurat nga prona dhe transfertat private. Sipas përlllogaritjeve të mbështetura në VKJ, varfëria e të ardhurave në Shqipëri ka qënë shumë e lartë, si në nivel ashtu edhe në thellësi, ku një nga çdo tre shqiptarë është nën nivelin (relativ) të varfërisë dhe mbi një e dyta e tyre jetojnë në varfëri të tejskajshme. Është gjetur se varfëria e të ardhurave është kryesisht një fenomen fshatar, ku 80 përqind të të varfërve jetojnë në mjedis fshatar. Varfëria përkufizohet se ka një të ardhur nën 60 përqind të të ardhurave mesatare mediane, ndërsa varfëria e tejskajshme përkufizohet se ka një të ardhur nën 40 përqind të të ardhurave mesatare mediane. Përdoren edhe norma të ngjashme të varfërisë të përfuara për varfërinë absolute (psh 2\$/ditë dhe 1\$/ditë). Normat e varfërisë fshatare janë dukshëm më të larta sesa normat e varfërisë qytetëse.

Rezultatet e vëzhgimit të vitit 1998 tregojnë se familjet që kanë më shumë gjasa për të qënë të varfëra janë ato që janë të mëdha, ndërkohë që kreu i familjes është ose i papunë ose i vetëpunësuar në bujqësi private dhe atje ku kreu i familjes ka nivele të ulëta arsimimi.<sup>7</sup> Familjet me tre fëmijë ose më shumë janë dukshëm më të predispozura për të qënë të varfëra dhe një numër i madh i fëmijëve jetojnë në varfëri. Gjetjet e vëzhgimit tregojnë gjithashtu që pothuajse dy të pestat e familjeve kreu i të cilave ka vetëm arsim fillor janë të varfëra. Midis familjeve me një kryefamiljar të punësuar, varfëria është e vendosur midis punonjësve të bujqësisë, ku dy nga pesë të varfër punojnë në bujqësi. Një gjetje tjetër e vëzhgimit të vitit 1998 është që nivelet e varfërisë janë të larta mes familjeve që jetojnë me asistencë sociale dhe një nga pesë të varfër është pensionist.

Megjithatë, numri i raportuar nga VKJ mund të çojë në qorrsoak, meqënëse matja e mirëqënies që del nga vëzhgimi ndikohet nga dy burime të rëndësishme paragjykimi. Së pari VKJ nuk e përfshin vlerësimin e prodhimit vetiak, i cili pritet të jetë i madh në zonat fshatare dhe mes familjeve më të varfëra. Së dyti, raportimi më i ulët se realja i të ardhurave është i dokumentuar mirë dhe ka gjasa të çojë në mbivlerësimin e niveleve të varfërisë, sidomos në vendet si Shqipëria me një ekonomi informale shumë aktive.

LSMS 2002, i cili është burimi parësor i të dhënave për këtë dokument, është përpjekja e parë e Shqipërisë për të mbushur hendekun aktual të dijes përmes mbledhjes së të gjithë informacionit të nevojshëm për një matje të plotë në nivel kombëtar të mbështetur tek konsumi. LSMS 2002 është pjesë e një projekti shumëvjeçar bashkëpunimi midis INSTAT, Bankës Botërore dhe Departamentit për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID) për të fuqizuar kapacitetet e qeverisë për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë të dhënat statistikore për monitorimin e varfërisë dhe vlerësimin e politikave.

---

<sup>7</sup> Shih gjithashtu edhe Rashid et al. (2001) dhe Banka Botërore (1997).

Raundi i parë i LSMS është kryer nga INSTAT në pranverë të vitit 2002 mbi një grup zgjedhjeje prej 3,600 familje dhe ofron një pikënisje të domosdoshme për të monitoruar ecurinë e strategjisë së qeverisë për uljen e varfërisë, siç parashikohet edhe në SKZHES. Renditja e viti 2001 për një rregjistrim paraprak të popullsisë ofroi një kuadër të grupeve të zgjedhjes për të cilin ndjehej shumë nevoja. Ky grup zgjedhjeje u mbështet në një projektim grupi në dy faza, me 450 njësi zgjedhjeje parësore (NJZP) të përzgjedhura nga lista e zonave të numërimit të rregjistrimit të popullsisë (EA).<sup>8</sup> Duke pasur parasysh ndryshimet drastike dhe të vrullshme që kanë ndodhur në zonën metropolitane të Tiranës, u vendos të përditësohej renditja e rregjistrimit paraprak të popullsisë e banesave në kryeqytet. Pas caktimit të NJZP, 8 familje u zgjedhën për secilën prej tyre.<sup>9</sup>

Kuadri i grupeve të zgjedhjes u ratifikua në katër rajone, çka pasqyron në vija të trasha një ndarje të vendit përgjatë vijave agro-ekologjike si edhe socio-ekonomike. Ai synon të përfaqësojë Tiranën, zonat e tjera qytetëse dhe fshatare, si edhe Tiranën dhe tre zonat e tjera agro-ekologjike/ekonomike (zona e bregut, zona qendrore dhe zona malore).<sup>10</sup> Grupi përfundimtar i të dhënave nga LSMS 2002 përfshin 1,000 familje për shtresat e bregut dhe ato malore, 999 për shtresën qendrore dhe 600 në Tiranë. Një numër total prej 1,640 familjesh janë fshatare dhe 1,959 janë qytetëse.

Hollësi të tjera shitesë mbi metodikën e vëzhgimit dhe procedurat e punës në bazë mund të gjenden në “Albania 2002 LSMS Basic Information Document” në [www.worldbank.org/lsm](http://www.worldbank.org/lsm) (në të ardhmen). Si pjesë e sistemit të vëzhgimit të familjeve, një panel vjetor mbi një nëngrup zgjedhjeje të LSMS është parashikuar të kryhet në pranverë të vitit 2003 dhe 2004. Gjithashtu, një LSMS mbi një prerje tërthore të re është planifikuar për vitin 2005 si pjesë e të njëjtit projekt.

#### 4. Struktura e këtij raporti

Pjesa tjetër e këtij materiali është e organizuar si më poshtë. Kreu II jep një pamje të përgjithshme të varfërisë në Shqipëri dhe përmban një profil përshkrues të të varfërve. Dimensionet hapësinore të varfërisë, deri në atë masë që mundësojnë të dhënat, trajtohen në Kreun III. Çështjet që kanë lidhje me tregjet e punës dhe varfërinë përbëjnë lëndën e Kreut IV. Dimensionet e varfërisë që kanë lidhje me kapitalin njerëzor diskutohen në Kreun V (shëndetësia) dhe Kreun VI (arsimi). Dy kapitujt e tjerë përmbajnë një analizë të strategjive që përpiqen t’i jepen zgjidhje problemit: Kreu VII kqyr rolin e programeve të mbrojtjes sociale, ndërkohë që Kreu VIII merret me migrimin e brendshëm dhe të jashtëm si mënyra për të përballuar varfërinë në Shqipëri. Konkluzionet jepen në Kreun IX.

---

<sup>8</sup> Meqënëse madhësia e EA fillestare për rregjistrimin e popullsisë ndryshonin shumë, në mënyrë që të arrihej në NJZP të madhësive të ngjashme, përpara përzgjedhjes u krye një agregim dhe ndarje e EA fillestare.

<sup>9</sup> Gjatë zbatimit të vëzhgimit pati një problem me përpunimin e pyetësorëve për një familje dhe kështu që kjo familje u përjashtua nga grupi i zgjedhjes. Si rrjedhojë, madhësia përfundimtare e grupit të zgjedhjes është 3,599 familje (16,521 individë)

<sup>10</sup> Shtresa e bregut përfshin rrethet e Lezhës, Kurbinit, Kavajës, Mallakastrës, Lushnjes, Delvines, Sarandes, Durrësit, Fierit dhe Vlorës. Shtresa e Shqipërisë së Mesme përfshin: Kucove, Skrapar, Kruje, Peqin, Gjirokastrë, Permet, Tepelene, Devoll, Kolonje, Pogradec, Mirdite, Puke, Malesi e Madhe, Shkoder, Elbasan, Berat, Korce, Mat, dhe Tirana fshat. Së fundmi, shtresa malore përfshin: Kukes, Has, Tropoje, Bulqizë, Diber, Gramsh, dhe Librazhd. Tirana qytet përbën një shtresim të veçantë.



Autorët do të jenë të gatshëm të ofrojnë të gjithë dokumentat mbështetës dhe teknike, dokumenta të cilët do të vendosen edhe në faqen e internetit për shfrytëzim më të lehtë nga të interesuarit.

## KREU II: VARFËRIA NË SHQIPËRI

### 1. Hyrje

Pamja shumëdimensionale e varfërisë është e pranuar kaq gjerë në literaturën për varfërisë sa që është pothuajse e tepërt ta vëmë theksin tek kjo gjë. Siç specifikohet edhe në Raportin e Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore për vitet 2000/2001, varfëria përqafon aspekte të privimit përtej konsumit material dhe përfshin dhimbjen psikologjike të të qenit të varfër, një ndjesi të brishtësisë ndaj ngjarjeve të jashtme dhe pafuqishmëria kundrejt institucioneve të shtetit dhe shoqërisë. Pranimi i kësaj pikëpamjeje ka ndikimet e veta për politikëbërësit si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndokombëtar. Në nivel kombëtar, qeveria e Shqipërisë ka përqafuar një qasje shumëdimensionale për uljen e varfërisë në SKZHES, duke përfshirë një angazhim të qartë për të pasur ecuri në drejtim të arritjes së OZHM. Në fushën ndërkombëtare kjo pasqyrohet më shumë me mbështetjen që vjen nga bashkësia ndërkombëtare për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), siç përcaktohet edhe në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Mijëvjeçarin.

Në përputhje me këtë konsensus të gjerë, vlerësimi i varfërisë në Shqipëri mbështetet në një përkufizim shumëdimensional të varfërisë dhe përveç privimit të të ardhurave, varfëria përkufizohet gjithashtu në lidhje me papërshtatshmërinë e një sërë masave të kujdesit social që nuk kanë lidhje me të ardhurat, si në arsim, shëndetësi, dhënie autoriteti, shfrytëzim të shërbimeve bazë dhe infrastrukturë. Gjithashtu, masa subjektive të kujdesit social janë prezantuar për të matur perceptimin që kanë njerëzit për sa i takon kushteve të tyre socio-ekonomike në vend të masave më objektive në kujdesin social. Ky kapitull është i organizuar si më poshtë. Seksioni 2 përkufizon kufirin e varfërisë dhe trajton çështjet që kanë lidhje me varfërinë e të ardhurave. Seksioni 3 përqëndrohet tek dimensionet e varfërisë që nuk kanë lidhje me të ardhurat, ndërkohë që seksioni 4 përmban një diskutim mbi varfërinë subjektive. Seksioni 5 trajton profilin e varfërisë, i ndjekur nga një zbërthim i pabarazive në seksionin 6. Modelet e konsumit përshkruhen në seksionin 6, përcaktorët e varfërisë shikohen në seksionin 7 dhe ky kapitull mbyllet me rezultatet kryesore dhe rrjedhojat e politikave në Seksionin 8.

### 2. Varfëria e të ardhurave

Meqënësia ekonomia në Shqipëri është në pjesën më të madhe fshatare dhe informale, dhe të ardhurat nuk janë saktësisht të matshme, matjet e mbështetura tek të ardhurat do të ofronin një përlllogaritje të shtrembëruar të varfërisë. Për këtë arsye, varfëria e të ardhurave në Shqipëri përlllogaritet në bazë të matjeve të mbështetura tek konsumi. Një individ quhet i varfër nëse niveli i tij i shpenzimeve për frymë bie nën nivelin minimal që nevojitet për të plotësuar nevojat bazë për ushqime dhe artikuj joushqimor të këtij individ. Ky nivel minimal konsumi quhet ndryshe “kufiri i varfërisë” dhe përfaqëson pikën e ndarjes midis të varfërve dhe atyre që nuk janë të varfër. Kufijtë e varfërisë mund të përcaktohen në mënyra të ndryshme dhe përfshijnë kufij varfërie, absolut, relativ dhe subjektiv. Kufijtë *absolut të varfërisë* përkufizohen në lidhje me një prag të paracaktuar ose të lidhur me një shportë ushqimore ose me nivele të caktuara të mirëqënies, dhe kanë përparësinë se të japin mundësi për një krahasim të lehtë në kohë dhe midis grupeve të ndryshme. *Kufijtë Relativ të varfërisë* pasqyrojnë shkallën e mungesave nga të cilat vuan një familje ose një individ në lidhje me të ardhurat e pjesës tjetër të popullsisë. Dhe së fundmi, *kufijtë subjektiv të varfërisë* trupëzojnë perceptimin e njerëzve në lidhje me gjëndjen e

mirëqënies së tyre vetë. Kufiri i varfërisë i përzgjedhur në fund fare varet nga objektivat e analizës.<sup>11</sup>

Përlllogaritja e kufirit absolut të varfërisë për qëllimet e këtij vlerësimi mbështetet mbi një shportë faktike konsumi të një grup zgjedhjeje popullore të marrë nga vëzhgimi dhe është konvertuar në masa monetare duke përdorur metodikën e “kostos së nevojave bazë” (KNB) (Ravallion dhe Bidani, 1994). Për përlllogaritjen e kufirit të plotë të varfërisë, është llogaritur në fillim një kufi varfërie për ushqimet (ose për koston e marrjes së një sasi minimale kalorish) dhe pastaj ky kufi është rregulluar për të përfshirë artikuj thelbësor joushqimorë. Përbërësi joushqimor është llogaritur si një mesatare e pjesës mesatare të atyre familjeve që shpenzojnë gati të njëjtën sasi për ushqim siç tregohet nga kufiri i varfërisë ushqimore (shih Aneks I për më shumë hollësi).

Kufiri i varfërisë llogaritet duke përdorur shportën ushqimore që konsumohet nga njerëzit e dhjetëshorëve të dytë deri në të katërt.<sup>12</sup> Duke pasur parasysh rekomandimet e FAO për konsumin minimal të kalorive sipas moshës dhe gjinisë dhe duke i rregulluar këto kërkesa për kalori sipas shpërndarjes së popullsisë në Shqipëri sipas rregjistrimit të popullsisë të vitit 2001, marrja e kalorive për frymë u përlllogarit në 2,288 kalori në ditë. E llogaritu në këtë mënyrë, kufiri ushqimor i varfërisë (ose kufiri i varfërisë së tejskajshme) është përlllogaritur në 3,047 Lek për frymë në muaj. Kufiri i plotë i varfërisë, i përlllogaritur me nevojat për artikujt bazë joushqimorë, përlllogaritet në 4,891 Lek për frymë në muaj.<sup>13</sup>

Në lidhje me masat e varfërisë, janë përdorur treguesit zbrërthyes standartë të familjes Foster-Greer-Thorbecke (FGT). Këta përfshijnë: (i) përqindjen e varfërisë, ose raportin e numrit të të varfërve, duke pasqyruar përqindjen e popullsisë konsumi për frymë i së cilës bie nën kufirin e varfërisë; (ii) thellësinë e varfërisë, e matur me indeksin e hendekut të varfërisë, duke matur sasinë e diferencës së të ardhurave mesatare të të varfërve në lidhje me kufirin e varfërisë; dhe (iii) hendeku i varfërisë i ngritur në katror, një masë e ashpërsisë së varfërisë.

Mbështetur në matjet e diskuturara më sipër, një e katërta e popullsisë në Shqipëri, ose afro 780,000 individë, bien nën kufirin e varfërisë. Varfëria e tejskajshme – siç përkufizohet nga kufiri ushqimor i varfërisë – ekziston dhe kap deri 4.7% të popullsisë, ose rreth 150,000 individë, të cilët nuk janë në gjendje të plotësojnë kërkesat elementare për ushqime. Në përputhje me studime të mëparshme, varfëria është vënë re të jetë më e lartë në zonat fshatare, ku numri i të varfërve është 66% më i lartë se në Tiranë dhe 50% më i lartë se në zona të tjera qytetëse. Konsumi për frymë në zonat fshatare, në masën 7,224 Leks, është sa rreth katër të pestat e niveleve të konsumit në zonat qytetëse.<sup>14</sup>

<sup>11</sup> Vendosja e një kufiri varfërie shumë shpesh kundërshtohet dhe është shpesh fokusi i një debati të nxhetë publik, sidomos kur përdoret si një prag reference për programet e pranimit. Për shpërndarjet rreth kufirit të varfërisë, zgjedhja bëhet më e vështirë, meqënëse edhe një lëvizje e vogël e kufirit mund të ketë një ndikim të madh mbi shifrat e varfërisë.

<sup>12</sup> Dhjetëshoret janë përlllogaritur nga agregati i konsumit për frymë i rregulluar më parë me ndryshimet në çmime. Dhjetëshorja e parë u përjashtua në mënyrë që të shmangej ndikimi mbi shportën me modelet që mund të vijnë si rezultat i faktorëve të largët. Megjithatë, popullsi të ndryshme reference, duke përfshirë 50% më të varfërit, sollën rezultate shumë të ngjashme.

<sup>13</sup> LSMS e vitit 2002 mblodhi të gjithë informacionin e nevojshëm për të llogaritur përbërësit kryesorë të agregatit të konsumit: konsumi ushqimor (si i blerë ashtu edhe i prodhuar vetë), shpenzimet joushqimore (konfeksione, artikuj shtëpiakë), fatura (gaz, telefon, energji, etj.), arsimit, shëndetit, mallrat afatgjata dhe strehimi. Shpenzimet e shëndetit dhe të strehimit nuk janë përfshirë në agregatin e konsumit, për arsye që shpjegohen në Aneksin I.

<sup>14</sup> Madhësia e hendekut është më e vogël sesa llogaritet nga VKJ 1998. Megjithëse është tunduese të bësh krahasime me përlllogaritjet e mëparshme të varfërisë, duhet të theksohet se, përveç ndryshimeve të


**Tabela 2. 1: Varfëria dhe pabarazia në Shqipëri**

	Tirana		Qytete të tjera		Fshat		Total	
	Varfër	Tejet varfër	Varfër	Tejet varfër	Varfër	Tejet varfër	Varfër	Tejet varfër
Numri total	17.8	2.3	20.1	4.8	29.6	5.2	25.4	4.7
Hendeku i varfërisë	3.8	0.6	4.7	0.9	6.6	0.7	5.7	0.8
Hendeku i varfërisë i ngritur në katror	1.3	0.22	1.7	0.24	2.1	0.16	1.9	0.19
Konsumi mesatar për frymë (lekë të reja)	9,043		8,468		7,212		7,801	
Gini	0.30		0.28		0.27		0.28	

Pabarazia e mbështetur në konsum është i moderuar dhe është në përputhje me shumë vende të tjera të rajonit, me një koeficient kombëtar Gini prej 0.28. Kjo përlogaritje mbështet përlogaritjet e mëparshme të pabarazisë të mbështetur në konsum, të cilat janë në përgjithësi më të ulëta se matjet e mbështetura tek të ardhurat. Përmes vendodhjeve të ndryshme nuk ka asnjë dallim të dukshëm. Raporti 90/10, një tjetër matje e pabarazisë, është i ulët në masën 3.6.

Figura 2.1, tregon përmes një grafiku të funksioneve kumulative të dendësisë për çdo vendodhje lidhjen midis varfërisë fshatare dhe qytetëse. Normat e varfërisë në zonat fshatare janë gjithnjë më të larta se normat qytetëse, pavarësisht kufirit të zgjedhur të varfërisë. Ndërkohë që nuk mbahet një mbizotërim probabilistik midis Tiranës dhe pjesës tjetër të zonave qytetëse, mbivendosja është minimale dhe vijat kryqëzohen vetëm tek nivelet e konsumit mbi çdo kufi të arsyeshëm të varfërisë.

**Figura 2.1: Funksionet kumulative të dendësisë sipas vendodhjes**



dukshme për shkak të ndryshimeve në përzgjedhjen e grupeve të zgjedhjes dhe metodikave të mbledhjes së të dhënave, matjet e mirëqënies të bëra nga VKJ nuk janë të krahasueshme me masën e mbështetur tek konsumi që përdoret në këtë vlerësim.

Kufiri absolut i varfërisë siç llogaritet më sipër është i lidhur me një shportë specifike konsumi. Përveç kësaj, kufijtë absolutë të varfërisë mund të ndërtohen gjithashtu në lidhje me barazvlerën (në kuptimin e paritetit të fuqisë blerëse) e të ardhurave prej 2 US\$ and 4 US\$ në ditë.<sup>15</sup> Në mënyrë të ngjashme, mund të ndërtohet edhe një kufi relativ i varfërisë në lidhje me të ardhurat mesatare mediane të popullsisë, një qasje që rekomandohet nga Eurostat dhe që përdoret gjerësisht nga vendet e Europës Perëndimore. Është e dobishme të ekzaminojmë ndjeshmërinë e përllogaritjeve të përqindjes së varfërisë në zgjedhje të ndryshme të kufirit të varfërisë.

**Tabela 2. 2: Krahasimi i kufijve të varfërisë**

Kufiri i varfërisë	Vlera (Lek)	Numri (%)
Kufiri ushqimor i varfërisë	3,047	4.7
50% i konsumit median për frymë	3,349	7.0
2 US\$ PPP	3,775	10.8
60% i konsumit median për frymë	4,019	13.5
<b>Kufiri i plotë i varfërisë</b>	<b>4,891</b>	<b>25.4</b>
4 US\$ PPP	7,550	59.3

Siç e tregon edhe Tabela 2.2, kufiri ushqimor i varfërisë vendos pragun më të ulët, i ndjekur nga kufiri relative i varfërisë i të ardhurave mediane, kufiri absolut i varfërisë 2 US\$ PPP, kufiri relativ i varfërisë 60 përqindësh i të ardhurave, kufiri absolut i varfërisë që llogaritet më sipër lidhet me një prag ushqimor dhe së fundmi kufiri absolut i varfërisë 4 US\$ PPP. Vini re që shumë pak njerëz jetojnë nën kufirin ushqimor të varfërisë, të vlerësuar në masën 3,047 Lek. Kufiri absolut i varfërisë, në masën 4,891 lek, shtrihet nën dy kufijë absolute të varfërisë PPP që përdoren për qëllime të krahasimeve me jashtë. Mbështetur në kufirin relativ të të ardhurave mediane, 7 përqind e popullsisë shqiptare konsumon më pak se gjysma e shpenzimeve mediane për frymë të vendit. Duke përdorur 60 përqind të konsumit median si një pikë relative ndarjeje, numri total i të varfërive dyfishohet në 13.5 përqind. Përqëndrimi i individëve përreth këtyre pikave të shpërndarjes është i dukshëm.

Tabela 2.3 jep ndjeshmërinë e kufijve të ndryshëm të varfërisë ndaj tronditjeve dhe sasive të papritura të parave të cilat i ndryshojnë të ardhurat me një sasi të barazvlerëshme me 5-10 përqind të të ardhurave rrjedhëse, çka jep idenë se një numër individësh hyjnë e dalin nga zona e varfërisë si rrjedhojë e kësaj ndjeshmërie. Shtylla e mesit (me të errëta) paraqet normat e numrave total të nxjerrë nga vendosja e secilit kufi varfërie siç propozohet. Të ardhurat lejohen të zbesin me 5 përqind dhe 10 përqind në shtyllat në të majtë të shtyllës së mesit dhe një rritje e ngjashme lejohet në shtyllat në të djathtë të shtyllës së mesit.

**Tabela 2. 3: Ndjeshmëria e numrave total ndaj ndryshimeve të kufirit të varfërisë**

	KV -10%	KV -5%	<b>Kufiri i Varfërisë</b>	KV +5%	KV +10%
<b>Numrat total</b>					
<i>Të varfër</i>	18.8	22.2	<b>25.4</b>	28.2	31.9
<i>Tejet të varfër</i>	2.9	3.8	<b>4.7</b>	6.2	7.0
<i>50% të konsumit median</i>	4.5	5.9	<b>7.0</b>	8.7	10.1
<b>Kufijtë e varfërisë (në Lek)</b>					
<i>Të varfër</i>	4,402	4,646	<b>4,891</b>	5,135	5,380
<i>Tejet të varfër</i>	2,742	2,895	<b>3,047</b>	3,200	3,352

<sup>15</sup> Kufiri PPP prej 1\$/ditë, i vlerësuar përafërsisht me 1,900lek/muaj, nuk raportohet, meqenëse vetëm një përqindje shumë e vogël e individëve bien nën këtë kufi. Kjo është një praktikë e zakonshme në vendet ECA ku përdoren më gjerë kufijtë PPP prej 2\$ dhe 4\$.

50% të konsumit median	3,014	3,182	<b>3,349</b>	3,517	3,684
------------------------	-------	-------	--------------	-------	-------

Kjo analizë na sugjeron se një numër i madh individësh janë të mbledhur përreth kufijve të varfërisë. Po të rritet kufiri i varfërisë me 10 përqind rritet përqindja e të varfërve me 25 deri në 50 përqind, në varësi të kufirit të varfërisë që përdoret. Kjo është e vërtetë edhe për zhvendosjet negative të kufirit të varfërisë. Me fjalë të tjera, një tronditje negative e mirëqënies (e barazvlershme me një rritje të kufirit të varfërisë, duke e mbajtur shpërndarjen të pandryshuar) dhe një tronditje pozitive (e parazvlershme me një zhvendosje për poshtë të kufirit) rezultojnë në ndryshime më shumë se proporcionale të varfërisë.

Rëndësia e rrjeteve të përshtatshëm të sigurisë sociale për këtë numër të madh individësh del si një përparësi e politikave publike. Gjithashtu, duke pasur parasysh thellësinë relativisht të vogël dhe ashpërsinë e varfërisë, transfertat e vogla të synuara mirë mund të sjellin rezultate të mëdha përsa i përket zbutjes së varfërisë. Së fundmi, kjo lloj shpërndarje na paralajmëron kundër përdorimit mekanik të kufirit të varfërisë si një prag synimi për programet publike, meqënëse nëse veprojmë kështu ka të ngjarë të përjashtojmë përfitues të mundshëm të cilët vuajnë nga po ato privime të cilat kërkojnë të zgjidhin programet në fjalë.

#### ***Krahasim ndërkombëtar i varfërisë***

Megjithëse kufiri PPP prej 1\$/ditë përdoret gjerësisht për të matur privimin e tejskajshëm dhe është gjithashtu edhe një standart i OZHM, është ndoshta më e përshtatshme për Shqipërinë,<sup>16</sup> sikurse për të vendet e tjera ECA, të përdoret kufiri prej 2\$/ditë i mbështetur në vlerat PPP të vitit 1996 për privimin absolut.<sup>17</sup>

***Tabela 2. 4: Normat e varfërisë në disa vende të rajoni ECA***

	Shqipëria	Bullgaria	Rumania	Maqedonia	Gjeorgjia	Azerbaixhani
Viti vëzhgimit	2002	2001	1998	1996	1999	1999
2 \$ PPP	10.8	7.9	6.8	6.7	18.9	23.5
4 \$ PPP	59.3	31.9	44.5	43.9	54.2	64.2

Tabela 2.4 tregon normat e varfërisë si për kufirin 2\$/ditë ashtu edhe për 4\$/ditë në PPP të vitit 1996 për Shqipërinë si edhe për disa vende të tjera të rajonit. Krahasimi me 2\$/ditë e vendos Shqipërinë mbrapa vendeve si Bullgaria dhe Rumania, të cilat janë në valën tjetër të pranimit në BE dhe përpara vendeve të Kaukazit si Gjeorgjia dhe Azerbajxhani. Ndërkohë që krahasimi me 4\$/ditë e vendos Shqipërinë mbrapa Bullgarisë, Rumanisë, Maqedonisë dhe Gjeorgjisë dhe vetëm shumë pak përpara Azerbajxhanit. Ashtu sikurse për çdo krahasim të tillë, duhet të vihet re nga ana tjetër që ndërkohë që sigurohet njëfarë shkallë krahasueshmërie midis vendeve duke përdorur vlerat PPP të cilat pasqyrojnë fuqi blerëse të ndryshme në këto vende, për shkak të ndryshimeve të metodikave të përdorura në përlllogaritjen e vlerave të mirëqënies, krahasimet janë disi më të dobëta.

<sup>16</sup> Për shëmbull, shih “Ta kthejme tranzicionin në të mirë për të gjithë: varferia dhe pabarazia në Europë dhe Azi Qendrore”, Banka Botërore, 2000

<sup>17</sup> Megjithëse krahasimet ndërkombëtare për shumicën e vendeve mbështeten në vlerat PPP të vitit 1993, këtu përdoren vlerat PPP të 1996 për të mundësuar krahasimin me botimin ECA (të përmendur më sipër).


### 3. Dimensionet e varfërisë që nuk kanë lidhje me të ardhurat

Përpara se të shikojmë një profil të të varfërve, është e rëndësishme të shikojmë dimensionet e ndryshme të varfërisë që nuk kanë lidhje me të ardhurat dhe privimi që mund të mbizotërojë dimensionin e pastër të të ardhurave dhe rezultatit e lidhur me të në një kuptim të përgjithshëm të keq-qënies (si kuptimi i kundërt i mirëqënies), edhe atëherë kur të ardhurat në para janë mbi kufirin e varfërisë, sido të jetë caktuar ky kufi. E sjellim trajtesën mbi këtë temë duke evidentuar dimensionet kryesore të varfërisë që nuk janë të lidhura me të ardhurat dhe duke vështruar përkatësinë e tyre për Shqipërinë. Konsensusi dhe angazhimi midis shumë vendeve dhe bashkësisë ndërkombëtare për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) pranon në mënyrë të nënkuptuar reagimet jo të drejtpërdrejta që do të kishte arritja e këtyre objektivave tek ulja e varfërisë dhe ngritja e mirëqënies për miliona familje dhe ofron një pikënisje për këtë evidentim. Përveç zhdukjes së varfërisë së tejskajshme dhe urisë, OZHM përqëndrohen në arritjen e arsimit fillor universal, nxitjen e barazisë midis gjinive, përmirësimit të vdekshmërisë foshnjore, përmirësimit të shëndetit të nënave, luftën kundër HIV-AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera dhe sigurimin e një qëndrueshmërie të mjedisit (shih Kutinë). Mbështetur mbi këto pika të msipërme, dimensionet specifike të varfërisë që nuk lidhen me të ardhurat e që meritojnë një ekzaminim të mëtejshëm përfshijnë (i) mundësi përdorimi të shërbimeve bazë; (ii) zhdukje të analfabetizimit dhe arsim; (iii) kequshqyerjen e fëmijëve; (iv) shëndetin e nënave; (v) pjesëmarrjen e krahut të punës; dhe (vi) dhënie të pushtetit dhe gjininë. Më poshtë këto pika trajtohen me rradhë.

#### *i. Mundësia e përdorimit të shërbimeve bazë*

Pamja e përgjithshme që del nga analiza e të dhënave të LSMS të vitit 2002 mbi mundësinë e përdorimit të shërbimeve bazë tregon se dimensionet e deprivimit jo të lidhura me të ardhurat përbëjnë varfërinë e të ardhurave dhe se pabarazitë janë më të theksuara sesa ç'duken po të shikonim vetëm dimensionin e të ardhurave. Në veçanti, kjo analizë tregon se modernizimi i vendit i cili në shumë aspekte është shkaktuar nga reformat e tranzicionit dhe periudha e fundit e rritjes së qëndrueshme ekonomike ka dhënë përfitime për zonat qytetëse, sidomos për Tiranën, me një hap shumë më të madh sesa për zonat fshatare, të cilat kanë mbetur mbrapa. Në shumicën e rasteve, mbulimi me shërbimet e infrastrukturës bazë është pothuajse universal në zonat qytetëse, por shumë më i vogël në zonat fshatare. Megjithatë, me këtë nuk duam të themi që zonat qytetëse nuk kanë probleme: edhe pse në teori mundësia e përdorimit është e disponueshme, këto shërbime vuajnë kaq shumë nga problemet që lidhen me cilësinë sa që ato janë gati të padisponueshme.

Një shëmbull i mirë do të ishte mundësia e përdorimit të ujit. Më pak se një në katër banorë



fshatarë kanë ujë të rrjedhshëm brenda banesave të tyre (dmth ujë që vjen përmes tubacioneve të ujësjellësit), dhe më pak se një në dy kanë mundësi përdorimi uji të rrjedhshëm, brenda ose jashtë banesës. Në Tiranë, nga ana tjetër, gati të gjithë kanë ujë të rrjedhshëm (96.6 përqind) dhe shumica (91.8 përqind) kanë ujë të rrjedhshëm brenda banesave. Gjendja është e ngjashme në

zonat e tjera qytetëse. Për vendin si të tërë, këto shifra janë respektivisht rreth 66 dhe 50 përqind.


Megjithatë, në lidhje me cilësinë e ujit, gjendja në Tiranë duket se është më keq se në zonat e tjera, përfshi qytetëse dhe fshatare (Tabela 2.5). Vetëm një në katër familje të kryeqytetit mendojnë se uji që përdorin ka cilësi të mirë (për t'u pirë), krahasuar me 83 dhe 87 përqind familje respektivisht në zona të tjera qytetëse dhe në zonat fshatare.

**Tabela 2. 5: Vetëvlerësimi i cilësisë së ujit**

Cilësia e ujit	Tirana	Qytet	Fshat	Total
I mirë për t'u pirë	25.7	83.3	87.4	79.2
Jo i mirë për t'u pirë	74.3	16.5	11.8	20.3
I mirë për asgjë	0.0	0.2	0.8	0.5
Total	100.0	100.0	100.0	100.0

Gjithashtu, midis atyre që marrin ujë të rrjedhshëm, gati 30 përqind e banorëve në zonat e tjera qytetëse (dhe 26 përqind në Tiranë) thonë se kanë ujë më pak se gjashtë orë në ditë. Në të gjithë vendin si të tërë, as një e dyta e numrit total të familjeve me mundësi përdorimi të ujit të rrjedhshëm nuk thonë se kanë furnizim të pandrëprerë me këtë shërbim dhe afro gjysma kanë ujë dhjetë ose më pak orë në ditë.

Kushtet e këqija në të cilat jetojnë shumë fshatarë shqiptarë pasqyrohen gjithashtu edhe në shifrat



e mundësisë së përdorimit të rrjetit të përmirësuar të kanalizimeve. Vetëm 40.8 përqind e banorëve në fshat kanë një tualet brenda banesave të tyre, ndërkohë që 45.5 përqind nuk kanë asnjë mundësi përdorimi të një tualeti me kanalizime të lidhura. Nga ana tjetër, në Tiranë 93.3 përqind e popullsisë jeton në banesa me të paktën një tualet brenda. Po të bëjmë një krahasim përmes rajoneve, rajoni kryesisht malor ka gjendjen më të keqe përse i takon kanalizimeve, ku

46.1 përqind e popullsisë nuk ka mundësi përdorimi të një tualeti të lidhur me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza.

Një shëmbull tjetër është energjia elektrike. Ndërkohë që mbulimi me rrjet është gati universal, ofrimi i shërbimit është shumë problematik dhe gjendja është më e rëndë në bashkësitë fshatare (Tabela 2.6). Vetëm 13.8 përqind e shqiptarëve thonë se marrin furnizim me energji elektrike pa ndërprerje (28 përqind në Tiranë, 7 përqind në zonat fshatare) dhe 72.7 përqind thonë se kanë ndërprerje çdo tditë (83 përqind në zonat fshatare, 56 në Tiranë). Midis atyre që thonë se kanë furnizim me ndërprerje, energjia nuk është e disponueshme 8.6 orë mesatarisht në një ditë të zakonshme (9.4 orë në zonat fshatare, 7.7 orë në zonat qytetëse, 5.6 orë në Tiranë).

**Tabela 2. 6: Energjia elektrike**



Shpeshtësia e ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike	Tirana	Qytete	Fshatra	Total
Kurrë	28.3	21.7	6.7	13.8
Disa herë në muaj	6.3	8.7	3.4	5.3
Disa herë në javë	9.8	11.1	6.4	8.3
Çdo ditë	55.6	58.4	83.4	72.7
Total	100.0	100.0	100.0	100.0

### Kutia 2.1: Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit

OZHM – të cilët përmbledhin 8 objektiva, 18 synime dhe 48 tregues – pasqyrojnë angazhimin ndërkombëtar për të përgjysmuar numrin e njerëzve të varfër deri në vitin 2015, për të përmirësuar arsimin dhe shëndetsinë dhe për të ruajtur mjedisin. Me nënshkrimin e Deklaratës së Mijëvjeçarit, qeveria e Shqipërisë ka marrë angazhim për të raportuar rregullisht mbi gjendjen e përpjekjeve shqiptare për të arritur OZHM. Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social (SKZHES) ka bërë të sajat shumë prej këtyre objektivave si synime dhe tregues për të matur ecurinë. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i rregullt mbi OZHM ka nevojë gjithashtu të trupëzohet në sistemet ekzistuese dhe ato të planifikuara të monitorim-vlerësimit, si edhe në nën-strategji të tjera si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor.

Një botim i kohëve të fundit i përgatitur nga Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC) për Kombet e Bashkuara në Shqipëri bën një analizë të përgjithshme se ku qëndron ky vend në lidhje me arritjen e 7 objektivave të OZHM dhe 11 synime të tyre (OZHM8 është zhvillimi i partneriteteve globale):

#### Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në Shqipëri

<u>OBJEKTIVI</u>	<u>HDPC, Shqipëri</u>	<u>Burime të tjera*</u>
OZHM1: Zhdukja e varfërisë së tejskajshme dhe urisë pamjaftueshme për parashikim	Ndoshta	Të dhëna të
OZHM2: Arritja e arsimit fillor universal arrirë	Ndoshta	Pa gjasa për t'u
OZHM3: Nxitja e barazisë midis gjinive, fuqizimi i grave arrirë	Ka të ngjarë	Me gjasa për t'u
OZHM4: Ulja e vdekshmërisë foshnjore arrirë	Ndoshta	Pa gjasa për t'u
OZHM5: Përmirësimi i shëndetit të nënave përmirësohen	Ka të ngjarë	Treguesit po
OZHM6: Lufta kundër HIV/AIDS, malaries, sëm. të tjera arrirë	Ka të ngjarë	Pa gjasa për t'u
OZHM7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit thueht asgjë	Pa gjasa	Nuk mund të

\*Nga “Plani i biznesit për të mbështetur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në Europë dhe Azi Qendrore”, ECSHD, Gusht 2002

Ky raport përfshin gjithashtu edhe përmbledhje të performances (shih shtyllëne dytë në tableën e mësipërme) në të cilën, në bazë të gjendjes aktuale dhe prirjeve në të shkuarën, autorët përipiqen të llogarisin mundësinë se sa do t'i arrijë Shqipëria secilin objektiv në kohë. Autorët janë të mendimit se “ekziston një mundësi e mirë që Shqipëria të mund t'i arrijë OZHM”, por kjo mund të ndodhë vetëm nëse kemi “politika të përmirësuara, institucione më të forta dhe burime shtesë”.

Megjithatë, sipas burimeve të tjera, siç tregohet edhe në shtyllën në të djathtë, arritja e këtyre objektivave duket më pak e lehtë për Shqipërinë. Gjithashtu, duhet vënë re se mungojnë një sërë treguesish të përshtatshëm për matur dhe gjurmues ecurinë. Një shëmbull i tillë është matja e varfërisë: në mungesë të një përlllogaritje të saktë që të shërbejë si pikënisje, ka qënë e vështirë deri tani për t'u angazhuar për një synim të caktuar.

Tabela 2.7 paraqet pesë tregues të varfërisë që nuk lidhet me të ardhurat të cilët së bashku përbëjnë Nevojat Bazë të Paplotësuara (UBN): uji dhe kanalizimet, kushtet e strehimit (siç perceptohen nga familja) furnizimi me energji elektrike, mbipopullimi i banesave dhe arsimit i kryefamiljarit. Një familje përkufizohet e varfër në lidhje me UBN kur dy ose më shumë prej këtyre nevojave bazë nuk plotësohen dhe përkufizohet si tejet e varfër në lidhje me UBN kur nuk plotësohen tre ose më shumë nga këto nevoja.

**Tabela 2. 7: Nevojat Bazë të Paplotësuara**

	Tirana	Qytete	Fshatra	Total
1. Ujë dhe kanalizime të papërshtatshme (*)	0.5	2.6	28.6	17.5
2. Strehim i papërshtatshëm (**)	8.5	6.3	16.5	12.5
3. Furnizim i papërshtatshëm me energji elektrike (***)	1.7	9.0	18.1	13.5
4. Mbiipopullim (më shumë se 3 persona/dhomë)	10.3	15.6	18.6	16.7
5. Arsim (kryefamiljar me fillore ose më pak)	34.7	47.0	74.8	61.2
Të varfër (dy ose më shumë UBN)	11.5	16.6	47.2	33.8
Tejet të varfër (tre ose më shumë UBN)	2.3	3.2	18.3	11.9
Jo të varfër (një ose asnjë UBN)	88.5	83.4	52.9	66.2

\*Ujë dhe kanalizime të papërshtatshme: nuk janë të disponueshëm as ujë i rrjedhshëm as WC me kanalizime

\*\*Vlerësim subjektiv (shtëpi e papërshtatshme për jetesë, ose në ndërtim e sipër)

\*\*\*Furnizim i papërshtatshëm me energji elektrike: ndërprerje e energjisë për më shumë se 6 orë në ditë

Renditja e normave të varfërisë UBN sipas vendodhjes ndryshon nga norma e varfërisë monetare që është paraqitur në seksionin e mëparshëm. Dallimet midis zonave fshatare dhe atyre qytetëse janë më të theksuara. Zonat fshatare janë shumë më keq, shpesh me një hendek të madh nga zonat qytetëse. Varfëria UBN është tre herë më e madhe në zonat fshatare sesa në zonat qytetëse. Dallimi në varfërinë e tejskajshme UBN është edhe më i theksuar, me një hendek gjashtëfish midis Tiranës dhe zonave fshatare.

Këta tregues, ndërkohë që janë të rëndësishëm në vetvete si nevoja bazë, kanë edhe një ndikim afatgjatë mbi varfërinë. Mungesa e ujit dhe kanalizimeve të mira mund të mos shkaktojë vetëm shëndet të keq por mund të dëmtojë mundësinë për të gjeneruar të ardhura dhe për të ndërtuar kapitalin njerëzor (siç mund të pasqyrohet, për shëmbull, në aftësinë për të mësuar ose për shkuar në shkollë). Mungesa e një furnizimi të besueshëm me energji elektrike pengon fitueshmërinë (ose edhe realizueshmërinë) e investimeve prodhuese, duke ulur rritjen ekonomike, çka shpesh ka pasoja afatgjata.

## **ii. Mungesa e analfabetizimit, arritja arsimore dhe frekuentimi i shkollës**

Rezultatet arsimore të një populli, përveç se janë një tregues i mirënjohur i mirëqënies, është gjithashtu edhe një mjet politikash për të këputur rrethin e varfërisë për shumë veta. Sipas standarteve ndërkombëtare, niveli i aftësisë për të shkruar dhe lexuar në Shqipëri është i lartë,

sidomos tek të rinjtë, në popullsinë qytetëse (Tabela 2.8), por bie ndjeshëm tek më të moshuarit fshatarë, ku vetëm gjysma e tyre thonë se mund të lexojnë dhe shkruajnë mirë.

**Tabela 2. 8: Shkrimi dhe leximi sipas grupmoshave dhe vendodhjes**

	Tirana		Qytete të tjera		Fshat		Total	
	> 14	> 60	> 14	> 60	> 14	> 60	> 14	> 60
A mund ta lexoni gazetën?								
Po, me lehtësi	96.0	82.5	93.4	71.4	89.5	53.3	91.5	62.5
Po, me vështirësi	1.6	6.7	2.1	9.5	4.2	17.2	3.2	13.5
Jo	2.4	10.8	4.5	19.1	6.3	29.6	5.3	24.0
A mund të shkruani një letër?								
Po, me lehtësi	96.1	83.2	93.4	71.4	89.5	53.2	91.5	62.5
Po, me vështirësi	1.5	6.0	2.0	9.1	4.2	16.7	3.2	13.0
Jo	2.4	10.8	4.6	19.5	6.4	30.1	5.4	24.4

Dallime të ndjeshme ekzistojnë në arritjen arsimore midis popullsive qytetëse dhe fshatare, dhe ndërkohë që më pak se një e katërta e popullsisë fshatare ka mbaruar një shkollë të mesme, rreth dy të tretat e popullsisë së rritur të zonat fshatare kanë një diplomë të shkollës së mesme ose të shkollës profesionale (Tabela 2.9). Dallimi fshat-qytet është më i dukshëm në nivelet universitare dhe pas-universitare: në zonat fshatare vetëm 1 ndër 40 të rritur ka një diplomë universiteti, krahasuar me 1 në 5 në Tiranë dhe 1 në 10 në zonat e tjera qytetëse.

**Tabela 2. 9: Arritja arsimore**

Diploma më e lartë e arritur (%, 21 vjeç e lart)	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total
Pa shkollë	0.6	1.0	0.9	0.9
Fillor	7.1	10.8	19.9	15.3
8-vjeçar	25.2	34.0	55.3	44.4
E mesme e përgjithshme	21.4	22.3	10.3	15.6
Profesional 2-vjeçar	3.1	3.8	1.2	2.3
Profesional 4-vjeçar	19.2	18.0	10.0	13.8
Universitet dhe më lart	23.4	10.2	2.5	7.7
Numri mesatar i viteve të shkollimit	10.9	9.5	7.4	8.5

Shkollimi mesatar në grupmoshën 21 vjeç e lart është 8.5 vjet, ku të rriturit nga zonat fshatare mbarojnë mesatarisht 3.5 vjet ose më pak arsim zyrtar krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre në Tiranë dhe rreth 2 vjet më pak se të rriturit në zonat e tjera qytetëse. Rregjistrimi neto në skollat fillore është i lartë, në normën 93.3 përqind, ku nuk ka dallime të mëdha midis zonave qytetëse dhe atyre fshatare. Edhe normat bruto të rregjistrimit janë të mëdha, në masën 99.8 përqind. Megjithatë këto shifra ka mundësi të fshehin dallime të konsiderueshme përsa i përket frekuentimit dhe cilësisë së arsimit. Rezultatet e punës cilësore kanë treguar se fëmijët fshatarë e ndjekin shkollën vetëm 2-3 orë në ditë dhe vuajnë gjithashtu nga mungesat e mësuesve ose nga mësuesit e pakualifikuar, mungesa e materialeve didaktike dhe infrastruktura e dobët.<sup>18</sup>

Normat e rregjistrimit neto në shkollat e mesme na ofrojnë një pamje më akute të gjëndjes së sistemit arsimor në Shqipëri, ku më pak se 40 përqind e fëmijëve të grupmoshave përkatëse rregjistrohen në këto shkolla në të gjithë vendin (krahasuar me 43.9 përqind në vitin 1998). Hendeku midis normave të rregjistrimit në fshat dhe qytet është më i dukshëm në arsimin pas-

<sup>18</sup> Për rezultate të ngjashme në lidhje me cilësinë e panjërtrajtshme të arsimit, shih gjithashtu UNICEF (2000), *Një vlerësim i kushteve sociale dhe ekonomike të rretheve të Shqipërisë*.

fillor, ku më pak se 3 nga 10 fëmijë të moshave shkollore janë të rregjistruar në fshat krahasuar me 7 në Tiranë dhe 6 në zonat e tjera qytetëse (Tabela 2.10).

**Tabela 2. 10: Normat e rregjistrimit sipas vendodhjes**

	Qytet				Fshat		Total	
	Qytet total		Tirana	Qytete të tjera	1998	2002	1998	2002
<b>Rregjistrimi neto</b>	<b>1998</b>	<b>2002</b>	<b>2002</b>	<b>2002</b>	<b>1998</b>	<b>2002</b>	<b>1998</b>	<b>2002</b>
Fillore	97.2	92.9	92.2	93.2	93.4	93.5	94.6	93.3
Mesme	71.2	62.2	70.8	59.5	30.2	24.9	43.9	38.7
<b>Rregjistrimi neto</b>								
Fillore		99.2	97.5	99.6		100.2		99.8
Mesme		70.3	81.5	66.8		28.3		43.9

*Shënim: brezat moshorë për vitin 1998 janë 6-14 dhe 15-18 vjeç, respektivisht, për shkollën fillore dhe hskollën e mesme. Brezat moshorë për vitin 2002 janë përlllogaritur që nga 30 shtator 2001 (fillimi i vitit shkollor), dhe janë 6-13 për shkollën fillore dhe 14-17 për shkollën e mesme.*

Nga ata fëmijë që nuk janë të rregjistruar në shkollë, më shumë se gjysma thonë se nuk kanë interes të studiojnë, ndërkohë që një e katërta si arsye për mosvajtjen në shkollë dhanë nevojën për të shkuar në punë. Rreth dy të tretat e këtij grupi janë të përfshirë në bujqësi.

### iii. Kequshqyerja e fëmijëve

Kequshqyerja i referohet një gjëndjeje të pashëndetshme fiziologjike që lidhet me çekuilibret, teprinë apo mangësitë e energjisë, proteinave apo lendëve të tejsra ushqyese (psh jodi, vitamina A, hekuri) dhe është shpesh pjesë e rrethit vicioz që përfshin edhe varfërinë dhe sëmundjet. Marrja apo thithja e një sasive të papërshtatshme energjish çon në format të kequshqyerjes të cilat, sidomos tek fëmijët, zakonisht përkufizohen si më poshtë: *Dobësim* (peshë e ulët për gjatësinë), që është tregues i një humbjeje akute peshe kohët e fundit, shpesh e shoqëruar me uri akute ose sëmundje të tjera; *Shkurtësi* (gjatësi e vogël për moshën), që është tregues i pamundësisë për të arritur rritjen potenciale lienare si pasojë e një shëndeti afatgjatë jooptimal ose kusheve të këqija të ushqyerjes; dhe *Nënpesha* (peshë e vogël për moshën), që është tregues i një mase të vogël trupore krahasur me moshën, që vjen si pasojë e faktorëve të tillë si nivele të ulëta ushqimi, një histori ushqimi të pamjaftueshëm dhe kushteve të këqija shëndetësore.

Tabela 2.11 paraqet treguesit Z-score (me pikë, të cilat shprehin vlerën antropometrike si një numër i deviacionit standart poshtë ose sipër vlerës mediane të një popullate nga e cila është marrë zgjedhja) për dobësimin, shkurtësinë ose nënpeshën. Pikat e ndarjes të përdorur në këtë vlerësim janë -2 Deviacione standarte (SD) nga popullsia e references për të përkufizuar kequshqyerjen e moderuar dhe -3 SD për kequshqyerjen e rëndë.

**Tabela 2. 11: Kequshqyerja e moderuar dhe e rëndë tek fëmijët nën pesë vjeç**

	Shkurtësia		Dobësimi		Nënpesha	
	E moderuar	E rëndë	E moderuar	E rëndë	E moderuar	E rëndë
<i>Sipas vendodhjes</i>						
Fshat	34.9	18.6	11.8	2.9	15.5	1.7
Qytet	31.4	19.3	8.3	1.2	11.3	0.8
<i>Sipas gjinisë</i>						
Meshkuj	34.4	19.4	12.2	2.8	17.4	1.9
Femra	32.9	18.1	8.5	1.7	9.6	0.6

Total	33.7	17.3	10.6	2.3	14.0	1.4
-------	------	------	------	-----	------	-----


Siç duket edhe më sipër, një nga shtatë fëmijë në Shqipëri është shumë i shkurtër, ndërkohë që një në tre është paksa i shkurtër. Përqindja e fëmijëve paksa të dobët është më e ulët, rreth 10 përqind.<sup>19</sup> Në përputhje me treguesit e tjerë, zonat fshatare në përgjithësi kanë një ecuri më të keqe se zonat qytetëse në të tre llojet e matjeve. Megjithëse dallimet nuk janë shumë të mëdha në pamje, djemtë duken se janë më pak të ushqyer se vajzat. Në lidhje me moshën, fëmijët në grupmoshat 24-35 muajsh shfaqin nivelet më të larta të shkurtësisë në mes të gjithë fëmijëve nën pesë vjeç.

#### iv. Shëndeti i nënës dhe ai prenatal

Pothuajse gati çdo gruajë i ofrohet gjatë lindjes ndihma e një personeli të kualifikuar mjekësor (dmth mjek ose mami e kualifikuar). Pjesa më e madhe e grave marrin edhe kujdes gjatë shtatzanisë. Dallimet fshat-qytet janë të mprehta dhe ndërkohë që rreth 10 përqind e grave në fshat thonë se nuk marrin asnjë lloj ndihme mjekësore gjatë shtatzanisë, vetëm 2 përqind e grave në zonat qytetëse kanë të njëjtin problem (Tabela 2.12). 2.8 përqind gra të tjera në zonat fshatare thonë se marrin ndihmë vetëm nga një personel i pakualifikuar, krahasuar me 2 përqind në zonat qytetëse. Parë sipas rajoneve, gjëndja është më e keqe në zonën e largët verilindore të vendit, ku 17.6 përqind e grave nuk kanë mundësi për të marrë ndihmë prenatale gjatë shtatzanisë dhe 4 përqind të tjera mbështetet vetëm në personel të pakualifikuar. Midis atyre që përfitojnë nga kujdesi, gratë në zonat fshatare bëjnë 3 vizita shtatzanie krahasuar me 5 vizita nga grate në zonat qytetëse.

**Tabela 2. 12: Kujdesi prenatal gjatë shtatzanisë**

	Të kualifikuar	Të pakualifikuar	Asnjë kujdes
Qytet	95.9	2.0	2.1
Nga të cilët:			
Tirana	93.9	6.1	0
Qytete të tjera	96.7	0.3	2.9
Fshat	87.8	2.8	9.4
Tirana	93.9	6.1	0
Breg	92.1	0	7.9
Qendër	92.6	2.8	4.7
Malësi	78.4	4.0	17.6
Total	90.6	2.5	6.9



#### v. Dhënia e pushtetit dhe gjinia

Nxitja e barazisë midis gjinive dhe fuqizimit të të grave është njëri prej Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Një tregues që përdoret për të matur ecurinë në drejtim të këtij objekti është norma e rregjistrimit të vajzave dhe djemve në arsimin fillor dhe të mesëm.

...përfshirë në analizë, nga 1,342 përpjekje matjeje. Shumë e të gatshme të sugjeruara nga programi kompjuterik 'Anthro.'

Të dhënat e vëzhgimit LSMS nuk tregojnë asnjë dallim të dukshëm midis gjinive përsa i takon rregjistrimit në shkollën fillore dhe të mesme (Figura 2.4). Përqindja e popullsisë që di shkrim e këndim midis individëve të moshës 15-24 është rreth 98 përqind dhe duket se nuk ka asnjë dallim të dukshëm midis gjinive në lidhje me këtë tregues.

Një tjetër tregues i mirë i dallimeve midis gjinive është pjesa e femrave në punët e paguara në sektorin jobujqësor. Një analizë e pjesëmarrjes së krahut të punës tregon dallime të dukshme midis gjinive, ku pjesëmarrja e femrave është rreth sa dy të tretat e asaj të meshkujve. Pavarësisht nga vendodhja, pjesa e femrave që kanë një vend pune me kohë të plotë është shumë më e ulët dhe vetëm 23 përqind e femrave thonë se punojnë me kohë të plotë, krahasuar me 45 përqind e meshkujve që thonë se punojnë me kohë të plotë (Tabela 2.13). Normat e ndryshme të papunësisë sugjerojnë se një numër i madh i femrave marrin pjesë shumë pak në krahun e punës dhe se janë ose të punësuar në aktivitete bujqësore ose punonjëse të çinkurajuara.

**Tabela 2. 13:** Pjesëmarrja e krahut të punës të popullsisë që është në moshë pune, sipas gjinive (mosha > 14)

	Meshkuj	Femra	Total
Numri total që punojnë	64.1	44.8	53.9
<i>Nga të cilët:</i> punojnë me kohë të plotë*	44.6	22.8	33.1
Punojnë me kohë të pjesshme	19.5	22.0	20.8
Të papunë	7.1	4.8	5.9
Punonjës të çinkurajuar, sezonalë dhe të shkurtuar	3.6	4.3	4.0
Norma e papunësisë	9.9	9.6	9.8
Norma e papunësisë 2**	14.3	16.8	15.4
Norma e papunësisë 3***	17.0	21.9	19.1

\* Individë të cilët punojnë një periudhë mesatare prej 35 orësh ose më shumë në javë konsiderohen si punëtorë me kohë të plotë.

\*\* i përfshin punonjësit e çinkurajuar/sezonalë/të shkurtuar si të papunë.

\*\*\* i përfshin individët që punojnë më pak se 15 orë në javë nësektorin e bujqësisë si të papunë.

Krahasuar me zonat qytetëse, pjesa që zënë femrat që punojnë në numrin total të krahut të punës është shumë më i lartë dhe hendeku midis gjinive më i ngushtë në zonat fshatare, që pasqyron edhe një herë pjesëmarrjen e femrave në punët bujqësore të familjes si punëtoresh të papaguara me orar të pjesshëm. Po ta zbusim përkufizimin “e kriterit një orësh” të punësimit, normat e papunësisë tek femrat në zonat fshatare do të shkonin në 19.4 përqind, që është dukshëm më e lartë se 15.3 përqind papunësi tek meshkujt (Tabela 2.14).

**Tabela 2. 14:** Pjesëmarrja e krahut të punës: dallimet midis gjinive sipas rajonit (mosha > 14)

	Tirana			Qytet			Fshat		
	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total
Në punë	52.1	26.5	38.8	48.8	27.0	37.3	75.1	58.4	66.2
<i>Nga të cilët:</i> Me kohë të plotë *	46.8	21.7	33.7	38.0	19.8	28.4	47.8	24.7	35.6
Me kohë të pjesshme	5.4	4.8	5.1	10.8	7.2	8.9	27.4	33.6	30.7
Të papunë	11.9	7.2	9.5	11.9	10.4	11.1	3.3	1.2	2.2
Të çinkurajuar, sezonalë dhe të shkurtuar	4.2	3.1	3.6	5.8	7.4	6.6	2.3	2.8	2.6
Norma e papunësisë	18.6	21.4	19.6	19.6	27.7	22.9	4.2	2.0	3.2
Norma e papunësisë 2 *	23.6	28.0	25.2	26.6	39.7	32.2	7.0	6.4	6.7
Norma e papunësisë 3 **	18.6	21.4	19.6	20.2	29.3	23.9	15.3	19.4	17.2

\* Individë të cilët punojnë një periudhë mesatare prej 35 orësh ose më shumë në javë konsiderohen si punëtorë me kohë të plotë.

\*\* i përfshin punonjësit e çinkurajuar/sezonalë/të shkurtuar si të papunë.

\*\*\* i përfshin individët që punojnë më pak se 15 orë në javë nësektorin e bujqësisë si të papunë.

#### vi. Mundësia e shfrytëzimit të pronave

Pronësia e tokës është shumë e përhapur në Shqipëri, pas “privatizimit” të vrullshëm në fillim të viteve 90. Megjithatë pasja e mundësisë së përdorimit të një prone nuk duket se është një kusht i mjaftueshëm për të dale nga gjendja e varfërisë; madje, siç e tregon edhe Tabela 2.15, pronësia e tokës është më e përhapur tek të varfërit (91 përqind e familjeve të varfëra fshatare kanë tokë në pronësi) sesa tek jo të varfërit (87.5 përqind). Vetëm në zonat qytetëse pronësia e tokës është më e përhapur tek familjet jo të varfëra (7.4) krahasuar me të varfërit (6.0 përqind).

Madhësia mesatare e një ferme në Shqipëri është shumë e vogël, vetëm 0.72 hektarë në zonat fshatare sipas LSMS të vitit 2002. Dallimet absolute midis familjeve të varfëra (0.6 hektarë mesatarisht) dhe jo të varfëra (0.76 hektarë) nuk janë shumë të forta. Megjithatë, nëse shikojmë shifrat për frymë, madhësia mesatare e tokës në pronësi tek jo të varfërit në fshat është 1,812 metra katrorë, 74 përqind më shumë se 1,039 metra katrorë, që është madhësia mesatare e tokës në pronësi tek të varfërit.

**Tabela 2. 15: Pronësia dhe madhësia e tokës bujqësore**

	Fshat			Qytet			Total		
	Jo të varfër	Të varfër	Total	Jo të varfër	Të varfër	Total	Jo të varfër	Të varfër	Total
Përqindja e familjeve që kanë tokë bujqësore në pronësi	87.5	91.0	88.3	7.8	5.9	7.6	48.9	62.4	51.5

Gjëja e gjallë është një tjetër pronë e rëndësishme për fshatarët në Shqipëri dhe është burimi i një pjese të konsiderueshme të prodhimit bujqësor. Më shumë se 86 përqind e familjeve që merren me bujqësi kanë gjë të gjallë, ku familjet e varfëra (92.7 përqind) kanë më shumë gjë të gjallë në pronësi se familjet jo të varfëra (84.6 përqind). Megjithatë, të varfërit kanë një numër më të vogël krerësh, krahasuar me jo të varfërit.

**Tabela 2. 16: Pronësia e gjësë së gjallë tek familjet që merren me bujqësi**

	Jo të varfër	Të varfër	Total
Përqindja e familjeve që kanë gjë të gjallë në pronësi			
Kanë në pronësi	84.6	92.7	86.5
Nuk kanë në pronësi	15.4	7.3	13.6
Numri mesatar i krerëve në pronësi			
Gjedh	1.2	0.9	1.1
Dele	15.2	10.9	13.7
Dhi	21.2	11.7	17.3

Përsa i takon pronave jetëgjata, ka dallime të mëdha tek vlera totale midis zonave qytetëse dhe fshatare, ku individët e familjeve qytetëse kanë përafërsisht 45,000 Lekë mallra jetëgjata krahasuar me vetëm 27,000 Lekë të familjeve fshatare (Tabela 2.17).

**Tabela 2. 17: Vlera e mallrave jetëgjata sipas vendodhjes**

	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total
Vlera totale për frymë e mallrave shtëpiake jetëgjata (Lek)	42,071	46,810	26,923	34,680

Dallimi midis familjeve të varfëra dhe jo të varfëra përsa i takon pronësisë së mallrave jetëgjata është i madh, ku sipas vlerës, individët tejet të varfër kanë në pronësi vetëm një të tetën e pronave të individëve jo të varfër dhe një të dytën e atyre të të varfërve (Tabela 2.18).

**Tabela 2. 18: Vlera e mallrave jetëgjata sipas gjëndjes ekonomike**

	Jo të varfër	Të varfër	Tejet të varfër	Total
Vlera totale për frymë e mallrave shtëpiake jetëgjata (Lek)	43,008	11,374	5,100	34,680



#### 4. Varfëria subjektive

Pyetësi i LSMS përmban një modul për varfërinë subjektive dhe disa pyetje mbi mënyra të ndryshme subjektive matjeje dhe perceptime të ndryshme po subjektive të varfërisë iu dhanë kryefamiljarëve. Përgjigjet ndaj pyetjeve subjektive ofrojnë një pamje të errët, ku 9 nga 10 kryefamiljarë u përgjigjën se nuk ishin të kënaqur me gjëndjen e tyre financiare, ku rreth një e dyta e këtij grupi tha se ishin tejet të pakënaqur (Figura 2.5). Siç e tregon edhe Figura 2.6, pakënaqësia është e lartë, madje, edhe përsa i përket plotësisht të nevojave bazë.





Tabela 2.19 jep nivelet mesatarë të konsumit sipas vetëvlerësimit të gjëndjes financiare të kryer nga kryefamiljari. Marrëdhënia midis gjëndjes objektive dhe subjektive është njësoj pavarësisht nga vendodhja. Niveli i shpenzimeve për frymë i familjeve me kryefamiljarë të pakënaqur nga ana financiare është më pak se një e dyta e shpenzimeve mesatare të atyre familjeve kryetarët e të cilave janë plotësisht të kënaqur me kushtet e tyre financiare.

**Tabela 2. 19: Kënaqësia me gjëndjen financiare dhe konsumin mesatar për frymë.**

	Tirana		Qytet		Fshat		Total	
	Konsumi mesatar pf	%	Konsumi mesatar pf	%	Konsumi mesatar pf	%	Konsumi mesatar pf	%
Plotësisht të kënaqur	17502	2.8	18341	2.1	13344	1.8	15638	2.0
Disi të kënaqur	14956	13.0	12196	12.4	9801	9.5	11343	10.8
Jo të kënaqur	8812	42.9	8528	45.7	7542	48.4	7965	46.9
Aspak të kënaqur	6762	40.7	6718	39.8	5942	40.4	6269	40.2
Total	9403	100.0	8468	100.0	7212	100.0	7801	100.0

Midis treguesve subjektivë të përdorur, LSMS përfshiu gjithashtu edhe një pyetje të modifikuar të shkallës Cantril, e cila iu referua shprehimisht vlerësimit të njerëzve në lidhje me mirëqënien e tyre ekonomike dhe jo kënaqësisë për jetën në përgjithësi.<sup>20</sup> Të anketuarëve iu kërkua ta rendisnin veten në një shkallë me dhjetë kategori, ku kategoria e fundit nënkuptonte më të varfërit dhe ajo e

<sup>20</sup> Në mënyrë specifike, pyetja ishte: “Imagjinoni një shkallë me dhjetë breza ku në fund, në brezin e parë, qëndrojnë njerëzit më të varfër, dhe në brezin më të lartë, në të dhjetin, qëndrojnë të varfërit. Në cilin brez të shkallës ndodhni ju sot?”

sipërmja më të pasurit. Në total, 26.2 përqind e të anketuarve e klasifikuan veten në kategorinë e fundit të shkallës së mirëqënies ekonomike, ndërsa vetëm 6.9 përqind e klasifikuan veten në tre kategoritë më të sipërme. Shumica e familjeve (23.7 përqind e renditën veten në kategorinë e tretë nga fundi, të ndjekura nga 21.3 përqind në kategorinë e katërt nga fundi dhe 16.1 përqind në kategorinë e pestë. Nëse dy kategoritë e fundit klasifikohen si të varfëra, matja subjektive e varfërisë prej 26.2 i përafrohet në mënyrë interesante matjes objektive. Megjithatë, nuk është e qartë nëse këto dy grupe janë po ato.

Në total, duket se ekziston një korrespondence e moderuar midis matjeve objektive dhe subjektive. Korrelacioni i rradhitjes midis ndryshoreve të konsumit për frymë dhe një shkalle me shtatë beza 7-rung scale<sup>21</sup> të matjes subjektive është 0.49 (Tabela 2.20). Tek ata që janë klasifikuar si të varfër “objektiv”, vetëm një e dyta e tyre e konsiderojnë veten si të varfër. Një përqindje e ngjashme e individëve të cilët e perceptojnë veten si të varfër, janë të varfër sipas matjes objektive metrike monetare. Tek jo të varfërit, një në pesë individë e perceptojnë veten si të varfër. Në tërësi, duket se njerëzit nuk e njësojnë konceptin e varfërisë vetëm me të ardhurat.

**Tabela 2. 20: Krahasimi i varfërisë objektive me atë subjektive**

Të varfër objektiv	Të varfër subjektiv		
	Jo të varfër	Të varfër	Total
Jo të varfër	81.9	18.1	100
	82.8	51.6	74.6
Të varfër	50.1	49.9	100
	17.2	48.4	25.4
Total	73.4	26.2	100
	100	100	100

Përgjigjet ndaj pyetjeve subjektive në pyetësorin e LSMS japin gjithashtu njëfarë treguesi të stadarteve të jetesës në Shqipëri në lidhje me rritjen e qëndrueshme ekonomike. Përgjigjet tregojnë se një në dhjetë kryefamiljarë thonë se u është përkeqësuar gjendja financiare vetiake gjatë tre vjetëve të fundit, ndërkohë që një të tretat e të gjitha familjeve thonë se kjo gjendje u është përmirësuar. Në të njëjtën kohë, më shumë se 20 përqind e familjeve mendojnë se në përgjithësi jeta e tyre është përkeqësuar dhe më shumë se 40 përqind e tyre thonë se shqetësim kryesor kanë kujdesin shëndetësor. Në përgjithësi, jo të varfërit duken se kanë perceptim pozitiv (ose jo negativ, të paktën) në lidhje me ndryshimet e mirëqënies së tyre ekonomike gjatë tre vjetëve të fundit, ndërkohë që tek të varfërit një pjesë e madhe (tek tejet të varfërit, kjo pjesë përbën shumicën) mendojnë se gjendja e tyre është përkeqësuar. Shumë pak prej të varfërve mendojnë se gjendja e tyre është përmirësuar gjatë tre vjetëve të fundit. Rreth dy të tretat e tejet të varfërve mendojnë se gjendja e tyre është përkeqësuar në fakt dhe një e treta që ngelet mendojnë se kjo gjendje nuk ka ndryshuar.

Është e vështirë të arrish në konkluzione të forta mbështetur në ato sa përmenden më sipër, edhe pse në të vërtetë duket sikur Shqipëria është një vend që po e merr veten, përse i përket të adhurave, por të varfërit e ndjejnë veten të përjashtuar nga ky përmirësim. Në të njëjtën kohë, më shumë shqiptarë duket se kanë pësuar një përkeqësim të kushteve të tyre të jetesës përse i takon dimensioneve të jetës së përditshme që nuk kanë lidhje me të ardhurat.

<sup>21</sup> Duke pasur parasysh numrin e kufizuar të të anketuarve të cilët e klasifikuan veten në katër brezat e sipërm, i futëm në një grup të vetëm.

## **5. Një profil i varfërisë**

### **i. Tiparet demografike të të varfërve**

Madhësia mesatare e një familjeje shqiptare është 4.3 anëtarë për familje. Madhësia mesatare e familjes tek të varfërit është 5.7, nga të cilët 2 anëtarë janë nën 15 vjeç, krahasuar me një madhësi familjeje prej 4 anëtarësh tek jo të varfërit, nga të cilët 1 është nën moshën 15 vjeç. Raporti i varësisë është vazhdimisht më i lartë tek të varfërit, pavarësisht vendodhjes. Kryefamiljarët e familjeve të varfëra janë mesatarisht 3.6 vjetë më të vegjël në moshë se kryefamiljarët e familjeve jo të varfëra dhe kanë vetëm 6 vjet shkollë, krahasuar me tetë vjetë tek jo të varfërit.

**Tabela 2. 21: Tiparet kryesore të të varfërve**


	Të varfër				Jo të varfër				Total			
	Tirana	Qytet	Fshat	Total	Tirana	Q	Fshat	Total	Ti	Q	F	T
Madhësia mesatare e familje	5.3	5.4	5.8	5.7	3.6	3.7	4.2	4.0	3.8	4.0	4.6	4.3
% 60 e lart	13.2	9.7	10.0	10.2	19.4	19.5	19.9	19.7	18.6	18.1	17.6	17.8
Nr i anëtarëve nën 15 vjeç	1.8	1.9	2.2	2.1	0.8	0.9	1.2	1.0	0.9	1.1	1.4	1.2
Raporti i varësisë	1.04	1.06	1.16	1.12	0.66	0.73	0.83	0.77	0.71	0.78	0.91	0.84
% familje me kryefamiljare femra	10.5	12.1	8.1	9.3	18.0	13.5	11.6	13.1	17.0	13.3	10.7	12.4
Mosha e kryefamiljarit	49.1	49.0	47.8	48.2	53.4	51.7	51.4	51.8	52.8	51.3	50.1	51.1
Vitet e arsimimit të kryefamiljarit	6.8	6.7	6.0	6.2	10.1	8.6	6.9	7.9	9.5	8.3	6.6	7.4
Nr mesatar i punëtorëve në familje	1.0	1.0	2.3	1.9	1.1	1.1	2.0	1.6	1.1	1.1	2.1	1.6

*Nurmi mesatar i punëtorëve përfshin punëtorë 15 vjeç e sipër vetëm.*

*Numri mesatar i shkollës së kryefamiljarit presupozon që kryefamiljari i ka plotësuar numrin maksimal të mundshëm të vjetëve në nivelin e shkollës së mesme të plotësuar.*

*Raporti i varësisë = (numri i fëmijëve të moshës 0-14 vjeç + numri i të moshuarve të moshës 60 e lart) / numrin e anëtarëve të familjes të moshës 15-59 vjeç*

Normat e varfërisë janë më të larta tek familjet e mëdha me 7 ose më shumë vetë, ku normat e varfërisë janë 50 përqind pavarësisht vendodhjes (Figura 2.7). Familjet me 4 ose më pak vetë përfaqësojnë rreth 43 përqind të popullsisë, por përbëjnë vetëm 15 përqind të të varfërve. Rreth 40 përqind e të varfërve jetojnë në familje të mëdha me 7 ose më shumë vetë (ndërkohë që përfaqësojnë vetëm 17 përqind të popullsisë).



Përqindja e varfërisë tek më të rinjtë është sipër mesatares kombëtare dhe është më e lartë tek fëmijët fshatarë. Në zonat fshatare, 4 nga çdo 10 fëmijë nën moshën 5 vjeç jetojnë në varfëri. Gati

gjysma e të varfërve të Shqipërisë janë nën moshën 21 vjeç. Të moshuarit në Tiranë shfaqin normat më të ulëta, me një përqindje prej 12 përqind.<sup>22</sup>

**Tabela 2. 22: Matjet dhe përqindjet e varfërisë sipas grupmohave dhe vendodhjeve**

	Përqindjet e varfërisë				% e popullsisë	Pjesa e varfërisë
	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total		
<b>Grupmoshat</b>						
Nën 5 vjeç	26.91	26.6	38.33	34.26	8.49	11.45
5-10 vjeç	27.16	24.27	37.4	32.76	11.98	15.46
11-21 vjeç	21.32	26.47	33.6	30.35	15.03	17.97
18-25 vjeç	18.43	20.01	26.11	23.55	10.96	10.17
26-45 vjeç	18.39	20.55	29.14	25.06	26.73	26.38
46-55 vjeç	9.62	11.94	22.1	16.8	10.29	6.81
Mbi 55	12.33	13.73	21.73	18.07	16.52	11.76
Total	17.83	20.13	29.6	25.39	100	100

## ii. Varfëria, kushtet e banesave dhe mundësitë e përdorimit të shërbimeve

Duket se ekziston një lidhje e fortë midis dimensioneve të privimit që nuk kanë lidhje me të ardhurat dhe varfërisë së të ardhurave. Edhe pas kontrollimit të dallimeve fshat-qytet, të varfërit përfitojnë më pak nga mundësia e përdorimit të shërbimeve publike dhe private. Individët e varfër janë dy herë më të predispozuar se jo të varfërit për të mos pasur mundësi përdorimi të mjediseve hidrosanitare të përshtatshme dhe janë edhe më pak të predispozuar për të pasur mundësi përdorimi të ujit të rrjedshëm. Gjithashtu, ata jetojnë në banesa të mbipopulluara: dallimi midis indeksit të mbipopullimit të të varfërve dhe jo të varfërve është i madh, ku pothuajse gjysma e të varfërve e ndajnë dhomën me dy ose më shumë anëtarë të tjerë të familjes, kundrejt vetëm 20 përqind tek jo të varfërit. Siç pritej, kufizimet me energji elektrike i kalojnë kufijtë ekonomikë, duke prekur gati në mënyrë të barabartë si të varfërit ashtu edhe jo të varfërit. Tek të varfërit, tetë nga dhjetë individë nuk kanë mundësi përdorimi telefoni privat.

**Tabela 2. 23: Varfëria, kushtet e jetesës dhe mundësia e përdorimit të shërbimeve**

	Jo të varfër			Të varfër			Total
	Qytet	Fshat	Total	Qytet	Fshat	Total	
<b>Uji</b>							
Ujë i rrjedhshëm brenda	90.3	27.4	55.7	73.6	13.4	32.7	49.8
Ujë i rrjedhshëm jashtë	5.1	21.2	14.0	11.4	30.3	24.2	16.5
Pa ujë të rrjedhshëm	4.7	51.5	30.4	15.1	56.4	43.1	33.6
<b>Kanalizime</b>							
WC brenda	92.0	48.3	68.0	80.7	22.9	41.4	61.2
WC jashtë, me kanalizim	5.6	13.1	9.7	10.4	14.4	13.1	10.6
WC jashtë, pa kanalizim	2.2	38.4	22.1	8.6	62.4	45.2	28.0

<sup>22</sup> Vini re se në përgjithësi profilet demografike janë të ndjeshëm ndaj presupozimeve të shkallës së barazvlefshmërisë të bëra në matjen e mirëqënies. Megjithatë, rezultatet e ndjeshmërisë së kryer (shih Aneksin II) tregojnë se renditjet e varfërisë janë të paepshme ndaj presupozimeve të ndryshme të shkallës së barazvlefshmërisë.

<b>Mundësi përdorimi telefoni</b>							
Fiks dhe celular	24.5	1.4	11.8	3.9	0.4	1.6	9.2
Vetëm linjë fikse	27.6	1.7	13.4	17.1	0.0	5.5	11.3
Vetëm celular	25.1	43.3	35.1	22.3	10.6	14.3	29.8
Pa telefon	22.8	53.6	39.7	56.7	89.0	78.6	46.6
<b>Energjia elektrike (nr i orëve të kufizimeve në ditë)</b>							
Asnjëherë	20.5	7.1	13.1	36.3	5.9	15.6	13.8
1-5 orë	34.6	19.0	26.0	29.7	19.4	22.7	25.2
6-12 orë	37.8	57.0	48.3	27.5	54.2	45.6	47.7
Më shumë se 12 orë	7.1	17.0	12.5	6.6	20.5	16.1	13.4
<b>Mbipopullimi (vetë në dhomë)</b>							
Më pak se 1	8.1	6.1	7.0	0.8	0.5	0.6	5.4
1 deri në 3	76.2	69.9	72.6	51.0	50.7	50.8	67.2
3 e më shumë	15.7	24.0	20.3	48.2	48.7	48.6	27.5
<b>Largësia nga qendra shëndetësore</b>							
10 minuta ose më pak	60.5	44.0	51.4	49.0	29.7	35.8	47.4
11-29 minuta	36.2	36.8	36.6	48.6	39.7	42.5	38.1
30-59 minuta	1.9	7.0	4.7	1.5	9.6	7.0	5.3
Një orë ose më shumë	1.4	12.2	7.4	1.0	21.1	14.7	9.2

### **KUTIA 2.2: Të mungon telefoni? Atëherë, është Vodafoni!**

Biznesi shpërthyes i telefonisë celulare, përkundër një sistemi tokësor të kufizuar e keqfunksionues, është tepër i dukshëm në Shqipëri. Mjafton të dalësh një shëtitje në këmbë në Tiranë dhe të bëhet e qartë se si shqiptarët e të gjitha moshave po mbështeten gjithnjë e më shumë tek teknologjia e fundit e telefonave celularë. Siç e tregojnë edhe të dhënat e LSMS, gati dy të tretat e popullsisë më në gjendje të Tiranës kanë të paktën një lidhje me telefoni celular në familje dhe gati po e njëjta përqindje kanë lidhje me telefon fikse në shtëpi. Tek të varfërit gjendja ndryshon disi: katër nga dhjetë banorë të varfër të Tiranës nuk kanë lidhje telefonike, edhe pse një e treta e tyre kanë lidhje me një telefon celular në familje. Në zonat fshatare, një përqindje më e madhe si e të varfërve ashtu edhe jo të varfërve kanë telefona celularë sesa ata që kanë telefona fikse, çka ka gjasa se pasqyron mbulimin e pakët me shërbimin tokësor në zonat e largëta. Dallimi midis të varfërve dhe jo të varfërve në zonat fshatare është i madh, ku të varfërit kanë mbetur shumë mbrapa në mundësinë e shfrytëzimit të shërbimeve telefonike, qofshin këto shërbime fikse ose celulare.

Shqiptarët qytetës shpenzojnë mesatarisht 5 përqind të buxhetit të tyre mujor për telefonata. Madje edhe në zonat fshatare, pjesa që zënë në buxhet shpenzimet për telefonin është e konsiderueshme, në masën 3 përqind. Megjithatë, po të kemi parasysh mundësinë e kufizuar të përdorimit të telefonave private në këto zona, përfituesit më të mëdhenj ka të ngjarë të jenë ofruesit e telefonisë vendore. Ndërkohë që telefoni celular duket se ofron me të vërtetë një zgjidhje alternative kundrejt telefonave fikse për banorët fshatarë më në gjendje, kostot e mëdha të këtij shërbimi e bëjnë të pamundur për të përfaqësuar një zgjidhje të mundshme alternative edhe për të varfërit, sidomos për të varfërit në fshat. Për ata që nuk mund të përballojnë koston e një

telefoni celular, karta telefonike dhe një telefon publik mbeten ende alternative më e mundshme për të mbajtur lidhjet.


### iii. Varfëria dhe arsimi

Lidhja e fortë midis varfërisë dhe niveleve të ulëta të arsimimit është e pranuar nga të gjithë dhe konfirmohet edhe nga analiza e të dhënave të LSMS. Përqindja e rregjistrimit në shkollën fillore është më e ulët tek të varfërit dhe më e ulët tek tejet të varfërit. Ky model është më shumë i theksuar për përqindjen e rregjistrimit në shkollën e mesme. Tek të varfërit dhe tejet të varfërit, vetëm 2 nga 10 fëmijë rregjistrohen në shkollën e mesme, kundrejt 5 nga 10 fëmijë tek jo të varfërit.

**Tabela 2. 24: Rregjistrimi neto sipas gjendjes ekonomike**

	Tejet të varfër	Të varfër	Jo të varfër	Total
<b>Rregjistrimi neto</b>				
Filllore	88.6	91.6	94.1	93.3
E mesme	19.8	19.4	46.7	38.7
<b>Rregjistrimi bruto</b>				
Filllore	90.9	97.1	101.1	99.8
E mesme	21.0	21.6	53.1	43.9

Grafiku i mëposhtëm jep një përfaqësim pamor të hendekut në rritje të normave të rregjistrimit sipas grupmoshave midis të varfërve dhe jo të varfërve. Megjithëse prirjet e normave të rregjistrimit në shkollat e mesme mbeten një shqetësim i përgjithshëm, pavarësisht gjëndjes shoqërore ekonomike, madhësia e normave të braktisjes së shkollës midis moshave 14 dhe 18 vjeç tek të varfërit është mbresëlënëse.




Përqindja e varfërisë tek të rriturit që kanë vetëm një dëftesë të shkollës fillore ose më pak është sa dyfishi i përqindjes së varfërisë tek individët që kanë një dëftesë shkolle profesionale ose më lart. Më shumë se 80 përqind e të varfërve nuk e kanë mbaruar shkollën e mesme apo nuk kanë dëftesë të një shkolle profesionale.




**Tabela 2. 25: Matjet e varfërisë dhe përqindjet sipas rezultateve shkollore dhe vendodhjes**

Rezultati shkollor për personat 21 vjeç e sipër	Matjet e varfërisë				% e popullsisë	Pjesa e varfërisë
	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total		
Pa arsim	19.0	20.5	30.7	26.6	3.5	4.1
Fillor	26.7	26.1	30.8	29.3	61.6	79.4
Të mesme	10.5	14.3	19.5	15.6	15.8	9.7
Profesionale 2-vjeçare	14.2	14.4	17.1	15.0	1.5	0.8
Profesionale 4-vjeçare	10.9	8.2	16.5	12.0	10.7	5.2
Universitet ose më sipër	2.9	2.6	3.8	2.9	6.9	0.7
Total	15.9	18.8	28.1	23.7	100.0	100.0

Vetëm 20 përqind e të varfërve i kanë vazhduar studimet pas shkollës fillore, ndërkohë që tek jo të varfërit kjo përqindje shkon mbi 40 përqind. Hendeku midis rezultateve shkollore të të varfërve dhe atyre të jo të varfërve është më i dukshëm në Tiranë, ku më shumë se dy të tretat e të rriturve kanë një diplomë pas shkollës fillore (ndërsa 25 përqind kanë një diplomë universitare), krahasuar me vetëm një të tretën tek të varfërit (dhe vetëm 3.5 përqind e të cilëve kanë mbaruar universitetin). Edhe pse të dukshme, dallimet midis të varfërve dhe jo të varfërve në zonat e tjera qytetëse janë më pak të theksuara, duke pasqyruar ndoshta dallimet midis arsimit që ofron Tirana dhe pjesa tjetër e vendit.



Përveç hendekut midis të varfërve dhe jo të varfërve, duket se edhe gjinia i shtohet rezultatit arsimor. Për një nivel të njëjtë ekonomik, të rriturit meshkuj janë më të arsimuar se të rriturat femra. Gati një e dyta e meshkujve jo të varfër kanë një diplomë të një shkolle pas asaj fillore (11 përqind kanë mbaruar universitetin, krahasuar me një të tretën e të rriturave femra (6 përqind e të cilave kanë mbaruar universitetin). Edhe tek të varfërit, përqindja e meshkujve me arsim më të lartë është më e lartë se ajo e femrave.



Arritja e synimit të OZHM për një rregjistrim universal në arsimin fillor është brenda mundësive të vendit. Më e vështirë, por ndoshta me një ndikim më afatgjatë, është rritja e rregjistrimit në shkollat e mesme dhe ato profesionale. Arsimi sipër nivelit të shkollës fillore ka një ndikim të madh për uljen e varfërisë dhe kjo duhet të vazhdojë të jetë një element i rëndësishëm i strategjisë së qeverisë.

**Tabela 2. 26: Varfëria dhe kequshqyerja e fëmijëve**

	Shkurtësia		Dobësimi		Nënpesha	
	E lehtë	E rëndë	E lehtë	E rëndë	E lehtë	E rëndë
Të varfër	36.0	17.2	11.4	3.3	17.6	2.5
Jo të varfër	32.5	19.9	10.3	1.8	12.2	0.7

Edhe kequshqyerja është gjetur se është disi më e zakonshme tek fëmijët e varfër nën 5 vjeç që janë të varfër sesa tek ata që nuk janë të varfër. Megjithatë, dallimet nuk janë të mëdha dhe nga ana statistikore janë të rëndësishme vetëm tek shkurtësia dhe nënpesha e lehtë.

#### iv. Varfëria dhe punësimi

Pavarësisht se si përkufizohet punësimi, të varfërit shfaqin norma më të mëdha papunësie kur krahasohen me jo të varfërit. Norma e papunësisë tek të varfërit sipas përkufizimit standart të ILO – në masën 14.2 përqind – është gati dyfishi i norms së papunësisë tek jo të varfërit. Tek tejet të varfërit kjo normë papunësie është thujse trefishi. Nëse përdorim një përkufizim më të lirshëm, normat e papunësisë tek tejet të varfërit është mbi 30 përqind. Midis të varfërve mund të gjejmë një pjesë shumë më të lartë të punonjësve marzhinalë, dmth punëtorët e çinkuruar, sezonalë dhe të pushuar nga puna.

**Tabela 2. 27: Pjesëmarrja e krahut të punës për të varfërit dhe jo të varfërit (mosha > 14)**

	Jo të varfër	Të varfër	Tejet të varfër	Total
Të punësuar	54.3	52.5	43.1	53.9
<i>Nga të cilët:</i>				
Me kohë të plotë *	34.3	28.9	20.0	33.1
Me kohë të pjesshme	20.0	23.6	23.0	20.8
Të papunë	5.0	8.7	13.4	5.9
Punëtorë të çinkurajuar, sezonalë dhe të pushuar nga puna	3.6	5.3	6.4	4.0
Norma e papunësisë	8.5	14.2	23.7	9.8
Norma e papunësisë 2**	13.7	20.9	31.5	15.4
Norma e papunësisë 3***	17.7	24.0	33.1	19.1

\* Individë të cilët punojnë një periudhë mesatare prej 35 orësh ose më shumë në javë konsiderohen si punëtorë me kohë të plotë.

\*\* i përfshin punonjësit e çinkurajuar/sezonalë/të shkurtuar si të papunë.

\*\*\* i përfshin individët që punojnë më pak se 15 orë në javë nësektorin e bujqësisë si të papunë.

Përqindja dhe madhësia e varfërisë janë më të mëdha tek familjet ku kryetari i familjes është i papunë. Në secilën prej tre zonave të cilat i mbulon LSMS (Tirana, qytete të tjera dhe fshat) përqindja e varfërisë është gati dyfish tek këto familje, krahasuar me familjet kryefamiljarët e të cilave janë në punë. Një dallim i ngjashëm mund të vihet re tek hendeqet e varfërisë si në zonat fshatare ashtu edhe në ato qytetëse. Në Tiranë, dallimi përsa i takon madhësisë së varfërisë midis këtyre dy grupeve është edhe më i theksuar, ku ky hendek është më shumë se tre herë më i madh nëse kryefamiljari është i papunë.

**Tabela 2. 28: Matjet e varfërisë sipas gjëndjes së punësimit të kryefamiljarit**

Gjëndja e punësimit të kryefamiljarit	Matja e varfërisë			Total
	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	
Përqindja				
Të papunë *	31.7	28.6	51.0	36.2
Të punësuar	16.4	15.7	28.3	24.1
Hendeku i varfërisë				
Të papunë *	9.8	6.0	12.1	8.5
Të punësuar	3.1	3.5	6.5	5.5

\* Përkufizimi standart i ILO

Nnumri i personave të punësuar për familje nuk duket se ka lidhje me varfërinë në të njëjtën mënyrë në vendodhje të ndryshme. Jashtë Tiranës një burim të ardhurash duket se është i mjaftueshëm për të ulur në mënyrë të dukeshme predispozitën për të qënë i varfër, ndërsa në Tiranë duhen të paktën dy burime për një gjë të tillë. Në zonat fshatare, meqënëse punësimi shtesë ka gjasa të fshehtë nëpunësimin në fermat familjare, nuk ekziston asnjë marrëdhënie e drejtpëdrejtë midis numrit të personave të punësuar për familje dhe varfërisë.

**Tabela 2. 29: Normat e varfërisë sipas numrit të personave të punësuar dhe vendodhjes**

Numri i personave të punësuar për familje	Vendodhja			Total
	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	
0	20.6	26.3	39.7	29.3
1	19.5	18.6	26.3	21.6
2 ose më shumë	14.5	17.7	29.6	26.3
Total	17.8	20.1	29.6	25.4

#### v. Varfëria dhe burimet e të ardhurave

Tabela 2.30 tregon përbërjet e ndryshme të të ardhurave të familjeve të varfëra dhe jo të varfëra. Burimi kryesor i të ardhurave për familjet e varfëra është biznesi bujqësor (37%), i ndjekur nga punësimi me pagë (27%). Për familjet jo të varfëra puna e varur është burimi i vetëm më i rëndësishëm (35%), i ndjekur nga bujqësia (25%) dhe transfertat (14%). Biznesi jo bujqësor ofron vetëm 6% të të ardhurave të familjeve të varfëra, diçka më pak se transfertat (8%) dhe “Ndihma Ekonomike” (7%). Krahasuar me familjet e varfëra, familjet jo të varfëra nxjerrin një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre nga transfertat. Për të dyja grupet, pensionet japin rreth 14% të totalit. Po ashtu, nuk mund të vihet re asnjë dallim përsa i takon pjesës së të ardhurave që vijnë nga asistenca e papunësisë (më pak se 1%), lejet e lindjes, kujdesi social dhe transferta të tjera të vogla publike dhe burime të tjera (të dyja më pak se 1%).

**Tabela 2. 30: Përqindjet e të ardhurave sipas gjëndjes së varfërisë**

	Punë e varur	Biznes bujqësor	Biznes jo bujqësor	Transferta	Ndihme Ekonomike	Pensione	Asistencë papunësie	Leje lindje, kujdes social, asistenca të tjera	Të tjera
Jo të varfër	34.6	24.8	8.5	14.4	2.0	13.7	0.4	1.3	0.5
Të varfër	26.8	36.7	5.7	7.9	7.4	14.1	0.5	0.6	0.3
<b>Total</b>	32.6	27.8	7.8	12.7	3.4	13.8	0.4	1.1	0.4

Në Tabelën 2.31, familjet janë klasifikuar sipas burimit kryesor të të ardhurave, dmth atij burimi që jep më shumë se 50% të totalit.<sup>23</sup> Më shumë se një e treta e familjeve që janë përfshirë në LSMS e marrin shumicën e të ardhurave të tyre nga puna me pagë (kjo pjesë është më e lartë në zonat qytetëse, sidomos në Tiranë– 64%). Në këtë grup, indeksi i përqindjes së varfërisë është rreth 21%, duke ndryshuar nga 19% në zonat qytetëse në 24% në zonat fshatare. Ashtu siç pritej, varfëria është më e mprehtë për familjet që mbështeten tek asistenca sociale (“Ndihme Ekonomike”, asistenca e papunësisë, leje lindje, kujdes social dhe transferta të tjera publike), ku indeksi i përqindjes është 46%, dhe është më i lartë në zonat qytetëse (48%) sesa në zonat fshatare (43%). Varfëria është po ashtu e mprehtë për familjet që mbështeten kryesisht tek biznesi bujqësor (34%, e të gjithë varfërisë fshatare) dhe tek pensionistët fshatarë (32%).

<sup>23</sup> Kjo nënkupton që rreth 5 përqind e familjeve nuk janë përfshirë në tabelë meqenëse asnjë burim i vetëm nuk e arrin këtë prag.

Midis atyre që mbështeten tek pensionet, familjet fshatare janë shumë më të varfëra, me një indeks të përqindjes së varfërisë që arrin 32%, krahasuar me 22% në zonat qytetëse. Përqindja e varfërisë është më e vogël tek familjet që mbështeten tek biznesi jo bujqësor (14%) dhe tek transfertat (17%). Normat e varfërisë tek familjet që mbështeten tek transfertat janë më të larta në zonat qytetëse (21%) se në zonat fshatare (15%).

**Tabela 2. 31: Përqindja e varfërisë sipas burimit kryesor të të ardhurave (të paktën 50%)**

	Qytet		Fshat		Total	
	Nr vëzh	Indeksi i përqindjes së varfërisë	Nr vëzh	Indeksi i përqindjes së varfërisë	Nr vëzh	Indeksi i përqindjes së varfërisë
Punë e varur	1029	18.8	341	23.7	1370	20.5
Biznes bujqësor	24	--n/a--	696	34.0	720	33.6
Biznes jo bujqësor	264	11.6	72	17.1	336	13.5
Transferta	134	21.2	168	14.6	302	16.7
Pensione	339	21.5	178	32.0	517	26.3
Asistencë sociale: Ndihe Ekonomike, papunësi, leje lindje, kujdes social, të tjera	77	48.1	55	43.1	132	45.6
Të tjera	10	--n/a--	3	--n/a--	13	--n/a--

## 6. Zbrëthimi e pabarazisë së të ardhurave

Proçesi i tranzicionit ekonomik shpesh ka ngritur shqetësime në lidhje me pasojat e mundshme negative mbi pabarazinë. Evidenca në rritje ekziston në vendet ECA për të mbështetur këtë pikëpamje dhe në lidhje me mënyrën se si pabarazia në rritje mund të pengojë proçesin e rritjes dhe të pengojë gjithashtu zbutjen e varfërisë. Një pjesë e mirë e rritjes së pabarazisë në ekonomitë në tranzicion mund të lidhet me rënien e punësimit të garantuar dhe rënien drastike të të ardhurave relative apo absolute të shumë punëtorëve të pakualifikuar. Në këtë aspekt, shumë veta do të thonin se një rritje e pabarazisë do të ishte në fakt një rezultat i mirëpritur, meqenëse do të pasqyronte një strukturë stimuluese që shpërblen produktivitetin e individëve dhe dallimet e kapitalit njerëzor. Megjithatë, pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme, pabarazia në rritje po bëhet një problem i mprehtë shoqëror në rajonin e ECA dhe shpesh lidhet me kohezionin e shprishur social dhe qeverisjen e dobët.

Pabarazia zbrëthet në përgjithësi në dy drejtime: (a) brenda dhe midis nëngrupeve të popullsisë; dhe (b) sipas burimit të të ardhurave. Ndërkohë që përdoret një koeficient Theil për llojin e parë të analizës, zbrëthimi i dytë mbështetet në koeficientin Gini. Synimi i zbrëthimit të propozuar është të eksplorojë natyrën e shoqërimit midis përbërësve të ndryshëm të të ardhurave dhe pabarazisë. Në veçanti, jemi të interesuar të dime nëse transfertat, qofshin publike ose private, kanë luajtur një rol stabilizues dhe nëse kanë çuar në zbutjen e pabarazisë.

Siç është thënë edhe më parë në këtë kapitull, pabarazia e konsumit në Shqipëri është relativisht e butë, me një koeficient Gini rreth 0.3. Megjithatë, pabarazia e të ardhurave është dukshëm më e lartë, me një Gini të të ardhurave totale për frymë prej 0.58. Rezultatet e zbrëthimit jepen në Tabelat 2.32 dhe 2.33, të cilat japin, për secilin përbërës të të ardhurave  $k$ , përqindjen e të ardhurave totale,  $S_k$ , koeficientin e përqëndrimit dhe kontributin marzhinal ndaj pabarazisë totale,  $P_k$ . Koeficienti  $\epsilon_k$  jep kontributin marzhinal të secilit burim të pabarazisë totale. Kur koeficienti i

përqëndrimin të burimit k është më i madh se koeficienti i përgjithshëm Gini, një rritje e burimit të të ardhurave k (duke mbajtur konstante çdo gjë tjetër) do të rriste pabarazinë.

Tabela 2.33 tregon se pabarazia ka një korrelacion pozitiv (të fortë) me të ardhurat nga biznesi jo bujqësor. Koeficienti relativ i përqëndrimin është shumë më i lartë se koeficienti i përgjithshëm Gini (0.99 kundrejt 0.58), kontributi në përqindje ndaj pabarazisë së përgjithshme është i lartë ( $P_k$  e barabartë me 43%) dhe kontributi marzhinal është pozitiv. Puna e varur shpjegon një pjesë të mirë pabarazisë, me një kontribut në përqindje prej mbi 30%, por kontributi i marzhinal negativ e ul pabarazinë e të ardhurave nga paga. Kontributet ndaj pabarazisë të të gjithë burimeve të tjera janë shumë të ulëta dhe kontributet e tyre marzhinale mbeten negative, duke pasqyruar rolin e tyre të mundshëm për uljen e kësaj pabarazie. Midis këtyre burimeve, në kufi të tyre, pensionet kanë efektin më të madh barazues (edhe pse kontributi i tyre i përgjithshëm është relativisht i vogël), ndërkohë që transfertat private kanë një ndikim marzhinal neutral mbi pabarazinë: një rritje e përqindjes së të ardhurave nga ky burim i fundit do të kishte një ndikim të papërfillshëm mbi pabarazinë totale. Një rritje e përqindjes së të ardhurave nga asistenca sociale do të kishte një ndikim marzhinal të butë mbi pabarazinë e përgjithshme por, duke pasur parasysh kontributin e vogël të këtij përbërësi ndaj pabarazisë së përgjithshme, ka një potencial barazues të kufizuar.

**Tabela 2. 32: Zbërthimi Gini sipas burimit të të ardhurave**

	Gini	Pjesa e të ardhurave	Të ardhurat mesatare (lekë)	$G_k$	$P_k$	$\epsilon_k$
Të ardhurat gjithsej	0.579		9088			
Punë e varur	0.735	0.354	3218	0.514	31.428	-0.040
Biznes bujqësor	0.820	0.147	1333	0.461	11.681	-0.030
Biznes jo bujqësor	1.095	0.251	2281	0.987	42.760	0.177
Transferta	0.899	0.107	968	0.565	10.380	-0.003
Pensione	0.755	0.113	1031	0.248	4.852	-0.065
Asistencë sociale	0.902	0.019	174	0.037	0.122	-0.018

Të dhënat mbi të ardhurat, sidomos nga burime të tilla si vetëpunësimi dhe biznesi, zakonisht mbajnë në vetvete probleme të matjes. Në mënyrë që të vlerësohet ndjeshmëria e rezultateve ndaj problemeve të mundshme në këtë përbërës dhe po të kemi parasysh kontributin jashtëzakonisht të lartë ndaj pabarazisë të këtij burimi, ky përbërës është vendosur në zero dhe si rrjedhim janë përcaktuar nga e para të ardhurat gjithsej. Tabela 2.33 tregon rezultatet si më sipër. Në këtë rast, pabarazia totale është më e ulët dhe koeficienti i përgjithshëm Gini është 0.50.

Kontributi marzhinal i punës së varur dhe transfertave është tani pozitiv. Në të kundërt dhe në përputhje me rezultatet e Tabelës 2.33, si pensionet edhe asistenca sociale – me kontribute marzhinale negative – vazhdojnë të kenë një rol barazues, edhe pse të dyja, po të kemi parasysh  $P$  e vogël, kanë një potencial shumë të vogël për të bërë ndonjë ndryshim në pabarazinë e përgjithshme.

Rezultatet e përgjithshme e vënë gishtin tek efektet mundësisht rishpërndarëse të favorshme (edhe pse të vogla) të politikave fiskale dhe zgjerimi i programeve të asistencës sociale për të ulur pabarazinë. Megjithatë, duke pasur parasysh paketën e kufizuar të burimeve të shpenzimeve shoqërore dhe të kontributit shumë të ulët të këtij përbërësi ndaj pabarazisë totale të të ardhurave, ka shumë pak gjasa që qeveria do të jetë në gjendje të ndikojë në këtë shpërndarje përmes rritjes së buxhetit të asistencës sociale. Një veprim më i mundshëm për qeverinë do të ishte të ulej varfëria dhe pabarazia përmes përmirësimit të efektivitetit të synuar të programeve sociale ekzistuese.

**Tabela 2. 33: Zbërthimi Gini sipas burimit të ardhurave (të ardhurat jo bujqësore presupuzohen të jenë zero)**

	Pjesa e të ardhurave	Të ardhurat mesatare (lekë)	G <sub>k</sub>	P <sub>k</sub>	ε <sub>k</sub>
Të ardhurat gjithsej		6807			
Puna e varur	0.473	3218	0.572	53.693	0.064
Biznesi bujqësor	0.196	1333	0.506	19.666	0.001
Biznesi jo bujqësor	0.000	0	.	.	.
Transferta	0.142	968	0.628	17.709	0.035
Pensione	0.152	1031	0.294	8.851	-0.063
Asistenca sociale	0.025	174	0.068	0.343	-0.022

## 7. Modelet e konsumit

Tabela 2.34 paraqet përqindjet e buxhetit, sipas vendodhjes, të përbërësve kryesor të shpenzimeve. Përkundër asaj që vihet re në ekonomi të tjera në tranzicion, pjesa që zë ushqimi është shumë më e lartë pothuajse në masën 63 përqind, ku individët në zonat fshatare shpenzojnë deri në dy të tretat të buxhetit të tyre për ushqime.<sup>24</sup> Shpenzimet për furnizimin me ujë, energji, etj., zënë rreth 12 përqind të buxhetit total, me një përqindje më të lartë në zonat qytetëse, sidomos në Tiranë. Pjesa që zënë shpenzime të tilla në zonat qytetëse rrjedh kryesisht nga faturat më të larta të energjisë elektrike dhe të telefonave (celularë), ndërkohë që mbi 40% e këtyre shpenzimeve në zonat fshatare kanë lidhje me përdorimin e druve të zjarrit dhe lendëve djegëse. Pjesa e buxhetit që zihet nga shpenzimet për arsim është e ngjashme me vende të tjera dhe është më e lartë në zonat qytetëse, përveç Tiranës, duke pasqyruar kështu kostot e larta të arsimit më të lartë për shkak të mungesës së mjediseve vendore.

Siç pritej, një pjesë e madhe e konsumit të ushqimeve në zonat fshatare (31 përqind) rrjedh nga prodhimi vetiak, duke e vënë theksin tek roli i rëndësishëm që luan bujqësia familjare (kopshtet personale) në ekonominë shtëpiake fshatare.

**Tabela 2. 34: Pjesët kryesore të buxhetit sipas vendodhjes**

	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total
Ushqime	58.5	59.1	66.3	62.8
Jo ushqime	24.8	24.0	21.2	22.6
Energji, ujë, etj	14.6	13.7	10.8	12.3
Arsim	2.1	3.2	1.7	2.3
Total	100.0	100.0	100.0	100.0

Të ngrënit nëpër restorante dhe konsumi i pijeve dhe kafeve nëpër bare është i përhapur në Shqipëri, sidomos në qendrat qytetëse dhe zë deri 8 përqind të shpenzimeve ushqimore të banorëve në Tiranë dhe 6 përqind në vendodhje të tjera qytetëse. Në të gjithë vendin, shqiptarët shpenzojnë 4.5 përqind të buxhetit të tyre për të ngrënë jashtë.

**Tabela 2. 35: Burimet e konsumit sipas vendodhjes**

	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total
--	--------	-----------------	-------	-------

<sup>24</sup> Duhet vënë re që pjesët e buxhetit ndikohen nga pamundësia për të përfshirë disa prej përbërësve (si qeraja dhe shëndeti) në agregat.

Të blera	91.0	90.3	65.9	76.9
Jo të blera	1.0	3.7	31.2	18.6
Të ngrëna jashtë	8.0	6.0	2.9	4.5
Total	100.0	100.0	100.0	100.0

Nuk është çudi që të varfërit shpenzojnë një pjesë më të madhe të buxhetit të tyre për ushqime (67 përqind) dhe një pjesë më të vogël se mesatarja për artikuj jo ushqimorë (17 përqind). Megjithëse në buxhet zënë një pjesë më të madhe, në shifra absolute të varfërit shpenzojnë më pak për ndërmarrjet publike të furnizimit dhe arsimin.

**Tabela 2. 36: Pjesët kryesore të buxhetit sipas gjëndjes ekonomike**

	Jo të varfër	Të varfër	Total
Ushqime	62.0	66.7	62.8
Jo ushqime	23.3	17.3	22.6
Energji, ujë, etj	12.5	13.5	12.3
Arsim	2.2	2.6	2.3
Total	100	100	100

Modelet e konsumit ushqimor zbulojnë zakone shumë të ngjashme ngrënieje në të gjitha vendodhjet. I vetmi ndryshim i dukshëm ka lidhje me pjesën më të madhe të shpenzimeve për miell dhe drithëra në zonat fshatare, pjesërisht i kompensuar nga konsumi më i madh i bukës dhe produkteve të brumërave në zonat qytetëse. Familjet në zonat qytetëse shpenzojnë më shumë nga buxheti i tyre mujor ushqimor për të ngrënë jashtë. Së fundmi, shpenzimet për frutat në zonat qytetëse janë sa dyfishi i atyre në zonat fshatare, çka ka mundësi të pasqyrojë kostot më të larta të ushqimeve të brishta në zonat qytetëse.

**Tabela 2. 37: Modelet e shpenzimeve ushqimore sipas vendodhjes**

	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total
Bukë dhe produkte brumi	9.1	9.7	5.2	7.1
Drithëra, miell dhe makarona	4.9	6.5	12.5	9.6
Mish	21.2	20.9	19.3	20.0
Peshk	1.5	1.3	1.1	1.2
Qumësht dhe produkte bulmeti	18.9	18.2	23.7	21.3
Vaj	6.5	7.1	7.3	7.1
Fruta	6.4	5.8	2.9	4.3
Perime dhe bishtaja	13.2	14.9	14.9	14.7
Perime të konservuara dhe të ngrira	1.9	1.9	2.0	1.9
Sheqer dhe ëmbëlsira	3.4	3.5	3.9	3.7
Ushqime të rregjura dhe pikante	0.6	0.5	0.5	0.5
Pije jo alkolike, çaj dhe kafë	4.3	3.5	3.6	3.6
Të përziera	0.2	0.2	0.3	0.3
Të ngrëna jashtë	8.0	6.0	2.9	4.5
	100.0	100.0	100.0	100.0
Shpenzimi mesatar ushqimor për frymë (lekë të reja)	5,290	5,015	4,782	4,910

## 8. Përcaktuesit e varfërisë



Ky seksion paraqet rezultatet e një analize me shumë ndryshore të përcaktorëve dhe plotësorëve të varfërisë. Është përllogaritur një model Probit, duke përdorur një procedure në dy etapa e cila të jep mundësi të marrësh në konsiderate modelin e grupit të zgjedhjes së LSMS. Në këtë mënyrë logariten edhe shtresëzimi, peshat dhe grupet e vogla. Ndryshorja e varur është e dallueshme dhe merr vlerë të barabartë me një kur konsumi për frymë bie nën kufirin e varfërisë. Problemet e endogjenitetit nuk janë ekzaminuar në mënyrë specifike dhe në këtë shkallë koeficientët mbi ndryshoret e pavarura duhet të interpretohen me rezerva. Duke pasur parasysh karakteristikat e ndryshme të varfërisë qytetëse dhe fshatare, ose sepse asnjëra prej familjeve qytetëse nuk i kanë këto karakteristika ose sepse të gjitha i kanë këto karakteristika, disa ndryshore janë përfshirë nga modeli qytetës.<sup>25</sup>

Rezultatet e analizës me shumë ndryshore konfirmojnë një pjesë të mirë të asaj që është paraqitur deri tani, në bazë të statistikave përshkuese. Arsimi është i lidhur ngushtë dhe negativisht me varfërinë. Si në zonat fshatare dhe në ato qytetëse, familjet me përqindjen më të madhe të anëtarëve me arsim të mesëm ose më të lartë kanë më pak gjasa për të qënë të varfër. Siç pritej, ndikimi i arsimit të lartë është më i madh se ai i arsimit të mesëm. Varfëria ka më shumë gjasa të gjendet në familjet e mëdha: probabiliteti i një familjeje për të qënë e varfër rritet me madhësinë e familjes. Familjet me një numër më të madh fëmijësh kanë gjithashtu më shumë gjasa për të qënë të varfëra. Gjendja e punësimit ka rëndësi, gjithashtu, dhe kur një pjesë e madhe e anëtarëve të familjes janë të papunë familja ka më shumë gjasa të jetë e varfër. Mundësia për të përdorur shërbime telefonike (ose telefon fiks në shtëpi ose telefon celular) është e lidhur negativisht me varfërinë. Ky efekt është më i madh tek telefonat celularë.

Ndërkohë që plotësorët e mësipërm janë të dukshëm nëpër zonat e ndryshme gjeografike, varfëria qytetëse dhe ajo fshatare ndryshojnë dhe ndikohen në mënyra të ndryshme nga karakteristika të tjera të familjes. Në zonat qytetëse, për shëmbull, përfitimi nga *Ndihma Ekonomike* është e lidhur në mënyrë pozitive me varfërinë, çka sugjeron se ky program të paktën arrin në mënyrë të pjesshme përfituesit e synuar në zonat qytetëse. Pronësia e pasurive shtëpiake si psh paisje shtëpiake dhe mallra të tjera jetëgjata (psh televizor, vetura) lidhet negativisht me varfërinë qytetëse. Po ashtu, mbipopullimi i lartë – i përcaktuar nga numri i dhomave për anëtar familjeje – në banesat qytetëse është lidhur ngushtë me varfërinë.

Në zonat fshatare, të pasurit e një anëtarit të familjes në punë të varur ose të qenit i vetëpunësuar në një biznes jo bujqësor e ul probabilitetin për të qënë i varfër. Në të kundërt, familjet që marrin transferta private ose pensione fshatare kanë më shumë gjasa për të qënë të varfëra. Pronësia e pasurive bujqësore është e lidhur negativisht me varfërinë. Ndryshoret e tjera që kanë rëndësi statistikore dhe që janë të lidhura negativisht me varfërinë janë madhësia e tokës, numri i lopëve, numri i kafshëve të vogla (pula dhe lepuj) dhe mallrat jetëgjata bujqësore. Lidhja me kanalizime të ujrave të zeza është gjithashtu e lidhur negativisht me varfërinë. Midis karakteristikave të bashkësisë të analizuara, familjet që jetojnë në një bashkësi me kanalizime ujrash të zeza janë më pak të predispozuar për të qënë të varfëra nga ana e të ardhurave. Në përputhje me analizën përshkuese dhe me rezultatet e mëparshme, pas kontrollit të disa tipareve, familjet me kryefamiljare gra kanë po aq gjasa për të qënë të varfëra sa edhe familjet me kryefamiljarë meshkuj. Madje, familjet me kryefamiljare femra në fshat kanë më pak gjasa për të qënë të varfëra.

Megjithëse analiza përshkuese zbulon dimensionet e forta hapësinore të varfërisë, analiza me shumë ndryshore tregon se, në të njëjtat kushte, familjet në zonat fshatare të verilindjes janë po aq

---

<sup>25</sup> Lexuesit e interesuar për modelin e plotë dhe rezultatet e përllogaritjes mund t'i drejtohen dokumentit të përmendur për më shumë hollësi.

të predispozuara për të qënë të varfëra sa edhe familjet e ngjashme fshatare në rajonet e tjera. Kjo vlen edhe për modelet qytetëse. Së fundmi, të jetuarit në një banesë të re me tulla nuk duket se është tregues i një varfërie më të pakët.

Për ta përmbledhur, analiza me shumë ndryshore konfirmon shumë prej rezultateve të mëparshme dhe e vë theksin tek fushat që kanë lidhje me politikën për uljen e varfërisë. Megjithëse lidhja shkak-pasojë duhet të nënkuptohet prej rezultateve me rezerva, rëndësia e faktorëve të tillë si psh arsimi i përmirësuar, sidomos në nivelet pas atij fillor, dhe vendet e punës jo bujqësore, sidomos në zonat fshatare, është e dukshme. Përveç kësaj, numri i faktorëve të lidhur ngushtë konfirmon natyrën shumëdimensionale të varfërisë dhe tregon, për shëmbull, që mundësia e kufizuar e përdorimit të kapitalit fizik dhe njerëzor, si në nivel shtëpiak ashtu edhe në nivel të bashkësisë, shkon krah për krah me privimet nga të ardhurat.

## 9. Konkluzione dhe rekomandime për politika

Kufiri i varfërisë i paraqitur në këtë kapitull është i pari kufi absolut i varfërisë i mbështetur në të dhënat për shpenzimet në nivel shtëpiak që përfaqësojnë të gjithë vendin të përlllogaritura për herë të parë në Shqipëri. Si çdo kufi varfërie, mbështetet në një numër presupozimesh dhe zgjedhesh metodike dhe si i tillë është i hapur për debat dhe diskutime. Matja e mirëqënies e përdorur për këtë qëllim mbështetet në metodën e Kostos së Nevojave Bazë (KNB), dmth një kufi i varfërisë ushqimore i mbështetur në koston e nevojave minimale për kalori të rritura për të krijuar hapësirë edhe për nevojat bazë jo ushqimore. Kjo solli si rezultat zgjedhjen e një kufiri absolut varfërie prej 4,891 Lekë për frymë në muaj.

Në bazë të kësaj matjeje, një e katërta e popullsisë shqiptare, ose afro 780,000 individë, bien nën kufirin e varfërisë. Varfëria e tejskajshme përfshin më pak se 5 përqind të popullsisë, të cilët nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre bazë për ushqimore. Një numër i madh i individëve janë grumbuluar rreth kufijve të varfërisë. Po ta rrisim kufirin e varfërisë me 10 përqind, përqindja e individëve të varfër rritet me 25 deri 50 përqind, në varësi të kufirit të varfërisë që përdoret. Kjo vlen edhe për lëvizjet negative të kufirit të varfërisë. Me fjalë të tjera, tronditje të vogla negative dhe pozitive çojnë në ndryshime disproporcionale të varfërisë. Varfëria duket se ka një dimension të shënuar hapësinor dhe rajonal në Shqipëri. Zonat fshatare dhe rajoni malor janë parë se janë gjithmonë më të varfëra, sipas të gjitha përkufizime të varfërisë. Nga një këndvështrim ndërkombëtar, të dhënat e paraqitura konfirmojnë pamjen e Shqipërisë si një nga vendet më të varfëra në Europë. Normat e varfërisë PPP të paraqitura (2 dhe 4 dollarë në ditë) janë më të larta se ato të vendeve fqinje dhe e vendosin Shqipërinë pak a shumë në të njëjtin pozicion me vendet e Kaukazit si Gjeorgjia, dhe vetëm shumë pak më sipër Azerbajxhanit. Përkundër shqetësimeve në rritje lidhur me pabarazinë e përhapur në ekonominë në tranzicion, këtu pabarazia është parë se është e moderuar, me një indeks Gini të mbështetur tek konsumi prej 0.28.

Nga këndvështrimi i profilit demografik të varfërisë, të dhënat e LSMS tregojnë se familjet më të mëdha në numër dhe më të vogla në moshë janë më shumë të predispozuara për të qënë të varfëra. Si rrjedhim, mund të pëdoren disa kriteret demografike për ta futur më mirë në shënjestër varfërinë dhe programet sociale. Familjet që mbështeten kryesisht tek asistencë sociale (dhe në zonat fshatare edhe tek pensionet) përfaqësohen në mënyrë jo proporcionale tek të varfërit, çka sugjeron se ka vend për të përmirësuar ndikimin e programeve ekzistuese.

Këto gjetje kanë pasojat e tyre për hartimin e politikave dhe programeve për uljen e varfërisë. Rëndësia e rrjeteve të përshtatshme të sigurisë sociale për këtë numër të madh individësh del si

përparësi për politikat publike. Po kështu, po të kemi parasysh thellësinë dhe ashpërsinë relativisht të ulët të varëfrisë, transfertat e vogla të synuara mirë do të mund të sillnin rezultate të mëdha përsa i përket zbutjes së varfërisë. Së fundmi, shpërndarja e varfërisë në Shqipëri shërben si një paralajmërim kundër përdorimit mekanik të kufirit të varfërisë si një prag synimi për programet publike, meqënëse nëse veprimet kështu do të përjashtonim përfituesit potencialë të cilët vuajnë nga privimet të cilat vetëm këto programe përpunon të zgjidhin.

Analiza e të dhënave të LSMS tregon se dimensionet e privimeve që nuk kanë lidhje me të ardhurat përbëjnë varfërinë e të ardhurave dhe pabarazitë në kushtet e jetesës janë më të theksuara sesa duken në pamje të parë po të shihet vetëm dimensionet e të ardhurave. Modernizimi vendit ka sjellë përfitime për zonat qytetëse, sidomos për Tiranën, me një hap shumë më të shpejtë sesa për zonat fshatare, të cilat kanë mbetur mbrapa. Në shumicën e rasteve, mbulimi me shërbimet e infrastrukturës bazë është shumë më i vogël në zonat fshatare, edhe pse zonat qytetëse përballen me probleme të rënda të cilësisë.

Nuk është nevoja të themi që dimensionet e varfërisë që nuk kanë lidhje me të ardhurat duhet t'u jepet më pak vëmendje sesa dimensionet e të ardhurave. Si pjesë e SKZHES, qeveria ka premtuar se do të bëjë përpjekje të reja në drejtim të përmirësimeve të shërbimeve të infrastrukturës publike, sidomos në lidhje me kryerjen e këtyre shërbimeve për më të varfërit. Ka të ngjarë që për shumë familje përjashtimi shoqëror, mungesa e mundësisë së përdorimit të shërbimeve dhe infrastrukturës bazë dhe të arsimit të mesëm dhe të lartë janë faktorë që pengojnë mundësinë e tyre për të dale sipër kufirit të varfërisë. Kjo gjë na sugjeron që politikat e uljes së varfërisë do të kishin nevojë të përqëndroheshin në rajonet fshatare dhe ato të largëta ku kushtet e këqija të shërbimeve bazë oanë edhe më të pranishme.

Mjetet e fermave në Shqipëri janë të shpërndara në mënyrë të barabartë, duke ndjekur një metodë nga poshtë lart për *dekolektivizimin* që u krye në fillim të viteve 90. Megjithatë, po të kemi parasysh pjesën e madhe të popullsisë së angazhuar në bujqësi, madhësia e fermës në shumë raste është tepër e vogël për të ofruar një mundësi të mirë biznesi ose edhe thjesht për t'i ofruar familjes një mundësi për të dale nga varfëria. Kështu, edhe pse pronësia mbi token është shumë e përhapur në Shqipëri, madhësia mesatare e fermës është shumë e vogël dhe mundësia e përdorimit të tokës nuk është një kusht i mjaftueshëm në vetvete për të dale nga varfëria. Largimi i njerëzve nga bujqësia dhe sektori fshatar ka gjasa të vazhdojë, si rrjedhim, edhe në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë, duke shkaktuar probleme të mëdha për politikat sociale dhe ato të punës si në zonat qytetëse ashtu edhe në ato fshatare. Kjo kërkon politika të punës më shumë efektive për të siguruar vende pune jo bujqësore më të qëndrueshme në zonat fshatare. Meqënëse sektori i bujqësisë ofron pjesën më të qëndrueshme të të ardhurave për të varfërit fshatarë, zgjidhja e faktorëve që pengojnë zhvillimin e këtij sektori duhet të jenë një përbërës thelbësor të çdo përzierje politikash që synojnë uljen e varfërisë fshatare.

Ekziston një lidhje e fortë midis varfërisë dhe niveleve të ulëta arsimore. Normat e rregjistrimit në shkollën fillore janë më të ulëta tek të varfërit dhe edhe më të ulëta akoma tek tejet të varfrit. Kjo dukuri është edhe më e theksuar në lidhje me normat e rregjistrimit në shkollën e mesme. Përqindja e varfërisë tek të rriturit që kanë vetëm dëftesë të shkollës fillore ose edhe më pak është sa dyfishi i përqindjes së varfërisë të personave që kanë të paktën dëftesë të shkollës së mesme. Më shumë se 80 përqind e të varfërve nuk kanë mbaruar shkollë të mesme ose profesionale. Siç ndodh zakonisht në vendet në tranzicion të Europës Lindore, treguesit e arsimit në Shqipëri janë të mirë nëse krahasohen me vende që kanë nivele të ngjashme varfërie. Arritja e rregjistrimit universal në shkollën fillore është brenda mundësive të këtij vendi. Më shumë vështirësi, dhe ndoshta më shumë rëndësi, paraqet nevoja për të rritur rregjistrimin në shkollat e mesme dhe ato

profesionale. Rëndësia e arsimit pasfillor është shumë e madhe duke pasur parasysh ndikimin që ka për uljen e varfërisë.

Vetëm 33 përqind e individëve 15 vjeç e lart thonë se kanë një punë me kohë të plotë, ndërkohë që 21 përqind të tjerë thonë që kanë kryer punë me orar të pjesshëm (31 përqind në zonat fshatare), duke e çuar numrin total të atyre që punojnë në 53.9 përqind. Rreth një e dyta e punëtorëve fshatare punojnë vetëm me kohë të pjesshme dhe një pjesë e madhe e tyre thonë se punojnë vetëm disa orë në javë. Pavarësisht se si përkufizohet papunësia, të varfërit shfaqin norma më të larta papunësie kur krahasohen me jo të varfërit. Norma e papunësisë sipas përkufizimit standart të ILO (në masën 14.2 përqind) është gati sa dyfishi i kësaj norme tek jo të varfërit. Ndërsa, tek tejet të varfërit është trefishi. Po të përdorim një përkufizim më pak strict, norma e papunësisë tek tejet të varfërit është mbi 30 përqind. Një pjesë më e madhe punëtorësh marzhinalë (ata që klasifikohen si të çinkurajuar, sezonalë dhe të pushuar nga puna) gjenden mes të varfërve.

Si përfundim, modernizimi i vendit i cili në shumë aspekte është shkaktuar nga reformat e tranzicionit dhe periudha e fundit e rritjes së qëndrueshme ekonomike, natyrisht që po jep kontributin e tij për përmirësimin e përgjithshëm të standarteve të jetesës në Shqipëri. Megjithatë, këto përfitime duken se po ndihen më shumë në zonat qytetëse, sidomos në Tiranë, ndërkohë që zonat fshatare dhe ato të thella kanë mbetur mbrapa. Disa dimensione që nuk kanë lidhje me të ardhurat të privimit duken se janë tronditëse po të kihet parasysh niveli i përgjithshëm i zhvillimit të vendit. Pa një ndërmarrje politikash të drejtpërdrejta, të përqëndruara dhe të mirësnuara nga ana e qeverisë, mundësia e shumë të varfërve fshatarë dhe të varfërve qytetarë të pashkolluar për të dale nga varfëria përmes përfitimit nga rritja ekonomike duket ende e largët.

## KREU III: DIMENSIONET HAPËSINORE TË VARFËRISË

### 1. Pamje e përgjithshme

Shqipëria ka një sipërfaqe prej 28,750 kilometra katrorë, nga të cilët 699,000 hektarë janë klasifikuar si tokë bujqësore (24 përqind e sipërfaqes totale), 1,027,000 hektarë si pyje (36 përqind) dhe 446,000 hektarë si kullota (15 përqind). Pjesa tjetër që mbetet, prej 25 përqind, klasifikohet si të tjera, që përfshin zonat qytetëse, rreth 135,000 hektarë liqene dhe kanale, dhe tokë shkëmbore dhe malore e papërdorur. Shqipëria mund të ndahet në tre zona agroekologjike kryesore. Ultësirat konsistojnë në fushat bregdetare përgjatë Detit Adriatik dhe janë zonat bujqësore më produktive të vendit. Mundësitë e vaditjes ekzistojnë dhe mund të kultivohen një numër i madh bimësh bujqësore. Zonat më të shtrira kodrinore janë kryesisht të mbjella me pemë frutore, ullinj dhe vreshta. Zona malore ka lugina të thella dhe maja të larta malesh si edhe dimra të vështirë. Bimët bujqësore mund të rriten nëpër lugina, ndërkohë që zonat më të larta janë kryesisht pyje ose kullota për gjënë e gjallë. Në përgjithësi, cilësia e kullotave është e ulët dhe zakonisht vihet re fenomeni i mbishfrytëzimit të kullotave.

Shqipëria është shumë malore, me lartësi që shkojnë nga niveli i detit përgjatë Detit Adriatik në perëndim deri në 2 751 m në Malin e Korabit në Rrethin e Dibrës në verilindje. Vetëm 16 përqind e tokave është nën nivelin 100 metra, 55 përqind janë midis 100 dhe 1,000 metra lartësi dhe 29 përqind janë mbi nivelin 1,000 metra lartësi. Si rrjedhim, toka që përdoret për bujqësi është shpesh e pjerrët, ku vetëm rreth 44 përqind e tokës bujqësore është me pjerrësi më pak se 5 përqind, 37.5 përqind me pjerrësi midis 5 dhe 25 përqind, dhe 18.5 përqind me pjerrësi mbi 25 përqind. Shqipëria mund të ndahet në tre zona kryesore agroekologjike në bazë të klimës dhe topografisë. Këto zona janë:

*Zona bregdetare.* Ultësira, e cila konsiston në fushat bregdetare përgjatë Detit Adriatik me lartësi që shkon deri 200 metra mbi nivelin e detit. Nënzona jugore ka një klimë mesdhetare relativisht të thatë me një stinë vere të nxehtë mesatarisht 26 gradë C dhe dimra të butë me temperature mesatare 10 gradë C, ndërkohë që nënzona veriore është 2 deri 3 gradë C më e ftohtë me një shpeshhtësi më të madhe ngricash dhe erërash të ftohta gjatë dimrit. Rreshjet e shiut variojnë nga 800-1,300 mm në jug dhe rriten deri në 2,000 mm në veri. Rreth 80 përqind e rreshjeve totale vjetore bien nga tetori në muajin mars, duke sjellë si rrjedhim nevojën për ujitje për prodhimet e verës. Në përgjithësi, këto kushte krijojnë mundësi për të kultivuar një numër të madh bimësh bujqësore si drithëra, foragjere, perime dhe vreshta, si edhe agrume në pjesën jugore të kësaj zone.

*Zona qendrore.* Kjo zone tradicionale kodrinore (nënmalore), që shkon nga 100 deri në 900 metra lartësi mbi nivelin e detit, konsiston kryesisht në kodra që shtrihen nga veriu nëjug midis fushave bregdetare dhe maleve. Kjo zone është 2 deri në 4 gradë C më e ftohtë, me rreshje më të mëdha se në fushat bregdetare. Këtu rriten ullinj, vreshta, pemë frutore të buta, miser dhe grurë dhe ka zona të gjera me pyje të ulëta dhe gëmusha. Kjo zone kalimtare nganjëherë konsiderohet se përfshin edhe bazenin bujqësor të madh e të rëndësishëm të Korçës në juglindje të vendit, i cili gjendet 800 metra mbi nivelin e detit në zonën më të thatë të vendit me një sasi rreshjesh mesatare vjetore prej 790 mm dhe një temperature prej 10.5 gradë C. Bimë bujqësore si gruri, fasulet, panxharsheqeri dhe patatet janë të rëndësishme në këtë zone, ku mund të rriten edhe pemë frutore të buta si mollët dhe kumbullat.

*Zona malore.* Zona malore konsiston në lugina ndërmallore dhe maja të larta malesh, me verëra të buta dhe dimra të ftohtë me ngrica të mëdha dhe rënie të mëdha dëbore. Temperaturat në verë rrallë e kalojnë vlerën 25 gradë C, ndërkohë që temperaturat minimale të dimrit mund të bien deri

në -20 gradë C. Rreshjet vjetore shkojnë mesatarisht në rreth 900 mm në jug deri në 1,500 mm në veri dhe deri 3,000 mm lart në malet veriore. Nëpër lugina mund të rriten bimë bujqësore si miser, foragjere, perime verore dhe grurë dimëror, ndërsa në lartësi të mëdha edhe elbi dhe patatat. Mund të rriten gjithashtu edhe pemë të buta frutore si mollët dhe kumbullat. Në lartësi të mëdha, kjo zone ka kryesisht pyje dhe kullota për gjënë e gjallë.

## 2. Varfëria nëpër rajone


Grupi i zgjedhjes i përdorur për LSMS është marrë nga të tre rajonet agroekologjike, meqenëse ato pasqyrojnë edhe kushtet dhe potencialin shumë të ndryshëm shoqëroro-ekonomik. Analiza e të dhënave tregon se familjet në rrethet më të thella të rajonit malor në veri dhe verilindje të vendit kanë ecurinë më të keqe përsa i përket varfërisë (Tabela 3.1). Gati një e dyta e banorëve të kësaj zone janë të varfër dhe më shumë se një e pesta e këtij grupi jetojnë në varfëri të tejskajshme. Gjithashtu, thellësia e varfërisë në këtë zone është shumë më e theksuar se në çdo rajon tjetër, ku indeksi i hendekut të varfërisë është mbi 11 përqind. Konsumi mesatar në këto rajone malore është sa dy të tretat e niveleve të konsumit në Tiranë dhe rreth 20-30 përqind më i ulët se pjesa tjetër e vendit. Normat e varfërisë në të gjitha rajonet e tjera janë rreth ose nën mesataret kombëtare.

**Tabela 3. 1: Normat e varfërisë sipas rajoneve**

	Tirana		Bregdet		Qendore		Malore		Total	
	Të varfër	Tejet të varfër	Të varfër	Tejet të varfër	Të varfër	Tejet të varfër	Të varfër	Tejet të varfër	Të varfër	Tejet të varfër
Përqindja	17.8	2.3	20.6	3.6	25.6	4.6	44.5	10.8	25.4	4.7
Hendeku i varfërisë	3.8	0.6	4.4	0.7	5.7	0.6	11.1	2.0	5.7	0.8
Hendeku i ngritur në kator	1.29	0.22	1.49	0.18	1.81	0.12	4.05	0.53	1.92	0.19
Konsumi mesatar për frymë (Lekë)	9,054		8,424		7,499		6,173		7,801	
Gini	0.31		0.29		0.28		0.28		0.29	

Po t'i hedhim një vështrim funksioneve të dendësive të akumuluar të të ardhurave sipas rajoneve na forcohet ideja se rajoni malor është më i varfëri, pavarësisht kufirit të përdorur të varfërisë. Rajoni qendror ka ecure më të mirë se rajoni malor, por më të keqe se Tirana dhe rajoni bregdetar. Mbi një sërë kufijsh të arsyeshëm varfërie Tirana ka një mbizotërim mbi rajonin bregdetar.

Fig 3.1: Funksionet e dendësive të akumuluar të të ardhurave sipas rajoneve



Nivelet e pabarazisë janë të buta dhe të qëndrueshme përmes rajoneve dhe koeficienti Gini në rajone është midis 0.28 dhe 0.29, me përjashtim të Tiranës, ku pabarazia është më e madhe dhe Gini është 0.31.

### 3. Varfëria fshatare

Siç është treguar edhe në kreun paraardhës, 66 përqind e një të pestës së parë më të varfër dhe 61 përqind e një të pestës së dytë janë familje fshatare. Në total, 34.8 përqind popullsisë fshatare janë të varfër ( të varfër 29.6 përqind dhe tejet të varfër 5.2 përqind). Një sasi e madhe konsumi (më shumë se 30 përqind) në zonat fshatare rrjedh nga vetëprodhimi, çka tregon rëndësinë prodhimit bujqësor në shkallë të vogël për sigurimin e ushqimit dhe mbajtjen e niveleve minimale të konsumit. Duke pasur parasysh që një pjesë e mirë e të ardhurave nga puna dhe të ardhurave nga bujqësia vetiake aktualisht mbështeten në sektorët ekonomikë jo të qëndrueshëm (psh ndërtimi), kjo bëhet edhe më e rëndësishme.

Të dhënat e LSMS tregojnë që zonat fshatare varen shumë tek bujqësia si burimin e tyre kryesor të të ardhurave (44 përqind), të ndjekura nga punësimi (19 përqind), transferat publike (17.8 përqind), transfertat private (12.6 përqind) dhe prodhimi jo bujqësor (5.9 përqind). Krahasuar me zonat qytetëse, pjesa që zënë të gjitha të ardhurat që nuk vijnë nga prodhimi fermer është më i ulët në zonat fshatare. Familjet qytetëse mbështeten shumë transfertat publike dhe private për 41.5 përqind të të ardhurave të tyre, ndërkohë që në zonat fshatare vetëm 30.4 përqind të të ardhurave vijnë nga këto burime. Nëse i ndajmë burimet e të ardhurave fshatare në pesë grupe konsumi, bëhet e dukshme që dallimi midis familjeve të varfëra fshatare dhe familjeve jo të varfëra fshatare qëndron kryesisht në nivelin e transfertave private. Pesëshorja më e lartë e mbështet një të katërtën e të ardhurave të saj tek transferta private, ndërkohë që më pak se dhjetë përqind e të ardhurave vijnë nga transfertat private në pesëshoren më të varfër.<sup>26</sup> Pjesa që zë

<sup>26</sup> Kjo vërejtje vlen edhe për zonat qytetëse ku një e pesta më e lartë mbështetet tek transfertat private për rreth 40 përqind të të ardhurave të tyre (pesëshoret qytetëse nuk tregohen në Tabelë).

bujqësia në të ardhurat bie nga mbi 50 përqind në një të pestën më të ulët deri në 33.8 përqind në një të pestën më të lartë. Megjithatë, e shprehur në vlerë pesëshorja më e lartë mer më shumë se dyfishi i të ardhurave nga bujqësia në muaj se një e pesta më e varfër. Tabela 3.2 tregon një zbërthim të përqindjes së të ardhurave sipas zonave fshatare/qytetëse si edhe sipas pesë grupeve fshatare.

**Tabela 3. 2: Burimet e të ardhurave sipas zonave fshatare/qytetëse dhe sipas pesëshoreve fshatare (në përqind)**

Burimet e të ardhurave	Qytet	Fshat	Pesëshoret fshatare				
			1	2	3	4	5
Punësimi	46.4	19.0	16.6	21.2	23.1	17.6	16.6
Bujqësia	1.9	44.3	52.4	45.6	42.7	42.6	33.8
Produktet blegtorale	0.2	8.7	8.3	7.9	7.9	7.5	12.6
Gjë e gjallë	0.1	7.9	11.7	7.4	9.3	5.9	3.5
Bimë bujqësore	1.6	27.7	32.4	30.3	25.5	29.2	17.7
Prodhimi jo bujqësor	9.0	5.9	2.6	8.5	6.0	7.8	4.9
Transfertat private (total)	16.5	12.6	8.8	8.5	12.3	13.1	24.2
Transfertat publike (total)	25.6	17.8	19.5	16.1	15.3	17.8	20.2
Të ardhura të tjera	0.7	0.4	0.1	0.0	0.6	1.1	0.3

Mesatarisht, të ardhurat e gjeneruara në zonat fshatare janë vetëm sa dy të tretat e të ardhurave që merr në muaj popullsia qytetëse. Siç pritej, të ardhurat nga biznesi dhe punësimi janë tre herë më të mëdha në zonat qytetëse. Transfertat private kanë më shumë rëndësi në zonat fshatare. Ndërkohë që sasia e transfertave private mujore për çdo pesëshore në zonat qytetëse nuk ndryshon shumë, pesëshoret më të varfëra fshatare marrin rreth një të pestën e transfertave të peshërores më të avrfer. Të ardhurat nga bujqësia janë gjithashtu më të mëdha në pesëshoret më të larta të konsumit, që vijnë kryesisht nga shitjet e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Familjet fshatare që bëjnë pjesë në pesëshoren më të varfër ndryshojnë gjithashtu dukshëm nga të tjerët përsa i takon disponibilitetit të të ardhurave të tyre që nuk vijnë nga fermat (dhjetë herë më të mëdha midis pesëshores së parë dhe asaj të pestë, por megjithatë më shumë se tre herë më i madh midis pesëshores së katërt dhe asaj të pestë).

**Tabela 3. 3: Vlera mesatare e të ardhurave familjare në muaj sipas burimit (Lekë)**

Burimi i të ardhurave	Qytet	Fshat	Pesëshoret fshatare				
			1	2	3	4	5
Punësimi	17,904	6,574	4,232	7,260	7,866	6,935	7,242
Bujqësia	717	12,172	7,262	9,858	13,395	16,017	17,089
Produktet blegtorale	70	1,501	860	1,523	1,348	1,946	2,124
Gjë e gjallë	68	1,289	1,365	1,360	1,343	1,290	1,017
Bimë bujqësore	580	9,382	5,037	6,976	10,704	12,781	13,948
Prodhimi jo bujqësor	14,922	2,952	633	1,305	2,372	2,785	9,573
Transfertat private (total)	2,527	4,027	1,706	2,565	4,386	4,835	8,206
Transfertat publike (total)	4,701	3,006	2,630	2,901	2,704	3,252	3,800



Të ardhura të tjera	526	105	22	5	241	73	243
Totali i të ardhurave	41,298	28,833	22,636	29,644	38,175	33,732	70,480

Gati 90 përqind e popullsisë fshatare kanë në pronësi dhe përdorin tokë bujqësore. Familjet më të varfëra kanë dhe përdorin tokë në një përqindje më të madhe (Tabela 3.4). Qeraja e tokës bujqësore haset shumë rrallë. Po të kemi parasysh që madhësia mesatare e tokës në pronësi të një familjeje është disi e vogël, mesatarisht rreth 0.72 hektarë, kjo tregon në këtë fazë ka shumë pak vend për zgjerimin e veprimeve bujqësore. Shumë vetë mbështeten tek prodhimi bujqësor për të jetuar dhe nuk duken të gatshëm të heqin dorë nga ky burim jetese. Madhësia mesatare e tokës në pronësi të një familjeje është 0.76 hektarë për familjet jo të varfëra dhe 0.6 hektarë për familjet e varfëra.

**Tabela 3. 4: Pronësia e tokës bujqësore (përqind)**

	Qytet			Fshat			Total		
	Jo të varfër	Të varfër	Total	Jo të varfër	Të varfër	Total	Jo të varfër	Të varfër	Total
Përqindja e familjeve që kanë tokë bujqësore	7.8	5.9	7.6	87.5	91.0	88.3	48.9	62.4	51.5
Përqindja e familjeve që kanë dhe përdorin tokë bujqësore	7.4	5.9	7.2	86.4	90.6	87.3	48.1	62.1	50.8
Përqindja e familjeve që kanë dhe lëshojnë me qera tokë bujqësore	0.9	0.0	0.8	3.9	2.2	3.5	2.4	1.5	2.3

Tabela 3.5 ofron një zberthim të mëtejshëm të madhësive të pronave të tokave në Shqipëri. Më shumë se 50 përqind e të gjitha familjeve në Shqipëri zotërojnë më pak se 0.5 ha tokë. Në zonat fshatare, më shumë se 60 përqind zotërojnë më pak se 0.8 ha tokë. Këto janë madhësi shumë të vogla toke dhe janë më të ulëta se mesatarja e vendeve të tjera të Europës Lindore. vetëm rreth 3 përqind e të gjitha familjeve zotërojnë sipërfaqe toke më të mëdha se 2.5 ha. Tre të katërtat e familjeve që jetojnë në zonat malore zotërojnë më pak se 0.5 ha. Megjithatë, kjo gjë tregon se shumë pak reformë strukturore ka ndodhur gjatë dhjetë vjetëve të fundit dhe pronësitë sipërfaqet e tokave në pronësi janë zvogëluar, në vend që të zmadhohen.

Siç e tregon edhe pjesa e poshtme e Tabelës 3.5, vetë sipërfaqja e tokës nuk e përcakton faktin nëse një familje është e varfër ose jo. Megjithatë, duhet pasur paraasysh se këto shifra kanë lidhje me grupin total të zgjedhjes, duke përfshirë kështu edhe familjet qytetëse me sipërfaqe të vogla toke në pronësi. Të dhënat tregojnë se familjet me më shumë se 1 ha tokë në pronësi priren të jenë më pak të varfër.

**Tabela 3. 5: Shpërndarja e tokës, sipa madhësisë së tokës dhe rajonit, pesëshore dhe të varfër/jo të varfër (përqind)**

Madhësia e tokës	Jo të varfër	Të varfër	Bregdet	Qendër	Mal	Vetëm fshat
Më pak se 0.2 ha	26.88	26.96	59.21	49.31	49.58	26.9
0.2 - 0.48 ha	15.73	26.5	5.51	13.24	25.5	18.24
0.48 – 0.8 ha	17.27	14.01	6.43	12.74	13.22	16.51
0.8 - 1.28 ha	19.75	19.72	13.33	13.7	7.6	19.74
1.28 – 2.5 ha	16.59	11.64	12.06	9.52	3.6	15.43

> 2.5 ha	3.78	1.17	3.45	1.49	0.52	3.17
Sipas pesëshoreve	1	2	3	4	5	
Më pak se 0.2 ha	26.7	27.8	25.9	27.5	26.5	
0.2 - 0.48 ha	25.81	16.93	18.82	13.82	12.86	
0.48 – 0.8 ha	14.72	15.78	19.1	18.46	11.54	
0.8 - 1.28 ha	20.19	19.47	18.74	19.92	20.42	
1.28 – 2.5 ha	11.2	18.74	12.39	17.05	18.99	
> 2.5 ha	1.36	1.3	5.08	3.23	6.16	

#### 4. Zonat fshatare dhe malore – xhepa të varfërisë së tejskajshme

Zonat fshatare të Shqipërisë, sidomos në rajonin malor të veriut, janë ndër zonat më të varfëra të Shqipërisë. Probleme për ata shqiptarë që jetojnë në këto zona janë klima e ashpër dhe relievi i thyer malor. Pjesa më e madhe e banorëve e nxjerrin jetesën përmes bujqësisë minimale, e cila është gjithashtu edhe një burim i rëndësishëm për ushqimin e pëditshëm të familjeve fshatare. Megjithatë, shumica nuk kanë tokë të mjaftueshme për të pasur shumëllojshmëri të mjaftueshme prodhimesh për jetesën dhe shumica mbështeten në një grup të vogël prodhimesh bujqësore për t'u ushqyer.

*“...Në shumicën e rasteve, i ushqej fëmijët me supë patatesh. Bukën e bëj vetë sepse kështu më del më lire. Fëmijët tani janë mësuar me faktin që mund të flenë edhe pa ngrënë, ndërkohë që më dhemb në shpirt tek i shoh të mos kërkojnë bukë edhe kur janë të uritur. Kur u martova nuk e dija që jeta do të ishte e tillë...” (një grua nga komuna e Bushatit)<sup>27</sup>*

Si edhe në zona të tjera të vendit, një nga dukuritë më të dukshme të varfërisë në zonat fshatare është mungesa e punësimit të qëndrueshëm; në përgjithësi, banorët e këtyre zonave duan punë por nuk kanë mundësi të gjejnë vende pune të cilat do t'u siguronin ndonjë lloj jetese të rehatshme.

*“Në Bushat nuk ka punë. Madje as shtëpitë e të tjerëve nuk mund t'i pastrosh sepse nuk janë aq të pasur sa të kenë para për paguar pastruese. Nuk shohim asnjë të ardhme. Nuk e dime çfarë do të bëhet me ne dhe fëmijët tanë. Kemi besim vetëm tek Perëndia.” (një grua nga komuna Bushat)*

*“Punoj gjithë ditën në shtëpi dhe atë pak tokë që kemi kemi mbjellë perime sa për të mbajtur frymën gjallë. Për vende punë as që bëhet fjalë. Nuk ka punë dhe nuk kemi ku të kërkojmë vende pune.” (një nënë me gjashtë fëmijë, komuna Bushat)*

Një pjesë e madhe e godinave në zonat fshatare janë tejet të vjetra dhe si të tilla shumë prej vështirësive të shoqëruara me mbajtjen e një jetese të shëndetshme kanë lidhje me mirëmbajtjen e godinave të vjetra në gjendje të keqe. Shumë struktura janë braktisur ose shkatërruar dhe kanë mbetur të papërdorura. Banorët e zonave fshatare përballen gjithashtu me vështirësi të mëdha me administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe shërbimeve shtetërore. Rrugët e vendit, sidomos në zonat malore, janë në një gjendje të rëndë. Shpesh kjo ka sjellë si pasojë izolimin e

<sup>27</sup> Kjo dhe citimet e tjera të përdorura në këtë seksion janë marrë nga intervistat me familje të ndryshme në komunat e Bushatit dhe Postribes jashtë Shkodrës, në malësi të thellë dhe të zhveshura të Shqipërisë, të cilat gjenden mbi liqenin me të njëjtin emër. Të dyja këto komuna kanë secila nga 11 fshatra dhe kanë një popullsi totale rreth njëzetëetë mijë banorë. Rezultatet dhe përfundimet e nxjerra nga këto intervista nuk janë aspak përfaqësuese, as për fshatin as për rajonin nga janë marrë as për Shqipërinë në tërësi.

shumë zonave të Shqipërisë, duke përfshirë edhe izolimin nga administrata shtetërore dhe shërbimet bazë. Kushtet sanitare janë shumë të këqija dhe shumica e familjeve nuk kanë tualete të përshtatshme. Në mungesë të ujit të rrjedhshëm dhe sistemeve të përshtatshme të ujërave të zeza, tualetet zakonisht vendosen jashtë shtëpive.

*“...Jemi gjashtë vetë në shtëpi. ...Të gjitha tubacionet e ujërave të zeza janë bllokuar. Uji qelbet erë. VC-ja ka dy vjet që nuk punon dhe duhet të dalim jashtë në fushë... Megjithatë një gjë e kemi të qartë: nuk kemi para as për të blerë ushqime, ndërkohë që komuna thotë se duhet të kujdesemi vetë për shtëpinë meqënëse tani jemi në pronarët. Nuk e dime ç’do të thotë kjo...” (një nënë me katër fëmijë, komuna Bushat).*

Energjia elektrike është një shëmbull tjetër. Ndërkohë që mbulimi me rrjet është gati universal, kryerja e këtij shërbimi është shumë e paqëndrueshme, ku gjendja është shumë më keq në bashkësitë fshatare. Pjesa më e madhe e njerëzve në zonat fshatare malore kanë furnizim me energji vetëm me ndërprerje dhe shumicën e kohës, edhe kur ka rrymë, tensioni është tepër i ulët për ta përdorur.

Në shumicën e rasteve, sidomos në rajonet veriore, mungesa e pranisë administrative është shoqëruar si pasojë me rikthimin e *fisit*, i cili është një strukturë administrative tradicionale e ndërtuar rreth lidhjeve farefisnore. Në shumë fshatra, kjo qasje tradicionale ka zëvendësuar plotësisht shtetin si mekanizmin parësor administrative për qytetarët vendorë.

*“Cilësia e shërbimeve sociale në fshat është e lidhur ngushtë me nivelin e deçentralizimit të pushtetit vendor. Në të vërtetë, këto shërbime nuk funksionojnë siç duhet dhe ne nuk kemi asnjë kompetencë për të bërë ndonjë përmirësim. Mendimet e qeverisë vendore nuk merren parasysh në lidhje me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga mësuesit, personeli shëndetsor apo të tjerë të përfshirë në këto shërbime. Edhe në ato raste kur në mënyrë të shprehur autoritetet vendore e thonë mendimin e tyre negative për ta këto mendime shpërfillen plotësisht. Në të vërtetë, ne gjendemi më pranë dhe u japim llogari bashkësive krahasur me ministrinë e ndryshme nga të cilat emërohen dhe të cilëve u përgjigjen personeli të tilla. Kur anëtarët e bashkësisë nuk janë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve të ofruara ata vijnë tek ne sepse mendojnë se ne mund ta ndryshojmë gjendjen ndërkohë që ata nuk mundin dhe nuk shkojnë në ministri për t’u ankuar.” (anëtar i këshillit të komunës, Bushat)*

Rikthimi i strukturave të ndryshme tradicionale ka risjellë në jetë gjakmarrjen. Në shumë zona të veriut, gjakmarrjet kanë shfarosur familje të tëra dhe i kanë lënë anëtarët e familjeve që kanë mbetur gjallë të izoluar brenda familjeve të tyre, duke i penguar të shkojnë në shkollë, të bëjnë pazar dhe të shkojnë në punë.

*“...Unë kam ardhur nga Tropoja për shkak të gjakmarrjes. Burrin ma kanë vranë përpara dy vjetësh, ndërsa burrin e motrës përpara pesë vjetësh. Kam dy fëmijë, por kam edhe fëmijët e motrës meqënëse ajo është martuar përsëri. Jemi dhjetë vetë në të njëjtën çati dhe nuk kemi as tokë as asistencë sociale. Djali tetëvjeçar dhe vajza gjashtëvjeçare nuk shkojnë në shkollë meqënëse jemi mbyllur në shtëpi nga frika e gjakmarrjes.” (një grua nga komuna Bushat)*

*“...Burrin ma kanë vranë për gjak përpara tetë vjetësh. Jetoj me dy prindër të moshuar dhe katër fëmijë. Dy vajzat kanë ikur sepse janë martuar. Kur u shpërndanë arat, përfituam edhe ne sipas ligjit, por u ngatërruam nëpër sherre dhe ish-pronarët e tokës dhe burrin ma vranë. Askush prej nesh nuk punon dhe nuk kemi as tokë as të ardhura të tjera për të nxjerrë bukën e gojës. Komuna më ka ndihmuar të gjej një punë si pastruese në shkollës, por vendimi i ministrisë ma ka kthyer jetën përmbys meqënëse thotë që shkollën duhet ta pastrojnë vetë nxënësit dhe si pasojë nuk ka*

*nevojë për pastruese. Në të vërtetë, kjo nuk është e mundur sepse fëmijët janë shumë të vegjël dhe shpesh nuk janë të veshur e të ngopur, dhe fshati nuk ka ujë. Drejtori i shkollës më mbajti dhe secili nxënës paguan një shumë çdo muaj, çka më del për të blerë bukë. Më duket vetja si lypëse dhe më vjen turp nga të tjerët sepse edhe ata nuk kanë para për vete. Nuk jetohet kështu, me lëmoshë. Nuk kemi të drejtë as për të marrë Ndihme Ekonomike sepse me letra jemi pronarë toke...” (një nënë me katër fëmijë, komuna Bushat)*

Gjendja arsimore është në kushte shumë të këqija në zonat fshatare. Mësuesit po largohen nga këto zona të largëta për të shkuar në qendra qytetëse dhe nxënësit që kanë mbetur shpesh gjenden në klasa të mbipopullura për shkak të nurmit të vogël të mësuesve. Në disa raste, gjendja është edhe më e rëndë sepse shkollat në fshat janë të vendosura larg njëra tjetres dhe fëmijëve u duhet të ecin në këmbë largësi të mëdha. Në kushte të këqija moti, të cilat hasen shpesh në veri dhe në rajonet malore, kjo çon në frekuentimin e dobët nga ana e nxënësve. Mungesa e fondeve për arsim i ka lënë shumë shkolla pa mjetet bazë për fëmijët. Në shumicën e rasteve vetë godina e shkollës është në gjendje të dobët. Madje edhe administratorët e shkollave e pranojnë që sistemi arsimor përballet me sfida të mëdha.

*“Komuna ka shtatë shkolla tetëvjeçare, një shkollë të mesme dhe katër shkolla fillore. Një klasë ka mesatarisht 30-40 nxënës, por ka edhe raste kur ky numër arrin deri në 45-50. Katër shkolla janë rindërtuar me fondet e shtetit, një shkollë është rindërtuar me fonde të një organizate ndërkombëtare. Pjesa tjetër e shkollave janë në gjendje shumë të keqe, ka shumë pak banka, nuk kanë xhama në dritare dhe dyert janë të prishura.” (inspektor arsimit, komuna Bushat)*

Gjendja e shëndetsisë është po aq e dëshpëruar. Në komunën e Bushatit, nga 11 fshatra të komunës, vetëm 4 kanë qendra shëndetsore dhe ka vetëm një shtëpi lindjeje, me katër mami dhe asnjë mjek gjinekolog. Përpara vitit 1990, ka pasur qendra shëndetsore në të gjitha fshatrat, ndërkohë që tani ose janë shkatërruar ose janë zënë nga të pastrehët.

Familjet fshatare thonë gjithashtu se duhet t’i japin “peshqeshe” mjekut në mënyrë që të përfitojnë shërbime të pranueshme mjekësore. Edhe pse kujdesi bazë presupuzohet se është falas në Shqipëri, rastet kur mjekët ose personeli mjekësor kërkojnë para janë shumë të shpeshta.

*“Mjekët të shohin nga duart. Nëse nuk u jep asgjë, as sytë nuk t’i hedhin. Tani po bëhet gati ligj t’i japesh doktorit 200 lekë për një vizitë dhe infermieres 100 lekë për një gjilpërë. Pastaj, janë edhe ilaçet. Merre me mend se çfarë mund të blejmë me pensionin tonë.” (plak rreth 60-vjeç, komuna Bushat)*

Kushtet dhe problemet e ilustruara më sipër kanë krijuar tek shumë banorë një ndjesi dëshpërimi. Të përballur me jetesë në kushte të këqija, shumë kanë bërë zgjedhjen për t’u larguar në favor të mundësive që paraqiten nga jetesa në zonat qytetëse dhe periurbane. Edhe pse shumica nuk e dine me domosdo se çfarë të shpresojnë nga migrimi i tyre, ia vlen të rrezikojnë, po të kihet parasysh alternativa e vetme të qëndrojnë dhe të vazhdojnë luftën siç kanë bërë deri tani.

*“Burri më ka vdekur. Kam tre fëmijë. Vajza vuan nga një sëmundje kronike. Unë jam invalide dhe gishtat i kam prerë. Atje kam bërë jetë qeni, meqënëse nuk kemi pasur tokë, nuk merrnim asnjë prodhim meqënëse jetonim në male dhe do të ishte e kotë të mbillnim ndonjë gjë. Unë merrja pension e invalidit 6,000 lekë në muaj. Kishim një shtëpi, por kur binte shiu hynte i gjithë brenda dhe nuk kishim para për të bërë asnjë riparim. Fshati ishte braktisur fare. Nejrëzit e fshatit nisën të ikin me dhjetëra. Më në fund, edhe ne vendosëm të largohemi meqënëse nuk jetonim dot vetëm në majë të malit. Këtu paguaj qera 4,000 lekë në muaj. Blejmë 2,000 lekë ushqime në muaj dhe nuk na ndihmon askush sepse komshijtë mezi mbahen vetë. Kemi marrë ca*

*ndihma humanitare ca kohë, por nuk ndodh më kështu. Vajza e sëmurë ka nevojë për bëhet operacion, por unë nuk kam para të paguaj. Duhet të pres sa të rriten dy fëmijët e tjerë edhe pak në mënyrë që të largohen e të gjejnë punë. Megjithatë bëme mirë që ikëm nga fshati, meqënëse edhe sikur të vdisje nuk kishte kush të të varroste. Por edhe këtu nuk është e lehtë ...” (një nënë me tre fëmijë e cila ka ikur tani nga komuna Bushat)*

## 5. Varfëria në zonat periurbane

Zonat periurbane shtrihen në periferi të dy qendrave qytetëse dhe gjenden shpesh ose mbi ose pranë burimeve me ujë të ëmbël (lumenj, përrenj, puse). Zakonisht përbëhen kryesisht nga vendbanime dhe struktura informale dhe shpesh nuk janë të lidhura me rrjetet e ndërmarrjeve komunale të furnizimit (ujësjellës, energji elektrike, kanalizime të ujërave të zeza). Shumica e banorëve të zonave periurbane janë të ardhur rishtazi nga zona të tjera të Shqipërisë të cilët kanë migruar në zonat qytetëse me shpresën për të gjetur vende pune dhe njëjetesë më të mirë për veten dhe familjen e tyre. Si e tillë, popullsia e zonave periurbane është në lëvizje e sipër dhe është e vështirë për t’u monitoruar. Shpesh herë këta banorë kanë migruar në masë nga zona të tjera të Shqipërisë dhe kanë ngritur bashkësi të cilat pasqyrojnë bashkësitë e vendodhjeve të tyre të mëparshme dhe përbëhen kryesisht nga fise (familje të zgjeruara).<sup>28</sup>

*“...Jemi 7 familje që kemi ardhur në Tiranë nga e njëjta lagje e fshatit. Jemi më shumë se 50 vetë, madje jemi farefis me njëri tjetrin. Burrat e diskutuan disa herë idenë për t’u larguar nga fshati, por nuk ishin shumë të vendosur meqënëse shpresonin që gjendja në fshat do të ndryshonte. U diskutua gjithashtu edhe ideja për të ndërtuar një ujësjellës, një rrugë dhe një qendër shëndetësore. Më vonë e kuptuam që askush nuk do të bënte asgjë për ne dhe sa më shumë të qëndronim në fshat aq më e rëndë do të bëhej gjendja. I shitëm lopët dhe i humbëm paratë në skemat piramidale. Bashkë me paratë na humbën edhe shpreat. Si ne, në grupe, po largoheshin edhe të tjerët dhe shumica u vendos në Tiranë. Kishim një burim sigurie meqënëse kishim pesëmbëdhjetë burra me vete të cilët dinin të ndërtonin shtëpi dhe kjo të paktën do të na mundësonte një vend ku të fusnim kokën. Kishim marrë gjithashtu lajme nga ata që ishin vendosur në Tiranë më pare edhe pse kishin jetuar në kushte të këqija, prapëseprapë nuk mund të krahasohej me jetën që kishim bërë në fshat. Prandaj edhe erdhëm këtu dhe u bashkuam me të afërmit dhe të njohurit që jetonin këtu ...” (një plak nga Kamza, pranë Tiranës)*

Disa kanë gjetur shpresë në jetën e tyre të re dhe ia kanë dale mbanë të lëvizin me sukses. Por të tjerët kanë gjetur të njëjtat vështirësi si kudo në Shqipëri. Ashtu sikurse edhe në zonat fshatare, një nga dukuritë e varfërisë është mungesa e vendeve të punës. Shumica e banorëve periurbanë e vendosin papunësinë në krye të problemeve të tyre. Në shumicën e rasteve të paktën një anëtar i familjes arrin të gjejë punë, por një punë e tillë është shpesh e përkohshme ose me ndërprerje. Gati asnjë familje nuk ka asnjë anëtar të punësuar në punë të rregullt dhe me kohë të plotë.

---

<sup>28</sup> Informacioni që kemi për varfërinë dhe jetesën në zonat periurbane është tejet të kufizuara meqënëse nuk ka asnjë studim të sasior për ta parë në mënyrë shkencore. Të dhënat e LSMS nuk janë përfaqësuese në nivelin periurban dhe si të tilla nuk të japin mundësi për të bërë një analizë statistikore të këtij fenomeni. Megjithatë, duke pasur parasysh ndryshimet demografike në vend dhe presionin që shkakton migrimi fshatar në buxhetet e kufizuara të bashkive në qendrat qytetëse, është e rëndësishme të kuptohen dhe studiohen më në thellësi zonat qytetëse. Ky seksion mbështetet në intervista të kryera me familje në zonat periurbane të Tiranës dhe Durrësit dhe citimet ofrojnë një shikim të shpejtë mbi varfërinë. Megjithatë, duhet të vini re që këto citime nuk kanë si synim të ilustronjë të gjitha zonat periurbane.

*“Kemi ardhura nga Puka në Tiranë. Kemi ardhur me shpresën për një jetë më të mirë, por jemi zhgënjyer. Nuk kemi gjetur punë, edhe pse burri dhe djali shkojnë përditë në qytet për të kërkuar punë. Nuk e kemi mbaruar edhe shtëpinë meqënëse paratë nga shitja e shtëpisë që kishim atje dhe kursimet nuk na dolën dhe çfarë kishim e kemi harxhuar. E blejmë ujën për t’u larë, për të gatuar dhe për të pirë. Nuk ka rrjet ujrash të zeza dhe nuk kemi banjo. Por nuk mund të ankohe mi, meqënëse nuk na detyroi askush të vinim këtu. Kur na pyesin të afërmit në Pukë se si po ia çojmë, e mbyllim gojën dhe u themi që i kemi të gjitha...” (një burrë nga Kamza)*

*“...Kam shtatë vjetë që jetoj këtu dhe së bashku me djalin bëjmë çfarëdolloj pune që gjejmë për të mbajtur familjen, që ka 11 vetë. Gruaja dhe nusja kujdesen për shtëpinë meqënëse nuk gjejnë dot punë asnjëra. Dalim nga shtëpia herët në mëngjes dhe shkojmë nëpër kantiere të qytetit për të kërkuar punë, meqënëse ky është zanati ynë. Vendi i punës që ka zgjatur më shumë ishte ndërtimi i një pallati banimi për katër muaj. Për kontratë as që bëhet fjalë meqënëse na thonë gjithmonë që nuk kanë nevojë për krah pune por na marrin në punë meqënëse u vjen keq. Kështu ndodh me të gjithë.” (një burrë nga Kamza)*

Pas punësimit, problemet e ushqimit ndoshta do të ishin të dytat për banorët periurbanë. Shuica e familjeve përballen me vështirësi të mëdha për të ushqyer familjet. Gati të gjithë blejnë ushqimet më të lira që mund të gjejnë dhe nuk i kushtojnë shumë rëndësi shumëllojshmërisë së dietës për vete dhe familjet. Shumica blejnë ushqime me kredi pa interesa (veresie), e cila bëhet zakonisht me anë të një sistemi liste informale të cilën e mban dyqanxhiu.

Shumica e shtëpive në zonat periurbane janë të reja dhe shpesh të bëra vetë. Në disa raste shtëpitë janë struktura solide prej betoni; në shumë raste të tjera, banesat e reja janë thjeshtë barraka, të ndërtuara me materiale të gjetura rrugëve dhe materiale druri. Shumica e godinave në zonat periurbane rreth Tiranës janë ndërtesa të paligjshme.

*“...Kjo godinë ka qënë stallë. Tani këtu jetojnë 12 familje. Kemi përdorur ç’të mundnim për ta ndarë godinën nga brenda: dërrasa, plastikë, kartona dhe llamarinë. Në vend të xhamave, kemi vënë mushama në dritare. Nuk ka ujë, për WC përdorim disa barraka të vogla, të cilat i kemi ngritur vetë mbi një kanal që gjendet atje. Kanali në fakt është i hapur dhe të gjitha familjet i derdhin ujërat e zeza atje. Jetojmë vetëm 10 metra larg kanalit dhe fëmijët luajnë ngjitur me të sepse nuk kanë ku të shkojnë. Nuk kemi leje. E për çfarë na duhet leja? Lopët që rriteshin këtu kanë pasur kushte më të mira se ne: ato kishin ujë, kanalizime ujrash të zeza, energji elektrike...” (një burrë nga komuna Kamzë)*

Së bashku me cilësinë e ndryshueshme të strehimit, duhet pasur parasysh, nga ana tjetër, që shumë familje shqiptare jetojnë ngjitur me njëra tjetrën me një numër të madh fisi të afërt dhe të largët. Është po ashtu e rëndësishme të kujtojmë që familjet e varfëra rrallë kanë më shumë se dy ambiente në shtëpi. Nuk është e pazakontë të gjejmë familje mbi 8-10 njerëz.

Një problem i madh në zonat periurbane është mungesa e shërbimeve bazë. Kryesor mes këtyre problemeve është uji i rrjedhshëm për shumë familje.<sup>29</sup> Shumë familje duhet ta marrin ujën nga ndonjë pus i afërt ose nga ndonjë burim uji të rrjedhshëm që nuk gjendet pranë banesës. Për shkak të një mungese të sistemit të heqjes së ujërave të zeza në këto zonat periurbane, shumë familje e marrin ujën nga burimet pranë të cilave derdhin mbeturinat e tyre (si ujrat e zeza ashtu edhe plehrat). Shumica e të njëjtave probleme vlejnë edhe për furnizimin me energji elektrike. Shumë

<sup>29</sup> Ka pasur ecure gjatë viteve të fundit për të përmirësuar infrastrukturën bazë të ujit në zonat periurbane të Tiranës (shtrimi i tubacioneve dhe lidhje e tubacioneve kryesore me shtëpitë), por këto tubacione nuk janë vënë ende në efektivitet të plotë.

vendbanime janë të lidhura me tela elektrike, por shumica tregojnë që ky shërbim është me ndërprerje (në rastin më të mirë) dhe se energjia e ofruar është e pamjaftueshme për të përdorur paisjet shtëpiake bazë.

Familjet që shkojnë në zonat qytetëse kanë shërbyer vetëm për të rritur mbipopullimin në një sistem arsimor që edhe pa ta është me mangësi. Numri i nxënësve për klasë është rritur në mënyrë drastike në zonat periurbane dhe shumë shkolla kanë nisur të funksionojnë me turne (një grup klasash paradite dhe klasat e tjera mbasadreke) për të lehtësuar barren mbi mësuesit dhe klasat. Kjo ka sjellë si pasojë që shumë nxënës vijnë në shkollë vetëm disa orë në ditë. Mundësia e përdorimit të shërbimeve shëndetësore në zonat periurbane është shumë e kufizuar dhe në zonat periurbane të Tiranës nuk ka ende një rrjet qëndrassh shëndetësore të cilat do të ishin në përputhje me numrin e banorëve.

## 6. Hartat e varfërisë dhe pabarazisë

Po të kemi parasush madhësinë e vogël të grupit të zgjedhjes, nuk është e mundur që prej LSMS të analizojmë dimensionin hapësinor të varfërisë në shkallë më të imët të zbrërthimit gjeografik. Një përpjekje për të marrë përqindjet në nivel prefekturash ka treguar mungesën e saktësisë së përllogaritjeve, sidomos në prefekturat më të vogla. Megjithëse renditja e prefekturave përmes përdorimit të të dhënave të LSMS duket e kënaqshme, të dhënat e sakta do të jenë të mundshme vetëm pas mbarimit të një analize të hollësishme dhe të gjerë hapësinore e cila e përllogarit varfërinë e plotë dhe hartat e pabarazisë në nivel rrethi dhe bashkie. Një analizë e tile e hartës së varfërisë dhe pabarazisë po kryhet si pjesë e një përpjekje të përbashkët midis MOLSA, INSTAT dhe Bankës Botërore. Në bazë të metodikës së përshkruar nga Elbers, Lanjouw dhe Lanjouw (2002), informacionet nga regjistrimi i popullsisë dhe nga vëzhgimi po kombinohen për të nxjerrë harta të zbrërthyer imët të varfërisë dhe pabarazisë në nivel rrethi, bashkie dhe prefekturë. Kjo përpjekje në proces dhe rezultatet përfundimtare po diskutohen me qeverinë e Shqipërisë. Kjo përfshin edhe rezultatet paraprake në formë hartash dhe tabelash.<sup>30</sup>

Në mënyrë që të nxirren hartat e varfërisë dhe pabarazisë, nevojiten të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet për konsum si ato që përfaqësohen në nivelet e ulëta të agregimit ose të tilla që të shërbejnë për llogaritje statistikore të besueshme. Vëzhgimet për buxhetet familjare ose Vëzhgimet për Matjen e Standartit të Jetesës të cilat mbulojnë të ardhurat dhe konsumin të cilat përdoren zakonisht për të llogaritur matjet e shpërndarjes rrallë janë të një madhësie të mjaftueshme, ndërsa regjistrimi i popullsisë ose vëzhgime me një grup të tillë të madh zgjedhje për të pasur mundësi zbrërthimi kanë shumë pak ose aspak informacion mbi ndryshoret monetare. Kjo na shtrëngon të kombinojmë atë çka përmendëm më sipër duke përdorur informacione mbi ndryshoret monetare nga njëri grup i vëzhgimeve (LSMS) dhe njësitë e zbrërthyer nga një grup tjetër vëzhgimesh (regjistrimi i popullsisë). Ideja bazë është të llogaritet një model i regresionit linear me përbërësit e variancës lokale duke përdorur informacionin nga regjistrimi i popullsisë dhe banesave apo burime të tjera të disponueshme për të gjitha njësitë statistikore të grupit të zgjedhjes (dmth nga regjistrimi i përgjithshëm i titujve të tokës bujqësore). Shpërndarja e përllogaritur e ndryshores së varur në modelin e regresionit (ndryshorja monetare) përdoret pastaj për të nxjerrë shpërndarjen për çdo nënpopullatë të përfshirë në regjistrimin e popullsisë në varësi të tipareve të vëzhguara të nënpopullatës. Nga shpërndarja e përllogaritur e ndryshores monetare në grupin e të dhënave të regjistrimit të popullsisë ose në secilën prej nënpopullatave të

<sup>30</sup> Përgatitja e hartës së varfërisë, e cila përdoret si dokument mbështetës për këtë seksion, është financuar nga Ministria Shqiptare e Punës dhe Çështjeve Sociale. Shprehim mirënjohjen për ndihmën e ofruar nga INSTAT dhe MPCŞ.

tij, bëhen përlogaritjet e një grupi matjesh të varfërisë në bazë të indekseve Foster-Green-Thorbecke. Pastaj, llogariten indeksi Sen dhe një kufi absolut i varfërisë duke përdorur informacionin që jep vëzhgimi i grupit të pasur të zgjedhjes, si dhe një grup matjesh të pabarazisë në bazë të koeficientit Gini të të varfërve dhe dy matje të entropisë të përgjithshme (GE). Këto indekse llogariten për të gjithë Shqipërinë dhe zërthehen në nivelin e katër shtresave të përdorura gjatë përcaktimit të grupit të zgjedhjes për LSMS, shtatë shtresat për të cilat janë ndërtuar modelet e regresionit linear, 12 prefekturat, 36 rrethet, 384 komunat dhe minibashkitë e qytetit të Tiranës.

Tabela 3.6 tregon matjet e varfërisë dhe pabarazisë dhe gabimet kufizimeve për të gjithë Shqipërinë dhe të zërthyerat sipas të katër rajoneve dhe sipas llojit fshatar/qytetësë për rajonet bregdetare dhe qendrore.<sup>31</sup> Rajoni i Tiranës është në gjendje më të mirë përsa i takon konsumit për frymë dhe përqindjes së individëve nën kufirin e varfërisë (përqindja e personave) krahasuar me rajonet e tjera, ndërkohë që zona malore ka pjesën më të madhe të individëve të varfër. Më shumë se një e treta e popullsisë është e varfër në zonat fshatare si në rajonin bregdetar ashtu edhe në atë qendror. Sipas të katër indekseve të varfërisë rajoni malor konsiderohet me gjendjen më të keqe. Rajoni i Tiranës tregon pabarazi më të mëdha në shpërndarjen e konsumit për frymë (sipas indeksit të koeficientit Gini dhe dy indekseve të Entropisë së Përgjithshme të përdorur) krahasuar me rajonet e tjera.

**Tabela 3. 6: Treguesit e varfërisë dhe pabarazisë (%)**

	Përqindja e individëve	FGT(1)	FGT(2)	Gini	Gini-të varfër	Sen	GE(0)	GE(1)	Con
SHQIPËRI	28.60	6.96	2.48	29.54	12.38	5.29	14.28	15.05	7,569.67
	1.28	0.44	0.19	0.52	0.27	0.40	0.53	0.77	120.21
BREGDET	26.64	6.48	2.32	31.57	12.40	4.83	16.36	17.68	8,148.48
	1.94	0.65	0.28	1.15	0.40	0.58	1.24	1.88	249.18
QENDORE	29.49	7.00	2.43	27.35	11.94	5.36	12.16	12.43	7,177.76
	2.32	0.76	0.33	0.54	0.46	0.71	0.51	0.52	222.95
MALËSI	40.85	10.98	4.20	27.40	13.56	9.43	12.25	12.41	6,181.78
	1.60	0.63	0.31	0.55	0.34	0.67	0.51	0.52	120.69
TIRANA	18.01	4.11	1.42	29.35	11.88	2.80	14.18	14.54	8,981.39
	1.09	0.38	0.17	0.63	0.52	0.30	0.65	0.70	140.85
BREGDET qytet	15.63	3.80	1.40	30.25	12.81	2.54	15.34	15.19	9,935.96
	1.84	0.61	0.28	0.94	0.78	0.47	1.04	1.00	467.70
BREGDET fshat	34.84	8.47	3.00	28.87	12.23	6.89	13.97	16.54	6,816.09
	3.22	1.09	0.46	1.74	0.48	1.09	1.94	3.87	283.67
QENDORE qytet	19.48	4.08	1.29	26.34	10.59	2.79	11.28	11.42	8,168.94
	1.56	0.48	0.20	0.64	0.50	0.39	0.56	0.58	163.15
QENDORE fshat	34.41	8.43	2.99	27.02	12.25	6.80	11.87	12.23	6,689.88
	3.45	1.13	0.48	0.86	0.53	1.14	0.80	0.85	327.31

Tabela 3.7 tregon matjet e varfërisë dhe pabarazisë në nivel prefekturë. Prefektura e Vlorës ka konsumin më të lartë për frymë dhe përqindjen më të ulët të njerëzve të varfër (16.57%), ndërkohë që sipas koeficientit Gini konsumi është shumë i përqëndruar (33.61%). Nga ana tjetër,

<sup>31</sup> Për çdo vendodhje të dhënë, mesataret përbëjnë përlogaritjet e pikes, ndërkohë që deviacionet standarte janë gabimet standarte të kufizimeve të këtyre përlogaritjeve.



Prefektura e Dibrës paraqet gjendjen më të dobët, me një konsum për frymë vetëm 6,211 lekë në muaj dhe përqindjen më të madhe të individëve të varfër (42.1%).

**Tabela 3. 7: Indekset e varfërisë dhe të pabarazisë sipas prefekturave (%)**

Prefektura	Përqindja individëve	FGT(1)	FGT(2)	Gini	Gini-të varfër	Sen	GE(0)	GE(1)	Con
1: BERAT	26.42	5.81	1.89	25.64	11.00	4.29	10.65	10.85	7,233.45
	2.16	0.67	0.27	0.52	0.44	0.59	0.46	0.47	193.63
2: DIBËR	42.77	11.88	4.65	28.31	13.95	10.36	13.09	13.39	6,125.03
	2.04	0.84	0.41	0.57	0.38	0.91	0.55	0.60	153.13
3: DURRËS	24.77	6.07	2.18	31.23	12.49	4.42	15.99	16.46	8,412.58
	1.38	0.48	0.22	0.96	0.40	0.42	1.00	1.14	259.03
4: ELBASAN	31.84	7.54	2.61	26.60	11.89	5.91	11.48	11.74	6,852.57
	1.74	0.57	0.24	0.42	0.32	0.55	0.37	0.38	147.41
5: FIER	29.71	7.05	2.46	28.83	11.99	5.43	13.49	14.03	7,365.17
	2.51	0.82	0.34	0.98	0.42	0.77	0.91	1.05	201.87
6: GJIROKASTËR	19.38	4.11	1.31	27.43	10.68	2.79	12.26	12.62	8,393.35
	1.90	0.54	0.21	0.64	0.48	0.43	0.61	0.70	284.64
7: KORÇË	26.95	6.09	2.03	27.03	11.27	4.52	11.82	12.09	7,405.28
	2.67	0.84	0.34	0.57	0.49	0.76	0.52	0.53	239.50
8: KUKËS	39.98	10.59	3.99	27.53	13.27	8.99	12.32	12.53	6,282.05
	1.90	0.76	0.37	0.61	0.43	0.81	0.56	0.57	150.55
9: LEZHË	36.68	9.83	3.76	30.74	13.54	8.11	15.59	17.24	6,898.25
	2.17	0.85	0.40	1.07	0.44	0.86	1.26	2.67	203.69
10: SHKODËR	32.77	8.43	3.14	28.60	13.06	6.72	13.38	13.59	7,025.02
	3.26	1.14	0.50	0.60	0.57	1.10	0.61	0.61	308.93
11: TIRANË	23.44	5.51	1.92	29.48	12.00	3.96	14.22	14.66	8,201.84
	1.19	0.39	0.17	0.46	0.31	0.33	0.46	0.52	134.69
12: VLORË	18.26	4.14	1.42	33.52	11.72	2.82	18.63	20.93	9,817.49
	1.58	0.47	0.19	2.12	0.45	0.37	2.55	4.42	502.02

Tabelat 3.8 dhe 3.9 tregojnë matjet e varfërisë dhe të pabarazisë të zërthyer në nivel rrethi dhe minibashkie (për Bashkinë e Tiranës).

**Tabela 3. 8: Indekset e varfërisë dhe të pabarazisë sipas rretheve (%)**

Rrethi	Përqindja individëve	FGT(1)	FGT(2)	Gini	Gini-të varfër	Sen	GE(0)	GE(1)	Con
1: BERAT	27.80	6.19	2.03	25.84	11.09	4.64	10.81	11.05	7,132.25
	2.46	0.77	0.31	0.57	0.47	0.70	0.50	0.51	207.01
2: BULQIZË	59.46	18.80	8.02	26.48	15.63	18.76	11.47	11.52	4,872.82
	2.68	1.41	0.78	0.65	0.54	1.74	0.58	0.58	157.85
3: DELVINË	14.50	3.17	1.05	42.84	11.19	2.05	30.83	35.36	13,400.59
	2.34	0.67	0.27	6.16	0.79	0.49	9.40	12.44	2,113.08
4: DEVOLL	27.89	6.09	1.96	26.21	10.70	4.57	11.05	11.39	7,203.81
	4.16	1.26	0.49	0.71	0.65	1.16	0.61	0.64	369.79

5: DIBËR	38.14	10.07	3.79	27.98	13.25	8.40	12.74	12.95	6,472.22
	2.01	0.79	0.38	0.70	0.48	0.82	0.66	0.66	161.23
6: DURRËS	21.78	5.38	1.96	31.60	12.71	3.80	16.50	16.76	8,996.73
	1.65	0.55	0.25	1.02	0.52	0.47	1.10	1.19	354.51
7: ELBASAN	28.61	6.55	2.20	26.68	11.45	4.95	11.53	11.81	7,170.90
	2.32	0.73	0.30	0.47	0.44	0.68	0.42	0.43	209.63
8: FIER	26.82	6.26	2.17	29.02	11.87	4.68	13.69	14.14	7,710.72
	2.33	0.74	0.30	1.03	0.43	0.66	0.97	1.08	227.85
9: GRAMSH	35.24	8.47	2.97	25.13	12.07	6.90	10.27	10.38	6,392.57
	2.46	0.84	0.37	0.67	0.50	0.84	0.56	0.56	168.85
10: GJIROKASTËR	18.33	3.93	1.27	28.55	10.85	2.65	13.32	13.82	8,783.22
	1.94	0.55	0.22	0.91	0.59	0.44	0.90	1.10	323.58
11: HAS	47.52	13.56	5.37	27.97	14.16	12.30	12.73	13.07	5,770.89
	3.13	1.38	0.71	1.02	0.68	1.58	0.95	1.03	228.69
12: KAVAJË	27.98	6.76	2.40	29.52	12.22	5.10	14.18	14.55	7,689.25
	2.56	0.84	0.35	0.94	0.43	0.76	0.90	0.98	262.13
13: KOLONJË	20.53	4.38	1.45	25.58	11.10	3.10	10.76	10.79	7,863.55
	2.70	0.73	0.29	0.71	0.71	0.60	0.64	0.63	327.84
14: KORÇË	25.68	5.79	1.92	27.35	11.25	4.23	12.12	12.36	7,601.15
	2.24	0.71	0.29	0.59	0.47	0.63	0.53	0.56	219.50
15: KRUIJË	33.32	8.05	2.81	26.64	12.03	6.39	11.50	11.70	6,742.49
	2.36	0.83	0.37	0.50	0.50	0.81	0.45	0.45	198.43
16: KUÇOVË	24.40	5.25	1.70	25.07	10.91	3.82	10.22	10.29	7,350.99
	1.79	0.54	0.22	0.54	0.51	0.47	0.47	0.45	168.99
17: KUKËS	40.61	10.71	4.01	27.39	13.16	9.14	12.18	12.43	6,230.81
	2.17	0.88	0.42	0.67	0.48	0.92	0.61	0.63	164.17
18: KURBIN	38.50	10.51	4.10	28.15	13.90	8.87	13.01	13.11	6,423.69
	2.94	1.15	0.55	0.64	0.57	1.20	0.60	0.61	229.02
19: LEZHË	35.04	9.28	3.51	33.49	13.31	7.52	18.52	21.45	7,463.12
	2.84	1.12	0.53	2.03	0.59	1.12	2.55	5.24	343.33
20: LIBRAZHD	37.13	9.27	3.35	26.15	12.56	7.70	11.14	11.32	6,356.48
	2.53	0.87	0.38	0.65	0.45	0.90	0.57	0.59	185.12
21: LUSHNJË	32.74	7.88	2.76	28.65	12.06	6.25	13.30	13.97	7,044.25
	2.91	0.98	0.42	0.99	0.45	0.95	0.91	1.09	198.99
22: MALËSI E MADHE	30.51	7.10	2.41	27.40	11.54	5.51	12.14	12.62	7,115.24
	4.57	1.38	0.55	0.92	0.60	1.34	0.85	0.94	488.03
23: MALLAKASTËR	33.29	8.03	2.83	27.09	12.15	6.43	11.91	12.23	6,793.93
	3.35	1.11	0.47	0.87	0.53	1.08	0.76	0.85	255.55
24: MAT	37.53	9.56	3.47	27.64	12.55	7.94	12.41	12.93	6,518.10
	4.74	1.74	0.77	0.94	0.74	1.78	0.89	1.01	395.92
25: MIRDITË	37.02	9.83	3.71	27.91	13.26	8.13	12.70	12.84	6,562.18
	4.11	1.51	0.71	0.83	0.84	1.56	0.82	0.78	349.77
26: PEQIN	38.25	9.42	3.33	26.16	12.14	7.85	11.07	11.39	6,303.18
	2.96	1.16	0.54	0.87	0.69	1.19	0.76	0.80	195.51
27: PËRMET	18.26	3.69	1.13	25.77	10.13	2.48	10.78	10.92	8,245.90
	2.46	0.67	0.25	0.59	0.60	0.53	0.51	0.52	334.91

28: POGRADEC	30.63	7.12	2.42	26.70	11.52	5.51	11.52	11.82	6,995.67
	3.59	1.19	0.50	0.70	0.62	1.13	0.61	0.64	274.13
29: PUKË	42.34	12.13	4.88	29.55	14.44	10.65	14.30	14.64	6,302.69
	6.30	2.38	1.09	0.99	0.78	2.60	1.07	1.10	547.14
30: SARANDË	14.03	3.07	1.03	32.68	11.34	1.98	17.69	18.81	10,763.33
	1.47	0.40	0.16	2.25	0.50	0.29	2.55	3.62	648.94
31: SKAPRAR	22.95	4.81	1.52	25.19	10.54	3.43	10.29	10.46	7,527.73
	2.96	0.78	0.29	0.71	0.51	0.68	0.60	0.65	332.95
32: SHKODËR	31.44	8.00	2.96	28.50	12.94	6.29	13.29	13.44	7,141.41
	2.70	0.95	0.43	0.60	0.57	0.91	0.59	0.59	249.20
33: TEPELENË	22.03	4.72	1.52	26.28	10.75	3.32	11.21	11.32	7,853.82
	2.32	0.66	0.26	0.59	0.57	0.56	0.53	0.52	273.04
34: TIRANË	22.76	5.32	1.85	29.43	11.95	3.79	14.17	14.63	8,278.93
	1.30	0.42	0.18	0.50	0.35	0.35	0.50	0.56	151.37
35: TROPOJË	33.25	8.24	2.96	26.88	12.48	6.57	11.76	11.86	6,758.61
	2.51	0.89	0.41	0.72	0.57	0.88	0.64	0.66	216.82
36: VLORË	19.55	4.47	1.54	32.32	11.80	3.09	17.28	19.11	9,329.39
	1.76	0.53	0.22	1.54	0.48	0.43	1.79	3.16	413.76

**Tabela 3. 9: Indekset e varfërisë dhe pabarazisë sipas minibashkive të qytetit të Tiranës (%)**

Minibashkia	Përqindja individëve	FGT(1)	FGT(2)	Gini	Gini-të varfër	Sen	GE(0)	GE(1)	Con
1	16.92	3.81	1.30	28.33	11.68	2.55	13.24	13.46	8,963.78
	1.26	0.43	0.19	0.73	0.66	0.33	0.72	0.78	176.52
2	15.76	3.48	1.17	29.66	11.40	2.29	14.44	14.76	9,510.04
	1.21	0.38	0.17	0.70	0.59	0.29	0.71	0.73	178.42
3	14.89	3.18	1.06	27.71	11.19	2.09	12.63	12.94	9,133.99
	1.17	0.35	0.15	0.83	0.59	0.27	0.79	0.93	201.79
4	20.50	4.70	1.64	27.37	11.95	3.31	12.35	12.43	8,206.32
	1.32	0.45	0.21	0.58	0.61	0.37	0.57	0.55	158.31
5	11.48	2.42	0.80	29.68	11.12	1.53	14.46	14.83	10,424.63
	0.90	0.25	0.11	0.73	0.57	0.18	0.72	0.79	198.43
6	24.76	5.72	1.98	28.52	11.84	4.20	13.44	14.41	7,806.92
	2.14	0.67	0.28	1.70	0.55	0.59	1.77	2.72	328.50
7	15.71	3.59	1.26	28.97	12.07	2.40	13.87	14.10	9,308.23
	1.10	0.35	0.16	0.61	0.63	0.27	0.62	0.63	192.80
8	15.74	3.45	1.17	28.25	11.48	2.29	13.13	13.35	9,137.55
	1.21	0.37	0.17	0.61	0.66	0.29	0.60	0.62	202.50
9	16.01	3.71	1.32	29.59	12.30	2.50	14.48	14.68	9,423.56
	1.18	0.40	0.19	0.68	0.73	0.31	0.71	0.72	186.16
10	9.06	1.67	0.49	27.96	9.51	1.00	12.72	13.12	10,541.28
	1.02	0.26	0.09	0.73	0.59	0.17	0.66	0.75	297.74
11	30.60	7.57	2.74	27.86	12.61	5.91	12.71	12.96	7,115.61
	2.22	0.85	0.40	0.79	0.63	0.79	0.75	0.75	175.10

Figura 3.2: Përqindja e individëve të varfër sipas prefekturave

Figura 3.3: Konsumi për frymë sipas rretheve





Figura 3.4: Përqindja e të varfërve sipas komunave dhe bashkive



Të dhënat e paraqitura më lart nëpër tabela mund të jepen edhe në formë hartash të varfërisë, tre prej të cilave janë dhënë këtu. Harta sipër majtas (Figura 3.2) tregon përqindjen e varfërisë sipas prefekturave, ndërkohë që harta sipër (Figura 3.3) tregon shpërndarjen e konsumit për frymë sipas rretheve. Harta në të majtë (Figura 3.4) tregon përqindjen e varfërisë sipas komunave dhe bashkive. Kjo analizë është sidomos informative për qëllime të caktimit të grupit të synuar, meqënëse vendodhja dhe përqëndrimi i të varfërve bëhet menjëherë i dukshëm pas një kqyrje të imët të tabelave dhe hartave që i shoqërojnë ato.


Kur të mbarojë përfundimisht, versioni i plotë i përgatitjes së hartave të varfërisë dhe pabarazisë të cilat tregojnë xhepat e pabarazive të ulëta e të larta të të ardhurave të matura sipas dy koeficientëve Gini dhe dy matjeve të entropisë.



## KREU IV: ZHVILLIMET E TREGUT TË PUNËS DHE VARFËRIA

### 1. Pamje e përgjithshme

Reformat makroekonomike dhe ristrukturimi i fillimit të viteve 90 e pakësoi kërkesën për krah pune në Shqipëri dhe sikurse edhe shumë ekonomi të tjera në tranzicion, ky vend ka përjetuar një rënie të normave të pjesëmarrjes të krahut të punës (LFP). Privatizimi në masë i ndërmarrjeve shtetërore dhe konkurrenca e rritur për një numër të pakësuar vendesh pune i ka shtrënguar shumë njerëz të largohen nga forca e krahut të punës në mënyrë të shpejtë. Sipas statistikave zyrtare, norma kombëtare LFP ka qënë më e ulët në vitin 2000, kur vetëm dy të tretat e popullsisë në moshë pune në vend ishte aktive në tregun e punës. Normat e LFP së meshkujve në Shqipëri kanë qënë historikisht më të larta se ato të pjesëmarrjes së femrave dhe vitet e tranzicionit kanë ndikuar



më shumë tek punëtorët femra sesa tek punëtorët meshkuj. Gjatë vitit 1998, për shëmbull, pas pasojave të krizës së skemave piramidale, norma LFP e meshkujve ishte 85 përqind, ndërsa vetëm 55 përqind e grave në moshë pune merrnin pjesë në tregun e punës.

Burimi: INSTAT, Shqipëri

Megjithatë, Shqipëria ka njërën prej normave më të larta të LFP mes vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore. Gjashtë viti 2001, veçm Republika Çeke dhe Sllovakia kishin norma më të larta të pjesëmarrjes se Shqipëria. Hendeku midis gjinive në pjesëmarrjen e krahut të punës në Shqipëri ka qënë relativisht i madh dhe është i krahasueshëm me hendekun e krahut të punës në Bosnje-Hercegovinë, Maqedoni, Rumani, Kroaci dhe RF e Jugosllavisë.

Nivelet e larta të pjesëmarrjes së krahut të punës në Shqipëri, sikurse edhe në ekonomitë e tjera në tranzicion, janë një trashëgimi e politikës së punësimit të plotë gjatë periudhës socialiste, sidoms për krahun e punës së femrave të cilat kishin shumë stimuj ekonomikë dhe shoqërorë për të qëndruar aktive në krahun e punës. Një tjetër force që mbështet normat e larta të LFP në Shqipëri është striktura e ekonomisë, e cila duke qënë kryesisht bujqësore, ofron punësim, qoftë edhe me kohë të pjesshme të shumtën e kohës, për një segment të konsiderueshëm të popullsisë. Punësimi në bujqësi në Shqipëri është rritur edhe më shumë gjatë viteve 90, kur qeveria zbatoi reformat e tokës duke krijuar një numër të madh pronarë tokash.

Të dhënat e LSMS tregojnë që 60 përqind e popullsisë në moshë pune në Shqipëri është aktive në tregun e punës dhe norma e LFP është 71 përqind për meshkujt dhe 50 përqind për femrat.<sup>32</sup> Të dhënat tregojnë që norma e LFP tek individët me arsim më të lartë se shkolla e mesme ishte 74 përqind, 7 përqind më e lartë sesa tek individët me arsim të mesëm dhe 18 përqind më e lartë sesa

<sup>32</sup> Mospërputhjet midis statistikave zyrtare dhe normave të vëzhguara të LFP ka të ngjarë të vijnë si shkak i grupmohave të ndryshme të përdorura gjatë llogaritjes. Aktualisht INSTAT përdor moshat 15 deri 59 për meshkujt dhe 15 deri 54 për femrat si moshë pune zyrtare, ndërkohë që ky studim përdor moshën 14 e lart si për meshkujt ashtu edhe për femrat. Shih kutinë ku jepen përkufizimet e tregut të punës, për më shumë hollësi.

tek individët me arsim më të ulët se shkolla e mesme.

**Tabela 4. 1: Pjesëmarrja e krahut të punës sipas gjinisë dhe arsimit (popullsia në moshë pune, moshë 14+)**

	Gjinia		Arsimi			Total
	Meshkuj	Femra	Më i ulët se i mesëm	I mesëm	Më i lartë se i mesëm	
Të punësuar	64.1	44.8	50.9	57.1	70.1	53.9
Të papunë	7.1	4.8	4.8	9.5	3.6	5.9
Norma e pjesëmarrjes të krahut të punës	71.1	49.5	55.7	66.6	73.7	59.7
Forca jashtë krahut të punës	28.9	50.5	44.3	33.4	26.3	40.3

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Meshkujt përbënin 56 përqind të krahut të punës dhe duke pasqyruar demografinë e vendit një e treta e krahut të punës konsistonte në punëtorë të moshave midis 15 dhe 30 vjeç. Përbërja e krahut të punës tregon që 62 përqind e atyre që janë aktive në krahun e punës kanë arsim më të ulët se shkolla e mesme dhe vetëm 10 përqind kanë arsim të lartë. Krahu i punës është së shumti fshatar (65 përqind), çika pasqyron strukturën ekonomike të vendit. Zonat fshatare kanë norma më të larta LFP (68 përqind) krahasuar me zonat qytetëse (48 përqind), dhe mes rajoneve geografike, Tirana ka normën më të ulët të LFP (48 përqind).

**Tabela 4. 2: Pjesëmarrja e krahut të punës sipas rajoneve (Popullsisë në moshë pune, moshë 14+)**

	Rajoni				Vendodhja		Total
	Bregdet	Qendrore	Mal	Tirana	Qytet (përveç Tiranës)	Fshat	
Të punësuar	54.0	57.0	57.7	38.8	37.3	66.2	53.9
Të papunë	5.0	5.6	5.4	9.5	11.1	2.2	5.9
Norma e pjesëmarrjes të krahut të punës	58.9	62.5	63.1	48.2	48.4	68.4	59.7
Jashtë krahut të punës	41.1	37.5	36.9	51.8	51.6	31.6	40.3

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Gjatë vitit 2002, një e treta e popullsisë në moshë pune ishte jashtë krahut të punës. Një pjesë e madhe e atyre që nuk bënin pjesë në krahun e punës banonin në zonat qytetëse (58 përqind) dhe një e dyta ishin nën moshën 40 vjeç. Shtëpiaket (25 përqind), pensionistat<sup>33</sup> (21 përqind), dhe studentët (19 përqind) së bashku përbënin pjesën kryesore të atyre që nuk bënin pjesë në krahun e punës. Një grup relativisht i madh individësh të raportuar si të paaftë (10 përqind) dhe ishte edhe një përqindje e madhe punëtorësh të çinkurajuar (10 përqind) mes atyre që ishin jashtë krahut të punës. Përqindjet e pensionistëve dhe të shtëpiakeve ishin dukshëm më të ulëta se në vitin 1996,<sup>34</sup> çka sugjeron që më shumë të moshuar po qëndronin aktive dhe më shumë shtëpiake po riktheheshin në krahun e punës. Nga ana tjetër, një përqindje e rritur e studentëve në këtë grup do të tregonte që më shumë të rinj po vononin të të gjenin punë për shkak të arsimit të mëtejshëm.

<sup>33</sup> Moshë aktuale e daljes në pension në Shqipëri është 54 për femrat dhe 59 për meshkujt, por është marrë vendimi që kjo moshë të bëhet 59 për femrat dhe 64 për meshkujt. Për të siguruar krahasueshmëri me vendet e tjera të CEE si edhe me studime të mëparshme mbi krahun e punës e në Shqipëri, popullsisë e moshave 15 deri 64 vjeç konsiderohen si popullsi në moshë pune për këtë studim.

<sup>34</sup> Sipas M. Rashid (2001), segmenti jashtë krahut të punës i vitit 1996 konsistonte më shumë në pensionistë (41 përqind), shtëpiake (38 përqind), studentë (12 përqind), dhe punëtorë të çinkurajuar (9 përqind). Vini re që studimi i vitit 1996 nuk e mbulonte Tiranën.



#### KUTIA 4.1: PËRKUFIZIME TË TREGUT TË PUNËS

Përkufizimet e mëposhtme mbështeten në pyetësin e LSMS të Shqipërisë për vitin 2002 dhe/ose ndjekin përkufizimet e tregut të punës të përdorur zakonisht nga ILO:

**Popullsia në moshë pune:** popullsia e moshës 14 vjeç e lart konsiderohet si popullsi në moshë pune për qëllimet e këtij studimi. (Vini re që statistikat zyrtare të botuara nga INSTAT e përkufizon moshën e punës si 15-54 vjeç për femrat dhe 15-59 vjeç për meshkujt.)

**I punësuar ose në punë:** çdokush që ka bërë njëfarë pune gjatë shtatë ditëve të fundit përpara vëzhgimit dhe çdokush me punë të përhershme që nuk ka punuar për arsytet e mëposhtme: sëmundje veti, leje lindje, sëmundje e një anëtarit të familjes, pushime, arsim ose kualifikim, ulje e përkohshme e ngarkesës së punës dhe grevë ose pezullim nga puna.

**I papunë:** një individ i cili nuk ka punuar gjatë shtatë ditëve të fundit përpara vëzhgimit, por i cili ka kërkuar punë gjatë katër javëve të fundit. Një individ konsiderohet gjithashtu i papunë kur nuk ka punuar gjatë shtatë ditëve të fundit, nuk ka kërkuar punë gjatë shtatë ditëve të fundit, por ka gjetur një punë që do të fillojë më vonë.

**Krahu i punës:** shuma gjithsej e të punësuarve dhe të papunëve

**I papërfshirë në krahu e punës:** një individ konsiderohet i papërfshirë në krahu e punës nëse nuk është i punësuar dhe nëse nuk kërkon punë.

**Norma e pjesëmarrjes së krahut të punës (LFP):** Krahu i Punës pjesëtuar me popullsinë në moshë pune

**Norma e punësimit:** të punësuarit pjesëtuar me popullsinë në moshë pune

**Norma e papunësisë:** numri i të papunëve pjesëtuar me krahu e punës


**Numri i orëve të punës në muaj:** prodhimi i orëve të punës në javë me numrin e javëve në vit pjesëtuar me 12, që është numri i muajve në vit.

**Punësimi me kohë të plotë:** Punësimi konsiderohet me kohë të plotë nëse një individ punon 35+ orë në javë.

**Punësimi me kohë të pjesshme:** punësimi konsiderohet me kohë të pjesshme nëse një individ punon më pak se 35 orë në javë.

## 2. Punësimi

Reformat makroekonomike dhe ristrukturimi që iu bë në fillim të viteve 90 ka çuar në një rënie të shpejtë të normave të punësimit në Shqipëri dhe edhe pse punësimi i meshkujve pothuajse e mori veten në fund të viteve 90 në nivelet që ishte përpara periudhës së tranzicionit, punësimi i femrave qëndroi i ulët. Ndrëkohë që ishte 60 përqind gjatë vitit 2001, norma e punësimit në



Shqipëri ishte e lartë sipas normave të Europës Qendrore dhe Lindore dhe ishte i

krahasueshëm me normat e punësimit të Sllovakisë, Bullgarisë dhe Rumanisë.

Burimi: INSTAT, Shqipëri

Normat e ulura të punësimit gjatë viteve 90 erdhën si pasojë e rënies së punësimit në sektorin publik. Numri i vendeve të punës në sektorin publik ka rënë në mënyrë drastike nga 850,000 në vitin 1991 në 189,000 në vitin 2001. Kjo rënie e punësimit në sektorin publik erdhi kryesisht si pasojë e privatizimit në masë të ndërmarrjeve shtetërore. Liberalizimi i çmimeve, heqja e subvencionimeve shtetërore, mungesa e kapitalit dhe konkurrenca e huaj – masa të cilat janë marrë për ta bërë ekonominë konkurruese në periudhën afatgjatë – i dobësuan pa masë ndërmarrjet e privatizuara rishtazi dhe i çuan në falimentim. Sektori industrial – nxjerrja e mineraleve, metalurgjia, istrumentat, kimikatet, letra dhe tekstilet – e vuajtën më shumë këtë gjë. Të ardhurat e ulura çuan në pakësimin e vendeve të punës edhe në strukturat qeveritare.

**Tabela 4. 3: Punësimi sipas sektorëve (fund-periudhe)**

	1991	1993	1995	1997	1999	2001
Total	1,404,091	1,045,918	1,137,829	1,107,677	1,065,104	1,063,093
Sektori publik	850,091	375,338	275,887	226,295	201,429	188,965
– Buxhetor	n/a	182,299	159,619	145,319	128,452	120,114
– Jo buxhetor	n/a	193,039	116,268	80,976	72,977	68,851
Sektori privat (jo bujqësor)	30,000	80,277	111,942	120,382	102,675	113,128
Sektori privat (bujqësor)	524,000	590,303	750,000	761,000	761,000	761,000

Burimi: INSTAT, Shqipëria

Punësimi në sektorin privat, nga ana tjetër, është rritur dukshëm gjatë të njëjtës periudhë, ku numri i vendeve të punës në sektorin privat jo bujqësor u rrit pothuajse katër herë. Punësimi privat bujqësor mbeti më i madhi ndër sektorët privat dhe numri i vendeve të punës në bujqësi u rrit me më shumë se 200,000 (ose 45 përqind) midis viteve 1991 dhe 2001.

Gjatë vitit 2001, më shumë se 80 përqind e punësimit total u siguroa nga sektori privat, ku shumica absolute e vendeve të punës janë në bujqësi (71 përqind). Përveç bujqësisë, shumica e vendeve të punës gjatë vitit 2001 qenë në sektorët shoqërorë (shëndetësia dhe arsimit), shërbime (tregëti, hotele dhe restorante), industritë prodhuese (kryesisht përpunim ushqimor dhe tekstile) dhe energji dhe transporte.

Norma e punësimit sipas vëzhgimit gjatë vitit 2002 prej 54 përqind ishte më e vogël se norma zyrtare e punësimit prej 60 përqind e raportuar për vitin 2001. Norma e punësimit ishte më e lartë për meshkujt (64 përqind) sesa për femrat (45 përqind), dhe individët me arsim më të lartë se shkolla e mesme kishin një normë më të lartë punësimi (70 përqind) se ata me arsim më të ulët.

**Tabela 4. 4: Punësimi sipas gjinisë dhe arsimit (përqind e popullsisë në moshë pune, moshë 15-64)**

	Gjinia		Arsimi			Total
	Meshkuj	Femra	Më pak se e mesme	E mesme	Më shumë se e mesme	
Në punë me kohë të plotë *	44.6	22.8	27.7	41.9		33.1
<i>Përqind e të punësuarve gjithsej</i>	<i>69.6</i>	<i>51.0</i>	<i>54.5</i>	<i>73.3</i>	<i>75.1</i>	<i>61.5</i>
Në punë me kohë të pjesëshme	19.5	22.0	23.1		17.5	20.8
<i>Përqind e të punësuarve gjithsej</i>	<i>30.4</i>	<i>49.0</i>	<i>45.5</i>	<i>26.7</i>	<i>24.9</i>	<i>38.5</i>
Gjithsej të punësuar	64.1	44.8	50.9	57.1	70.1	53.9

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Gjashtëdhjetë e dy përqind e të punësuarve kishin punë me kohë të plotë dhe 39 përqind e të punësuarëve kishin punë me kohë të pjesshme dhe një përqindje shumë më e madhe e meshkujve (70 përqind) sesa femrat (51 përqind) kishin punë me kohë të plotë. Më shumë individë me arsim më të lartë të mesëm (75 përqind) kishin punësim me kohë të plotë, krahasuar me 73 përqind të punëtorëve me arsim të mesëm dhe 55 përqind me arsim më të ulët se të mesëm. Norma e punësimit në Tiranë ishte vetëm 39 përqind, duke qënë më e ulëta në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Nga ana tjetër, 87 përqind e vendeve të punës në Tiranë ishin me kohë të plotë. Zona bregdetare gjithashtu kishte përqindjen më të madhe të vendeve të punës me kohë të plotë (68 përqind). Në zonat kryesisht bujqësore qendrore dhe malore punësimi ishte në prëgjithësi me kohë të pjesshme.

**Tabela 4. 5: Punësimi sipas rajoneve (përqind e popullsisë në moshë pune, moshë 14+)**

	Rajoni				Vendodhja		Total
	Bregdet	Qendror	Malor	Tirana	Qytet (përjashtoj Tiranën)	Fshat	
Në punë me kohë të plotë *	36.4	31.9	28.1	33.7	28.4	35.6	33.1
<i>Përqind e të punësuarve gjithsej</i>	67.5	56.0	48.6	86.9	76.2	53.7	61.5
Në punë me kohë të pjesshme	17.5	25.1	29.6	5.1	8.9	30.7	20.8
<i>Përqind e të punësuarve gjithsej</i>	32.5	44.0	51.4	13.1	23.8	46.3	38.5
Gjithsej të punësuar	54.0	57.0	57.7	38.8	37.3	66.2	53.9

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Shpërndarja e kraut të punës nëpër sektorë të ndryshëm tregon që 56 përqind e punësimit total i takonte bujqësisë, çka është më pak se përqindja e raportuar nga statistikat zyrtare (72 përqind). Përqindja e punësimit jo bujqësor (34 përqind), nga ana tjetër, ishte më e madhe se përqindja e raportuar nga të dhënat zyrtare (20 përqind), dhe shumica e vendeve të punës që nuk ishin në bujqësi u takonin shërbimeve (9.5 përqind), shëndetësisë dhe arsimit (6.9 përqind), ndërtimit (6.8 përqind), energjisë dhe transportit (4.3 përqind), dhe administrates publike (4.3 përqind).

Vetëpunësimi ishte lloji më i zakonshëm i punësimit dhe gjatë vitit 2002 gati dy të tretat e të punësuarve ose ishin të vetëpunësuar ose punonin pa rrogë në fermën e shtëpisë apo në biznesin e shtëpisë dhe vetëm një e treta ishin të punësuar me page. Shumica absolute e të vetëpunësuarve ishin të anagazhuar në bujqësi.

#### *Punësimi me pagë*

Përqindja e të punësuarve me page (35 përqind) ishte dukshëm më e lartë se përqindja e raportuar në vitin 1996.<sup>35</sup> Punësimi me page ishte gati i shpërndarë në mënyrë të barabartë midis sektorëve publikë dhe atyre private, të cilët së bashku ofronin rreth 98 përqind të vendeve të paguara të punës. Vendet e punës në strukturat qeveritare (40 përqind e punësimit gjithsej me page) mbizotëronin në punësimin në sektorin publik, ndërkohë që ndërmarrjet shtetërore siguronin një përqindje më të vogël të punësimit gjithsej (8 përqind të punësimit gjithsej me pagë).

**Tabela 4. 6: Kohëzgjatja e punësimit me pagë**

Koha e punësimit	Punëdhënësi
------------------	-------------

<sup>35</sup> Sipas Rashid (2001), përqindja e punësimit me page në vitin 1996 ishte 23 përqind. LSMS e vitit 1996 nuk e mbulonte Tiranën, ku mbizotëronte punësimi me pagë.

	Qeveria	Shoqëri private	Ndërmarrje shtetërore	OJQ	Punëdhënës individ
Më pak se 7 muaj	4.6	14.4	14.0	15.3	9.7
7-12 muaj	4.9	7.6	27.7	11.1	7.1
1-2 vjet	13.1	23.0	11.5	22.6	18.2
3-5 vjet	17.4	27.4	31.0	23.3	21.4
6-10 vjet	18.7	17.7	9.7	18.6	17.9
Më shumë se 10 vjet	41.4	9.9	6.2	9.2	25.7
Total	100	100	100	100	100

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Tek të punësuarit me page, punësimi në strukturat qeveritare ishte më i sigurti, ku gati 80 përqind e punëmarrësve i mbanin vendet e punës më shumë se tre vjet dhe 60 përqind i mbanin gjashtë vjet ose më shumë. Vendet e punës ishin më pak të sigurta në ndërmarrjet shtetërore, ku, mesatarisht, një vend pune zgjaste tre vjet ose më pak. një e dyta e vendeve të punës në shoqëritë private dhe në OJQ ishin krijuar gjatë pesë vjetëve të fundit. Një analizë e punësimit brenda sektorëve tregon se shumica e vendeve të punës të krijuara rishtazi ishin krijuar në sektorin privat. Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se firmat private dhe punëdhënësit individë siguronin më shumë se 50 përqind të vendeve të punës të krijuara gjatë pesë vjetëve të fundit që i paraprinin vëzhgimit.

Më shumë se 80 përqind e punësimit me page ishte me kohë të plotë. Brenda sektorëve, ndërmarrjet shtetërore ofronin përqindjen më të madhe të vendeve të punës me kohë të plotë (95 përqind të punësimit gjithsej me SOE). Shoqëritë private siguronin po ashtu shumicën e punësimit me kohë të plotë (91 përqind), sikurse edhe OJQ (88 përqind). Përqindja e vendeve të punës ishte më e lartë tek vendet e punës të ofruara nga strukturat qeveritare (20 përqind) dhe punëdhënësit individë (26 përqind).

**Tabela 4. 7: Lloji i punësimit sipas punëdhënësve**

	Kohë të plotë	Kohë të pjesshme	Total
Ndërmarrjet shtetërore	94.6	5.4	100.0
Shoqëri private	91.1	8.9	100.0
OJQ	87.6	12.4	100.0
Qeveria	79.8	20.2	100.0
Punëdhënës individë	74.6	25.5	100.0
Total	82.8	17.2	100.0

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

#### *Sektori informal*

Sipas klasifikimeve të ILO, ekonomia informale karakterizohet si një grup njësisish të angazhuara në prodhimin e mallrave apo shërbimeve me objektivin parësor për të krijuar vende pune dhe të ardhura për personat në fjalë. Këto njësi funksionojnë në mënyrë tipike në nivel të ulët organizativ, me shumë pak ose aspak ndarje midis krahut të punës dhe kapitalit si faktorë prodhimi dhe funksionojnë në shkallë të vogël. Marrëdhëniet e krahut të punës – aty ku ekzistojnë

– mbështeten kryesisht në punësimin e rastit, marrëdhënie farefisnore ose marrëdhënie vetiake ose shoqërore, në vend të përdorimit të kontratave apo garancive formale.<sup>36</sup>

Sipas ILO, sektori informal mund të shikohet si një grup njësisish operative të cilat formojnë një pjesë të sektorit shtëpiak si ndërmarrje familjare apo ndërmarrje të parregjistruara në pronësi të familjeve. Në bazë të këtij përkufizimi, sektori informal konsiston më shumë në punonjës me llogari më vete dhe ndërmarrje familjare jo bujqësore.<sup>37</sup>

Pavarësisht koncepteve të përkufizuara relativisht mirë, është shumë e vështirë të bësh një vlerësim sasior të ekonomisë informale. Në varësi të qëllimeve të veçanta analitike dhe mbështetur në të dhënat e mbledhura, hulumtuesit përdorin kritere të ndryshme për të karakterizuar sektorin informal në ekonomi të ndryshme. Njëra prej dilemave të hasura më shpesh është nëse duhet të përfshihet ose jo vetëpunësimi bujqësor si pjesë e sektorit informal dhe shumë veta vendosin të mos e përfshijnë sepse vetëpunësimi bujqësor nuk kërkon rregjistrim zyrtar apo marrje leje nga autoritetet dhe të gjithë aktivitetet fermere gëzojnë status ligjor. Sipas udhëzimeve të ILO, sektori informal përkufizohet këtu si punonjës me llogari më vete dhe punonjës të ndërmarrjeve familjare jobujqësore.

Sektori informal në Shqipëri analizohet duke përdorur të dhënat e punësimit dhe të dhënat mbi ndërmarrjet familjare jobujqësore. Të dhënat e punësimit tregojnë që rreth 10 përqind e të punësuarve në Shqipëri kanë punuar në ndërmarrje familjare jobujqësore ose si punonjës me llogari më vete. Madhësia e sektorit informal është shumë më e madhe në zonat qytetëse (24 përqind) sesa në zonat fshatare (5 përqind). Rreth 15 përqind e të punësuarve në Tiranë janë punonjës me llogari më vete ose punojnë nëpër ndërmarrje familjare jobujqësore.

Pothuajse tre të katërtat e individëve në sektorin informal ishin të punësuar të paktën për tre vjet dhe rreth 10 përqind e tyre kanë qënë të angazhuar në sektorin informal për në shumë se 10 vjet. Më shumë se 90 përqind e njerëzve të përfshirë në sektorin informal e kanë nisur biznesin e tyre si një mënyrë për t'i gjetur vetes punë.


***Tabela 4. 8: Të dhënat e punësimit në Shqipëri, 2002***

Sektori i punësimit	Tirana	Qytete të tjera	Fshat	Total
Fermë familjare	0.0	4.7	78.5	54.9
Me llogari më vete ose ndërmarrje familjare jobujqësore	15.0	23.8	5.4	10.4
Punësim me page jashtë shtëpisë	85.0	71.5	16.1	34.7
Total	100.0	100.0	100.0	100.0

<sup>36</sup> Sipas ILO, njësitë prodhuese të sektorit informal kanë tiparet karakteristike të ndërmarrjeve familjare. Aktivitetet e qëndrueshme dhe aktivitetet e tjera të përdorura në njësitë prodhuese nuk u përkasin njësisve prodhuese por pronarëve të tyre. Këto njësi nuk mund të angazhohen në shitblerje apo të lidhin kontratë me njësi të tjera dhe nuk kanë detyrime në emër të tyre. Pronarët duhet të gjejnë financimin e nevojshëm duke e mbajtur vetë rrezikun dhe mbajnë vetë përgjegjësi për borxhin apo detyrime të tjera të krijuara gjatë procesit prodhues. Shpenzimet për prodhimin shpesh herë nuk dallohen nga shpenzimet shtëpiake. Po kështu, mallrat kapitale si ndërtesa apo mjetet e transportit përdorin pa dallim si për qëllime biznesi ashtu edhe për qëllime familjare.

<sup>37</sup> Përveç konceptit të ILO, literatura ekonomike përdor rëndom edhe përkufizime të tjera operative për sektorin informal. Njëri prej përkufizimeve të përdorura gjerazi mbështetet në statusin e ndërmarrjes familjare, e cila shumë shpesh nuk është e rregjistruar tek autoritetet vendore dhe si të tilla mbeten jashtë kuadrit institucional zyrtar. Një qasje tjetër është përdoret statusi i krahit të punës i individit si një kriter për të dalluar sektorin formal nga ai informal.

Shtatëdhjetë e pesë përqind e të vetëpunësuarve ishin meshkuj dhe 25 përqind e tyre ishin femra. Të gjitha grupmoshat dhe të gjithë nivelet arsimore janë të pranishme mes të vetëpunësuarve. Përqindja e të vetëpunësuarve me arsim më të lartë se të mesëm është 11 përqind, çka është pak



më e lartë se ajo e forces së krahut të punës gjithsej (10 përqind). Tek të vetëpunësuarit, ka më shumë meshkuj se femra me arsim më të lartë se të mesëm (12 përqind kundrejt 9 përqind).

Gjashtëdhjetë e katër përqind e të vetëpunësuarve banojnë në Tiranë dhe në zonat e tjera qytetëse, duke konfirmuar edhe një herë se aktivitetet informale janë më të zakonshme nëpër zonat qytetëse.<sup>38</sup>

Të dhënat mbi ndërmarrjet familjare jobujqësore tregojnë se rreth 15 përqind e familjeve në Shqipëri kishin një ndërmarrje jobujqësore. Të dy grupet e të dhënave, edhe të dhënat mbi punësimin individual, edhe të dhënat mbi ndërmarrjet familjare jobujqësore, tregojnë se rishitja e mallrave (49 përqind), transporti taksit dhe ai i mallrave (15 përqind), prodhimi (7 përqind), ndërtimi (6 përqind), agrobiznesi dhe përpunimi i ushqimeve (6 përqind) dhe restorantet (5 përqind) ishin ndër bizneset familjare më të zakonshme. Ndërkohë që agrobiznesi, përpunimi i ushqimeve dhe prodhimi hasen më shumë në zonat fshatare, në zonat qytetëse ka më shumë restorante, shërbime, dhe punë shëndetësore dhe shoqërore. Shitjet, transporti dhe ndërtimi hasen njësoj si në zonat fshatare ashtu edhe në ato qytetëse.

<sup>38</sup> Ju kujtojmë se përkufizimi i përdorur këtu nuk e përfshin vetëpunësimin bujqësor si pjesë të sektorit informal.

**Tabela 4. 9: Ndërmarrjet familjare jobujqësore sipas industrive**

Industria	Tirana	Qytet	Fshat	Total
Shitje	44.9	51.6	45.8	48.6
Transport	14.1	13.2	17.5	14.9
Prodhim (dru, metal, konfeksione)	3.7	6.4	8.8	7.0
Ndërtim	6.3	6.5	5.5	6.1
Agrobiznes dhe përpunim ushqimesh	1.3	1.7	13.2	6.1
Restorante	10.2	6.5	1.6	5.1
Shërbime vetiake (sallone parukerie dhe bukurie, etj)	1.1	3.2	1.2	2.2
Shërbime të tjera (ligjore, marketing, këshillim, etj.)	3.4	1.7	1.0	1.6
Punë shëndetsore dhe sociale	3.5	1.4	0.6	1.4
Zbavitje	0.0	1.9	1.0	1.3
Të tjera	11.7	46.0	3.8	5.9

Më shumë se 80 përqind e ndërmarrjeve familjare jobujqësore kanë ekzistuar për të paktën dy vjet, ndërsa 40 përqind e tyre kanë qënë më shumë se pesë vjet të vjetra. Dyzetë përqind e ndërmarrjeve familjare ishin në shtëpi ose kishin një vendodhje fikse, por më shumë se 30 përqind e tyre nuk kishin një vendodhje fikse ose funksiononin në rrugë. Familje të vetme kishin në mënyrë të pavarur 94 përqind të ndërmarrjeve jobujqësore, ndërkohë që gjashtë përqind të tjera kishin më shumë se një familje për pronar. Më pak se një e dyta e këtyre ndërmarrjeve ishin të rregjistruara në zyrat tatimore vendore dhe diçka më shumë se 55 përqind e tyre mbanin një lloj sistemi llogarish. Shtatëdhjetë e shtatë përqind e bizneseve kishin vetëm një punonjës, në shumicën e rasteve vetë kryefamiljari, ndërkohë që pjesa tjetër kishte punësuar edhe të tjerë, anëtarë ose jo të familjes.

### 3. Papunësia

Normat e lartat të papunësisë në Shqipëri, sikurse edhe në vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore, kanë ardhur si pasojë e privatizimit në masë të ndërmarrjeve shtetërore joeficiente e kryer nga ana qeverisë si pjesë e reformave makroekonomike ose ristrukturimit. Punësimi në sektorin publik i pakësuar në mënyrë drastike ka detyruar shumë punëtorë të kërkojnë punë në sektorët private dhe informalë, ose të largohen fare nga forca e krahut të punës. Në masën 17 përqind në vitin 2000, viti i fundit për të cilin ka të dhëna rajonale, norma e papunësisë në Shqipëri ishte ende shumë e lartë dhe ishte e krahasueshme me normat e Serbisë dhe Malit të Zi (26 përqind), Kroacisë (21 përqind), Sllovakisë (19 përqind), dhe Bullgarisë (18 përqind).

Qysh prej pikut të vitit 1993, kur më shumë se 22 përqind e krahut të punës në Shqipëri ishte pa punë, norma e papunësisë ka rënë midis dhjetë dhe njëzetë përqind dhe në vitin 2001, viti i fundit për të cilin kemi të dhëna, norma e papunësisë ishte 14.5 përqind. Papunësia në Shqipëri ka qënë historikisht më e lartë tek femrat sesa tek meshkujt.

**Tabela 4. 10: Forca e krahut të punës dhe papunësia, 1991-2001 (në mijë)**

	1991	1993	1995	1997	1999	2000	2001
Gjithsej të papunë të rregjistruar	140	301	171	194	240	215	181
– Meshkuj	65	159	91	110	130	113	96
– Femra	75	142	80	84	110	102	85
Norma e papunësisë, përqind	9.1	22.3	13.1	14.9	18.4	16.8	14.5

– Meshkuj	7.8	20.9	11.7	13.9	16.4	15.0	13.2
– Femra	10.5	24.2	15.0	16.6	21.4	19.3	16.5

*Burimi: INSTAT, Shqipëri*



**Tabela 4. 11: Papunësia sipas gjinisë dhe arsimit (përqind)**

	1993	1995	1997	1999	2001
Gjithsej të papunë të rregjistruar	100	100	100	100	100
– Meshkuj	53	53	56	54	53
– Femra	47	47	44	46	47
Nga të cilët:					
– me arsim fillor	52	48	49	48	49
– me arsim të mesëm	45	49	48	49	48
– me arsim të lartë	3	2	3	3	2
Nga gjithsej të papunë të rregjistruar:					
- 15-19 vjeç	15	12	12	13	7
- 21-34 vjeç	49	46	46	46	47
- 35 vjeç e lart	36	42	42	42	46

Burimi: INSTAT, Shqipëri

Të dhënat për periudhën 1993-2001 tregojnë kishte më shumë meshkuj të rregjistruar si të papunë sesa femra. Në vitin 2001, vetëm dy përqind e individëve me arsim të lartë ishin të rregjistruar si të papunë, çka sugjeron se arsimi i lartë ka gjasa të mëdha për të ndihmuar largimin nga varfëria. Arsimi fillor ose i mesëm, nga ana tjetër, nuk e garanton një mundësi të tillë. Gjatë periudhës 1993-2001, pjesa që zinin personat 35 vjeç e lart tek të papunët u rrit me 10 përqind, ndërkohë që pjesa që zinin personat nga 15 deri 19 vjeç u ul nga 15 në 7 përqind. Gjatë vitit 2001, 93 përqind e të papunëve ishin në moshën fillore të punës.

Të dhënat e LSMS 2002 tregojnë që norma e papunësisë në Shqipëri ishte diçka nën 10 përqind.<sup>39</sup> Po t'i fusim edhe punëtorët e çinkurajuar, sezonalë dhe të pushuar nga puna si të papunë, norma e papunësisë bëhet 15 përqind. Papunësia është më e lartë tek femrat sesa tek meshkujt, ku ky hendek midis gjinive rritet më shumë nëse aplikojmë përkufizime më pak strikte të papunësisë. Sipas të dhënave të vëzhgimit, papunësia është më e lartë tek individët me arsim të mesëm sesa tek individët me arsim më të ulët ose më të lartë se arsimi i mesëm.

**Tabela 4. 12: Forca e krahut të punës dhe papunësia sipas gjinive dhe arsimit (përqind e popullsisë në moshë pune, mosha 14+)**

	Gjinia		Arsimi			Total
	Meshkuj	Femra	Më i ulët se i mesëm	I mesëm	Më i lartë se i mesëm	
Norma e pjesëmarrjes së krahut të punës	71.1	49.5	55.7	66.6	73.7	59.7
Jashtë krahut të punës	28.9	50.5	44.3	33.4	26.3	40.3
Norma e papunësisë	9.9	9.6	8.6	14.2	4.9	9.8
Norma e papunësisë 2*	14.3	16.8	14.7	19.9	7.2	15.4
Norma e papunësisë 3**	17.0	21.9	21.3	18.9	5.6	19.1

\* Llogarit edhe punëtorët e çinkurajuar/sezonalë/të pushuar nga puna si të papunë.

\*\* Llogarit individët të cilët punojnë më pak se 15 orë në javë në bujqësi si të papunë.

Në masën 20 përqind, norma e papunësisë në Tiranë në vitin 2002 ishte dy herë më e madhe se norma mesatare në të gjithë vendin dhe ishte më e larta mes rajoneve. Sipas këtij vëzhgimi, pothuajse një në pesë të rritur të aftë në punë në Tiranë ishte i papunë. Në total, norma e

<sup>39</sup> Duke përdorur përkufizimin standart të ILO.

papunësisë në zonat qytetëse (23 përqind) ishte gati shtatë herë më e lartë se norma në zonat fshatare (3 përqind).


**Tabela 4. 13: Forca e krahut të punës dhe papunësia sipas rajoneve (përqind e popullsisë në moshë pune, moshë 14+)**

	Rajoni				Vendodhja		Total
	Bregdet	Qendror	Mal	Tirana	Qytet (përfshijë Tiranën)	Fshat	
Norma e pjesëmarrjes së krahut të punës	58.9	62.5	63.1	48.2	48.4	68.4	59.7
Jashtë krahut të punës	41.1	37.5	36.9	51.8	51.6	31.6	40.3
Norma e papunësisë	8.4	8.9	8.6	19.6	22.9	3.2	9.8
Norma e papunësisë 2*	14.5	14.3	13.9	25.2	32.2	6.7	15.4
Norma e papunësisë 3**	15.1	21.6	19.0	19.6	23.9	17.2	19.1

\* Llogarit edhe punëtorët e çinkurajuar/sezonalë/të pushuar nga puna si të papunë.

\*\* Llogarit individët të cilët punojnë më pak se 15 orë në javë në bujqësi si të papunë.

Kishte më shumë të papunë meshkuj se femra dhe më shumë se një e dyta e të papunëve kishin vetëm arsim fillor. Rajoni qendror përbën më shumë se 40 përqind të të papunëve dhe rreth 70 përqind e të papunëve janë 25-64 vjeç.



Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Mesatarisht, një person i papunë shpenzon 14 orë në muaj për të kërkuar punë dhe kohëzgjatja e kërkimit të punës nuk ndryshon sipas gjinive apo niveleve të ndryshme arsimore. Kërkimi për punë zgjat më shumë në rajonet malore dhe qendrore, megjithëse edhe në Tiranë të papunët shpenzojnë mesatarisht një vit për të kërkuar punë. Një punonjësi më të madh në moshë i duhet më shumë për të gjetur punë sesa një më të riu në moshë. Mesatarisht, 15-25-vjeçarët gjejnë punë brenda vitit, por punonjësve 46 vjeç e lart mund t'u duhet deri 18 muaj.

Vetëm një e katërta e atyre që ishin aktualisht të papunë<sup>40</sup> ishin të angazhuar në aktivitete krijimi të ardhurash gjatë 12 muajve të fundit përpara vëzhgimit. Papunësia afatgjatë ishte më e lartë për femrat se për meshkujt, ku 90 përqind e femrave që ishin aktualisht të papuna kishin qënë pa punë të paktën për një vit. Vetëm 45 përqind e të papunëve janë të rregjistruar tek zyrat vendore të punës dhe mënyra më e rëndomtë për të gjetur punë është përmes njohjeve shoqërore dhe familjare.

#### **Kutia 4.2: Përse është kaq e lartë norma e papunësisë në Tiranë?**

Sipas të dhënave të vëzhgimit, Tirana ka pjesëmarrjen më të ulët të krahut të punës dhe normën më të lartë të papunësisë mes katër zonave gjeografike të Shqipërisë. Ky rast ku kryeqyteti ka një normë më të lartë papunësie se pjesët e tjera të vendit është e pazakontë për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, sepse përvoja në rajon ka treguar që kryeqytetet ofrojnë zakonisht më shumë mundësi punësimi dhe si rrjedhojë kanë norma më të ulëta papunësie.

Një shpjegim për normën e lartë të papunësisë të Tiranës mund të ishte lloji i punësimit që ofron ky qytet. Historikisht, qeveria e Shqipërisë ka investuar shumë në kryeqytet duke ndërtuar shumë ndërmarrje industriale në Tiranë dhe rreth saj. Nga fundi i viteve 80, Tirana u ofronte vende pune shumë personave në struktura qeveritare dhe ndërmarrje shtetërore. Reformat e ekonomisë së tregut dhe privatizimi në fillim të viteve 90 shkaktoi pushime në masë nga puna të punëtorëve të ndërmarrje të sapoprivatizuara por të falimentara dhe nga ana e tyre të ardhurat e ulura publike sollën një pakësim të madh të vendeve buxhetore të punës. Duke qënë se zinte një pjesë të mirë të vendeve të punës në industri dhe administratë publike, Tirana pësoi një ngritje të menjëhershme të papunësisë.


Një shpjegim tjetër për normat e larta të papunësisë në Tiranë ishte edhe migrimi i madh i brendshëm në Shqipëri. Vështirësitë ekonomike të fillimit të viteve 90 i shtrënguan shumë njerëz nga zonat e varfra fshatare të zhvendosen në Tiranë në kërkim të mundësive më të mira të punës. Edhe sikur vendet e punës në Tiranë të ishin të pakta, prapëseprapë prespektiva e hapjes së vendeve të punës në të ardhmen, zhvillimeve të sektorit privat dhe ndihma dhe investimet e huaja tërhoqën me mijëra vetë në kryeqytet. Edhe pse zyrtarisht numri i popullsisë në Tiranë është më pak se 500,000, periferia e qytetit strehon më shumë se 300,000 njerëz të tjerë.

Normat e larta të papunësisë në përgjithësi hasen më shumë në zonat qytetëse të Shqipërisë. Siç është përmendur edhe më përpara, ata që jetojnë në zonat fshatare kanë mundësi të punojnë token dhe pavarësisht sa e vogël mund të jetë ara në përdorim, ajo ofron një mundësi për të krijuar të ardhura. Të varfërit që jetojnë në zonat qytetëse, nga ana tjetër nuk e kanë një mundësi të tillë dhe duhet të korkojnë punë jashtë shtetësisë.

#### **4. Zhvillimet e pagave**

Inflacioni i lartë i zhduki fitimet që mund të vinin nga paga nominale në fillim të viteve 90 dhe e çoi pagën reale në zonën negative. Rënia më e madhe ka ndodhur në vitin 1992, kur paga reale u ul 25 përqind. Gjatë viteve 1994 dhe 1995, paga reale u rrit me normën 25 përqind në vit. Megjithatë, kriza e skemave piramidale dhe inflacioni i lartë i vitit 1997 i pakësoi shumicën e këtyre përfitimeve dhe paga reale ra në 17 përqind. Stabilizimi makroekonomik pas krizës dhe normat e ulëta të inflacionit (të përbëra vetëm nga një shifër) gjatë viteve të fundit i kanë dhënë mundësi pages reale të rritet përsëri dhe qysh prej vitit 1998 ka qënë në rritje prej më shumë se 10 përqind në vit.

<sup>40</sup> Punësimi korrent, ose afatshkurëtr, mbështetet tek gjëendja e tregut të punës brenda shtatë ditëve të fundit përpara vëzhgimit.



Midis vitit 1997 dhe 2000, transporti dhe telekomunikacionet kanë pasur rritjen më të madhe nominale të pages midis industrive. Gjatë vitit 2000, paga mesatare mujore në transport dhe

komunikacione ishte më e larta mes nga të gjitha industritë e tjera, të ndjekura nga pagat në sektorin e prodhimit dhe të shërbimeve. Edhe pse rritja e pages në sektorin e shërbimeve gjatë viteve 1997-2001 ishte e dyta për nga madhësia tek industritë, fitimet në këtë industri nuk kanë qënë të qëndrueshme.

**Tabela 4. 14: Paga mesatare sipas industrive, sektorit publik dhe sektorit privat**

Industria	1997 (Lek)	1997	1998	1999	2000	2000 (Lek)
Prodhimi	9,411	100	115	130	141	13,230
Ndërtimi	8,340	100	127	131	150	12,489
Transporti dhe telekomunikacionet	9,350	100	126	155	174	16,225
Tregëtia	8,819	100	109	124	123	10,889
Shërbimet	7,814	100	152	137	167	13,012
Mesatarja kombëtare	9,063	100	120	134	147	13,355

Burimi: INSTAT, Shqipëri

Analiza e të dhënave të LSMS 2002 tregon se gjatë vitit 2002, mesatarisht, OJQ dhe organizatat humanitare/donatore kanë paguar pagën më të lartë mujore ndërsa ndërmarrjet shtetërore kanë paguar pagën më të ulët mujore në Shqipëri. Punësimi në sektorin privat (ose në një shoqëri private ose tek një punëdhënës individ) siguronte një page mujore më të lartë se ajo e sektorit publik (os enë strukturat qeveritare ose në ndërmarrjet shtetërore). Në të gjithë sektorët, pagat në Tiranë ishin më të larta se në çdo rajon tjetër. Jashtë Tiranës, pagat në rajonin bregdetar ishin mesatarisht më të larta se në dy rajonet e tjera.

**Tabela 4. 15: Paga mesatare mujore sipas punëdhënësit sipa rajoneve (në lekë)**

Punëdhënësi	Bregdet	Qendror	Mal	Tirana	Total
OJQ ose organizatë humanitare	18,626	19,085	29,156	44,796	25,685
Shoqëri private	18,242	18,253	13,852	30,748	21,309
Qeveri	16,200	14,231	13,737	25,855	17,242
Punëdhënës individ	19,924	17,888	15,102	22,949	19,368
Programe të punëve publike <sup>41</sup>	-	-	-	17,773	17,773
Ndërmarrje shtetërore	13,938	12,964	14,458	14,459	13,903
Mesatarja kombëtare	17,526	16,163	14,416	25,935	18,680

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Sipas të dhënave të vëzhgimit, një individ me arsim të lartë fitonte 23,991 Lekë në muaj, çka ishte 37 përqind më shumë se fitimet mesatare të arsimit të mesëm dhe 44 përqind më shumë se paga mesatare me arsim më të ulët se të mesëm. Dallimi në paga ishte sidomos i lartë tek OJQ dhe shoqëritë private dhe ishte i ulët tek ndërmarrjet shtetërore.

<sup>41</sup> Nga tre pesona të përfshirë në vëzhgim, të cilët thane se ishin të përfshirë në programe të punëve publike në Tiranë, dy ishin profesionistë teknikë dhe një ishte në administratë.

**Tabela 4. 16: Paga mesatare mujore sipas sektorit dhe arsimit (Lek)**

Punëdhënësi	Më të ulët se të mesme	Të mesme	Më të lartë se të mesme	Total
Shoqëri private	17,709	20,548	37,852	21,309
OJQ ose organizatë humanitare	12,896	17,759	33,398	25,685
Punëdhënës individ	18,051	20,229	28,895	19,368
Programe të punëve publike	-	13,939	25,000	17,773
Qeveri	13,506	14,878	20,895	17,242
Ndërmarrje shtetërore	13,357	13,591	16,690	13,903
Mesatarja kombëtare	16,709	17,301	23,991	18,680

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Një analizë më e hollësishme e pagave mesatare mujore në industri të ndryshme tregon se vendet e punës në sektorin bankar, organizatat ndërkombëtare ose firmat e huaja, transporti detar dhe ajror dhe peshkim ofronin pagat më të larta në Shqipëri. Punësimi në tregjet financiare, firmat e informatikës dhe OJQ ofronin gjithashtu paga të larta. Krahasuar me mesataren kombëtare, pagat në industritë prodhuese, shërbime, punë shëndetësore dhe sociale dhe arsim ishin shumë të ulëta. Punësimi në ndërmarrjet familjare private ofronte pagën më të ulët në vend.


**Tabela 4. 17: Pagat mesatare mujore të raportuara sipas industrive, 2002**

Industria	Total (Lek)
Bankë	59,731
Organizata ndërkombëtare / firma të huaja	51,308
Transporti detar dhe bregdetar	50,000
Industria e peshkimit	40,000
Prodhimi i produkteve plastike	32,483
Tregjet financiare	30,000
Informatika / kompjutera	28,087
OJQ	26,672
Transporti ajror	26,278
Ndërtimi	21,860
Administrata publike	21,382
Serviset dhe shitjet e automjeteve	21,283
Bujqësia	19,179
Shitja me pakicë e ushqimeve	18,806
Transporti tokësor	18,697
Sektori i energjitikës	16,384
Prodhimi ushqimor	16,338
Arsimi	14,785
Prodhimi i lëkurëve	14,320
Hotele dhe restorante	14,184
Industria e letrës	13,000
Punët shëndetësore dhe sociale	12,759
Industria kimike	12,482
Industria e çelikut	12,000
Ndërmarrjet e furnizimit publik (ujë, energji, etj.)	11,305
Industria e duhanit	10,813

Shërbimet vetiake (lavanteri, sallone parukerie, etj.)	9,393
Industria e minierave	8,000
Industria tekstile	7,985
Ndërmarrjet familjare	6,670
Mesatarja kombëtare	18,680

Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

Mesatarisht, meshkujt fitonin paga më të larta se femrat në të gjithë sektorët, me përjashtim të OJQ-ve dhe organizatave humanitare ose donatore. Ky disavantazh i femrave është më i dukshëm në sektorin privat. Brenda sektorit publik, mesatarisht, edhe strukturat qeveritare ofronin page mesatare më të lartë për meshkujt se për femrat, ndërkohë që tek ndërmarrjet shtetërore patgat mesatare më së shumti të barabarta për meshkujt dhe femrat.



Burimi: LSMS e Shqipërisë, 2002

### Kthimi mbi arsim: përlllogaritjet OLS të funksionit të fitimeve nga puna

Përlllogaritjet OLS të funksionit të fitimeve nga puna na ndihmojnë të përcaktojmë se si faktorë të ndryshëm, të tillë si arsimi, gjinia, mosha, rajoni, sektori dhe industria e punësimit, ndikojnë tek pagat. Ndryshoret shpjeguese të përdorura për të shpjeguar dallimet midis pagave janë arsimi, gjinia, mosha, rajoni, sektori i punësimit, industria dhe qëndrimi në punë. Rezultatet e regresionit nuk tregojnë asnjë kthim në rritje mbi arsimin për ekonominë kombëtare. Vetëm në sektorin publik, ata që kishin arsim universitar fitonin më shumë, por nuk kishte asnjë kthim në rritje mbi arsimin në sektorin privat. Në dallim nga ekonomitë e përparuara të CEE, ku ndryshimet strukturore të viteve të tranzicionit kanë çuar në kthime në rritje mbi arsimin, ekonomia shqiptare vazhdon të mbështetet shumë tek krahu i punës me aftësi të pakta dhe nuk duket se e shpërblen arsimin.

Përsa i përket karakteristikave demografike, rezultatet e regresionit tregojnë se mosha nuk është një faktor i rëndësishëm përse i tkaon përcaktimit të pages. Femrat janë në disavantazh përse i përket fitimeve nga puna dhe po të çdo gjë tjetër të barabartë, një punonjëse femër fiton mesatarisht 20 përqind më pak se një punonjës mashkull. Dallimet rajonale janë të shënuara dhe vendet e punës në Tiranë ofrojnë paga më të larta se në çdo zone tjetër të vendit. Pavarësisht sektorit të punësimit, një punonjës në Tiranë fiton mesatarisht 20 përqind më shumë se një punonjës në zonën bregdetare, 30 përqind më shumë se një punonjës në zonën qendrore dhe gati 40 përqind më shumë se një punonjës në zonën malore.

**Tabela 4. 18: Diferenciali page private/publike sipas rezultateve arsimore**

Arsimi	Sektori i punësimit		Diferenciali i pagës (përqind)
	Publik (Lek)	Privat (Lek)	
Më i ulët se të mesme	13,455	17,890	-0.33
Të mesme	14,636	20,404	-0.39
Më i lartë se të mesme	20,661	35,302	-0.71
Total	16,685	20,380	-0.22

*Burimi: LSMS i Shqipërisë, 2002*

Punonjësit në sektorin privat paguhen gati 30 përqind më shumë se në sektorin shtetëror. Diferenciali i pages private-publike ndryshon sipas rezultateve arsimore dhe individët me arsim të lartë në sektorin privat kanë fitimin më të madh të pagës (71 përqind). Fitimet më të mëdha nga puna e bëjnë punësimin në sektorin privat edhe më tërheqës dhe i shtyn më shumë persona në këtë sektor. Përvoja afatgjatë në punë në sektorin publik nuk sjell ndonjë përfitim të dukshëm për fitimet nga puna. Megjithatë, vendet e punës në sektorin privat e shpërblejnë përvojën në punë – një punonjës i sektorit privat me tre ose më shumë vjet përvojë pune fiton mesatarisht 25 përqind më shumë se një i sapomarrë në punë.

## 5. Tregu i punës dhe varfëria

Punësimi është një nga determinantët kryesorë të varfërisë dhe në përgjithësi rritja e mundësive për punësim dhe krijimi i vendeve të reja të punës janë parë si mjete dhe rrugë për të luftuar varfërinë. Të dhënat e LSMS-së mbështesin këto lidhje midis tregut të punës dhe varfërisë në Shqipëri: niveli i varfërisë i lidhur me gjendjen e krahut të punës tregon se përqindja e varfërisë ka qenë më e lartë tek të papunët (33 përqind), ku një nga tre persona të papunë është i varfër. Përqindja e varfërisë midis të punësuarve dhe të papunëve ishte pothuajse e barabartë në masën afërsisht 22 përqind, gjë që sugjeron që pjesa e punësuar e popullsisë nuk është e garantuar nga varfëria. Nga ana tjetër, kjo situatë tregon se të papunët mbështeten tek të ardhurat jashtë tregut formal të punës, si p.sh të ardhura nga sektori informal dhe nga anëtarë të familjes në emigracion dhe mund të kenë strategji të tjera për t'i bërë ballë varfërisë.

Fakti nëse kryefamiljari është i punësuar ose jo është jetik për shmangien e varfërisë. Të dhënat e vrojtimit tregojnë se incidenca e varfërisë ishte shumë më e lartë në familjet ku kryefamiljari ishte i papunë. Mesatarisht niveli i varfërisë ishte pothuajse dy herë më i lartë për këto familje sesa për ato ku kryefamiljari ishte i punësuar.

Familjet shqiptare zakonisht kanë shumë anëtarë dhe shumica e tyre kanë më shumë se dy persona të punësuar. Incidenca e varfërisë midis familjeve me dy ose më shumë anëtarë të punësuar (24.5 përqind) është më e ulët sesa në familjet që kanë një anëtar të punësuar (27.2 përqind) ose asnjë anëtar të punësuar (28.2 përqind), por gjithësesi niveli i varfërisë është i lartë, që sugjeron se disa paga në një familje gjithësesi nuk përbëjnë garanci për të mos qenit i varfër.

***Tabela 4. 19: Niveli i varfërisë sipas numrit të pjesëtarëve të punësuar në një familje***

Përqindja e punësimit në familje <sup>42</sup>	Përqindja e personave <sup>43</sup>	Përqindja e varfërisë
Zero	7.0	28.2
Një e treta ose më pak	14.5	27.2
Më shumë se një e treta	78.5	24.5
Gjithsej	100.0	25.4

*Burimi: LSMS-ja për Shqiptarë*

### ***Karakteristikat e tregut të punës për të varfërit***

Shpesh të varfërit janë më pak të punësuar dhe shumë më shpesh të papunë sesa jo të varfërit. Të papunët përbëjnë 9 përqind të të varfërve dhe vetëm 5 përqind të jo të varfërve. Pak më shumë se 50 përqind e të varfërve dhe jo të varfërve ishin të punësuar, por kapaciteti i të ardhurave për të varfërit ishte shumë i dobët sepse shumica e tyre ishin të punësuar në industri me produktivitet të ulët ose me paga të ulta. Pothuajse dyfishi i të varfërve (34 përqind) në krahasim me jo të varfërit (18 përqind) merrnin paga të ulta dhe afërsisht pesë përqind e të varfërve merrnin paga të larta krahasuar me 16 përqind për jo të varfërit. Mbi shtatëdhjetë përqind e të varfërve punonin në bujqësi krahasuar me 50 përqind që është kjo shifër për jo të varfërit dhe përveç bujqësisë, sektor tjetër i punësimit të të varfërve është ndërtimi, ndërsa për jo-të varfërit kryesisht administrata publike dhe sektori social.

<sup>42</sup> Përqindja perkufizohet si numri i anetareve që punojnë pjesëtuar me numrin e pjesëtareve të familjes

<sup>43</sup> Përqindja e personave në familje me përqindje të caktuar punësimi



**Tabela 4. 20: Karakteristika të tregut të punës (përqindja e popullësisë në moshë pune 14+)**

	Jo- të varfërit	Të varfërit	Gjithsej
<b>Gjithsej</b>	100.0	100.0	100.0
<b>Gjendja e krahut të punës</b>			
Në punë	54.3	52.5	53.9
Të papunë	5.0	8.7	5.9
Jashtë krahut të punës	40.7	38.8	40.3
<b>Kategoritë e të ardhurave<sup>44</sup></b>			
Të ulta	18.1	33.5	20.2
Të mesme	65.7	61.9	65.2
Të larta	16.2	4.6	14.6
<b>Sektori i punësimit</b>			
Publik	20.8	8.7	18.2
Privat	79.2	91.3	81.8
<b>Industria e punësimit</b>			
Bujqësi	49.2	72.8	54.3
Ndërtim	6.5	8.3	6.9
Shitje me pakicë	8.5	4.9	7.7
Administrata publike	5.7	1.1	4.7
Shëndetësi dhe arsim	8.6	2.8	7.3
Transport	3.6	1.7	3.2
Industria minerare	2.1	0.7	1.8
Sektori energjetik	1.5	0.9	1.4
Prodhim tekstilësh	1.2	1.5	1.3
Industria ushqimore	1.4	0.3	1.2
Të tjera	11.8	4.9	10.3

*Burimi: LSMS-ja e vitit për Shqipërinë*

Të varfërit, në të gjithë sektorët, paguhen shumë më pak se jo-të varfërit, ku paga mujore mesatare e të varfërve është 46 përqind më pak se për jo-të varfërit. Sektori privat paguan paga më të larta sesa ai publik, por diferenciali i pagës midis të varfërve dhe jo-të varfërve është pothuajse njësoj i barabartë për të dy sektorët. Ndërmarrjet shtetërore paguajnë pagat më të ulta në të gjithë sektorët dhe në të njejtën kohë kanë edhe diferencialin më të ulët të pagës së varfërisë.

**Tabela 4. 21: Paga mesatare mujore sipas statusit të varfërisë**

Punëdhënësi	Jo- të varfërit	Të varfërit	gjithsej	Përqind Difer.
Strukturat qeveritare	17,700	12,197	17,242	-55.0
Kompani private	22,158	16,845	21,309	-53.1
Ndërmarrje shtetërore	14,215	12,828	13,903	-13.9
Punëdhënësi individual	20,389	15,422	19,368	-49.7
Gjithsej	19,333	14,745	18,680	-45.9

*Burimi: LSMS-ja e vitit 2002 për Shqipërinë*

<sup>44</sup> Kategoritë që marin fitime përmes punës janë përlllogaritur vetëm për të punësuarit me pagë.

### ***Punësimi si një nga determinantët kryesorë të varfërisë***

Rezultatet e një analize që marrin parasysh disa faktorë gjithashtu konfirmojnë se bashkë me numrin e pjesëtarëve të një familjeje, arsimimin, gjininë dhe vendndodhjen, statusi i punësimit të pjesëtarit të familjes është edhe ai një determinant kryesor i varfërisë. Këto rezultate tregojnë se kur një pjesë më e madhe e anëtarëve të familjes është e papunë, ajo familje ka shumë më shumë gjasa të jetë e varfër. Nga ana tjetër, në zonat fshatare qënia e një anëtari të familjes i punësuar ose i vetëpunësuar në një biznes jobujqësor ul probabilitetin e të qenit i varfër.

### ***Varfëria dhe sektori informal***

Në vitin 2002, në të gjithë sektorët e punësimit në Shqipëri, punëtorët e sektorit informal kishin nivelin më të ulët të varfërisë, prej 11 përqind. Incidenca e varfërisë midis punëtorëve të sektorit informal ishte dy herë më e ulët sesa përqindja mesatare kombëtare për të punësuarit (22 përqind) dhe pothuajse tre herë më e ulët sesa përqindja e nivelit të varfërisë për të punësuarit në bujqësi (29 përqind).

## **6. Komente përmbyllëse dhe pasojat për politikat**

Shqipëria ka një përqindje të lartë të pjesëmarrjes së krahut të punës (66 përqind), por niveli i aftësive profesionale është i ulët dhe pothuajse dy të tretat e krahut të punës kanë mbaruar vetëm arsimin tetëvjeçar dhe nganjëherë edhe atë nuk e kanë përfunduar. Pothuajse dy të tretat e popullësisë në moshë pune ose janë të vetëpunësuar, ose punojnë pa pagë në fermën e familjes apo në një ndërmarrje jofermere. Fenomeni i vetëpunësimit haset kryesisht në bujqësi dhe vetëm një e treta e të punësuarve paguhen me rrogë. Afërsisht 10 përqind e të punësuarëve në Shqipëri punojnë në sektorin informal dhe kjo përqindje në zonat qytetëse arrin në 24 përqind. Të punësuarit në sektorin informal janë më shumë meshkuj sesa femra. Në sektorin informal ka evidenca punësimi afatgjatë dhe pothuajse 75 përqind e individëve janë të përfshirë në aktivitete informale për më shumë se tre vjet dhe afërsisht 10 përqind e tyre kanë qenë të punësuar në sektorin informal për më shumë se 10 vjet.

Afërsisht 15 përqind e familjeve shqiptare kanë një ndërmarrje jofermere në pronësi të familjes (94 përqind) ose në pronësi të përbashkët me dy ose më shumë familje të tjera (6 përqind). Më pak se gjysma e të gjitha subjekteve është e rregjistruar në zyrën lokale të tatim-taksave, afërsisht 55 përqind e tyre mbajnë një lloj kontabiliteti dhe shumica e tyre kanë të punësuar vetëm nga një ose dy persona. Ndër aktivitetet të hasura më rëndom në sektorin informal në Shqipëri përfshihen: shitja e mallrave, ofrimi i shërbimeve të transportit, prodhimi, ndërtimi, përpunimi ushqimor dhe restorantet.

Papunësia mbetet ende një fenomen i përhapur dhe përqindja e papunësisë është e lartë në veçanti në zonat qytetëse. Mbizotëron kryesisht papunësia afatgjatë - mesatarisht duhet mbi një vit për të gjetur një punë. Në krahasim me zonat e tjera gjeografike të vendit, në Tiranë shënohen nivelet më të ulta të pjesëmarrjes në krahun e punës dhe niveli më i lartë i papunësisë.

Pas një rënie të ndjeshme nga fillimi dhe fundi i viteve 90-të, pagat reale në Shqipëri po shënojnë përsëri rritje. Gjatë viteve 1999-2001, pagat reale u rritën measatarisht me 10 përqind në vit. Megjithatë, pagat në Shqipëri mbeten shumë të ulta – në vitin 2002, paga mesatare mujore ishte 18,680 Lek (afërsisht 133 dollarë) dhe për pothuaj 50 përqind të personave të punësuar me pagë/rrogë të ardhurat e tyre ishin më pak se 100 dollarë në muaj. Pagat e ulta lidhen kryesisht me arsimimin e ulët, si edhe me faktin që punohet në industri që paguajnë pak dhe ku puna nuk është e sigurtë, si p.sh në shërbime, bujqësi dhe në sektorin social. Për të njejtat kualifikime, gratë fitojnë shumë më pak sesa burrat. Fitimi në sektorin privat është më i lartë sesa në sektorin publik dhe diferenca në paga rritet sipas arsimit.

Punësimi është një nga determinantët kryesorë të varfërisë – probabiliteti i të qenit i varfër është shumë më i madh kur një pjesëtar i familjes është i papunë. Nga ana tjetër, në familjet fshatare fakti që një nga pjesëtarët e familjes është i punësuar me rrogë ose është i vetëpunësuar në një biznes jobujqësor ul probabilitetin e të qenit i varfër. Të varfërit gjenden më shpesh pa punë sesa jo të varfërit dhe niveli i varfërisë midis të papunëve është shumë më i lartë tek të papunët sesa tek ata që janë të punësuar. Incidenca e varfërisë midis personave jashtë krahut të punës është e barabartë me incidencën e varfërisë midis të punësuarëve. Megjithatë, fakti që dikush është i punësuar nuk e pengon varfërinë – shumë të varfër janë të punësuar, por kapaciteti i të ardhurave të tyre është më i ulët sesa i jo të varfërve sepse të varfërit gjejnë punë në industri me produktivitet të ulët si p.sh në bujqësi dhe ndërtim dhe në të gjithë sektorët të varfërit, measatarisht fitojnë 46 përqind më pak se jo të varfërit. Fakti që përqindja e varfërisë është 11 përqind nuk e imunizon sektorin informal nga varfëria. Megjithatë, përqindja e varfërisë në sektorin informal është më e ulët sesa për të punësuarit me rrogë (14 përqind) dhe pothuaj tre herë më e ulët sesa përqindja e varfërisë midis të vetëpunësuarëve në bujqësi (29 përqind).

Problemi mbizotërues me tregun e punës dhe varfërinë në Shqipëri ka të bëjë me mënyrën sesi duhet zgjidhur oferta e tepërt e krahut të punës dhe mekanizmat e kufizuar të tregut për të siguruar rregullimin. Oferta e tepërt e krahut të punës është rezultat i përqindjeve të larta të lindjeve dhe mungesës së kërkesës për krah pune për ta thithur ofertën. Shteti nuk është më në gjendje të mbajë nivele të larta të kërkesës për krah pune dhe mekanizmat e rinj të tregut janë tepër të dobët për kompensuar humbjet e punësimit. Gjithashtu, pagat janë të ulta dhe nuk ka shumë vend për axhustime çmimesh. Oferta e tepërt e krahut të punës ka sjellë nivele të larta papunësie, punësim të fshehur dhe një sektor informal kryesisht të mbështetur në aktivitete minimal sa për të mbajtur frymën gjallë. Rrjedhimisht, segmente të mëdha të krahut të punës, si p.sh rinia, të sapo diplomuarit, gratë dhe individët e moshës së para-pensionit nuk marrin pjesë në tregun e punës.

## KREU V: SHENDETESIA

### 1. Përmbledhje

Sektori i shëndetësisë në Shqipëri është kryesisht publik dhe Ministria e Shëndetësisë është ofruesi kryesor i shërbimeve. Sektori privat është i kufizuar kryesisht në shpërndarjen dhe tregtimin e shërbimeve farmaceutike dhe stomatologjike, megjithëse dekadën e fundit ka patur një rritje të qendrave private të shërbimeve ambulatorë dhe të qendrave të diagnostifikimit në zonat qytetëse, në veçanti në Tiranë. Ministria e Shëndetësisë është pronare dhe ka nën administrimin e saj të gjitha shërbimet shëndetësore përmes drejtorive të rretheve, me përjashtim të qarkut të Tiranës ku tashtë funksionon një program pilot që i jep të gjitha përgjegjësitë e administrimit për ofrimin e kujdesit për shëndetin parësor dhe shëndetin publik Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës (ASHR) të ngritur rishtazi. Sistemi shëndetësor financohet kryesisht nga buxheti, megjithëse në vitin 1995 u themelua Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) me qëllim sigurimin e burimeve shtesë për financimin e sistemit. ISKSH-ja financohet nga tatimet që mbahen në pagë dhe transfertat buxhetore për grupet vulnerabël të popullësisë, por duke qenë së një përqindje e madhe e popullësisë shqiptare është e përfshirë në aktivitete informale, kjo skemë nuk përfaqëson burime të qenësishme financimi.

Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet nga qendrat shëndetësore dhe ambulancat në zonat fshatare; përveç qendrave shëndetësore, kujdesi parësor shëndetësor në zonat qytetëse sigurohet gjithashtu edhe nga poliklinikat e mëdha që ofrojnë shërbime të specializuara ambulatorë. Në vitin 1997, qeveria hartoi një politikë për kujdesin parësor shëndetësor që ka si synim ngritjen e një ambulance në çdo fshat dhe një qendër shëndetësore për çdo komunë, dhe të krijojë ekipe të kujdesit shëndetësor parësor të drejtuar nga mjekët e familjes. Qendrat shëndetësore zakonisht kanë nga tre mjekë të shëndetit parësor dhe infermiere. Gjatë viteve të fundit janë shtuar përpjekjet për rinovimin dhe rifreskimin e shumë objekteve të kujdesit shëndetësor parësor, të cilat ishin të pa mirëmbajtura dhe ishin dëmtuar shumë gjatë ngjareve të vitit 1991 dhe 1997.

*Tabela 5. 1: Shërbime shëndetësore*

	1990	1999
<b>Shërbim ambulator</b>		
<b>Numri i objekteve</b>	3302	2242
– Qendra shëndetësore	1046	567
– Ambulanca	2196	1624
– Poliklinika	60	51
<b>Kujdesi spitalor</b>		
Numri i spitaleve	160	51
– nga të cilat janë fshatare	86	0
Numri i spitaleve për 100,000 banorë	4.87	1.50
Numri i shtretërve në spitale	13228	10207
Numri i shtretërve në spitale për 100,000 banorë	402.6	302.5

*Burimi: INSTAT 2002*

Kujdesi dytësor dhe tretësor shëndetësor ofrohet nga spitalet dhe klinikat publike. Gjatë dekadës së fundit, në vend ka patur një rënie të ndjeshme të numrit të spitaleve dhe shtretërve në spitale. Megjithëse shumë nga institucionet që u mbyllën kishin mungesa të ndjeshme përsa i përket aparaturave dhe infrastrukturës së nevojshme shëndetësore, mbyllja e tyre pati një ndikim negativ në aksesin ndaj këtyre shërbimeve. Shqipëria ka numrin më të ulët të shtretërve spitalorë për numër banorësh në të gjithë Evropën, ndërsa numri i shtretërve për 100,000 banorë është sa gjysma e mesatares për vendet e BE-së dhe më pak se gjysma e mesatares për vendet e CEE-së.

## 2. Situata shëndetësore e popullsisë

Pavarësisht nga niveli i ulët i të ardhurave për frymë dhe shërbimet e kufizuara shëndetësore, jetëgjatësia në Shqipëri është 72 vjeç për burrat dhe 78 për gratë, duke qenë kështu një nga më të lartat në rajon dhe më e lartë se mesatarja e vendeve të CEE-së dhe të gjithë Evropës. Ekspertët mendojnë se pas këtyre treguesve pozitivë qëndrojnë dieta dhe mënyra e jetesës.<sup>45</sup> Megjithatë, ka dallime të mëdha rajonale për sa i përket jetëgjatësisë. Zonat në rajonet e varfra Veriore kanë një jetëgjatësi shumë më të ulët në lindje. Ndryshe nga shifrat e jetëgjatësisë, vdekshmëria foshnjore dhe amtare në Shqipëri – 28 nga 1000 lindje të gjalla dhe 26 nga 100,000 lindje të gjalla përkatësisht – janë nga më të lartat në rajon. Vdekshmëria foshnjore mendohet të jetë e lartë në veçanti në zonat fshatare, ku jeton edhe shumica e të varfërve.

**Tabela 5. 2: Jetëgjatësia në lindje**

	Gjithsej		Meshkuj		Femra	
	1990	2000	1990	2000	1990	2000
Shqipëria	72.6	74.9	69.6	72.0	75.9	78.0
Bullgaria	71.5	71.7	68.3	68.5	74.9	75.1
Kroacia	72.6	73.0	68.7	69.1	76.4	76.7
Hungaria	69.4	71.5	65.2	67.2	73.9	75.8
Rumania	69.8	71.3	66.6	67.8	73.1	74.8
Sllovenia*	74.1	75.8	70.0	71.8	78.0	79.5
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë		73.4		71.2		75.7
Turqia*	66.2	69.5	63.9	67.0	68.5	72.1
Republika Federale E Jugosllavisë		72.6		70.3		75.1
EVROPA	73.1	73.6	69.0	69.6	77.0	77.8
Mesataraja për BE*	76.5	78.3	73.1	75.1	79.8	81.4
Mesatarja për vendet e CEE	71.0	73.1	67.1	69.3	75.0	76.9

*Burimi: OBSH/Europe Health For All (HFA)*

*\*: Të dhënat i korespondojnë viteve 1990 dhe 1999.*

Aktualisht përqindja e vdekshmërisë në Shqipëri (5 për 1,000 banorë sipas Obzervatorit Evropian për vitin 2003) është shumë e ngjashme me atë të vitit 1990, por ka patur ndryshime thelbësore në shkaqet e vdekjeve qysh nga ajo kohë. Sëmundjet e qarkullimit të gjakut ende mbeten nga shkaqet kryesore të vdekjeve në Shqipëri, ndërsa sëmundjet infektive, të sistemit të frymëmarrjes dhe tretjes kanë rënë për sa i përket rëndësisë si shkaqe të vdekjeve, ndërsa vdekjet si pasojë e plagosjeve dhe neoplazmës/tumorit janë rritur ndjeshëm.

<sup>45</sup> Po të krahasojmë treguesit e mënyrës së jetesës në Shqipëri me ato të mesatares së vendeve të BE duke përdorur të dhënat e HFA, del se megjithëse përqindja e duhanxhijnjve të përditshëm në Shqipëri e kalon mesataren e CEE, kondumi I alkolit për frymë është ndër më të ulët në Evropë dhe sasi a e frutave dhe perimeve për person është ndër më të lartët.

**Tabela 5. 3: Shkaqet e vdekshmërisë sipas grupeve të sëmundjeve (për 100,000 banorë)**

Sëmundja	1990	1999
Sëmundje infektive & parazitike	10.80	2.22
Neoplazma	66.70	75.50
Endokrinale, metabolike, të ushqimit	5.30	3.82
Sëmundje të gjakut	3.00	1.10
Çrregullime mendore	0.00	1.87
Sëmundje të sistemit nervor dhe të organeve të shqisave	14.90	8.80
Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut	204.00	204.69
Sëmundje të sistemit të frymëmarrjes	94.30	31.30
Sëmundje të sistemit të tretjes	17.10	10.05
Sëmundje të sistemit gjenital dhe urinar	10.60	7.41
Komplikacione shtatëzanie	0.90	0.06
Sëmundje të lëkurës	0.40	0.12
Sëmundje të sistemit të kockave/muskujve	0.00	0.71
Keqformime kongenitale	4.10	3.05
Sëmundje të caktuara të fëmijërisë së hershme	9.20	8.00
Simptoma, senilitetit dhe kushtet e papërkufizuara mire	89.30	43.43
Dëmtime të jashtme & helmime	21.70	51.40
Gjithsej	<b>552.30</b>	<b>453.53</b>

Burimi: INSTAT 2002(shifrat për 100,000 banorë)

### **Gjendja shëndetësore e popullësisë sipas vetë-raportimeve**

LSMS-ja e vitit 2002 siguroi informacion mbi sëmundshmërinë. Ky informacion përmbledhet në Tabelën 5.4<sup>46</sup> Afërsisht 16% e shqiptarëve deklarojnë se kanë patur një gjëndje kronike, ndërsa ndër ata që raportojnë sëmundje kronike shumica janë mbi 50 vjeç (shih Shtojcën në lidhje me sëmundshmërinë e vetë-raportuar të rregulluar me treguesin e moshës). Kjo matje e parë e sëmundshmërisë së vetë-raportuar ndryshon gjithashtu sipas gjinisë dhe rajonit të banimit. Numri i grave që deklarojnë një gjëndje kronike është më i madh sesa i burrave dhe po kështu personat që banojnë jashtë Tiranës ka më shumë gjasa të deklarojnë se vuajnë nga sëmundje kronike. Shumica e gjendjeve kronike të raportuara kishte të bënte kryesisht me sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut (afërsisht 40% e personave), sëmundje të kockave (40%), sëmundje të sistemit nervor (10%) dhe atij të frymëmarrjes (9%).

<sup>46</sup> Matjet e sëmundshmërisë të vetë raportuar duhen marrë me rezrvë, meqenëse mund të korrelojnë pozitivisht me të ardhurat dhe nivelin arsimor të individëve. Për shëmbull, njerëzit me nivele më të larta arsimit janë më të predispozuar t'i drejtohen shërbimeve të kujdesit shëndetësor ku mund të diagnostikohet një sëmundje kronike dhe janë më të predispozuar ta njohin një simptomë të një sëmundjeje e cila do t'i shtyjë të shkojnë për një vizitë tek mjeku. Po kështu, më të shkolluarit janë më të predispozuar të kuptojnë nëse kanë një gjëndje kronike ose jo. Është pikërisht për këtë arsye që më shumë jo të varfër dhe më shumë të arsimuar thonë se kanë një problem kronik shëndetësor, krahasuar me numrin e personave më pak të shkolluar.

**Tabela 5. 4: Sëmundshmëria e vetë-raportuar sipas gjinisë, rajoneve dhe nivelit të varfërisë**

	Meshkuj	Femra	Tiranë	Qytete të tjera	Fshat	Jo të varfër	Të varfër	Ekst. Të varfër	Total
Kronike	0.140	0.183	0.135	0.173	0.162	0.172	0.133	0.111	0.162
	(0.005)	(0.006)	(0.009)	(0.009)	(0.007)	(0.006)	(0.009)	(0.016)	(0.005)
Sëmundje	0.127	0.147	0.039	0.124	0.164	0.130	0.158	0.188	0.137
	(0.007)	(0.008)	(0.007)	(0.010)	(0.010)	(0.006)	(0.013)	(0.031)	(0.007)

*Burimi: LSMS e vitit 2002 për Shqipërinë;*

*Shënim: Në kllapa gjenden gabimet standarde.*

Të dhëna nga LSMS-ja tregojnë se afërsisht 14% e totalit të popullësisë deklaroi të ketë qenë sëmurë apo të ketë pësuar një dëmtim gjatë katër javëve përpara intervistës. Ashtu si në rastin e gjendjeve kronike, ka ndryshime të mëdha në sëmundshmërinë e vetë-raportuar sipas gjinisë, moshës, vendbanimit dhe shkallës të varfërisë. Për të gjithë grupin e zgjedhjes, diferenca midis gjinive nuk është shumë e madhe, por gratë në moshë për të lindur dhe lart ka më shumë gjasa të deklarojnë se kanë qenë të sëmura sesa burrat. Në rastin e grave në moshë për të lindur, ky rezultat mund të sjellë probleme gjatë shtatëzansit. Gjithashtu vihen re ndryshime të mëdha sipas rajoneve të banimit. Pjesa e popullësisë që banon në Tiranë dhe që deklaroi se ka kaluar sëmundje është shumë më e ulët sesa pjesa tjetër e popullësisë. Në dallim nga rasti i sëmundjeve kronike nuk ka asnjë korelacion midis deklaramit se personi ka vuajtur nga një sëmundje gjatë katër javëve të fundit dhe nivelit të arsimit të personit. Ky fakt nuk është i habitshëm duke qenë se ka shumë fakte që tregojnë se individët me nivel më të lartë arsimit në përgjithësi kanë rezultate më të mira shëndetësore. Së fundi, përqindja e të varfërve që deklaroi se kanë kaluar një sëmundje është shumë më e lartë sesa përqindja e jo të varfërve që deklaroi të njëjtin fakt. Shumica e personave që deklaroi se kanë kaluar një sëmundje (afërsisht 80%) shprehën se ajo ka qenë i ftohtë ose se kishin qenë me grip gjatë katër javëve të fundit. Midis të varfërve kjo përqindje ishte e barabartë me 84%, ndërsa tek jo të varfërit ishte 76%. Po kështu, 86% e personave që jetonin në zonat malore të vendit deklaruan se kishin qenë me të ftohtë ose me grip krahasuar me 72% që ishte kjo shifër për Tiranën apo për zonën bregdetare.

### **3. Sigurimet shëndetësore**

Skema e sigurimeve shëndetësore që ofrohet nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) ende mbetet një skemë shumë e kufizuar, jo vetëm për sa i përket numrit të popullsisë që mbulon, por gjithashtu edhe për sa i takon numrit të shërbimeve që mbulon. Skema e prezantuar për herë të parë në vitin 1995 u zbatua me faza. Gjatë fazës së parë, fondet e mbledhura nga Instituti u përdorën për të paguar pagat e mjekëve të kujdesit parësor dhe për të mbuluar barnat kryesore. Në fazën e dytë, që nisi në vitin 1997, skema mbulonte shërbimet e mjekut të familjes dhe mjekut të përgjithshëm, që u ofroheshin falas individëve të mbuluar nga skema dhe një subvencion për pothuajse 300 barna. Në fillim të vitit 2001, listës së medikamenteve të subvencionuara iu shtuan edhe 30 produkte; ndërsa në rajonin e Tiranës Fondi i Sigurimeve Shëndetësore e shtriu mbulesën e vet për të përfshirë të gjitha shërbimet ambulatorë. Në rajonin e Tiranës,




sigurimet shëndetësore tashmë mbulojnë edhe shërbimet e specializuara ambulatorie së bashku me shërbimet e mjekut të përgjithshëm dhe mjekut të familjes.<sup>47</sup>

Në dallim nga pjesa tjetër e vendit, fondi i ISKSH-së paguan nëpunësit e poliklinikave dhe qendrave shëndetësore në qarkun e Tiranës. ISKSH-ja financohet gjithashtu edhe shpenzimet për shërbimet e kujdesit parësor sipas një marrëveshjeje midis ASHR-së të Tiranës dhe ISKSH-së. Kjo marrëveshje përcakton paketën e shërbimeve shëndetësore që ISKSH-ja do të blerë për çdo poliklinikë apo qendër shëndetësore. Paketa e shërbimeve shëndetësore përfshin shpenzimet për pagesën e mjekut të përgjithshëm, mjekut të specialitetit, infermiereve dhe pjesës tjetër të personelit të punësuar në poliklinika dhe në qendrat shëndetësore, së bashku me shpenzimet korrente.

Sipas ligjit për sigurimet shëndetësore (Ligji nr. 7870 i vitit 1994), të gjithë individët ekonomikisht aktivë në Shqipëri, qofshin të punësuar, punëdhënës, të vetë-punësuar ose punëtorë shtëpiakë të papaguar duhet të kontribuojnë në skemë dhe të marrin një “librezë shëndetësore”. Shteti është përgjegjës për kontributet e sigurimeve për individët që nuk janë ekonomikisht aktivë. Shteti paguan kontributet e sigurimeve për fëmijët, studentët pa shkëputje nga puna, pensionistët, të paaftët, të papunët, gratë shtatëzëna dhe për ushtarët që kryejnë shërbimin ushtarak të detyruar.

Megjithatë, të dhënat nga LSMS-ja e vitit 2002 tregojnë se vetëm afërsisht 39% e gjithë numrit të popullësisë deklaroi se kanë një librezë të sigurimeve shëndetësore. Siç mund të shihet edhe nga Figura 4.1, përqindja e individëve me librezë shëndetësore rritet në përputhje me të ardhurat dhe ndryshon ndjeshëm midis zonave fshatare dhe qytetëse. Personat që jetojnë në zonat qytetëse, sidomos në Tiranë kanë më shumë gjasa të kenë librezë shëndetësore sesa personat që jetojnë në zonat fshatare. Diferencat janë gjithashtu të mëdha edhe sipas rajoneve dhe ndërsa 63% e personave që jetojnë Tiranë raportojnë se janë të siguruar nga sigurimet shëndetësore, kjo shifër është vetëm 17% për individët që jetojnë në zonat malore. Së fundi, fëmijët dhe individët mbi 50 vjeç gjithashtu kanë më shumë gjasa të kenë librezë shëndetësore sesa të tjerët. Afërsisht 40% e fëmijëve nga mosha 0-14 vjeç dhe mbi 50% e personave mbi 50 vjeç (60% për personat mbi 70 vjeç) kanë librezë shëndetësore.



<sup>47</sup> Obzervatori Evropian, 2003.

Nëngrupet e popullatës sigurimet e të cilave paguhen nga shteti ka më shumë gjasa të kenë librezë shëndetësore sesa të mos kenë. Kështu, p.sh fëmijët dhe të moshuarit janë ata që kanë më shumë gjasa të kenë librezë shëndetësore duke qenë se shteti paguan për kontributin e tyre. Megjithatë, ka rëndësi të theksohet se megjithëse këto grupe janë ata që kanë më shumë gjasa të kenë librezë shëndetësore, në fakt jo të gjithë e kanë. Mbi 80% e fëmijëve janë studentë pa shkëputje nga puna e megjithatë më pak se 40% prej tyre deklarojnë se kanë librezë shëndetësore. Kjo tregon se ose jo të gjithë ata që I mbushin kushtet për t'u pajisur me të janë të informuar në lidhje me këtë gjë, ose që vetëm ata që kanë një shtysë të forte për ta marrë (si psh personat me sëmundje që përfitojnë zbritje nga shumica e barnave) kanë librezë shëndetësore nga sigurimet shëndetësore.

Për më tepër, struktura e punësimit e bën shumë të vështirë për shtetin të detyrojë pagesën e kontributeve për sigurime shëndetësore për individët që punojnë në bujqësi ose që janë të angazhuar në aktivitete informale. Afërsisht 55% e të punësuarëve punojnë në fermën e familjes, 10% në një ndërmarrje jofermere dhe afërsisht 35% kanë një punë me pagë. Në fakt nuk të habit fakti që individët ekonomikisht aktivë janë pikërisht personat që kanë më pak gjasa të kenë librezë shëndetësore. Midis popullësisë aktive, të papunët (i vetmi grup për të cilin shteti paguan sigurimet) janë ata që kanë më shumë gjasa të kenë librezë shëndetësore, ndërkohë që punonjësit e pushura nga puna dhe punonjësit e bujqësisë për më pak se 15 orë në javë janë edhe personat që kanë më pak gjasa të kenë librezë shëndetësore.

#### **4. Shfrytëzimi i kujdesit shëndetësor**

##### **Shërbim ambulator**

Afërsisht 17% e shqiptarëve deklarojnë se kanë shkuar për një vizitë në një ofrues të kujdesit shëndetësor parësor gjatë katër javëve përpara sondazhit. Midis atyre që deklaruan se vuanin nga një sëmundje kronike, 57% i drejtohen shërbimit ambulator (ambulancë publike, mjek privat, infermiere, mami ose ndihmësmjek dhe vizita tek mjeku “popullor”), ndërsa personat e kategorisë që deklarojnë një sëmundje apo dëmtim, 58% i drejtohen shërbimit ambulator. Mesatarisht ekzistojnë dallime të mëdha përsa i takon shfrytëzimit të shërbimit ambulator sipas grupeve të popullësisë. Dallimet përsa i përket shfrytëzimit të kujdesit shëndetësor janë të mëdha midis personave që jetojnë në zonat fshatare me ata që jetojnë në zonat qytetëse, diferenca të cilat vazhdojnë të ndjehen edhe kur merren parasysh dallimet midis moshave. Kështu p.sh, ndërsa në Tiranë tre në katër persona kur sëmuren i drejtohen shërbimit ambulator, në zonat fshatare vetëm një nga dy persona i drejtohen këtij shërbimi. Afërsisht, jo të varfërit ka më shumë gjasa të drejtohen tek mjeku për shërbim shëndetësor kur sëmuren (61.6%) në krahasim me të varfërit (48.8%). Gjithashtu, dhe siç pritet, individët me librezë shëndetësore ka më shumë gjasa t'i drejtohen një ofrues të shërbimit ambulator kur janë të sëmurë sesa personat që nuk kanë librezë shëndetësore. Siç është përmendur edhe më lart, të paturit e një librezë shëndetësore ul çmimin e medikamenteve me recetë dhe eliminon pagesat për shërbimet e mjekut të përgjithshëm dhe mjekut të familjes. Ekzistojnë prova që tregojnë

se duke patur parasysh cilësinë e ulët të këtyre shërbimeve shumica e individëve që shkojnë për një vizitë tek ofruesit publik të shërbimeve shëndetsore parësore, shkojnë më shumë për të marrë një recetë për barna. Në këto rrethana, individët të cilëve nuk ua mban xhepi të paguajnë çmimin e plotë të barnave që jepen me recetë mund të mos nxiten të drejtohen në shërbimet shëndetsore.

**Tabela 5. 5: Shfrytëzimi i shërbimit ambulator (përqindja e të sëmurëve)**

	Meshkuj	Femra	Tiranë	Qytet	Fshat	Jo të varfër	Të varfër	Pa librezë shëndetësore	Librez
<b>I sëmurë gjatë katër javëve</b>									
Sherbim ambulator	50.0	52.1	68.6	56.0	48.4	54.9	42.2	45.2	61.4
Mjek privat	5.2	5.1	12.8	7.7	3.8	6.4	1.9	4.3	6.5
Infermiere/ndihmësmjek	12.2	13.4	1.0	10.0	14.5	13.1	12.3	13.4	11.9
Mjek popullor	0.2	1.0	0.0	0.0	1.0	0.6	0.7	0.8	0.4
Kërkojnë mjekim	56.8	58.8	74.4	63.0	55.1	61.6	48.8	52.4	67.2
<b>Gjithsej</b>									
Shërbim ambulator	12.7	16.0	10.7	15.4	14.6	15.3	11.6	11.2	19.4
Mjek privat	1.4	1.9	1.0	2.4	1.4	1.8	1.1	1.2	2.4
Infermier/ndihmësmjek	2.6	3.5	0.5	2.4	3.9	3.1	3.1	3.2	2.9
Mjek popullor	0.2	0.4	0.0	0.2	0.4	0.3	0.3	0.4	0.2
Kërkojnë mjekim	14.7	18.6	11.6	17.7	17.2	17.6	14.1	13.5	21.8

*Burimi: LSMS-ja e vitit 2002.*

*Meqënëse shumë persona kanë shkuar në më shumë se një orfues të shërbimit, shumatorja vertikale shton më shumë se përqindja e njerëzve që kërkojnë kujdes.*

Ambulancat publike janë edhe vendi që presin shumicën e individëve që kërkojnë shërbim ambulator. Të dhënat e LSMS-së tregojnë se 85% e individëve që janë vizituar tek një ofrues i kujdesit shëndetësor parësor u janë drejtuar ambulancave publike (72% only visited an ambulatory). Tabela 5.5 tregon mënyrën sesi varion përqindja e individëve që shkojnë të vizitohen në një shërbim ambulatory kur janë të sëmurë sipas vendbanimit, nivelit të varfërisë dhe faktit nëse ka apo jo librezë shëndetësore. Personat që banojnë në Tiranë dhe në zona të tjera qytetëse ka më shumë gjasa të shkojnë një ambulancë për kujdes shëndetësor sesa personat që banojnë në zonat fshatare. Ky fakt nuk të habit pasi në shumë zona fshatare kujdesi parësor shëndetësor ofrohet nga ambulancat që kanë vetëm nga një infermiere apo mami. Po kështu, individët me librezë shëndetësore ka më shumë gjasa të shkojnë në një ambulancë publike sesa ata persona që nuk kanë librezë shëndetësore. Megjithëse mjekët mund të mos u kërkojnë pagesë pacientëve që nuk kanë librezë shëndetsore, vetëm mjekët mund të lëshojnë receta për barnat dhe librezat shëndetsore u jep të drejtë pacientëve përjashtim ose zbritje në çmimin e medikamenteve që mbulojnë nga sigurimet shëndetësore. Duke qenë se sigurimet shëndetësore në të gjithë vendin mbulojnë vetëm shërbimet e mjekëve të përgjithshëm dhe medikamentet për të cilat ata lëshojnë recetë, dallimi në përqindjen e shfrytëzimit midis personave që kanë librezë shëndetësore dhe atyre që nuk kanë ka rëndësi vetëm për ata që shkojnë në një ambulancë publike, jo për personat që shkojnë tek mjeku apo infermierja që punojnë privat.

Pjesëmarrja e sektorit privat në ofrimin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri është shumë e kufizuar dhe është pothuajse e gjitha e përqëndruar në ofrimin e shërbimeve stomatologjike dhe farmaceutike.<sup>48</sup> Megjithatë, gjatë vitit të fundit ka patur një rritje të numrit të qendrave private të diagnostifikimit dhe të qendrave të specializuara ambulatorë që gjenden kryesisht në zonat qytetëse. Nuk të habit fakti që përqindja e individëve që shkojnë tek mjekët privatë kur janë të sëmurë është vetëm afërsisht 5%. Shumica e personave që përdorin këto shërbime jetojnë në zonat qytetëse dhe kryesisht në qarkun e Tiranës ku përqindja e individëve që shkojnë tek mjekët privatë është pothuajse dy herë më e madhe se përqindja në zonat e tjera qytetëse dhe tre herë më e lartë sesa në zonat fshatare. Duke qenë se këto shërbime janë mesatarisht më të shtrenjta sesa ato që afrohen nga shërbimi publik, të varfërit mesatarisht kanë tri herë më pak gjasa të shkojnë për kontroll mjeksor tek një mjek privat sesa jo të varfërit.

Një në tetë shqiptarë kur kanë nevojë për kujdes shëndetësor shkojnë tek infermierja, ndihmësmjeku, ose mamia. Shumica e personave që përdorin këto shërbime jetojnë ose në zonat fshatare ose në zonat qytetëse jashtë Tiranës. Po kështu, banorët e Shqipërisë qendrore ka më shumë gjasa t'i përdorin këto shërbime sesa ata që jetojnë jashtë këtij rajoni. Së fundi, nuk është i madh numri i personave që për këto shërbime mjeksore shkojnë tek mjeku popullor. Numri i këtyre personave është më pak se 1% dhe bëhet fjalë kryesisht për persona që jetojnë në zonat malore.

Këto dallime në llojin e ofruesit të shërbimit ambulator sipas rajoneve mund të shpjegohen pjesërisht nga dallimet në disponibilitetin e këtyre ofruesve sipas rajoneve. Në fillim të tranzicionit, shumë mjekë lanë zonat fshatare dhe ato të thella malore të tërhequr nga mundësi më atraktive nëpër qytete, e sidomos në Tiranë. Futja e pagesave të reja për mjekët e përgjithshëm, që përfshinin edhe sistemin për numër banorësh të mbuluar me më shumë peshë për popullësinë fshatare dhe të izoluar, arriti të tërhiqte disa mjekë të përgjithshëm në zonat fshatare, por nuk arriti ta bënte një gjë të tillë për zonat e thella malore (IHSD, 2000) duke sjellë ndryshime të mëdha në numrin e personelit shëndetësor sipas rajoneve të ndryshme të vendit (Tabela 5.6).

**Tabela 5. 6: Personeli mjeksor për 1000 banorë sipas rretheve**

Rajoni	Rrethi	Specialist/1000	Mjek i Përgj/ 1000	Inferm./ 1000	Dentist/ 1000	Farmacist/ 1000
Qendror	Berati	0.68	0.47	4.37	0.11	0.04
	Elbasan	0.55	0.41	3.74	0.11	0.04
	Gjirokastrë	1.14	0.66	6.19	0.19	0.07
	Korçë	0.89	0.60	4.53	0.15	0.05
	Shkodër	0.68	0.45	4.34	0.11	0.05
Bregdetar	Durrës	0.75	0.55	3.18	0.16	0.04
	Fier	0.52	0.43	2.85	0.10	0.03
	Lezhë	0.56	0.43	4.05	0.16	0.04
	Vlorë	1.00	0.60	4.62	0.16	0.06
Malor	Dibër	0.56	0.33	4.96	0.07	0.05

<sup>48</sup> Obzervatori Evropian, 2003.

	Kukës	0.80	0.45	5.85	0.12	0.07
Tiranë	Tiranë	1.69	0.57	4.09	0.15	0.11
	Gjithsej	0.90	0.50	4.11	0.13	0.06

*Burimi: Të dhënat e përfaqësuara janë siguruar nga Maeda bazuar në të dhëna të Ministrisë së Shëndetësisë*

Diferencat në shfrytëzimin e kujdesit shëndetësor sipas grup-moshave janë më të mëdha për fëmijët dhe të moshuarit (Tabela 5.7). Përqindja e fëmijëve jo të varfër që i drejtohen kujdesit shëndetësor kur janë sëmurë është 66%, ndërsa kjo shifër është vetëm 50% për fëmijët e varfër. Dallimet në shfrytëzimin e shërbimit ambulator janë më të mëdha midis të moshuarve. Afërsisht 70% e të moshuarve jo të varfër marrin shërbim ambulator kur janë të sëmurë, ndërsa për të moshuarit që jetojnë në familje të varfëra kjo shifër është vetëm 41%.

**Tabela 5. 7: Përqindja e shfrytëzimit të shërbimit ambulator midis personave që deklarojnë sëmundje sipas nivelit të varfërisë dhe moshës**

	Jo të varfër	Të varfër	Gjithsej
0-14	0.657	0.483	0.593
	(0.031)	(0.045)	(0.028)
15-24	0.414	0.486	0.435
	(0.053)	(0.071)	(0.046)
25-49	0.558	0.526	0.549
	(0.030)	(0.051)	(0.027)
50-69	0.672	0.483	0.640
	(0.033)	(0.066)	(0.030)
>=70	0.720	0.415	0.636
	(0.050)	(0.086)	(0.050)

*Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria*

### **Shëndeti i nënës dhe kujdesi i paralindjes**

Niveli i vdekshmërisë amtare në Shqipëri është ndër më të lartët në rajon: 3 herë më i lartë se në Serbi dhe Malin e Zi dhe dy herë më i lartë se në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, një nga objektivat kryesorë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Ekonomiko-Social të qeverisë shqiptare është ulja e vdekshmërisë amtare.

LSMS-ja shqiptare nuk përmban informacion mbi vdekshmërinë amtare; megjithatë ajo përmban shumë informacion në lidhje me aksesin e grave ndaj kujdesit shëndetësor kur janë shtatëzëna dhe për lindje. Megjithëse pothuajse të gjitha gratë që kanë lindur gjatë tre vjetëve përpara intervistës deklarojnë se kanë marrë kujdes paralindjes (93%), gjithësesi ekzistojnë disa ndryshime përsa i takon të ardhurave dhe rajonit të banimit në përqindjen e grave që kanë marrë këtë shërbim shëndetësor. Gratë e varfra që jetojnë në rajonet malore dhe ato që jetojnë në zonat fshatare kanë më pak gjasa të marrin shërbim shëndetësor gjatë shtatëzimit në krahasim me të tjerat. Po kështu, në grupin e grave që marrin shërbim paralindjes ka sërish diferenca në numrin e vizitave konsultore. Gratë në Tiranë konsultohen mesatarisht pothuajse dy herë më shumë në krahasim me gratë që jetojnë në zonat malore ose në zonat fshatare.

**Tabela 5. 8: Kujdesi paralindjes sipas nivelit të varfërisë dhe rajoneve**

	Jo të varfër	Të varfër	Bregdet	Qendrore	Malore	Tiranë	Zona të tjera qytetëse	Rurale
Përqindja e grave që marrin kujdes paralindjes	0.96 (0.01)	0.87 (0.03)	0.92 (0.02)	0.95 (0.02)	0.83 (0.03)	1.00 (0.00)	0.97 (0.01)	0.91 (0.02)
Numri i vizitave	4.4 (0.18)	3.9 (0.22)	4.1 (0.27)	3.9 (0.22)	2.8 (0.12)	7.7 (0.55)	4.9 (0.29)	3.4 (0.15)

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002 për Shqipërinë;

Në kllapa janë gabimet standarde

Gjithashtu ka dallime edhe në përqindjen e grave që u jepet kujdes gjatë lindjes dhe në llojin e personelit që asiston në lindje. Megjithëse pothuajse të gjitha gratë janë ndihmuar gjatë lindjes nga një personel i kualifikuar (98%), gratë që banojnë në zonat qytetëse dhe gratë jo të varfra kishin më shumë gjasa t'u jepej kujdes nga mjeku sesa nga mamia.

**Tabela 5. 9: Ndihma gjatë lindjes sipas llojit të personelit sipas rajoneve dhe nivelit të varfërisë (përqindjet)**

	Tiranë	Zonë tjetër qytetës	Fshat	Jo të varfër	Të varfër	Total
Mjek	0.89	0.84	0.60	0.71	0.64	0.69
Mami	0.11	0.14	0.37	0.28	0.31	0.29
Mami tradicionale	0.00	0.00	0.01	0.00	0.02	0.01
Fis/të tjerë	0.00	0.02	0.01	0.00	0.04	0.01
Gjithsej	0.10	0.24	0.66	0.68	0.32	1.00

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002 për Shqipërinë

### Medikamente të lëshuara pa recetë

Afërsisht 30% e individëve kur sëmuren blejnë medikamente pa recetë. Nuk ka dallime përsa i përket të ardhurave në lidhje me përqindjen e individëve që blenë medikamente farmaceutike, por ka diferenca të mëdha rajonale. Shqiptarët që jetojnë në zonat malore në veri-lindje të vendit ka më shumë gjasa të blejnë medikamente pa recetë kur janë të sëmurë pavarësisht nga mosha (43% blenë medikamente pa recetë). Përkundrazi, individët që jetojnë në Tiranë kanë shumë më pak gjasa të blejnë medikamente pa recetë në çdo moshë sesa individët që jetojnë në çdo rajon tjetër të vendit (17%). Këto rezultate nuk janë të çuditshme duke qenë se individët që banojnë në zonat malore janë më pak të predispozuar t'u drejtohen shërbimeve shëndetsore kur janë të sëmurë, ndërkohë që banorët e Tiranës janë më të predispozuar t'u drejtohen shërbimeve shëndetsore kur janë të sëmurë.

### Shtrimet në spital

Të dhënat e LSMS-së së vitit 2002 tregojnë se afërsisht 4% e të gjithë numrit të popullësisë deklarojnë të jenë shtruar në spital një vit përpara intervistës. Nuk ka dallime përsa i përket normave të shtrimit në spital sipas gjendjes së varfërisë nëse merret në

konsideratë edhe moshë. Megjithëse ka dallime sipas rajoneve dhe në këtë kontekst banorët e Tiranës kanë përqindjen më të ulët të shtrimeve në spital gjatë vitit të kaluar (2.5) në krahasim me zonat e tjera qytetëse (4.7) dhe me zonat fshatare (4.6).

## 5. Shpenzimet për shëndetësinë

### *Shpenzimet publike për shëndetësinë*

Në vitin 2002 shpenzimet publike për shëndetësinë arritën në 18,022 milionë Lek për kujdesin shëndetësor.<sup>49</sup> Kjo shumë është afërsisht sa 3% e totalit të PBB-së, duke qenë kështu një nga përqindjet më të ulta në Ballkan dhe afërsisht gjysma e mesatares së vendeve të CEE-së.<sup>50</sup> Shpenzimet publike për shëndetësinë jo vetëm që janë të ulta në krahasim me vendet e tjera të rajonit, por janë gjithashtu të ulta në krahasim me vetë shpenzimet e Shqipërisë një dekadë më parë. Si përqindje e totalit të shpenzimeve të qeverisë, shpenzimet publike për kujdesin shëndetësor në vitin 2002 ishin 9.8%, pak më të larta nga 8.8% që ishte shifra për vitin 2000. Në të kundërt, Kroacia dhe Sllovenia shpenzuan përkatësisht 13.7 dhe 15.6 përqind të totalit të shpenzimeve të buxhetit për shëndetësinë, në të njëjtën kur mesatarja për vendet e BE-së ishte afërsisht 13 përqind (1998).

**Tabela 5. 10: Shpenzimet publike për shëndetësinë**

	1991	2000	2001	2002
Totali shpenzimeve publike/PBB	62.2	25.9	27.5	27.9
Shpenzimet publike për shëndetësinë/PBB	4.8*	2.3	2	2.7
Shpenzimet për shëndetësinë si % e totalit të shpenzimeve		8.8	7.4	9.8

*Burimi: Shqipëri, Ministria e Financave; \* OBSH/Evropë, HFA Database, qershor 2002*

Shpenzimet e kufizuara për kujdesin shëndetësor kanë sjellë një rritje të pjesëmarrjes së sektorit privat në financimin e shëndetësisë. Shërbimet shëndetësore po paguhen gjithmonë e më shumë nga xhepi si për bashkëpagesën formale ashtu edhe për pagesat nën-dorë. Duke përdorur të dhënat e LSMS-së së bashku me të dhënat administrative mbi shpenzimet publike, shpenzimet publike për shëndetësinë në vitin 2002 janë përlllogaritur se përbëjnë afërsisht 30% të totalit për kujdesin shëndetësor. Në dallim nga këto të dhëna, përqindja e shpenzimeve publike për shëndetësinë në Greqi është 51% e totalit të shpenzimeve për shëndetësinë, ndërsa në Slloveni kjo shifër është afërsisht 86%.<sup>51</sup>

### *Shpenzimet private për shëndetësinë*

Rënia e ndjeshme në fondet publike të veçuara për shëndetësinë ka sjellë një rritje të ndjeshme të shpenzimeve private. Të dhëna të përafërta nga LSMS-ja për Shqipërinë demonstrojnë se shpenzimet familjare për kujdes shëndetësor janë shumë të mëdha dhe përbëjnë midis 1.8 dhe 3.4 përqind të gjithë PBB-së dhe afërsisht 70% të të gjitha shpenzimeve për shëndetësinë.<sup>52</sup> Kjo tendencë është shqetësuese duke qenë se shumica e

<sup>49</sup> Burimi: Ministria e Financës, Programi Afatmesëm Buxhetor (MTEF).

<sup>50</sup> Në përputhje me angazhimin e tyre për të përmirësuar mundësinë e përdorimit dhe parazinë e shërbimeve shëndetësore, autoritetet shqiptare kanë nisur të rrisin shpenzimet për kujdesin shëndetësor. PAB e Qeverisë së Shqipërisë 2003-2005 ka parashikuar një rritje në burimet publike të përcaktuara për shëndetësinë nga 2.7% në 3.1% të PBB deri në vitin 2005.

<sup>51</sup> Të dhënat për përqindjen e shpenzimeve publike si përqindje të shpenzimeve gjithsej për shëndetësinë për Greqinë dhe Slloveninë janë marrë nga banka e të dhënave "Shëndet për të gjithë" OBSH/Evropë.

<sup>52</sup> Kjo përqindje përfshin edhe kostot e transportit. Kufiri I sipërm është përlllogaritur duke shumëzuar të dhënat për shpenzimet me periudha të njëjta njëmuajore me 12. Kufiri I poshtëm është përlllogaritur duke



shpenzimeve janë nga xhepi dhe ka rezultuar në pabarazi të të ardhurave përse i përket aksesit ndaj shërbimeve shëndetësore dhe në mungesë të mbrojtjes financiare të popullsisë përballë shpenzimeve katastrofike për shëndetin.

### Shërbimi ambulator

Megjithëse nuk ka ndryshime në shumat a paguara nga të varfërit dhe jo të varfërit për shërbimet ambulatorie ekzistojnë diferenca të mëdha midis rajoneve. Banorët e rajonit të Tiranës mesatarisht paguajnë shumë më pak për vizitat në shërbimin ambulator, duke përfshirë trajtimin, analizat, dhuratat, medikamentet dhe transportin për në shërbimin ambulator në krahasim me ata që jetojnë jashtë Tiranës. Megjithatë, totali i shpenzimeve në Tiranë nuk është shumë i ndryshëm nga totali i shpenzimeve në shërbimin ambulator për banorët e zonave qytetëse të rajonit qendror, por është shumë më i ulët sesa për zonat fshatare ose qytetëse të çdo rajoni tjetër në vendet ose për zonat fshatare të rajonit qendror.

Ka disa arsye përse banorët e Tiranës shpenzojnë më pak për shërbimin ambulator. Qysh nga viti 2001, në rajonin e Tiranës ka funksionuar një program pilot sipas të cilit i gjithë sistemi i kujdesit parësor për rajonin u riorganizua dhe tashmë drejtohet nga Autoriteti i ri Shëndetësor Rajonal i Tiranës. Financimi i të gjithë sistemit tashmë është përgjegjësi e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, i cili midis të tjerave paguan rrogat e të gjithë mjekëve, infermiereve, mamive dhe ndihmësmjekëve. Në dallim nga më sipër, në të gjithë pjesën tjetër të vendit Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor përgjigjet për pagat e mjekëve të familjes dhe mjekët e përgjithshëm. Personeli që paguhet nga Instituti i Sigurimeve merr mesatarisht paga më të larta sesa ato të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu, vetëm në rajonin e Tiranës sigurimet shëndetësore mbulojnë të gjitha shërbimet ambulatorie dhe jo vetëm shërbimet e ofruara nga mjeku i përgjithshëm apo mjeku i familjes. Kështu, dallimi në shpenzimet e shërbimit ambulator midis rajonit të Tiranës dhe rajoneve të tjera vjen si shkak i përqindjes më të ulët të personave që paguajnë për shërbime ambulatorie në Tiranë.

***Tabela 5. 11: Shpenzimet për shërbimin ambulator sipas rajoneve***

	Kurim	Dhurata	Medikamente	Analiza	Transport	Gjithsej
Pagesa mesatare mujore						
Bregdetare	263.2	227.1	1645.0	425.3	164.1	2728.7
Qendrore	437.7	128.5	1203.2	212.8	373.0	2353.1
Malore	527.6	200.3	1467.6	256.5	483.6	2928.1
Tiranë	166.0	32.2	970.6	214.0	11.7	1401.2
Gjithsej	360.9	163.2	1368.9	294.0	278.6	2465.8
Përqindja që paguan						
Bregdetare	40.7	39.4	93.5	32.3	30.2	97.9
Qendrore	55.6	21.9	84.7	25.4	32.5	94.9
Malore	57.6	27.7	91.8	37.9	57.3	98.3

kalibruar të dhënat nga LSMS me të dhënat e njohura administrative për të korrigjuar sezonalitetin e mundshëm të shpenzimeve për kujdesin shëndetësor të cilat sondazhi nuk ka arritur ti kapë. Në shtojcë mund të gjeni një përshkrim të të metodikës të përdorur për të përlogaritur kufirin e poshtëm.

Tiranë	25.8	9.5	82.2	22.2	5.0	87.5
Gjithsej	48.0	27.8	88.3	28.8	31.7	95.7

*Burimi: LSMS-ja e vitit 2002 për Shqipërinë*

Medikamentet përbëjnë kategorinë kryesore të shpenzimeve për personat që i drejtohen shërbimit ambulator në të gjitha rajonet e vendit dhe përfaqësojnë afërsisht 55% të totalit të shpenzimeve për vizitat mjeksore në shërbimin ambulator. Pothuajse të gjithë paguajnë për barnat e lëshuara me recetë (88% të totalit), megjithëse personat që kanë librezë shëndetësore përfitojnë zbritje të çmimit. Shpenzimet për medikamentet pa recetë gjatë katër javëve përpara intervistës ishin afërsisht 340 Lek (afërsisht 10% të kufirit ushqimor të varfërisë). Nuk ekziston asnjë diferencë në totalin e shpenzimeve për medikamentet pa recetë sipas nivelit të të ardhurave apo zonave të banimit. Shpenzimet për kurim, analiza dhe transport përfaqësojnë përkatësisht afërsisht 11-12% të totalit të shpenzimeve. Rregullimi me faktorin e vendbanimit nuk sjell asnjë dallim të dukshëm në shpenzimet për shërbime ambulatorie midis personave që kanë librezë shëndetësore dhe atyre që nuk e kanë, çka tregon se mjekët e përgjithshëm ndofta nuk bëjnë asnjë dallim midis të siguarëve dhe të pasiguarve kur kërkojnë pagesë nga pacientët.

### **Shtrimet në spital**

Tabela 5.12 tregon shpenzimet mesatare për shtrimin në spital midis individëve që deklarojnë se janë shtruar në spital një vit përpara intervistës. Shtrimet në spital janë të rralla dhe të dhënat e përafërta të paraqitura në tabelë nuk janë tepër sakta, por japin një ide të përgjithshme në lidhje me modelin e shpenzimeve sipas nivelit të varfërisë dhe rajoneve. Të varfërit shpenzojnë mesatarisht afërsisht 30% më pak për shtrimet në spital sesa jo të varfërit (megjithatë kjo diferencë nuk ka rëndësi statistikore) si në zonat fshatare, ashtu edhe në zonat qytetëse.

Totali i shpenzimeve për kujdesin spitalor mund të jetë i madh, sidomos për të varfërit. Kështu, ndërsa konsumi mesatar mujor për frymë për një familje të varfër është afërsisht 3,800 Lek, shpenzimet mesatare mujore për kujdesin spitalor midis të varfërve që deklarojnë të jenë shtruar në spital vitin kaluar është afërsisht 1,300 Lek ose afërsisht 34% i totalit të shpenzimeve mujore për frymë. Në rajonin e Tiranës kjo situatë është edhe më dramatike duke qenë se shpenzimet mesatare për shtrimin në spital arrijnë 40% të shpenzimeve mujore për frymë të një familjeje të varfër.

***Tabela 5. 12: Totali vjetor i shpenzimeve spitalore***

	Jo të varfër	Të varfër	Total
Tiranë	34,013.7	18,315.3	29,191.9
	(12640.7)	(3698.8)	(9111.0)
Qytet	22,409.7	17,314.8	21,381.2
	(5883.5)	(2981.2)	(4699.9)
Fshat	21,539.5	14,569.3	19,572.6
	(2387.3)	(1975.2)	(1860.6)
Gjithsej	22,605.1	15,554.6	20,786.6
	(2585.7)	(1555.6)	(1974.1)

*Burimi: LSMS-ja e vitit 2002 për Shqipërinë;*

*Në kllapa jepet deviacioni standart*

### *Pagesat informale*

Pagesat informale janë pagesa jozyrtare që i jepen një ofruesi të kujdesit shëndetsor për shërbime që supozohet që pacientit duhet t'i jepen pa asnjë kosto/falas. Megjithëse në disa vende evropiane është bërë gjë e zakonshme që që pacientët të ofrojnë pagesa të pakërkuara në formë bakshishi për ofruesit e kujdesit shëndetsor, ka shumë fakte që tregojnë se një përqindje e madhe e pagesave informale aktualisht nuk janë vullnetare/me dëshirë të pacientit dhe ose kërkohen ose pranohen (Lewis, 2000). Pagesat informale mund të përbëjnë pengesë për aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore, si edhe mund të pengojnë përpjekjet e qeverisë për të përmirësuar barazinë dhe eficiencën e sistemit shëndetësor.

Siç shihet në Tabelën 5.11, afërsisht 30% e personave shkojnë për t'u vizituar në një ofrues të shërbimit ambulator gjatë katër javëve të fundit përpara sondazhit deklarojnë se i kanë bërë një dhuratë mjekut, infermieres ose shërbimit shëndetësor. Ekzistojnë dallime të mëdha rajonale për sa i takon përqindjes së personave që deklarojnë se kanë bërë të tilla pagesa. Kështu, p.sh në Tiranë vetëm 10% e personave që u janë drejtuar shërbimit ambulator i kanë bërë “dhuratë” ofruesit, ndërsa për rajonet bregdetare kjo shifër është 40%. Jo vetëm që banorët e Tiranës paguajnë më pak, por mesatarisht ata paguajnë shumë më pak se personat që jetojnë në rajonet e tjera.

***Tabela 5. 13: Pagesat informale mesatare në shërbimin ambulator midis atyre që bëjnë pagesat informale***

Bregdetare	Qendrore	Malore	Tiranë
576.4	587.5	722.0	337.5
(84.7)	(105.3)	(109.1)	(52.2)

*Burimi: LSMS-ja e vitit 2002 për Shqipërinë*

*Në kllapa jepen deviacionet standarte*

Pagesat informale në shërbimin ambulator përfaqësojnë afërsisht 11% të totalit të shpenzimeve në dallim nga kujdesi spitalor, ku përfaqësojnë afërsisht 25% të totalit të shpenzimeve. Midis personave që bëjnë “dhurata” gjatë periudhës së shtrimit të tyre në spital (60% e rasteve), 43% thanë se kjo dhuratë iu ishte kërkuar apo pritej prej tyre. Në rastin e shërbimit ambulator, afërsisht 40% e personave që shkuan në ambulancat publike thanë se kjo iu kërkohej apo pritej prej tyre, ndërsa 25% e atyre që i janë drejtuar një infermiereje kanë përmendur kërkesa të tilla.

Problemi i pagesave informale në rastin e shtrimeve në spital mesa duket është i madh (të gjitha shërbimet spitalore supozohen të jenë falas) dhe madje më i rëndësishëm nga problemi i shërbimeve në ambulanca. Kushtet në spitalet publike në përgjithëse janë të këqija, me mungesa në shërbime nga më elementaret si energjia elektrike, ilaçet dhe pajisjet mjeksore. Siç tha një grua shqiptare në një intervistë në kuadrin studimit mbi perceptimet për kujdesin shëndetësor publik (Ministria e Shëndetësisë, 2000): “Kur e kisha nënën të shtruar në spital, m'u desh të pastroja që nga mbulesa e komodinës deri

tek gotat. Banjot janë në kushte të këqia. Po nuk pagove nuk të prek njeri me dorë. Këtu duan të gjithë para, që nga roja, tek infermieret, sanitaret dhe mjekët..” Pagat e ulta të personelit e kanë thëlluar edhe më shumë këtë problem dhe ndofta kontribuojnë në shumimin dhe përhapjen e pagesave informale.

***Kutia 5.1: Pagesat informale për kujdesin shëndetësor në zonat peri-urbane të Tiranës dhe Durrësit***

*Megjithëse fëmijët e mi janë shumë të vegjël për të shkuar në shkollë, të dy janë vaksinuar dhe i vizitoj rregullisht në spitalin lokal shtetëror. Për kontrolle të thjeshta mjeksore kërkohen nga 200 deri në 500 Lek të reja, por kurime më komplekse kushtojnë shumë më shumë. Kështu, p.sh kur më lindi djali i fundit na u desh të paguanim 10,000 Lek.*

– burrë 35 vjeçar nga rrethinat e Durrësit

Normalisht duhet të paguajmë 500 Lek për trajtim. Kur më lindi vajza e madhe (në Kukës), mjeku më dha të kuptoja se priste diçka prej meje por unë nuk e pagova sepse unë prisja djalë e fëmija kishte dalë vajzë! Megjithëse të gjithë fëmijët i kam të vaksinuar, dy fëmijët më të vegjël nuk kanë lindur në maternitet. Gratë e fisit e ndihmuan Dritën (të shoqen) në lindje. Kur dikush nga familja ka nevojë të shkojë tek mjeku, ne shkojmë në spitalin shtetëror në Durrës.

– Ramizi, kryefamiljar 32 vjeçar nga një zonë kënetore në Durrës.

Të dy fëmijët e mi kanë lindur në spitalin shtetëror. Për secilën nga lindjet familja ime pagoi nga 5,000 - 10,000 Lek mjekëve. Zakonisht paguajmë afërsisht 500 Lek për një vizitë të zakonshme tek mjeku. Unë nuk jam i kënaqur me cilësinë e shërbimit të spitalit, edhe pasi i kam paguar mjekët. Edhe pasi kam paguar për ilaçet që më ka dhënë mjeku me recetë, shpesh ato janë të skaduara.

– Shukri, 25 vjeç, kryefamiljar, nga zona kënetore në Durrës

*Vajza e Fatjonit është e sëmurë me të ftohtë kronik dhe i duhet që vazhdimisht të shkojë tek mjeku në klinikë. Mjekët nuk kërkojnë para, por po nuk u dhe vetë gjë do të na thonë vazhdimisht të shkojmë sërish për kontrolle mjeksore. Mjekët thjesht harxhojnë kohën derisa marrin paratë. Kur Anxhela (mbesa) duhet të shkojë tek mjeku, fëmijët e tjerë të familjes mbledhin kanaçe dhe i shesin për riciklim për të bërë para për mjekun. Herën e fundit që ishim tek mjeku paguam 1,300 Lek për ilaçet. Në kohën e komunizmit mjekët kujdeseshin më shumë, ose së paku bënë sikur kujdeseshin.*

– Familja Abdul në zonën e Bregut të Lumit në Babru, zonë peri-urbane në Tiranë

*Nga Bezhani dhe Tracy, 2002: Intervista të hapura me familje në zonat peri-urbane të Tiranës dhe Durrësit. Këto pjesë intervistash nuk përfaqësojnë vendin apo zonat në të cilat janë marrë këto intervista, por janë një tregues i problemeve me të cilat ndeshen disa nga banorët e këtyre zonave.*

**Sa shpenzojnë familjet shqiptare për shëndetin**

Shqiptarët shpenzojnë mesatarisht pothuajse 700 Lek për frymë në muaj për kujdes shëndetësor, që është afërsisht 18% e konsumit mesatar për frymë të një familjeje të varfër. Megjithatë, ka diferenca të mëdha në shumatat që familjet shpenzojnë sipas

pesëshoreve të konsumit. Familjet që futen tek 20% më i varfër i shpërndarjes së konsumit mesatarisht shpenzojnë afërsisht gjysmën që shpenzojnë familjet në pesëshoren më të pasur për shëndetin. Si përqindje e konsumit të përgjithshëm, familjet në pesëshoren më të varfër të shpërndarjes së të ardhurave shpenzojnë afërsisht 10% të konsumit të tyre mujor për frymë për shëndetin; në dallim nga këta, familjet më të pasura shpenzojnë mesatarisht afërsisht 5% të totalit të tyre të shpenzimeve për shëndetin. Duke qenë se rastet e shtrimeve në spital janë të ralla, shumica e shpenzimeve për shëndetin kalon tek vizitat mjeksore të shërbimit ambulator. Medikamentet përfaqësojnë një përqindje të madhe të totalit të shpenzimeve për shëndetin dhe siç është përmendur më parë në rastin e shërbimit ambulator, medikamentet përfaqësojnë afërsisht 55% të totalit të shpenzimeve, ndërsa në rastin e shtrimit në spital përqindja është 17%. Por gjithashtu ka shumë persona që blejnë ilaçe pa receta dhe kështu shpenzimet për medikamentet përfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme të shpenzimeve totale të familjes. Mesatarisht, 3.5% e totalit të shpenzimeve për frymë të një familjeje shkon për blerjen e ilaçeve, prodhimi dhe shpërndarja e të cilave është pothuajse e gjitha në dorën e sektorit privat. Familjet në brezin e varfër të brezave të shpërndarjes së të ardhurave paguajnë mesatarisht dy here më shumë për medikamente (si përqindje të totalit të shpenzimeve) sesa familjet në brezin më të pasur të shpërndarjes së të ardhurave.<sup>53</sup>

**Tabela 5. 14: Shpenzimet mujore shëndetsore për frymë dhe përqindja që zënë shpenzimet shëndetsore në shpenzimet totale familjare për frymë nëpër pesëshoret e konsumit**

	Pesëshoret					Total
	I	II	III	IV	V	
Shpenzimet për shëndetin për frymë	449.8	544.4	618.5	691.4	892.9	672.9
	(45.8)	(51.0)	(48.3)	(57.4)	(77.8)	(32.9)
% e shpenzimeve totale <sup>a</sup>						
Totali i shpenzimeve për shëndetin	9.1	7.9	7.1	6.1	4.9	6.7
Shpenzime spitalore	1.3	1.2	0.8	0.8	0.4	0.8
Shpenzimet për shërbim ambulator	6.2	5.3	5.0	4.0	3.3	4.6
Shpenzime për ilaçe <sup>b</sup>	4.9	4.1	3.8	3.2	2.5	3.5
% e të ardhurave të përhershme ( <i>gjithsej shpenzime për frymë duke përfshirë shpenzimet për shëndetin</i> )						
Totali i shpenzimeve për shëndetin	12.7	10.6	9.2	7.8	6.1	8.8
Shpenzimet spitalore	1.8	1.7	1.1	1.0	0.5	1.1
Shpenzimet për shërbim ambulator	9.0	7.4	6.6	5.2	4.2	6.1

<sup>53</sup> LSMS 2001 është mbledhur gjatë periudhës kohore midis prillit dhe qershorit të vitit 2002. Ky sondazh ka një modul të gjerë në lidhje me shëndetsinë, I cili përfshin ndër të tjera edhe pyetje në lidhje me shërbimet e pacientëve të shtruar dhe jo të shtruar, shfrytëzimin e këtyre shërbimeve dhe shpenzimet për to. Meqënëse shumë njerëz nuk mund të mbajnë mend me saktësi numrin e vizitave që bëjnë në shërbime të caktuara shëndetsore, sidomos në ato parandaluese, periudha e kujtesës epyejeve të LSMS që kanë lidhje me pacientët që nuk shtrohen në spital ishte vetëm katër javë. Duke vepruar kështu, pyetësi shmang gabimet e kujtesës, por nuk merr paraqysh sezonalitetin e shfrytëzimit të kujdesit shëndetsor. Si të tilla të dhënat mujore të paraqitura këtu përfaqësojnë vetëm muajt gjatë të cilëve janë mbledhur të dhënat.

Shpenzimet për barnat	6.6	5.2	4.9	3.9	3.1	4.5
-----------------------	-----	-----	-----	-----	-----	-----

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria

<sup>a</sup> Shpenzimet gjithsej për shëndetin iu mblohdën shpenzimeve familjare për frymë për të llogaritur këto përqindje. Megjithatë, shpërndarja nëpër pesëshoret e konsumit nuk përfshin shpenzimet për shëndetsinë

<sup>b</sup> Përfshin medikamentet e lëshuara me recetë nga shërbimet e ambulatorore, shtrimi në spital dhe medikamentet që jepen pa recetë

## 6. Shpenzimet katastrofike për shëndetsinë dhe Varfëria

Tabela 5.15 tregon pabarazitë e sistemit shëndetësor në mbrojtjen financiare të familjeve ndaj shpenzimeve katastrofike për shëndetsinë (shpenzimet që e kalojnë 10% të totalit të të ardhurave). Mesatarisht 26% e individëve deklarojnë se shpenzimet e tyre për shëndetin janë të barabarta ose e kalojnë 10% të totalit të të ardhurave të tyre dhe afërsisht 9% deklarojnë se shpenzimet e tyre për shëndetin përfaqësojnë 25% ose më shumë të totalit të të ardhurave të tyre. Individët në pesëshoren e të varfërve kanë më shumë gjasa pësuar shpenzime katastrofike për shëndetsinë sesa pesëshora më e pasur.

**Tabela 5. 15: Përqindja e individëve shpenzime katastrofike shëndetsore**

	Pesëshoret e konsumit					Total
	I	II	III	IV	V	
Mbi 10%	0.32	0.30	0.27	0.25	0.14	0.26
	(0.03)	(0.02)	(0.02)	(0.02)	(0.01)	(0.01)
Mbi 25%	0.13	0.10	0.10	0.07	0.05	0.09
	(0.02)	(0.02)	(0.02)	(0.01)	(0.01)	(0.01)
Mbi 50%	0.05	0.02	0.03	0.02	0.01	0.03
	(0.01)	(0.01)	(0.01)	(0.01)	(0.00)	(0.00)

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria; Shpenzimet Total lidhen me konsumin total me përfshirje të shpenzimeve për shëndetin.

Sipas Wagstaff dhe van Doorslaer (2003), përlllogariten një përqindje e shpenzimeve katastrofike p rëshëndetsinë,  $\mu_E$ , si edhe një indeks I cili ponderon këtë matje duke e vënë më shumë theksin tek familjet e varfëra. Përlllogaritet gjithashtu edhe një matje e tepriçës së pagesave katastrofike,  $\mu_o$ , e cila mat se sa e kalon masa e shpenzimeve për shëndetin përqindjen e të ardhurave të cilën e përkufizojmë si katastrofike. Këto matje na ofrojnë një statistikë përmbledhëse që tregon nëse të varfërit janë më të prekur nga shpenzimet katastrofike p rshëndetin dhe nëse pagesat e tepërta janë më të mëdha sesa ato që bëjnë familjet më të pasura.

Këto indekse konfirmojnë që familjet e varfëra jo vetëm që kanë më shumë gjasa të kenë shpenzime katastrofike për shëndetin, por ato janë edhe më të predispozuar për të pasur një tepriçë të pagesave për shëndetin mbi pragun e përcaktuar (matjet e ponderuara  $W_E$  dhe  $W_O$  janë më të mëdha sesa mesataret,  $\mu_E$  dhe  $\mu_o$ ).

**Tabela 5. 16: Përqindja katastrofike dhe matjet e tepricave katastrofike për shpenzimet shëndetsore**

Pragu	$\mu_E$	$C_E$	$W_E$
>10%	0.25632	-0.13371	0.290592
>25%	0.08977	-0.17031	0.105063
	$\mu_o$	$C_o$	$W_o$
>10%	0.021712	-0.03133	0.022392
>25%	0.047343	-0.08104	0.05118

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria

$C_E$  dhe  $C_o$  janë raportet e përqëndrimit për përqindjet e popullsisë dhe matjet e tepricave të pagesave.<sup>54</sup>

Matjet e shpenzimeve katastrofike për shëndetsinë na tregojnë afërsisht përqindjen e personave shpenzimet shëndetësore të cilëve e kalojnë pragun e paracaktuar, por na tregojnë afërsisht nëse ky person me këto shpenzime futet apo jo në kategorinë e të varfërve, apo në rast se personi që është i varfër bie edhe më në varfëri. Sipas Wagstaff dhe van Doorslaer (2003), bëhen matjet e varfërisë përpara dhe pas shpenzimeve shëndetsore, të cilat na ofrojnë pastaj informacionin e mësipërm. Një përmbledhje e këtyre matjeve paraqitet në Tabelën 5.17.

**Tabela 5. 17: Matjet e varfërisë përpara dhe pas pagesave për kujdesin shëndetsor**

	Të ardhurat	
	Para pagimit	Pas pagimit
<i>Të varfër</i>		
Përqindja	25.4	33.9
Hendeku i normalizuar	5.7	9.9
<i>Tejet të varfër</i>		
Përqindja	4.7	10.3
Hendeku I normalizuar	0.8	2.9
<i>Shtrimi në spital</i>		
Përqindja	25.4	27.5
<i>Pacientë që nuk shtrohen në spital</i>		
Përqindja	25.4	31.9

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria

Pagesat për kujdesin shëndetësor dhe në veçanti pagesat për shërbimin ambulator fusin disa njerëz në kategorinë e varfërisë, ndërsa disa të tjerë i zhysin edhe më thellë. Ndërsa një e katërta e shqiptarëve i kanë të ardhurat për frymë nën nivelin e varfërisë (44,891 Lek për person në muaj), të ardhurat për frymë për afërsisht 34% të popullsisë bien nën nivelin e varfërisë pasi t'u jenë hequr nga të ardhurat e tyre shpenzimet për shëndetin. Po

<sup>54</sup> Grafiku I përqëndrimit përkufizohet si dyfishi I sipërfaqes midis grafikut të përkufizimit dhe vijës së barazisë së përsosur. Kurba e përqëndrimit ndërtohet duke përcaktuar përqindjen e akumuluar të grupit të zgjedhjes përgjatë boshtit të abshisës (të renditur sipas të ardhurave) përkundër përqindjes së akumuluar të personave që e kalojnë pragun të vendosur në bostin e koordinatave.

kështu, megjithëse vetëm 5% e popullsisë konsiderohet si tejet e varfër përpara se të merren në konsideratë shpenzimet për shëndetin, pothuajse 10% e popullsisë bie nën kufirin ushqimor të varfërisë pasi zbriten këto shpenzime. Për çudi, shpenzimet për shërbimin ambulator ka më shumë gjasa ta bëjnë dikë të varfër sesa shpenzimet për shtrimin në spital.

## **7. Faktorët përcaktues të kërkesës për kujdes shëndetësor**

Një analizë standarde u përdor për studimin e faktorëve që përcaktojnë probabilitetin nëse një person kërkon kujdes shëndetsor kur sëmurët. Kjo analizë u bë në mënyrë të veçantë për fëmijët nga mosha 0-14vjeç dhe për të rritur që deklaruan se kishin shkuar për vizitë një ofruer të kujdesit parësor shëndetsor kur kishin qenë të sëmurë ose të lënduar gjatë katër javëve përpara intervistës së LSMS-së. Rezultatet e kësaj analize tregojnë se të ardhurat dhe fakti se personi ka librezë shëndetësore rrisin ndjeshëm probabilitetin të kërkuarit kujdes shëndetsor në të dy grupet e zgjedhjes. Në rastin e të rriturve, arsimi i personit gjithashtu luante rol në rritjen e probabilitetit të kërkuarit kujdes shëndetsor. Në rastin e fëmijëve, u vu re largësia nga një farmaci ulte kërkesën për shërbime të shëndetit parësor dhe largësia nga një spital publik e rriste. Dy rezultatet e fundit mund të ishin konsekuencë e cilësisë së ulët së shërbimeve të shëndetit parësor, duke qenë se shumë njerëz kishin zgjedhur të anashkallonin këto shërbime parësore ose i përdornin vetëm për të marrë receta për barna. Kështu që, sa më larg të ishte faracia aq më pak ishin të stimuluar personat për t'u vizituar tek mjeku i përgjithshëm në një qendër shëndetësore parësore për të marrë receta për barna. Së fundmi, megjithëse LSMS nuk e mbulonte shërbimin ambulator të ofruar në spitalet publike, ekziston evidence nga burime të tjera që tregon se shumë njerëz i anashkalojnë këto shërbime të kujdesit shëndetsor parësor dhe shkojnë drejtpërdrejtë tek specialistët nëpër poliklinika dhe spitale kur kanë nevojë për kujdes shëndetsor.

U llogarit edhe elasticiteti i çmimit të kërkesës për kujdes shëndetsor. Elasticiteti i çmimit bie me rënien e të ardhurave dhe personat në brezin e sipërm të shpërndarjes së të ardhurave janë më pak të predispozuar për ta ndryshuar sjelljen e tyre përpara se të përket rasteve kur kërkojnë kujdes shëndetsor kur ndryshojnë çmimet. Elasticiteti i çmimit i kërkesës së kujdesit shëndetsor për fëmijët ishte më elastike se ajo e të rriturve, por në përgjithëse për të gjitha nivelet e të ardhurave dhe për të dy grupet e zgjedhjes elasticiteti i çmimit të kërkesës ishte shumë i ulët, në disa raste shumë afër me zeron. Kjo është në dallim të madh me rezultatet e nxjerra nga Gertler dhe van der Gaag (1990) duke përdorur të dhënat nga Peruja dhe Bregu i Fildishtë dhe nga Chawla (2001), duke përdorur të dhënat nga Nikaragua. Megjithatë, studime të tjera kanë aritur në rezultate të ngjashme (shih Heller, 1982, Akin et al. 1984).

## **8. Komente përmbyllëse dhe ndikimet tek politikat**

Analiza e të dhënave të LSMS-së për vitin 2002 tregon se vetëm 58% e personave që kanë deklaruar një sëmundje ose lëndim i drejtohen shërbimit ambulator dhe ka pabarazi të mëdha në gjendjen shëndetësore përpara se të përket të ardhurave dhe pabarazive rajonale



dhe në aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore. Gjithashtu ka dallime të mëdha midis zonave fshatare dhe atyre qytetëse përsa i takon aksesit për ujë të pijshëm dhe kushteve të higjienës. Banorët e zonave qytetëse kanë akses për ujë në shtëpitë e tyre, ndërsa vetëm gjysma e familjeve që jetojnë në zonat fshatare kanë mundësi përdorimi të objekteve sanitare (tualet, kanalizime, etj.). Gjithashtu ka dallime të mëdha në përqindjen e individëve që i drejtohen shërbimit ambulator. Të varfërit dhe individët që jetojnë jashtë qarkut të Tiranës janë më të predispozuar të raportojnë një sëmundje sesa jo të varfërit, por nga ana tjetër ata janë më pak të predispozuar të kërkojnë kujdes shëndetsor kur sëmuren. Nga ana tjetër, banorët e qarkut të Tiranës kanë më pak gjasa të deklarojnë një sëmundje, por janë më të predispozuar nga ana tjetër për të kërkuar kujdes kur sëmuren. Gjithashtu ka diferenca të mëdha rajonale edhe në shfrytëzimin e kujdesit spitalor. Banorët më në gjendje ekonomike të zonave qytetëse ka më shumë gjasa të kenë librezë të sigurimeve shëndetësore sesa banorët e zonave fshatare. Gjithashtu individët për të cilët shteti mbulon sigurimet shoqërore ka më shumë gjasa të jenë të siguruar sesa ata që kontribuojnë vetë.

Pothuajse të gjitha grate marrin kujdes shtatzanie dhe pothuajse në të gjitha lindjet ekziston ndihma nga një kujdes I kualifikuar. Megjithatë, ka dallime të mëdha përsa i takon të ardhurave dhe dallime rajonale në numrin e konsultimeve paralindjes dhe llojit të personelit që ndihmon gratë gjatë lindjes. Megjithatë, krahasimisht, gratë në zonat malore kanë gjasat më të pakta për të marrë kujdes shtatzanie dhe kanë numrin më të vogël të konsultave nëpër klinika. Në dallim me to, gratë në Tiranë shkojnë dy here më shumë në konsulta shtatzanie krahasuar me gratë në zonat e tjera të vendit.

Për kujdesin shëndetësor ka shpenzime të mëdha nga xhepi. Shpenzimet për medikamente përfaqësojnë përqindjen më të madhe të këtyre shpenzimeve. Pagesat informale janë shumë të përhapura, sidomos në rastin e shërbimit spitalor ku 60% e personave deklaruan se kishin dhënë para nën dorë. Gjithashtu këto pagesa përfaqësojnë një përqindje të madhe të totalit të shpenzimeve, duke u përgjigjur për afërsisht një të katërtës së totalit të shpenzimeve për kujdesin spitalor.

Shpenzimet për kujdesin shëndetësor përfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme të totalit mujor të shpenzimeve të një familjeje dhe variojnë me nivelin e të ardhurave të familjes. Megjithëse më të varfërit paguajnë më pak në terma absolute, ata shpenzojnë në fakt një përqindje më të madhe të të ardhurave të tyre për kujdesin shëndetësor sesa të pasurit. Familjet e varfra jo vetëm që kanë më shumë gjasa të vuajnë nga shpenzimet katastrofike shëndetsore, por gjithashtu kanë më shumë gjasa të kenë teprime më të mëdha në pagesat shëndetsore mbi pragun katastrofik.

Rezultatet e analizave tregojnë se ekzistojnë tashmë tre fusha prioritare për politikë-bërësit që janë të interesuar në përmirësimin e aksesit dhe efektivitetit të kujdesit shëndetësor. Së pari, duhet të rritet mbulesa nga sigurimet shëndetësore si përsa i përket numrit të personave të mbuluar nga skema, gjithashtu edhe për nga numri i shërbimeve të afuara. Sigurimet shëndetësore jo vetëm që janë një burim i rëndësishëm financimesh për sektorin; por gjithashtu ato sigurojnë mbrojtje financiare për personat e siguruar ndaj shpenzimeve katastrofike shëndetsore. Kjo në veçanti për shtresat e varfra dhe vulnerabël

të popullsisë, të cilët rrezikojnë të bien në varfëri si rrjedhojë e një rasti të vetëm sëmundjeje, dhe që duhet të mbulohen nga sigurimet shëndetësore. Në të vërtetë, megjithëse shtresat e varfra dhe vulnerabël janë ata që kanë më shumë gjasa të mbulohen nga sigurimet shëndetësore aktualisht, mbeten ende grupe të mëdha të të varfërve dhe shtresave vulnerabël të cilët nuk janë të mbuluar. Për më tepër, sigurimet shëndetësore aktualisht mbulojnë vetëm shërbimet e mjekut të përgjithshëm ose të mjekut të familjes, duke mos siguruar mbrojtje ndaj shpenzimeve shëndetsore katastrofike. Në Tiranë, ISKSH-ja mbulon të gjithë shërbimin ambulator dhe nuk është për t'u habitur fakti se banorët e këtij rajoni shpenzojnë mesatarisht më pak për shërbimin ambulator në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë së vendit. Sigurisht që ka shumë vend për rritjen e gamës së shërbimeve të afuara.

Një fushë tjetër që kërkon vëmendje imediate janë pagesat informale, zhdukja e të cilave do të ketë efekte pozitive në aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore. Pagesat informale në shërbimin ambulator përbëjnë afërsisht 11% të totalit të shpenzimeve në dallim nga kujdesi spitalor, ku përfaqësojnë afërsisht 25% të totalit të shpenzimeve. Mesatarisht shqiptarët shpenzojnë pothuajse 700 Lek për frymë në muaj për kujdes shëndetësor, që përbën afërsisht 18% të konsumit mesatar për frymë të një familjeje të varfër. Megjithatë, ka dallime të mëdha në shumatat që familjet shpenzojnë sipas kuintileve të konsumit. Familjet që i përkasin 20% të të varfërve të shpërndarjes së konsumit shpenzojnë mesatarisht afërsisht gjysmën e asaj që shpenzojnë familjet në kuintilin më të pasur për shëndetin. Si përqindje e totalit të konsumit, familjet në kuintilin e të varfërve shpenzojnë pothuajse 10% të konsumit të tyre mujor për frymë për shëndetin. Përveçse rrisin barrën e shpenzimeve nga xhepi, sidomos për të varfërit, pagesat informale gjithashtu ndikojnë negativisht në përpjekjet për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sektorit.

Prova nga burime të pasigurta tregojnë gjithashtu se cilësia e kujdesit shëndetësor, në veçanti në shërbimin ambulator dhe sidomos jashtë Tiranës, ku një numër i madh individësh zgjedhin t'i anashkalojnë këto shërbime dhe të shkojnë direkt në spital është nën standart. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit ambulator është domosdoshmëri për zgjerimin e fushëveprimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore, në mënyrë që ato të përdoren më shumë sesa thjesht për të marrë receta për barna.

## **Aneksi i Kapitullit V**

***Tabela 5.A. 1: Sëmundjet kronike të deklaruara sipas statusit të varfërisë***

	Jo të varfër	Të varfër	Gjithsej
Sëmundjet infektive	1.9	2.4	2.0
Sëmundjet e gjakut dhe sistemit të qarkullimit dhe prodhimit të gjakut	38.8	28.7	36.8
Sëmundje të organeve të frymëmarrjes	8.9	9.9	9.1
Tumore	1.0	1.2	1.0
Sëmundje të organeve të tretjes	7.5	6.1	7.2
Sëmundje të sistemit urinar ose gjenital	5.1	8.5	5.8
Endokrina	5.1	4.7	5.0
Çrregullime psikologjike	3.6	3.5	3.6
Sëmundje të kockave dhe indeve lidhëse	13.7	15.0	14.0
Sëmundje të sistemit nervor	10.3	11.9	10.7
Sëmundje kongjenitale	1.9	4.8	2.5
Çrregullime të tjera	2.1	3.5	2.4
Total	100.0	100.0	100.0

*Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria;  
Gabimet standarte në kllapa*

***Tabela 5.A. 2: Sëmundjet e raportuara në katër javët e fundit përpara zondazhit, sipas gjëndjes së varfërisë, përqindje***

	Jo të varfër	Të varfër	Gjithsej
Të ftohtë/Grip	75.8	84.4	78.3
Dhembje stomaku	2.3	1.7	2.1
Diare	1.9	1.5	1.8
Hundë/vesh	2.5	2.0	2.3
Mëlçi	0.9	0.5	0.8
Veshka	2.7	2.2	2.5
Dhembje koke	4.6	2.2	3.9
Zemra	1.6	1.1	1.5
Mushkëritë	1.4	0.6	1.1
Lëkura	0.7	0.8	0.7
Sëmundje të transmetueshme seksualisht	0.0	0.0	0.0
Kocka të thyera	1.8	0.7	1.5
Trauma të tjera	0.6	0.1	0.4
Komplikacione shtatëzanie/lindjeje	0.1	0.2	0.2
Sëmundje të tjera	3.2	2.1	2.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

**Tabela 5.A. 3: Shfrytëzimi i kujdesit shëndetësor sipas gjinisë, zonës së banimit, nivelit të varfërisë, dhe faktit nëse personi ka ose jo librezë shëndetësore ( me përqindje)**

	Meshkuj	Femra	Tiranë	Qytet	Fshat	Jo të varfër	Të varfër	No Librezë shëndetësore	Librezë
<b>Asnjë sëmundje</b>									
Shërbim ambulator	7.2	9.8	8.4	9.6	7.9	9.4	5.9	5.6	13.0
Mjek privat	0.9	1.4	0.5	1.6	1.0	1.2	1.0	0.7	1.7
Infermiere/ndihmësmjek	1.2	1.8	0.5	1.4	1.8	1.6	1.4	1.5	1.5
Mjek popullor	0.2	0.3	0.0	0.2	0.3	0.3	0.2	0.3	0.2
Që kërkojnë kujdes	8.6	11.6	9.1	11.3	9.8	11.0	7.6	7.1	14.9
<b>Sëmundja</b>									
Shërbim ambulator	50.0	52.1	68.6	56.0	48.4	54.9	42.2	45.2	61.4
Mjek privat	5.2	5.1	12.8	7.7	3.8	6.4	1.9	4.3	6.5
Infermiere/ndihmesmjek	12.2	13.4	1.0	10.0	14.5	13.1	12.3	13.4	11.9
Mjek popullor	0.2	1.0	0.0	0.0	1.0	0.6	0.7	0.8	0.4
Që kërkojnë kujdes	56.8	58.8	74.4	63.0	55.1	61.6	48.8	52.4	67.2
<b>Gjithsej</b>									
Shërbim ambulator	12.7	16.0	10.7	15.4	14.6	15.3	11.6	11.2	19.4
Mjek privat	1.4	1.9	1.0	2.4	1.4	1.8	1.1	1.2	2.4
Infermiere/ndihmësmjek	2.6	3.5	0.5	2.4	3.9	3.1	3.1	3.2	2.9
Mjek popullor	0.2	0.4	0.0	0.2	0.4	0.3	0.3	0.4	0.2
Që kërkojnë kujdes	14.7	18.6	11.6	17.7	17.2	17.6	14.1	13.5	21.8

Burimi: LSMS e vitit 2002, Shqipëria

**Tabela 5.A. 4: Përqindja e individëve që i drejtohen kujdesit shëndetësor sipas rajoneve dhe grup-moshave**

Mosha	Bregdetare	Qendror	Malor	Tiranë	Gjithsej
0-14	69.9	63.7	33.2	80.2	59.3
15-24	59.0	46.4	20.8	32.0	44.1
25-49	66.6	51.5	40.6	71.5	54.8
50-69	77.1	62.1	43.5	68.6	64.0
>=70	73.6	61.3	41.3	93.9	63.6
Total	69.8	58.3	35.8	74.4	57.9

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria

**Tabela 5.A. 5: Konsultime shtatzanie sipas personelit që e ofron sipas rajoneve dhe nivelit të varfërisë (përqindjet)**

	Tiranë	Qytet	Fshat	Jo të varfër	Të varfër	Gjithsej
Mjek	0.84	0.79	0.59	0.69	0.60	0.67
Mami	0.14	0.21	0.41	0.30	0.40	0.33
Mami tradicionale	0.02	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	0.10	0.26	0.64	0.71	0.29	1.00

Burimi: LSMS-ja e vitit 2002, Shqipëria

## KAPITULLI VI: ARSIMI

### 1. Përmbledhje

Në fillimet e tranzicionit, Shqipëria trashëgoi një sistem arsimit që lejonte pjesëmarrje të barabartë përfundimisht për të gjithë në sistemin arsimor. Megjithatë, gjatë viteve pas rënies së regjimit komunist, i gjithë vendi në tërësi dhe sistemi arsimor në veçanti kanë kaluar shumë sfida që vërshtirësuan kontributin e sistemit arsimor në uljen e varfërisë dhe pabarazisë në vend. Me rënien e regjimit Hoxha Shqipëria kaloi një krizë të thellë e cila pati ndikim në të gjithë sektorët, edhe arsimi nuk bëri asnjë përjashtim. Megjithatë vendi që nga ajo kohë ka patur periudha të një rritje të shpejtë ekonomike, të ardhurat për frymë sot janë të njëjtat me ato të vitit 1989 dhe burimet qeveritare nuk kanë arritur ende nivelët që ekzistonin përpara tranzicionit. Kjo rënie e burimeve publike ka ndikuar direkt në burimet e alokuara për arsimin, për pjesën e tyre në PBB ranë nga 5% në 1991 në 3% sot.

Mungesa e burimeve nuk është e vetmja sfidë me të cilën përballlet sot arsimi shqipëtar; dy periudha të një shkatërrimi total të mjeteve mësimore, lëvizjet e mëdha të popullsisë brenda vendit, dhe kërkesat e reja të një ekonomie në tranzicion i kanë bërë presion këtij sistemit. Ndryshimet që pasuan regjimin komunist dhe rënia e skemave piramidale në 1997 u kombinuan me një vandalizëm të përgjithshëm të pronës që nuk kurseu as mjetet mësimore; shumë nga këto mjete u shkatërruan dhe tani nevojiten burime esenciale për ti rehabilituar ato plotësisht. Gjithashtu, heqja e kufizimeve të lëvizjes së popullsisë, u shoqërua nga migrimi i grupeve të mëdha popullore nga zonat rurale në ato urbane dhe nga Shqipëria në vende të tjera. Migrimi ka krijuar presione të fuqishme mbi shkollat urbane dhe periurbane të cilat nuk ishin gati të prisnin fluksin e madh të studentëve të rinj të ardhur nga zonat rurale. Sfidat nuk qëndron vetëm në faktin se është një numër i madh fëmijësh që duan të shkollohen, por edhe sepse ardhja e emigrantëve të rinj nga zona ku cilësia e shkollave ishte më e ulët, edhe sepse nevojat e tyre janë ndryshe nga ato të fëmijëve të qytetit. Migrimi ka krijuar sfida edhe për zonat rurale, pasi shumë nga mësuesit e kualifikuar kanë lënë me dëshirë punën për të gjetur punë me paga më të larta në qytet, një eksod që ka ulur me tej cilësinë e shkollave rurale. Së fundi, me transformimin në një ekonomi tregu, vendi po kalon një periudhë transformimesh të mëdha social-ekonomike. Ekonomia e tregut kërkon aftësi të tjera të fuqisë punëtore nga ato që duheshin në ekonominë e komanduar. Kështu që edhe sistemi

arsimor duhet të adoptohet me këto aftësi të reja, të cilat krijojnë nga ana tjetër një sfidë të vështirë për tu përballuar me qëllim që të ndihmohet procesi i zhvillimit të vendit, dhe të ndihmojë në punësimin e popullsisë për ta nxjerrë atë nga varfëria. Pikërisht në këtë ambient të vështirë sistemit arsimor në Shqipëri i duhet të sigurojë frekuentim të barabartë të shërbimeve arsimore, sidomos për arsimin bazë dhe atë të mesëm, dhe të kontribuojë në thyerjen e rrethit vicioz të varfërisë dhe mungesës së arsimimit.

## **2. Arritjet në Arsim**

### Analfabetizmi

Një nga arritjet madhore të sistemit arsimor në Shqipëri gjatë epokës komuniste ishte zhdukja pothuaj e plotë e analfabetizmit. Të dhënat nga LSMS e vitit 2002 tregojnë se sot me shumë se 90% e popullsisë mbi moshën 14 vjeç mund të shkruajnë e të lexojnë pa ndonjë vështirësi. Pjesa me e madhe e të rriturve që nuk mund të shkruajnë e lexojnë (rreth 5% e tyre), ose mund por me vështirësi, i përkasin brezat të vjetër. Ndërsa vetëm 1% e të rriturve nën moshën 50 vjeç janë plotësisht analfabet, rreth 15% e atyre mbi moshën 50 vjeç janë analfabet. Në radhët e rinisë shqipëtare, 98% mund të lexojnë dhe shkruajnë pa ndonjë vështirësi,<sup>55</sup> krahasuar me 95% të dhjet vjetëve me parë.<sup>56</sup>

Përqindja e analfabetizmit varion sipas të ardhurave, gjinisë dhe vendit të banimit. Numri i tyre është dy herë me i madh tek të varfërit në krahasim me jo të varfrit, dhe gjithashtu dy herë me i madh tek gratë sesa tek burrat. Gjithashtu, ndërsa 4% e popullsisë që jeton në zonat urbane janë analfabet, vetëm 6% e atyre që jetojnë në zonat rurale janë analfabet. Është e rëndësishme të thuhet se ndryshimet gjinore janë zhdukur në brezat më të rinj, si rezultat i përpjekjeve të sistemit arsimor për eliminimin e hendekut gjinor në marrjen e arsimit.

### Vitet e shkollimit

Mesatarisht, shqiptarët 21 vjeç e sipër kanë arsim tetëvjeçar. (Tabela 6.1). Kjo mesatare mbart ndryshime tek të ardhurat dhe vendet e banimit. Të rriturit që jetojnë në një familje të varfër kanë mesatarisht dy vjet shkollë me pak sesa ata që jetojnë në familje me gjendje me të mirë. Gjithashtu edhe të

<sup>55</sup> Në qoftë se përfshijmë tek të shkolluarit edhe ata që shkruajnë dhe lexojnë me vështirësi atëhere kjo shifër rritet në 99%.

<sup>56</sup> Treguesit Botëror të Zhvillimit, Banka Botërore.


rriturit që jetojnë në Tiranë kanë rreth 3.5 vjet shkollë me shumë sesa ata që jetojnë në zona rurale. Vitet mesatare të shkollimit tek të rriturit janë relativisht të ulëta të krahasuara këto me vendet e tjera të rajonit. Për shembull, vitet mesatare të shkollimit tek rinia për të njëjtën moshë bashkëkohësish është një vit me pak në Shqipëri sesa në Bosnie Hercegovinë.<sup>57</sup>

**Tabela 6. 1: Diploma me e lartë e marrë për gjithë rajonin**

Diploma me e lartë e marrë (% , 21 vjeç e sipër)	Tiranë	Qytete të tjera	Fshat	Totali
Pa shkollim	0.6	1.0	0.9	0.9
Fillore (4 vjet)	7.1	10.8	19.9	15.3
Tetëvjeçare (8 vjet)	25.2	34.0	55.3	44.4
E mesme e përgjithshme	21.4	22.3	10.3	15.6
Profesionale (2 vjet)	3.1	3.8	1.2	2.3
Profesionale (4 vjet)	19.2	18.0	10.0	13.8
Universitet e me lartë	23.4	10.2	2.5	7.7
Mesatarja e viteve shkollore sipas vendndodhjes				
Nr. i viteve shkollore	10.9	9.5	7.4	8.5

Burimi: LSMS Shqipëtare e vitit 2002.

Siç duket në figurën 6.1, ka ndryshime të mëdha në numrin total të viteve të



shkollimit të kryera në varësi të të ardhurave dhe vendbanimit. Megjithëse përqindja e popullsisë të këtij brezi që ka mbaruar arsimin bazë është e lartë, ka një rënie të madhe të numrit të studentëve që vazhdojnë shkollimin pas mbarimit të arsimit bazë. Në rastin e Shqipërisë, arsimi bazë përfundon në vitin e 8të, gjë që shpjegon edhe rënien drastike të

<sup>57</sup> Ndër të rriturit e moshës 15-35 vjeç vitet mestarte të shkollimit në shqiptarët është 9.5 vjet, ndërsa për BH është rreth 10.6 (Banka Botërore, 2003).

shkollimit pas këtij viti si në figurë. Ajo çka është e ndryshme në Shqipëri, krahasuar me vende të tjera të rajonit<sup>58</sup>, është përqindja e vogël e të rinjve që ndjekin aktualisht arsimin e mesëm, si edhe ndryshimet e mëdha në të ardhurat e banuesve rural me ata urban në numrin e viteve të arsimit të përfunduar.

Në Shqipëri ndryshimet në të ardhurat fillojnë në nivelet shumë të ulëta të shkollimit dhe rriten me rritjen e numrit të viteve të shkollimit. Të varfërit përfundojnë me pak vite shkollim, në çdo nivel arsimit, dhe këto ndryshime janë të vogla në arsimin tetëvjeçar por rriten dukshëm pas këtij arsimit.

Ka ndryshime të mëdha edhe ndërmjet zonave rurale dhe atyre urbane, dhe ndërsa këto ndryshime janë të vogla në arsimin bazë, ato rriten në nivelete me të larta të arsimit të mesëm. Nga ata që mbarojnë arsimin tetë vjeçar, numri që vazhdojnë arsimin e mesëm është më i madh në banorët qytetarë, si të varfër dhe jo të varfër, sesa në banorët e zonave rurale. Për shembull, ndërsa rreth 72% e qytetarëve jo të varfër fillojnë arsimin e mesëm, vetëm 37% e qytetarëve të varfër dhe me pak se 20% e banorëve në zonat rurale fillojnë arsimin e mesëm. Kjo nuk është e rastësishme pasi numri i shkollave të mesme në zonat rurale është ulur me kalimin e kohës, që tregon një problem kërkese në këto zona.

#### Përqindjet e regjistrimit

Ka ndryshime të mëdha në përqindjet e regjistrimit në të gjitha nivelet e arsimit, në gjithë rajonet dhe në të gjitha nivelet e të ardhurave. Përqindja e regjistrimit tek të varfërit, dhe sidomos të shumë të varfërit, është shumë me e ulët se ajo e jo të varfërve, po kështu, përqindja e regjistrimit në zonat rurale është me e vogël sesa në zonat urbane. Këto ndryshime në ritmet e regjistrimit mund në të ardhmen të ruajnë dhe të thellojnë akoma me shumë pabarazinë e të ardhurave, pasi familjet e varfëra do të drejtohen nga individë me nivel të ulët arsimit. Nuk ka me ndryshime gjinie në regjistrime, me përjashtim të nivelit universitar ku ritmi i regjistrimit për femra është disi me i lartë sesa ai për meshkuj.

Nuk ka probleme madhore të mungesave në radhët e të regjistruarve për çdo nivel të arsimit. Përqindja e studentëve të regjistruar që nuk kanë frekuentuar mësimet për me shumë se një muaj është me pak se 2%. Megjithatë, të dhënat sugjerojnë se në zonat periurbane fëmijët ose

---

<sup>58</sup> Shih shembullin e rastit të Kosovës (Banka Botërore, 2001) dhe Bosnja Hercegovina (Banka Botërore, 2003)



mungojnë në orët e mësimit ose frekuentojnë pak orë (ndonjëherë edhe me pak se 4 orë) mësim në ditë. Për fat të keq LSMS nuk përfaqësohet në këtë nivel, dhe nuk mund të përdoret për të nxjerrë statistika të besueshme për zonat periurbane.

**Tabela 6. 2: Përqindjet neto të regjistrimit për të gjitha gjinitë, rajonet, dhe nivelet e të ardhurave**

	Meshkuj	Femra	Tiranë	Qytete të tjera	Të gjitha qytetet	Fshat	Jo të varfër	Të varfër	Shumë të varfër	Totali
Para-shkollor (3-5 vjeç)	30.7%	32.3%	20.2%	50.8%	43.4%	25.1%	38.4%	18.2%	10.0%	31.5%
Tetëvjeçar (6-13)	93.5%	93.0%	92.2%	93.2%	92.9%	93.5%	94.1%	91.6%	88.6%	93.3%
Mesëm (14-17)	38.8%	38.7%	70.8%	59.5%	62.2%	24.9%	46.7%	19.4%	19.8%	38.7%
I lartë (18-22)	7.6%	9.6%	22.7%	16.6%	18.3%	2.6%	11.2%	0.4%	0.0%	8.7%

*Burimi: LSMS Shqipëtare 2002; Të dhënat parashkollore raportojnë me shumë frekuentim net sesa regjistrim net. Gjithashtu, për të përlogaritur këto rezultate vëzhgimet e pa-raportuara (27%) nuk janë përfshirë. Terciar përfshin studentë në universitet dhe studime pas universitare.*

*Para shkollor:* Regjistrimet në arsimin para shkollor kanë rënë gjatë periudhës së tranzicionit. Ndërsa në 1990 me shumë se një në dy fëmijë të moshës 3 deri 5 vjeç regjistroheshin në arsimin para shkollor (iNSTAT, 2001),<sup>59</sup> sot është i regjistruar me pak se një në tre fëmijë. Duke i parë këto shifra nga një tjetër këndvështrim, ndër gjithë vendet e Ballkanit vetëm Bosnja dhe Hecegovina ka një përqindje të ulët të regjistrimit në këtë nivel.<sup>60</sup> Por nuk është ulur drastikisht vetëm numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor, por ka gjithashtu diferenca të mëdha në regjistrime për të gjitha rajonet dhe nivelet e të ardhurave. Përqindja neto e fëmijëve të regjistruar nga familjet e varfëra është afërsisht sa gjysma e asaj të fëmijëve të familjeve me gjendje me të mirë. Kjo është për tu shqetësuar pasi programet parashkollore ndihmojnë në zbutjen e disavantazheve që mund të kenë fëmijët e shtresave të ulëta social ekonomike kur hyjnë në arsimin tetëvjeçar. Në rastin e Shqipërise, përderisa fëmijët që jetojnë në familje jo

<sup>59</sup> Të dhënat e 1990 bazohen në përqindje gros të regjistrimeve.

<sup>60</sup> Të dhënat nga vendet e tjera të Ballkanit vijnë nga databaza e UNiCEF TransMONEE për vitin 1999.

të varfëra janë ata që përfitojnë nga këto programe, çdo ndryshim fillestar në favor të tyre do të thellohet deri sa të gjithë fëmijët të hyjnë në arsimin e detyrueshëm. Fatmirësisht, mosha e fillimit të arsimit bazë të detyrueshëm është e ulët (6 vjeç), dhe kjo mund të balancojë rënien e numrit të regjistrimeve në arsimin tetëvjeçar.

**Kutia 6.1: Hyrja në shkollë në zonat periurbane të Tiranës dhe Durrësit**

*Vajza jonë e madhe është aktualisht në klasën e tretë. Ajo shkon në këmbë në shkollën fqinjë se bashku me dy fëmijë të tjerë, shkolla është një orë larg. Orari i mësimit është nga 12 e drekës deri në 4 :30 i mbasdites. Gjatë dimrit (sezoni të shirave) ajo mungon në shkollë gati dy javë në muaj për shkak të baltës dhe përmytjeve. Mbi të gjitha nuk jemi të kënaqur me cilësinë e mësimit që vajza jonë merr. Në (Drita) i japim ndihmë në shtëpi, në mëngjes, por nuk mjafton. Fëmijët e tjerë janë akoma të vegjël për të shkuar në shkollë.*

- Familja e Ramizit dhe Dritës në Durrës, zona moçalore

*Në nuk jemi të regjistruar në zonën periurbane të Tiranës, ndaj është e vështirë për të regjistruar fëmijët. Djali ynë i madh, Peshopia, 9, aktualisht nuk është i regjistruar në shkollë, pik së pari për shkak të problemit të regjistrimit të banesës, megjithatë ne po përpiqemi ta zgjidhim këtë problem dhe shpresojmë që djali të regjistrohet në simestrin tjetër që fillon pas pushimeve. Për momentin, asnjë fëmijë i familjes nuk është i regjistruar në shkollë.*

- Familja në Bregun e Lumit në Babru, zona periurbane e Tiranës.

*Arsimi është gjëja me e rëndësishme (për fëmijët) por asnjë nga fëmijët e mijë nuk është i regjistruar në shkollë. Doja të regjistroja djalin e madh (7)por nuk mund të përballoja shpenzimin e 7,000 Lekëve për libra dhe regjistrim. Kjo pagesë regjistrimi bëhet pasi familja ime nuk është nga kjo zonë.*

- Familja e Kujtimit në Bathore, zona periurbane e Tiranës

*Djali im 16 vjeçar përfundoi shkollën tetëvjeçare dy vjet me parë, por rezultatet e tijë ishin të ulta, kështu që ai e kishte të pamundur të ndiqte shkollën e mesme lokale. Kur familja ime jetonte në Kukës, djali me i madh ishte nxënës i mirë, por kur u transferua në shkollën e Bathores notat e tij ranë. Djali i dytë (14) është në klasën e tetë dhe merr mësim nga ora 8:00 e mëngjesit deri në 11:00. Ata bëjnë 4 orë mësim nga 30 minuta. Djali me i vogël (10) është në klasën e tretë dhe bën mësim nga ora 1:30 e drekës deri në 5:00 mbasdite.*

- Familja e Besnikut në Bathore 2, zona periurbane e Tiranës.

*Burimi: intervista marrë familjeve në zonat periferike të Tiranës dhe Durrësit (Bezhani dhe Tracy, 2003)*

*Këto intervista nuk pretendohen të përfaqësojnë të gjithë vendin apo zonat*

*ku ato u kryen, por janë tregues të problemeve që hasen nga disa banorë të tyre.*

*Arsimi bazë:* Arsimi bazë i detyrueshëm në Shqipëri përfshin katër vjet të fillores dhe katër vjet të tetëvjeçares. Ritmet e regjistrimit në këtë nivel janë gati njësoj si për vajzat ashtu edhe për djemtë. Përqindja gros e regjistrimit në nivelin bazë të shkollës është gati 100% ndërsa përqindja neto e regjistrimit është rreth 94%. Megjithëse përqindjet e regjistrimit në nivelin bazë të arsimit janë të larta, ato fshehin disa ndryshime në të ardhurat të cilat ndikojnë kryesisht të varfërit. Për shembull, përqindja e regjistrimit të fëmijëve që jetojnë në familje që nuk përballojnë dot as nevojat për ushqim është 5 pikë më pak se ajo e fëmijëve që jetojnë në familje jo të varfëra. Duhet theksuar se të varfërit e mesëm kanë të njëjtat përqindje regjistrimi sa familjet jo të varfra, duke na sygjyeruar kështu që politikat duhet të pikësynojnë tek me të varfërit e të varfërve për të siguruar kështu që të gjithë shqiptarët të marrin arsimin bazë.

Një tregues tjetër i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, që është arritja e pjesmarrjes së plotë në arsimin tetëvjeçar deri në 2015, është pikërisht përqindja e atyre që përfundojnë arsimin tetëvjeçar. Në rast se fëmijët e fillojnë shkollën në moshën 6 vjeç, ata duhet të përfundojnë arsimin e tyre tetëvjeçar kur të arrijnë moshën 14 vjeç. Megjithatë, të dhënat nga LSMS e Shqipërisë 2002 tregojnë se mesatarisht vetëm 62% e fëmijëve të kësaj moshe kanë përfunduar arsimin bazë tetëvjeçar. Kjo mund të jetë rezultat i një regjistrimi të vonë, pasi shumë fëmijë të moshës 14 dhe 15 vjeç janë akoma të regjistruar në arsimin tetëvjeçar. Përqindja e fëmijëve 16 vjeçar që kanë përfunduar arsimin bazë tetëvjeçar, për shembull, është rreth 95%.

**Tabela 6. 3: Përqindjet gros të regjistrimit në shkollat e mesme**

	Shqipëria		Kroacia	Maqedonia
	1990	2002	1999	1999
Totali	79	38.7		
Akademik		33.1	19.9	22.2
Profesionale		5.6	58.2	43.2

*Burimi: INSTAT dhe LSMS 2002 për Shqipërinë; Databazë e TransMONEE të UNICEF për Kroacinë dhe Maqedoninë*

*Arsimi i mesëm:* Regjistrimi në shkollat e mesme është i ulët, dhe si në rastin e arsimit parashkollor, ka një rënie të madhe të regjistrimit gjatë viteve të tranzicionit. Për shembull, përqindja e regjistrimit për shkollat e mesme sot është sa gjysma e përqindjes së 1990, dhe është gjithashtu më e ulët se përqindjet e vendeve të tjera të rajonit. Pjesa

me e madhe e regjistrimeve të këtij niveli është në programet akademike me një përqindje regjistrimi prej rreth 33%; nga ana tjetër, shkollat e mesme profesionale dhe teknike kanë një përqindje regjistrimi vetëm prej 6%. Siç shihet edhe në tabelën 6.3, gjendja është shumë ndryshe në vendet e tjera të rajonit, ku shumica e regjistrimeve është në programet e mesme profesionale.

#### **Kutia 6.2: Faktorët e regjistrimeve në shkollat e mesme**

Një analizë e plotë u krye për të studiuar faktorët që kushtezojnë regjistrimet në shkollat e mesme si në zonat rurale ashtu edhe në zonat urbane të Shqipërisë. Të dhënat e perdorura janë marre nga shembuj të fëmijëve (14-18 vjeç) që kanë përfunduar shkollën tetëvjeçare. Rezultatet tregojnë se në zonat urbane të vetmet ndryshime që shpjegojnë dukshëm arsyet e regjistrimit, për të gjitha modelet e vlerësuara, janë arsimimi i kreut të familjes, arsimimi i bashkëshortes/it (ndryshime që janë përdorur si bazë për arsimin e prindërve) dhe moshja e fëmijës. Çmimet e fletoreve dhe të lapsave me ngjyra kanë një ndikim tepër negativ në regjistrim. Në zonat rurale, faktorët kryesorë të regjistrimit në shkollat e mesme rezultuan të ishin: (i) presenca e një shkollë të mesme në komunitet, (ii) arsimi i bashkëshortes së kryefamiljarit, (iii) konsumi për çdo familje, dhe (iv) pronësia mbi bagëtinë (efekti i pasurisë). Faktorët që kishin një ndikim negativ në regjistrim në zonat rurale ishin: (i) pronësia e kuajve, dhe në disa modele dhe pronësia e deleve, dhe (ii) prezenca në familje e fëmijëve të tjerë në moshën për të ndjekur shkollën e mesme. Mesatarisht familje me pronësi mbi gjedhët kanë vetëm një kre, ndërsa familje që kanë dele kanë rreth 14 krerë, gjë që kërkon me shumë punë sesa në rastin e parë. Pronësia e deleve dhe kuajve kërkon kështu me shumë mundësi punësimi të fëmijëve brenda në familje, dhe pronësia e tyre rrit koston oportune të çuarjes së fëmijëve në shkollë.

Përqindja e regjistrimit në shkollat e mesme nuk është vetëm e ulët, por ajo gjithashtu varion shumë sipas të ardhurave dhe rajonit ku banojnë. Për shembull, regjistrimi net në arsimin e mesëm të fëmijëve të varfër është me i vogël se gjysma e atij të fëmijëve jo të varfër. Për rajone të ndryshme pabarazia në regjistrim në shkollat e mesme janë me të dukshme. Ndërsa rreth 70% e fëmijëve të grup moshës përkatëse në Tiranë rezultojnë të regjistruar, dhe afër 60% në zonat e tjera urbane, vetëm çereku i grup moshës perkatëse të zonave rurale rezultojnë regjistruar në shkollat e mesme. Kjo pjesërisht për shkak të furnizimit të paktë me paisje mësimore në zonat rurale.

*Arsimi Terciar:* Regjistrimi në universitetet e Shqipërisë është shumë i ulët. Me një përqindje gros regjistrimi prej rreth 11% dhe një përqindje neto rreth 9% Shqipëria ka pjesëmarrjen me të ulët në universitet në të gjithë Europën. Në radhën e ekonomive në tranzicion në Evropë dhe Azinë Qendrore vetëm Turkmenistani dhe Uzbekistani kanë përqindje regjistrimi me të ulët (UNICEF, TransMONEE). Në këtë nivel ka gjithashtu edhe ndryshime të mëdha për sa i perket të ardhurave, rajoneve dhe gjinisë. Vetëm në nivelin universitar regjistrimi i vajzave dhe djemve ndryshon, duke pasur me shumë vajza sesa djem. Pothuajse të gjitha regjistrimet përqëndrohen në studentët jo të varfër që jetojnë në zonat urbane, sidomos në Tiranë.

### *Ndryshimet në breza*

Periudha e tranzicionit solli shumë sfida social-ekonomike që ndikuan edhe sistemin arsimor. Fëmijët që shkolin në shkollë gjatë tranzicionit panë si fillim se të ardhurat e familjeve të tyre u rënduan dhe më pas vuajtën edhe uljen e burimeve të qeverisë në dispozicion të arsimit. Siç tregohet në tabelën 6.4, brezat më të rinj, të moshës së arsimit të detyruar gjatë tranzicionit, kanë një përqindje më të vogël në përfundimin e shkollës sesa brezat që përfunduan arsimin tetëvjeçar gjatë regjimit komunist<sup>61</sup>. Në radhët e brezave më të rinj, fëmijë ndërmjet 15-19 vjeç, ka fëmijë që janë akoma të regjistruar në shkollë, por edhe pse këta individë konsiderohen si të kenë përfunduar shkollën bazë tetëvjeçare, numri i njerëzve që përfundojnë klasën e 8 në këtë brez bashkëkohor do jetë përsëri më i ulët se ai i brezave të moshës 25-29 vjeçare. Në fillim të tranzicionit, individë që janë tani 25 vjeç ose me shumë ishin 14 vjeç ose me shumë dhe si të tillë e kishin përfunduar ose ishin duke e përfunduar shkollën tetëvjeçare. Breza më të rinj shkuan në shkollën tetëvjeçare pas rrëzimit të regjimit komunist dhe përjetuan krizën dhe ndryshimet e thella të viteve 90

**Tabela 6. 4: Raporti i atyre që kanë mbaruar arsimin bazë tetëvjeçar dhe vazhdojnë arsimin e mesëm**

Brez moshat	Tetëvjeçare të përfunduar	Të regjistruar në të mesme
15-19	0.925 (0.011)	0.484 (0.023)
20-24	0.952 (0.010)	0.393 (0.022)
25-29	0.990 (0.004)	0.512 (0.027)
30-34	0.977 (0.006)	0.525 (0.022)
35-39	0.986 (0.004)	0.491 (0.022)
40-45	0.943 (0.008)	0.534 (0.022)

*Burimi: LSMS 2002 për Shqipërinë gabimet standart në kllapa.*

Ka ndryshime të mëdha edhe në brezat për sa i përket propocionit të studentëve që vazhdojnë shkollën e mesme pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm tetëvjeçar. Ka një rënie të madhe (gati 80%) në raport me ata që vazhdojnë arsimin e mesëm në brezat e moshës 20-24 vjeç. Megjithatë, në brezat më të rinj raporti rritet përsëri. Çuditërisht, ata 20 dhe 24 vjeçare sot, kanë qënë rreth moshës 15 e 21 vjeç, gati në moshën e shkollës së mesme, në vitin 1997, viti i ndryshimeve të mëdha që pasojë me rënie e skemave piramidale, kur shumë shkolla u vandalizuan. Megjithatë nuk ka asnjë ndryshim statistikor në raportet e atyre që vazhdojnë shkollën e mesme ndërmjet brezave më të rinj dhe atyre të moshës 25 dhe 45 vjeç.

<sup>61</sup> Ka patur zhvendosje të mëdha të popullsisë në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit. Brezi më i ri është gjithashtu ai që ka migruar me shumë. Ka mundësi që keto ndryshime në përfundimin e shkollës mund të rrjehin nga migrimi selektiv ku anetarët me të arsimuar të këtij brezi lënë vendin. Kjo do të zvogelojë proporcionin midis njerëzve që përfundojnë arsimin tetëvjeçar dhe atyre që qëndrojnë.



### 3. Arsyet e regjistrimeve të ulëta

Arsyeja kryesore për një regjistrim të ulët në nivelin para shkollor duket sikur është mungesa e kopshteve. Numri total i programeve para shkollore ka rënë në mënyrë të konsiderueshme gjatë 10 vjeteve të fundit, nga 3,426 në 1990 deri në 2,111 në 1999 (iNSTAT 2002). Shumë nga programet para shkollore ishin të lidhura me industrinë ku punonin prindërit, dhe kur u mbyllën këto industri në fillim të tranzicionit, u mbyllën edhe kopshtet. Një arsye tjetër që citohet shumë nga prindërit në Tiranë është se preferohet që fëmijët të mbahen në shtëpi.<sup>62</sup>

**Tabela 6. 5: Arsyet e mos frekuentuar kopshtet për rajone, propocioni i moshave 3-5 vjeç**

	Tiranë	Qytet	Fshat	Totali
Asnjë	0.07	0.16	0.54	0.42
Shumë të vegjël	0.05	0.11	0.06	0.07
Shumë e shtrenjtë	0.12	0.16	0.00	0.05
Shumë larg	0.00	0.00	0.13	0.09
Jo cilësi e mirë	0.00	0.01	0.04	0.03
Preferojnë të rrinë në shtëpi	0.65	0.49	0.20	0.30
Nuk e shohin te nevojshme	0.10	0.04	0.01	0.02
Të tjera	0.02	0.02	0.01	0.02
Totali	1.00	1.00	1.00	1.00

*Burimi: LSMS 2002 për Shqiprinë*

Në rastin e arsimit të mesëm, arsyet kryesore për mungesën e regjistrimit janë të lidhura me mungesën e kërkesës. Një nga çdo dy të rinj të pa regjistruar nuk ka interes të ndjekë shkollën, kryesisht sepse ata e konsiderojnë të përfunduar arsimimin e tyre me përfundimin e arsimit bazë tetëvjeçar<sup>63</sup>. Një arsye tjetër për mos frekuentimin e arsimit të mesëm është dhe nevoja për të punuar, duke u dhënë kështu një kosto oportune me të lartë frekuentimit të shkollës së mesme. Në zonat rurale rreth 13% e fëmijëve që nuk ndjekin shkollën janë të angazhuar në punë bujqësore. Nga ana e të intervistuarve distanca e shkollës është përmendur si arsye për të mos ndjekur shkollën, sidomos në zonat rurale. Kjo nuk është e papritur përderisa numri i shkollave të mesme ka rënë prej më shumë se 50% gjatë dekadës së fundit. Pjesa me e madhe e kësaj rënie ndodhi në shkollat e mesme profesionale dhe teknike, të cilat ranë nga 575 profesionale dhe 177 shkolla të përziera në 1990 në vetëm 51 dhe 9 respektivisht në vitin 2001. Në kontrast me këtë, numri i shkollave akademike u ngrit gjatë dekadës së fundit dhe sot ekzistojnë 251 shkolla me shumë se në 1990 (iNSTAT 2002). Rënia në numrin e shkollave ka ndikuar me shumë në zonat rurale, ku një dekatë më parë kanë ekzistuar 550 shkolla profesionale dhe të përziera ndërsa tani ka vetëm katër.<sup>64</sup>

<sup>62</sup> Përse ky rast nuk është e qartë. Arsyet mund të jetë papunësia e madhe i ka mbajtur gratë në shtëpi; mund të jetë edhe një reflektim i cilësisë së ulët që ekziston në programe.

<sup>63</sup> Me shumë se 90% e atyre që thonë se nuk janë regjistruar sepse e kanë përfunduar në mendjen e tyre arsimin me marrjen e diplomës së arsimit tetëvjeçar.

<sup>64</sup> iNSTAT, siç është thënë nga Berryman, 2000.



**Tabela 6. 6: Arsyet për mos regjistrimin në radhët e 14-17 vjeçarëve (raportet)**

	Tiranë	Qytet	Fshat	Jo të varfër	Të varfër	Totali
Shumë i shtrenjtë	0.03	0.04	0.05	0.05	0.05	0.05
Pa interes	0.15	0.49	0.29	0.30	0.35	0.32
Punë bujqësore	0.00	0.00	0.14	0.11	0.11	0.11
Punë të tjera	0.08	0.06	0.05	0.07	0.03	0.05
Largësia e shkollës	0.00	0.00	0.16	0.11	0.17	0.13
Cilësia e ulët	0.00	0.00	0.01	0.01	0.00	0.00
Siguria	0.04	0.03	0.02	0.03	0.01	0.02
Shkollë e përfunduar	0.62	0.26	0.24	0.29	0.20	0.26
Të tjera	0.08	0.12	0.05	0.04	0.08	0.06
Totali	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00

Burimi: LSMS 2002 për Shqipërinë

#### 4. Shpenzimet në Arsim

##### *Shpenzimet Publike*

Me kthesën në ekonomi që ndoqi rënien e regjimit komunist, burimet qeveritare ranë në mënyrë të konsiderueshme. Sot, pas shumë viteve pas rënies dhe pas shumë vitesh zhvillim në vënd, shpenzimet qeveritare (si përqindje e PBB totale) është akoma sa gjysma e asaj që ka pas qënë. Megjithëse rënia në shpenzimet qeveritare tregon pjesërisht një ekonomi tregu në tranzicion, ajo gjithashtu tregon edhe rënie në aftësitë e qeverisë mbi mbledhjen e burimeve.

**Tabela 6. 7: Shpenzimet publike në arsim si përqindje e PBB dhe shpenzimeve publike totale**

	1991	2000	2001	2002
Totali i shpenzimeve publike/PBB	62.2	25.9	27.5	27.9
Shpenzimet në Arsim si % e PBB	5	3.2	3.3	3.4
Arsimi si % e shpenzimeve totale publike	8.1	12.3	12	12.1

Burimi: Ministria e Financës Shqipëtare

Ulja në burimet qeveritare ka ndikuar negativisht shpenzimet qeveritare në arsim, të cilat ranë nga 5% e PBB në 1991 në 3% sot. Shpenzimet publike në arsim në Shqipëri nuk janë vetëm të ulta në krahasim me një dekadë me parë, por janë të ulëta në krahasim edhe me shumë vende të tjera të rajonit (Republika Sllovaqe, 4.3% e PBB në 1999, Republika Çeke, 4.6%, Polonia 4.1%, Hungaria 4.1%, OECD 5.3%; UNICEF, OECD).

##### *Shpenzimet Private*

Ulja në shpenzimet publike për arsimin është kompensuar me rritjen e shpenzimeve private, të cilat mesatarisht përfaqësojnë rreth 1.4% të shpenzimeve totale mujore për frymë në familje (gati 2.5% për familje me studentë). Familjet që i përkasin kuintilit të lartë të ardhurash paguajnë një mesatare prej 2.5 herë me shumë sesa ato që i përkasin kuintilit të varfër. Megjithatë, si përqindje e shpenzimeve totale mujore, familjet me të

varfra paguajnë të njëjtën përqindje ose edhe me të madhe (ndryshimi, megjithatë, nuk është i statistikisht i dukshëm) nga shpenzimet totale të familjes së tyre.

Shpenzimet e larta në familje gjate viteve të arsimit bazë nuk tregojnë kosto më të larta në këtë nivel, por janë tregues i regjistrimeve të ulëta në arsimin pas atij bazë. Për shembull, të gjitha familjet, pavarësisht nëse kanë apo jo fëmijë të moshës shkollore, shpenzojnë mesatarisht gati 300 lek në muaj. Gjithshtu, për vitet e arsimit bazë shpenzimet e njëjta të familjeve për të gjitha kuintilet janë rezultat i një pjese të vogël që zënë fëmijë të moshës shkollore në këto familje dhe shpenzime më të mëdha për familje me të ardhura më të mëdha. Megjithatë, kur merren në konsideratë vetëm familjet me fëmijë të moshës shkollore, familjet e kuintilit të lartë të të ardhurave shpenzojnë mesatarisht dy herë më shumë sesa shumica që paguajnë familjet e varfëra për arsimin. Ndër familjet me studentë, shpenzimet në arsim mund të zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të tyre totale, duke përfaqësuar 2.2% të shpenzimeve totale mujore për familjet më të pasura dhe 3.5% për familjet më të varfëra.

**Tabela 6. 8:** Totali i shpenzimeve familjare në arsim për të gjitha nivelet dhe kuintilet e konsumit

	Pesëshoret e Konsumit					Totali
	1	2	3	4	5	
Arsimi bazë	270.0	262.9	265.3	225.5	272.8	258.9
i mesëm i përgjithshëm	35.7	70.2	109.0	137.9	239.2	133.9
i mesëm profesional	18.4	11.3	36.3	27.6	140.4	56.2
Arsimi I lartë	5.7	21.9	55.6	132.1	179.6	93.6
Totali	329.9	366.3	466.3	523.1	832.1	542.6
Pjesa nga konsumi	1.6%	1.3%	1.4%	1.3%	1.4%	1.4%
Familjet me studentë						
Pjesa nga konsumi	2.2%	2.0%	2.1%	2.5%	3.5%	2.5%
Familjet me fëmijë në moshën e shkollës						
Arsimi bazë	387.0	465.6	486.5	564.3	1002.5	555.0

Burimi: LSMS 2002 për Shqiprinë

Shpenzimet për arsimin e mesëm dhe universitar janë në përgjithësi me të larta sesa shpenzimet për nivelin bazë. Të dhënat nga LSMS për Shqiprinë tregojnë se shpenzimet totale mujore për person për arsimin e mesëm janë mesatarisht rreth 3.3 herë me të mëdha se shpenzimet individuale për arsimin bazë. Gjithashtu, shpenzimet totale mujore për studentë në arsimin e mesëm janë rreth 7.5 herë me të mëdha sesa shpenzimet për studentë për vitet e arsimit bazë. Në të dyja rastet e arsimit të mesëm dhe terciar ka gjithashtu ndryshime të mëdha në të ardhurat për shkak të shumave totale të shpenzuara. Për shembull, si për shkollën e mesme dhe asaj të lartë studentët që i përkasin familjeve të kuintilit të lartë të ardhurash paguajnë mesatarisht katër herë me shumë sesa ata që i përkasin familjeve të varfëra.

**Tabela 6. 9:** Shpenzimet totale personale në arsim sipas nivelit të shkollimit dhe të ardhurave

	Pesëshoret e shpenzimeve
--	--------------------------

	1	2	3	4	5	Total
Arsimi bazë	220.8	316.1	331.3	382.7	777.4	371.4
i mesëm	580.1	492.2	815.2	935.9	2422.8	1207.4
Arsimi I lartë	1162.1	1248.2	1446.3	2550.5	4270.1	2761.6
Totali	237.0	325.8	416.8	595.1	1365.0	561.5

Burimi: LSMS 2002 për Shqiprinë

Efektet mbi shpenzimet e ulëta publike në arsim bien në sy edhe duke vërejtur përqindjen e studentëve që kanë raportuar se kanë bërë pagesa me para në dorë ose me dhurata në shkollë dhe mësuesve gjatë vitit të fundit akademik. Si në arsimin bazë ashtu edhe në atë të mesëm, me shumë se 40% e studentëve raportojnë se kanë bërë pagesa të tilla shkollave dhe mësuesve. Numri i studentëve që bëjnë pagesa mësuesve është me i madh në radhët e familjeve të kuintilit të pasur se sa në ato të atij të varfër. Evidenca të qarta nga zonat periurbane të Tiranës dhe Durrësit tregojnë se shumë familje kontribuojnë me materiale ndërtimi dhe naftë në riparimin dhe mirëmbajtjen e shkollave.

### Kutia 6.3: Pagesa jo formale në arsim

Djali im i dytë (14) është në klasën e 8te ... djali me i vogël (10) është në klasën e 3të... Duhet të paguaj për librat, riparime dhe një kontribut për pagesën e rojes së shkollës.


- Familja e Besnikut në Bathore 2, zona në periferi të Tiranës

Një nga arsyet që u largova nga Peshkopia dhe erdha në Tiranë ishte një arsim me i mirë për djemt e mi. Djali jonë 12 vjeçar ndjek mësimet nga ora 7 i mëngesit deri me 2 pasdite, dhe arsimohet edhe në anglisht. Unë paguaj 300 Lek në muaj për librat dhe kontributin për pagesën e rojes së shkollës. Megjithatë unë e hoqa nga shkolla vajzën 16 vjeçare kur ajo ishte në vitin e dytë. Arsyeja? Nuk donim që vajza të ndiqte shkollën.

- Familja e isufit në Bathore 1, Zona në periferi të Tiranës.

intervista të bëra me familje që jetojnë në zonat periferike të Tiranës dhe Durrësit (Bezhanj dhe Tracy, 2003). Këto intervista nuk mund të merren si përfaqësime të të gjithë vendit apo të zonave ku ato u ndoqën, por janë tregues të problemeve me të cilat përballen disa nga banorët e këtyre zonave.

Shpezimet e ulta publike në arsim nuk reflektohen vetëm në raportet e mëdha të kontributit të familjeve ndaj shkollave dhe mësuesve, por edhe në raportet e studentëve



që marrin mësimet private si pasojë e rënies së cilësisë së mësimdhënies në shkolla me kalimin e viteve. Proporcionalisht, numri i studentëve që marrin mesime private është me i lartë në arsimin e mesëm sesa në atë bazë, dhe ka ndryshime të mëdha midis studenteve që marrin mesime private sipas të ardhurave. Ndërsa një e treta e të ardhurave të studentëve të arsimit të mesëm që i përketin 20% të familjeve më të pasura shkon për mesime private, vetëm me pak se 1% e të

ardhurave shkon për mësim private nga ata që jetojnë në 20% të familjeve më të varfëra

Numri i madh i studentëve që marrin mësim private është shqetësues pasi ky fakt mund të ndikojë dukshëm në pabarazinë e të ardhurave. Kjo na tregon se ka probleme serioze në cilësinë e mësimdhënies në shkollat publike dhe se studentët me të ardhura me të larta mund të përballojnë mësim private janë me të predispozuar të marrin arsim me të mirë dhe kështu mundësi punësimi me të mëdha.

Pjesa më e madhe e studentëve që marrin mësim private kanë si tutorë mësuesit e tyre ose mësues të tjerë të shkollës. Kjo bën që të kompromentohet mësimdhënia në shkollë, pasi mësuesi i detyron studentët të marrin mësim private ose studentët ndjehen të detyruar që ta bëjnë një gjë të tillë. Në shkollat tetëvjeçare të paktën 50% e studentëve paguajnë për mësim private të marra nga mësuesit e tyre ose mësues të të njëjtës shkollë; në rastin e shkollave të mesme përqindja është me e lartë se 60%.

## 5. Arsimi dhe Tregjet e Punës

Tabela 6.10 tregon maredhënien midis arsimit e fuqisë punëtore të brezave të reja dhe të vjetra. Shqiptarët me arsim të ulët, dmth me diplomën e shkollës tetëvjeçare ose me pak përfaqesohen me shumë në radhët e punëtorëve të punësuar në bujqësi, punëtore sezonal, punëtorë të pushuar, dhe si popullsi jo aktive, në krahasim kjo me ata që kanë nivel me të lartë arsimimi. Në kontrast, shqiptarët me diplomë universitare përfaqësohen me shumë në radhët e të punësuarve, pavarësisht nga mosha apo gjinia.

**Tabela 6. 10: Statusi i fuqisë punëtore të meshkujve shqiptar për të gjitha nivelet e arsimit, përqindje**

	Punë në bujq. <15orë	Punë të tjera	Papunë	Të pushuar	Sezonal	Pa përkrahje	Jo aktiv	Totali
<b>Meshkuj 18-35</b>								
Me pak se tetëvjeçare	0.16	0.04	0.02	0.24	0.07	0.08	0.05	0.09
Tetëvjeçare	0.63	0.57	0.51	0.36	0.63	0.58	0.56	0.56
E mesme	0.16	0.21	0.29	0.30	0.20	0.24	0.29	0.23
E mesme profesionale	0.05	0.12	0.14	0.09	0.07	0.10	0.08	0.11
i lartë	0.00	0.07	0.04	0.00	0.02	0.00	0.02	0.05
Totali	0.04	0.64	0.12	0.01	0.02	0.04	0.14	1.00
<b>Meshkuj 36-64</b>								
Me pak se tetëvjeçare	0.38	0.11	0.10	0.00	0.00	0.22	0.21	0.13
Tetëvjeçare	0.45	0.40	0.42	0.63	0.24	0.22	0.33	0.39
E mesme	0.06	0.15	0.14	0.17	0.18	0.18	0.09	0.14
E mesme profesionale	0.11	0.22	0.30	0.17	0.49	0.28	0.26	0.22
i lartë	0.00	0.13	0.04	0.02	0.09	0.10	0.11	0.11
Totali	0.04	0.75	0.06	0.00	0.00	0.01	0.13	1.00

Burimi: LSMS 2001 Shenim: Përqindjet shtohen në 100 vertikalisht.

Raporti i fuqisë punëtore shqiptare me diplomë të shkollës së mesme kërkon një analizë të veçantë. Regjistrimet në arsimin e mesëm ranë në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve që pasuan rënien e komunizmit. Të rinjtë shqiptarë po e abandonojnë shkollën me herët sesa brezat me të vjetër. Siç shihet në tablën 6.11, përqindja e të rinjve shqiptarë meshkuj me arsim të mesëm të përgjithshëm në radhët e të papunëve dhe punëtorëve të pushuar dhe pa përkrahje është më e madhe sesa përqindja që zënë ata në gjithë popullsinë, duke na treguar kështu se arsimi i mesëm nuk e përmirëson mundësitë në tregun e punës për të diplomuar të tillë. Gjithashtu, edhe për brezat me të vjetër, përqindja e meshkujve me arsim të mesëm profesional dhe teknik në radhët e të papunëve, të punonjësve sezonal, të pa përkrahur dhe jo aktiv, është me e madhe se përqindja që zënë ata në popullsi. Në rastin e atyre që kanë arsim të mesëm të përgjithshëm, përqindja e tyre ndër punëtorët sezonal dhe të pa përkrahur është më e madhe sesa përqindja e tyre në popullsinë totale. Kjo veti dekurajuese e të diplomuarve të arsimit të mesëm shpjegon pjesërisht ritmet e ulta të regjistrimit sot në këto programe, pasi ato duket se ofrojnë shumë pak benifite në lidhje me tregun e punës.

**Tabela 6. 11: Pjesmarrja e fuqisë punëtore femra për të gjitha nivelet e arsimit dhe moshës**

	Punësim në bujq. <15orë	Punësim tjetër i papunë	Hamej	Sezonal	Pa përkrahur	Jo aktiv	Totali
<b>Femrat 18-35</b>							
Me pak se tetëvjeçare	0.04	0.01	0.03	0.00	0.01	0.03	0.02
Tetëvjeçare	0.71	0.58	0.41	0.55	0.61	0.56	0.57
Mesme e përgjithshme	0.14	0.20	0.33	0.45	0.30	0.30	0.24
E mesme profesionale	0.11	0.10	0.17	0.00	0.04	0.09	0.10
E lartë	0.01	0.11	0.06	0.00	0.04	0.02	0.06
<b>Totali</b>	<b>0.07</b>	<b>0.46</b>	<b>0.07</b>	<b>0.00</b>	<b>0.02</b>	<b>0.33</b>	<b>1.00</b>
<b>Femrat 36-64</b>							
Me pak se tetëvjeçare	0.32	0.14	0.04	0.21	0.00	0.30	0.21
Tetëvjeçare	0.58	0.50	0.38	0.32	0.87	0.44	0.47
Mesme e përgjithshme	0.05	0.12	0.25	0.16	0.00	0.10	0.11
E mesme profesionale	0.03	0.16	0.33	0.31	0.07	0.13	0.15
E lartë	0.01	0.09	0.01	0.00	0.07	0.03	0.06
<b>Totali</b>	<b>0.06</b>	<b>0.47</b>	<b>0.05</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.39</b>	<b>1.00</b>

*Burimi: LSMS 2002 e Shqiprisë*

Specializimi është një çështje me vete. Këto shkolla i specializojnë fuqitë punëtore për komplekset industriale shtetërore, fuqitë punëtore për fermat kolektive, dhe gjithashtu specializojnë teknikët e mesëm për ti përgatitur ata për studimet Univeristare Teknike<sup>65</sup>. Meqë shumë ndërmarrje shtetërore janë mbyllur ose zvogëluar dhe ndërmarrje të reja private janë duke u krijuar që kanë nevojë për aftësi të tjera, shumë nga këto shkolla të vjetëra humbën interesin ndaj tyre dhe kështu shumë prej tyre janë mbyllur. Kjo shpjegon në një far mënyre pse brezat e vjetër që janë specializuar nga këto programeve profesionale gjatë regjimit të kaluar kanë kaq pak mundësi në tregun e punës, dhe pse kanë

<sup>65</sup> Fondacioni Evropian i Specializimit: Tregu i Punës shqiptar –, Torino, Prill 2001.

rënë gjithashtu edhe ritmet e regjistrimeve në këto shkolla nga brezat e rinj. Sigurisht që programet profesionale janë të domosdoshme por nevojat e arsimimit kanë ndryshuar në krahasim me çfarë ato ofronin tradicionalisht. Tregu i punës sot kërkon aftësi të tilla që ti lejojë punëtorët të adoptohen me ndryshimet e ambientit dhe me punë dhe detyra të reja.

**Tabela 6. 12: Të ardhurat mujore e punëtorëve të paguar sipas niveleve të arsimit, gjinisë dhe moshës**

	18-35		36-64	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Me pak se tetëvjeçare			13449	10235
			(910)	(1841)
Tetëvjeçare	18775	11515	18570	10724
	(842)	(712)	(813)	(560)
Mesme e përgjithshme	20051	12289	19241	12690
	(1261)	(544)	(849)	(577)
E mesme profesionale	19972	13379	19844	13371
	(1527)	(830)	(806)	(531)
E lartë	26962	19604	25781	23103
	(2779)	(1820)	(1342)	(1505)

*Burimi: LSMS 2001 Shënim: gabime standarte në kllapa*

Arsimi nuk ndikon vetëm në mundësinë për të patur një punë ose jo, por ndikon edhe në të ardhurat. Tabela 6.12 tregon pagat reale mesatare mujore të Shqiptarëve të moshës 18 vjeç e lartë. Në radhët e të rinjve nuk ka ndonjë ndryshim statistikor ndërmjet të ardhurave të atyre me shkollë tetëvjeçare dhe atyre me shkollë të mesme, si të përgjithshme edhe profesionale, gjë që e përforcon me shumë faktin sesa pak vlera ka shkolla e mesme, pasi nuk i përmirëson të ardhurat e atyre që kanë mbaruar shkollën e mesme në krahasim me ata që mbarojnë tetëvjeçaren. Kjo shpjegon edhe faktin e niveleve të ulta të regjistrimit në shkollat e mesme, pasi përfitimet në tregun e punës me vazhdimin e shkollës së mesme nuk janë me të larta sesa nga ato me shkollë tetëvjeçare. Edhe në brezat e vjetër nuk ka ndryshim të dukshëm midis të ardhurave të atyre me shkollë të mesme dhe atyre me shkollë tetëvjeçare. Por ka një ndryshim të dukshëm midis atyre me arsim tetëvjeçar dhe të mesëm dhe atyre me diplomë universitare.

Në një vend si Shqipëria që karakterizohet nga një migrim i madh, efekti i arsimit mbi mundësitë e tregut të punës kuptohet me mire nëse merren në konsideratë edhe mundësitë e punësimit jashtë vendit. Për shembull, arsimi i mesëm mund ti japë mundësi të rinjve shqipëtarë për të punuar jashtë vendit ose për të gjetur mundësi jashtë zonës ku ata jetojnë. Megjithëse nuk ka një informacion të saktë mbi shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, LSMS 2002 ka mblodhur informacion mbi migrimin e përkohshëm dhe atë të përhershëm. Në radhët e të rinjve nuk ka ndonjë ndryshim në përqindje të atyre që migrojnë brenda vendit për sa i përket niveleve të arsimit. Gjithashtu, nuk ka ndryshime statistikore ndërmjet atyre me arsim tetëvjeçar dhe të mesëm që jetuan jashtë vendit për me shumë se tre muaj. Megjithatë, kjo evidencë nuk është përfundimtare, pasi

informacioni mbi ata që jetojnë jashtë vendit në kohën e intervistave nuk është i disponueshëm.

## **6. Konkluzionet dhe sugjerime për politikat**

Të dhënat e analizuara nga LSMS 2002 tregojnë se të ardhurat dhe pabarazia rajonale kanë ndikime të mëdha në aksesin ndaj faciliteteve të arsimit dhe përfundimin e tij. Ndërsa Shqipëtar të moshës 21 vjeçare dhe me lart kanë mesatarisht 8.5 vjet arsim, ka një numër të madh ndryshimesh sipas të ardhurave dhe vendbanimit, dhe një i rritur që jeton në një familje të varfër ka mesatarisht dy ose me pak vjet arsim sesa një tjetër i rritur në familje me kushte me të mira. Gjithashtu, të rritur që jetojnë në Tiranë kanë rreth 3.5 vjet arsim me shumë sesa ata që jetojnë në zonat rurale. Ka ndryshime të mëdha gjithashtu edhe në numrin total të viteve të përfunduara sipas të ardhurave dhe vendbanimit, dhe megjithëse përqindja e atyre që përfundojnë arsimin bazë është e lartë, ka një ulje drastike në numrin e studentëve që vazhdojnë shkollën pas arsimit bazë. Ka gjithashtu diferenca të mëdha ndërmjet zonave rurale dhe urbane, dhe ndërsa këto ndryshime janë të vogla në arsimin bazë, ato rriten në nivelin e arsimit të mesëm.

Ka ndryshime të mëdha në përqindjen e regjistrimit në të gjitha nivelet e arsimit për të gjitha rajonet dhe nivelet e të ardhurave. Përqindjet e regjistrimit për të varfërit, dhe sidomos të varfërit në ekstrem, janë me të ulta sesa të atyre në radhët e jo të varfërve; gjithashtu edhe përqindjet e regjistrimeve në zonat rurale janë shumë me të ulta sesa ato të zonave urbane. Regjistrimet në arsimin parashkollor kanë rënë thellësisht gjatë periudhës së tranzicionit, nga me shumë se një në dy fëmijë të moshës 3 deri në 5 vjeç në 1990 në me pak se një në tre fëmijë në 2002. Arsyeja kryesore për regjistrime të ulëta në nivelin e arsimit para shkollor duket se është mungesa e shkollave, numri i të cilave ka rënë gati një të tretën në dekadën e fundit.

Përqindjet e regjistrimit në shkollat e arsimit të mesëm janë të ulta, dhe kanë rënë gjatë viteve të tranzicionit gati sa gjysma e nivelve të 1990. Përqindjet e regjistrimit në arsimin e mesëm ndryshojnë gjithashtu në varësi të të ardhurave dhe rajonit të banimit, dhe regjistrimi neto në arsimin e mesëm i fëmijëve të varfër është me i ulët se gjysma e atyre të fëmijëve jo të varfër. Përmes gjithë rajoneve, ndërsa 70% e fëmijëve të grup moshës përkatëse janë regjistruar në Tiranë, dhe afër 60% në zonat e tjera urbane, vetëm çereku i fëmijëve të moshës së shkollës së mesme rezultojnë të regjistruar. Arsyeja e vetme për mungesën e regjistrimit në shkollat e mesme është se shumica e kosniderojnë arsimimin e tyre si të përfunduar me mbarimin e arsimit bazë tetëvjeçar. Një arsye tjetër për mos pjesëmarrje në shkollë është se studentëve u duhet të punojnë pas përfundimit të arsimit tetëvjeçar.

Shpenzimet publike në arsim kanë rënë në mënyrë të konsiderueshme gjatë dekadës së fundit, në nivelin e pothuaj gjysmës së asaj që ishte në vitin 1990. Rënia në shpenzimet publike në arsim është balancuar me rritjen e shpenzimeve private, të cilat paraqesin mesatarisht 1.4% të shpenzimeve totale për frymë në një familje (gati 2.5% e familjeve me studentë). Familjet e një kuintili të lartë të ardhurash paguajnë një mesatare prej 2.5 here me të lartë sesa ato familje që i përkasin kuintilit të varfër. Megjithatë, si përqindje

e shpenzimeve totale mujore, familjet e varfëra paguajnë një përqindje të njëjtë ose edhe me të madhe (diferenca megjithatë nuk është statistikisht sinjifikative) të shpenzimeve totale të familjes. Pagesat jo formale janë tepër të përhapura dhe si në arsimin bazë ashtu edhe në ate të mesëm me shumë se 40% e studentëve raportojnë të kenë bërë pagesa të tilla shkollës dhe mësuesve.

Përsa i përket mardhënies midis arsimit dhe punësimit, shqiptarët me diplomë të shkollës tetëvjeçare ose me arsim me të ulët përfaqësohen me shumë mes radhëve të punësuarve në bujqësi, punëtorëve sezonal, punëtorëve te papunë, dhe popullsisë jo aktive në ekonomi. Në kontrast, shqiptarët me një diplomë universitare përfaqësohen me shumë në radhët e të punësuarve, pavarësisht nga mosha dhe gjinia. Arsimi ndikon edhe në të ardhurat, dhe ekziston një ndryshim i dukshëm midis të ardhurave të atyre me arsim me të ulët se ai tetëvjeçar dhe atyre me një diplomë universitare. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë ndryshim statistikor midis të ardhurave të atyre me arsim tetëvjeçar dhe atyre me arsim të mesëm, si për arsimin e përgjithshëm ashtu edhe për ate profesional, gjë që përforcon vlerat e pakta të arsimit të mesëm.

Analizat rezultojnë në dy prioritete për bërësit e politikave të interesuar në përmirësimin e aksesit dhe efektivitetit të arsimit. Pikë së pari, regjistrimet në arsimin e mesëm duhet të rriten dhe cilësia e arsimit në këtë nivel duhet të përmirësohet. Arsimi i mesëm duhet të reflektojë aftësitë e tregut përkatës, duke i vënë theksin fleksibilitetit, aftësive analitike dhe të adaptimit për shkak të një curriculumi të varfër. Ndihet nevoja e futjes së programeve të reja profesionale, të lidhura ngushtë me kërkesat potenciale për fuqi punëtore të kualifikuar, në mënyrë që të përgatisë studentë të aftë për tregun e punës. Programe speciale të reja të arsimit të mesëm nevojiten sidomos në zonat rurale, ku mungesa e tyre është një nga arsyt kryesore të regjistrimeve të ulëta.

Pagat e ulëta të mësuesve dhe cilësia e ulët e arsimit kanë çuar në krijimin e një rryme të mësimit privat nga të njetit mësues. Mësimi privat kompromenton arsimin e marrë dhe pabarazinë në rezultate pasi vetëm ata që kanë mundësi financiare mund ti marrin këto mësim duke marrë kështu shkollim me të mirë. Fakti që një përqindje e madhe e studentëve i marrin këto mësim dhe shumica e tutoreve janë vetë mësuesit e shkollës tregon se ky është një problem serioz në rritje në sektorin e arsimit, dhe se duhet të korrigjohet në mënyrë që të përmirësohet drejtësia dhe eficaenca në financimin dhe rezultatet e arsimit.



## KREU VII: PËRBALLIMI I VARFËRISË – ROLI I PROGRAMEVE TË MBROJTJES SOCIALE

### 1. Hyrje

Mbrojtja sociale në Shqipëri aktualisht konsiston në tre grupe kryesore të programeve publike, duke shtuar këtu edhe transfertat private midis dhe brenda familjeve. Programet publike përbëhen nga një sistem gjithëpërfshirës sigurimesh shoqërore, programet e rrjetit të sigurimeve sociale dhe politika të tregut të punës. Të gjithë këta elementë parashtrohen më poshtë me detaje.

#### *Sistemi i sigurimeve shoqërore*

Shqipëria miratoi një ligj të ri për sigurimet shoqërore në vitin 1993. Ky ligj krijoi një sistem të detyrueshëm, të manaxhuar publikisht, kontributiv me mbulesë universale. Sipas këtij ligji kërkohet kontributi i të gjithë individëve ekonomikisht aktivë, duke përfshirë të vetëpunësuarit në bujqësi (fermerët). Ligji parashikon mbrojtje gjithëpërfshirëse ndaj humbjes së të ardhurave për shkak të moshës së madhe, paaftësisë, humbjes së personit që sjell kontributin parësor të të ardhurave nga puna në familje, vdekjes, papunësisë, sëmundjes së përgjithshme, dëmtime dhe sëmundje profesionale, lindje dhe leje lindjeje. Ka afërsisht 20 lloje të ndryshme përfitimesh për të siguruarit. Grupe të ndryshme të personave ekonomikisht aktivë përfitojnë nga lloje të ndryshme përfitimesh. Një program pensioni mbulon të punësuarit, një tjetër të vetëpunësuarit, por praktikisht përfshin skema të veçanta për të vetëpunësuarit në zonat qytetëse dhe ata në zonat fshatare. Pensionet janë të një lloji të përfitimi të përcaktuar. Formula me dy pjesë e pensionit përfshin një pension bazë dhe një pjesë që ka lidhje me sasinë e të ardhurave nga puna. Pjesa e dytë është e barabartë me një përqind të bazës së llogaritjes së pensionit për çdo vit sigurimi. Kjo bazë llogaritet si mesatarja e të ardhurave bruto për të cilat janë paguar sigurime shoqërore për individin për tre vjet me rradhë gjatë 10 vjetëve të fundit përpara daljes në pension. Baza rregullohet çdo vit për ndryshimet në kontributin mesatar që paguhet nga gjithë kontribuesit në skemë. Kështu pensionet varen si nga vitet e punësimit kontribues, niveli i të ardhurave mbi të cilin janë bazuar kontributet ashtu edhe mbi kontributet mesatare të punëtorëve çdo vit. Ligji i vitit 1993 I shtrëngoi kriteret e pranueshmërisë për daljen në pension, duke e rritur në mënyrë graduale moshën e daljes në pension në 60 vjeç për burrat dhe 55 për gratë. Në vitin 2002, qeveria nisi një rritje tjetër graduale prej pesë vjetësh në moshën e daljes në pension për burrat dhe për gratë. Qeveria rriti gjithashtu tavanin për të ardhurat kontribuese, uli normat e kontributit mbi page me pesë pike përqindjeje dhe forcoi mekanizmat për zbatimin e mbledhjes së tyre.

#### *Rrjeti i sigurimeve shoqërore*

Rrjeti i sigurimeve shoqërore (asistenca sociale) në Shqipëri përbëhet nga tre programe të asistencës sociale me ndihmë në para dhe një program shërbimesh të përkujdesjes sociale për jetimët, të paaftët dhe të moshuarit. Programet e asistencës sociale janë: një ndihmë në para që ka si synim varfërinë (e quajtur *ndihma ekonomike*); një pagesë që bëhet çdo muaj për të paaftët që nga fëmijëria; dhe kompensim çmimi për pensionistët dhe familjet e tyre.

### Ndihma Ekonomike

Programi i asistencës sociale është programi kryesor në “para” në Shqipëri. Ky program siguron një përfitim sipas të ardhurave për familjet me të ardhura të ulta ose pa të ardhura. Programi është i strukturuar përmes granteve të kushtëzuara nga qeveria kombëtare të cilat administrohen nga pushteti vendor duke përdorur rregulla të pranueshmërisë dhe përfitueshmërisë të përcaktuara për të gjithë vendin. Njësitë më të mëdha të pushtetit vendor janë bashkitë, ndërsa njësitë më të vogla janë komunat. Pushteti vendor merr dhe përpunon aplikimet, duke përfshirë edhe një vizitë të detyrueshme tek çdo familje që ka aplikuar për të parë nëse kjo familje është ose jo në kushte për të përfituar nga skema. Vendimi përfundimtar për të dhënë ose jo asistencën merret nga këshillat bashkiakë dhe komunalë, të cilët përcaktojnë edhe shumën që do të përfitohet. Shuma e asistencës që i jepet një familjeje do të bazohet në një vendim të qeverisë kombëtare që nga nëntori i vitit 1996. Ky përcakton tavanin e përfitimit për familjen në masën 2.5 herë më shumë se asistencë e papunësisë. Baza e përfitimit (për çdo familje që përfiton nga skema) nuk duhet të jetë më e lartë se 95 përqind e përfitimit të papunësisë për individin. Në varësi të tavanit të përgjithshëm, anëtarë të moshuar ose të paafte të familjes përfitojnë një shumë shtesë mbi 95 përqind të përfitimit individual të papunësisë; personat nën moshën për punë marrin 25 përqind të shumës bazë; ndërsa ata në moshë për punë 20 përqind. Programi evidenton familjet kategorisht të pranueshme të cilat përmbushin kriteret të ndryshme të përzgjedhjes të hartuara për të përjashtuar familjet sipas përbërjes së familjes (psh anëtarë të familjes që nuk janë ekonomikisht të varur) ose pronësinë e mjeteve apo pronave që përbëjnë në vetvete pasuri ose aftësi për të krijuar të ardhura. Për familjet e pranueshme, programi specifikon maksimumin e përfitimit për familjet pa të ardhura të tjera. Për familjet me të ardhura private të kufizuara, mund të jepet një pagesë e pjesshme përfitimi. Përfitimi i pjesshëm hiqet nga niveli maksimal i përcaktuar për të kompensuar të gjitha të ardhurat private (duke përfshirë edhe ardhurat oportune) që familja siguron nga prodhimi i shtëpisë (p.sh nga toka ose kopshti) apo që i siguron nga punësimi i jashtëm. Praktikisht, pagesa e përfitimit është gjithashtu e kufizuar nga fondet disponibël të buxhetit. Për një farë kohe, relacionet që vijnë nga burime jozyrtare sugjerojnë se disa pushtete vendore nuk i kanë marrë parasysh kriteret kombëtare të legjitimitetit dhe kanë vendosur kriteret e tyre të vendim-marrjes për të vendosur kush do të marrë ndihmë ekonomike. Megjithatë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ka bërë kohët e fundit një rishikim të legjitimitetit të të gjithë personave që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe si rezultat i këtij rishikimi është ulur ndjeshëm ngarkesa aktuale për këto organe. Ministria tashmë ka raportuar se sipas rezultateve të drejtorisë së kontrollit në Shërbimin Shtetëror Social pagesat për familjet që nuk duhet të përfitojnë nga skema përbëjnë një përqindje të ulët të të gjithë pagesave.

### Pagesat e rregullta mujore për të paafte

Pagesa e rregullt mujore në “cash” për personat e paafte qysh nga fëmijëria i paguhet një personi i cili është deklaruar si i tillë përpara se të mbushte 21 vjeç (24 në rast se ndjek universitetin). Ky është një përfitim afrofe dhe që arrin në 70 përqind të pagës minimalre. Shuma dyfishohet në rast se personi i paafte ndjek shkollën e mesme dhe trefishohet nëse personi ndjek studimet universitare. Qysh nga vitit 1995, ky përfitim është administruar në të njëjtën mënyrë si programi i *ndihmës ekonomike* në nivel të komunitet lokal dhe zyrat

qendore dhe rajonale të GASS-it kanë kryer monitorimin dhe supervizionin e përgjithshëm të funksioneve.<sup>66</sup>

### Kompensimi i çmimit për pensionistët dhe familjet e tyre

Kompensimi për pensionistët dhe familjet e tyre për rritjen e çmimit të bukës, energjisë elektrike dhe ushqimit u fut në lidhje me eleminimin e kontrolleve dhe subvencioneve të çmimeve për të lehtësuar ndikimin dhe për të ruajtur konsensusin në favor të reformave ekonomike.<sup>67</sup> Qysh nga viti 1994, programi për kompensimin e çmimeve ose është lënë përgjysëm ose është trupëzuar brenda pagave (për punonjësit e sektorit shtetëror) për të gjitha kategoritë që e përfitojnë këtë kompensim, me përjashtim të pensionistëve. Në vitin 2001, qeveria bëri një rishikim të rëndësishëm të kompensimit të çmimit për pensionistët. Rrjedhimisht, kjo kufizoi kategorinë e pensionistëve që do të merrnin kompensim për pjesëtarët e familjeve të tyre që ishin të papunë, që ishin fëmijë deri në moshën 18 vjeçare ose studentë deri në moshën 25 vjeçare që nuk ishin në kategoritë e punësimit—të cilën qenë zgjedhur për shkak të përputhshmërisë së tyre me Konventën Evropiane për Sigurinë Sociale. Kjo masë që hyri në fuqi qysh nga 1 janari i vitit 2002 pritej të ulte shpenzimet për pensionet në vitin 2002 me afërsisht 250 milionë lek. Kompensimi i çmimit financohet nga buxheti qendror dhe administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që identifikon se cilët do të jenë përfituesit (pensionistët dhe personat në varësi të tyre) dhe bën pagesën e përfitimit së bashku me pensionin. Për shumicën e pensionistëve kompensimi është pjesë e pagesës së zakonshme të pensionit.

---

<sup>66</sup> Përpara vitit 1995, Instituti i Sigurimeve shoqërore ishte organi që administronte programin e asistencës për të paafët.

<sup>67</sup> Kompensimi i çmimeve të ushqimeve u fut për të shoqëruar liberalizimin që u bë në muajin gusht të vitit 1992 për shumicën e çmimeve të mallrave konsumatore, duke përfshirë të gjitha ushqimet përveç bukës; kompensimi për çmimin e bukës u fut në muajin korrik të vitit 1993, kur çmimet e bukës u ngritën deri në atë nivel sa të arrinin të mbulonin koston; kompensimi për enregjinë elektrike u fit në muajin prill të vitit 1994, për të shoqëruar rritjen e madhe të çmimeve të energjisë elektrike. Gjatë vitit 2000, sasia mujore e kompensimit për energjinë elektrike ishte 350 lek për banesë, ndërkohë që kompensimi i bukës ishte 150 lek për pensionist në muaj. Sasia e kompensimit që u jepej personave që ishin në varësi të pensionistëve – dmth çdo anëtar familjeje të mbajtur nga pensionisti, pavarësisht nga mosha – ishte 414 lek në muaj. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore atëherë kishte 0.6 persona në vartësi të çdo pensionisti. Pensionistët fshatar kishin të drejtë vetëm për kompensim të energjisë elektrike.

### Shërbime të Përkujdesjes Sociale

Shqipëria ka një sistem të shërbimeve rezidenciale sociale për jetimët, të paftët dhe të moshuarit që kanë nevojë për ndihmë. Ky sistem administrohet nga Administrata e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale (GASS). Projekti për Ofrimin e Shërbimeve Sociale në Shqipëri, i mbështetur nga një kredi e IDA-s ka si synim forcimin, zgjerimin dhe ristrukturimin e sistemit aktual të shërbimeve.

**Kutia 7.1: Shpenzimet për Mbrojtjen Sociale, 1998**

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat mbi shpenzimet për mbrojtjen sociale si përqindje e PBB-së për vendet e OECD-së në vitin 1998. Kjo tabelë tregon shpenzimet për sigurimet shoqërore, ndihmën ekonomike, mbrojtjen sociale (shumën e të dyjave). Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe ndihmën ekonomike jepen edhe si përqindje e PBB-së dhe si shpenzimet e përgjithshme për mbrojtjen sociale.

Shteti	Sigurimet shoqërore (% e PBB)	Sigurimet shoqërore (% e mbrojtjes sociale)	Ndihma ekonomike (% of PBB)	Ndihma ekonomike (% e mbrojtjes sociale)	Mbrojtja sociale (% e PBB)
Australia	5.5	0.65	3.0	0.35	8.6
Austria	10.2	0.75	3.5	0.25	13.7
Belgjika	11.1	0.76	3.6	0.24	14.7
Danimarka	13.6	0.71	5.4	0.29	19.0
Finlanda	13.8	0.74	4.8	0.26	18.6
Franca	11.8	0.75	4.0	0.25	15.8
Gjermania	11.6	0.74	4.0	0.26	15.5
Greqia	10.2	0.83	2.1	0.17	12.3
Islanda	8.4	0.78	2.4	0.22	10.8
Irlanda	4.6	0.61	2.9	0.39	7.5
Italia	15.4	0.91	1.6	0.09	16.9
Japonia	7.1	0.91	0.7	0.09	7.9
Korea	1.0	0.66	0.5	0.34	1.6
Luksemburgu	1.1	0.26	3.1	0.74	4.1
Meksiko	4.8	0.94	0.3	0.06	5.2
Hollanda	14.7	0.85	2.5	0.15	17.2
Zelanda e Re	8.0	0.71	3.3	0.29	11.2
Norvegjia	12.7	0.74	4.5	0.26	17.3
Portugalia	7.5	0.81	1.7	0.19	9.2
Rep. Sllovaqe	8.7	0.80	2.2	0.20	10.9
Spanja	10.4	0.91	1.1	0.09	11.5
Suedia	15.9	0.75	5.3	0.25	21.1
Zvicra	14.0	0.87	2.1	0.13	16.1
Turqia	6.1	0.85	1.1	0.15	7.3
Britania e Madhe	12.2	0.83	2.5	0.17	14.8
SHBA	5.1	0.88	0.7	0.12	5.7
Mesatarja	9.6	0.77	2.6	0.23	12.1

*Burimi: Banka Botërore (2003): Sondazh për Asistencën Sociale në vendet e OECD, Volumi I:*

### *Tregu i Punës*

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (NES) përgjigjet për: (i) një rrjet kombëtar të zyrave të punës (aktualisht të kufizuara në zonat qytetëse); (ii) Inspektoriatin Kombëtar të Punës, që ka si detyrë kryesore zbatimin e standardeve të sigurisë në punë dhe t'u kërkojë punënjësive të krahut informal të punës të kontribuojnë në Fondin e Sigurimeve Shoqërore; (iii) programet e tregut pasiv të punës (administrimin e përfitimeve të sigurimit të papunësisë, si edhe mbështetje me të ardhura për kategoritë e caktuara të individëve që kanë dalë të papunë nga privatizimi masiv i ndërmarrjeve shtetërore); (iv) programet aktive të tregut të punës (a) Programi i Nxitjes së Punësimit, që ofron ose një vit punësimi të përkohshëm ose trainim në vendin e punës për punëkërkuarit e papunë si edhe mbështetje për ngritjen e institucioneve përkatëse, dhe (b) Programin e Punëve Publike deri kur mbaroi financimi i tij në vitin 2000; dhe (v) trainim profesional.

Këto programe u hartuan pjesërisht përmes Projektit të Zhvillimit të Tregut të Punës në Shqipëri, që u mbështet nga Banka Botërore. Një nga përfitimet e projektit është ngritja e kapaciteteve të nevojshme për mbledhjen e të dhënave statistikore për pjesën zyrtare të tregut të punës. Sivjet u aprovua një strategji e re NES përmes një marrëveshjeje tripalëshe midis përfaqësuesëve të qeverisë, punëdhënësit dhe punonjësve. Strategjia ka si synim reformimin e NES në të gjitha nivelet dhe propozon krijimin e një Fondi Punësimi në kuadrin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Në një kuptim më të gjerë, rrjeti aktual i sigurimeve shoqërore ka zëvendësuar strategjinë e trashëguar të mbrojtjes sociale e cila u garantonte individëve punësim me paga të ulta në ferma kolektive dhe në ndërmarrje shtetërore, ndërsa sistemi i çmimit të administruar në një ekonomi të mbyllur i mbante çmimet e artikujve për konsumatorët po aq të ulët. Rrjedhimisht rrjeti aktual i sigurimeve shoqërore përfaqëson një ndryshim rrënjësor që kishte si synim të për lëvizjen drejt një sistemi të orientuar nga tregu ku rrisqet e papunësisë dhe çmimet për krahun e punës dhe mallrat e konsumit reflektojnë gjithmonë e më shumë forcat e tregut. Ashtu si në vendet e tjera të rajonit të ECA-s, kushtet e domosdoshme të standardeve më të larta jetesës dhe rritja e mundësive solli me vete risqe të reja sociale dhe ekonomike për individët dhe familjet e tyre. Shqipëria është ende në procesin e përshtatjes ndaj këtyre ndryshimeve përmes dy drejtimeve kryesore të migrimit – migrimit të brendshëm dhe emigracionit – duke qenë se njerëzit kërkojnë të jenë më afër mundësive të punësimit. Një drejtim ka të bëjë me fluksin e vazhdueshëm të familjeve nga ish fermat kolektive që nuk janë më ekonomikisht rentabël drejt zonave peri-urbane rreth Tiranës, Durrësit dhe zonave të tjera të Shqipërisë qendrore që po rriten shumë shpejt. Këto ferma jo rentabël janë të vendosura kryesisht në pjesët më veriore të vendit dhe në një shkallë më të ulët edhe në pjesët më jugore të vendit. Drejtimi i dytë i migrimit ka të bëjë me të rinjtë që largohen drejt vendeve fqinje dhe vendeve të tjera në kërkim të një pune apo të ardhurave më të larta. Aktualisht një pjesë e mirë e të ardhurave të tyre janë kthyer në Shqipëri duke qenë se të ardhurat nga emigracioni mbështesin familjet e tyre. Afërsisht një e treta e meshkujve shqiptarë nga moshën 20 – 35 vjeç tani jetojnë jashtë shtetit në këtë mënyrë; dhe një e treta e të gjitha të ardhurave e familjeve shqiptare përbëhet nga të ardhura nga emigracioni.

## 2. Impakti i programeve të mbrojtjes sociale në ndihmë në para në Shqipëri

Tabelat 7.1 dhe 7.2 tregojnë rëndësinë e transfertave të të ardhurave publike dhe private brenda strukturës së të ardhurave familjare. Në vitin 2002, mesatarisht për të gjitha familjet, transfertat publike të deklaruara në sondazh përfaqësonin 21.3 përqind të të ardhurave shtëpiake. Transferat private përfaqësonin një tjetër 14.4 përqindsh. Rrjedhimisht, së bashku këto transfertat siguronin më shumë se një në çdo tre lekë. Kjo i bënte ato mesatarisht një burim më të rëndësishëm të të ardhurave familjare, sesa të ardhurat e tyre nga punësimi (31.5 përqind) apo nga bujqësia (25.0 përqind). Për mbarë popullatën, burimet e transfertave të të ardhurave të cilat ishin të rëndësishme nga ana sasiore si përqindje e të ardhurave shtëpiake (p.sh ato që kontribuonin mbi 2 përqind) konsistonin në të gjitha kategoritë e pensioneve qytetëse të të moshuarve (10.5 përqind), pensionet fshatare të moshës së vjetër (3.8 përqind) dhe pensione të tjera (2.4 përqind)], *ndihma ekonomike* (3.1 përqind) dhe të ardhurat nga emigracioni nga fis jashtështetit (12.8 përqind). Për ta mbyllur, pensionet shtetërore dhe transfertat private nga të afërmit shqiptarë jashtështetit zinin vendin kryesor, ndërsa *ndihma ekonomike* kontribuonte shumë më pak.

**Tabela 7. 1: Burimet e të ardhurave (Të ardhura mesatare; Lek në muaj)**

Burimet e të ardhurave	Total	Urban	Rural	Pesëshoret qytetëse					Pesëshoret fshatare				
				1	2	3	4	5	1	2	3	4	5
Punësimi	11740	17904	6574	13153	17580	14884	16564	24849	4232	7260	7866	6935	7242
Rrogë/pagë	11392	17289	6451	12983	17101	14343	15947	23808	4165	7160	7732	6798	7033
Pagë në natyrë	45	81	15	57	79	80	75	104	7	27	10	29	3
Shpërblime	302	534	108	114	400	461	542	936	61	73	124	108	207
Bujqësi	6949	717	12172	135	426	1309	417	1039	7262	9858	13395	16017	17089
Prodhim blegtoral	849	70	1501	51	48	17	35	176	860	1523	1348	1946	2124
Gjë e gjallë	732	68	1289	-7	-2	-15	-25	319	1365	1360	1343	1290	1017
Të lashta	5369	580	9382	91	381	1307	407	544	5037	6976	10704	12781	13948
Prodhim jobujqësor	8411	14922	2952	2643	5014	12832	8594	36984	633	1305	2372	2785	9573
Transferta private (TP) (total)	3343	2527	4027	2129	2077	3279	2343	2601	1706	2565	4386	4835	8206
Transferta private (cash)	3151	2318	3849	2044	1968	3077	2144	2234	1640	2488	4334	4765	7456
Transferta private (në natyrë)	192	209	178	85	110	202	199	367	66	76	52	70	750
TP – pjesëtar familjeje në Shqipëri	247	359	153	242	235	589	423	259	125	199	194	116	125
TP në para nga familja në Shqipëri	220	321	136	228	212	557	395	180	92	187	185	95	119
TP në natyrë – familja në Shqipëri	27	38	17	14	23	32	27	79	32	12	9	21	6
TP nga një pjesëtar i familjes nga jashtë shtetit	3020	2114	3780	1762	1835	2690	1910	2210	1497	2084	4190	4664	8079
TP në para – pjesëtar familjeje jashtë shtetit	2858	1948	3621	1714	1753	2520	1740	1925	1468	2020	4149	4618	7337
TP në natyrë – anëtar familjeje jashtë shtetit	162	165	159	48	82	170	171	285	29	64	41	46	742
TP nga OJQ- (jo familjare)	76	54	94	125	7	0	10	132	84	282	2	55	2
TP në para nga OJQ- (jofamiljare)	72	49	92	102	2	0	9	129	80	281	0	53	0
TP në natyrë –OJQ (jofamiljare)	4	5	2	23	5	0	1	3	4	1	2	2	2
Transferta publike (total)	3779	4701	3006	4411	4478	4703	5468	4318	2630	2901	2704	3252	3800
<i>Ndihme Ekonomike</i>	264	316	220	853	452	350	128	45	471	204	192	87	45
Pension qytetës	2173	3431	1118	2482	2862	3543	4354	3444	640	743	1305	1601	1605
Pension fshatar	638	184	1019	318	223	106	216	114	936	1158	766	994	1275

Pensione të tjera	423	441	408	481	455	422	437	426	465	583	312	372	232
Pagesë papunësie	59	106	19	134	159	79	92	88	20	57	0	1	9
Transferta për leje lindjeje	41	59	26	41	70	56	77	48	27	38	29	28	0
Transferta kujdesjeje sociale	22	19	25	76	0	20	11	3	5	56	17	43	0
Transferta të tjera (shtetërore)	159	146	171	26	257	126	153	150	66	63	82	126	626
Të ardhura të tjera	297	526	105	164	67	1186	345	663	22	5	241	73	243
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>28833</b>	<b>41298</b>	<b>28833</b>	<b>22636</b>	<b>29644</b>	<b>38175</b>	<b>33732</b>	<b>70480</b>	<b>16485</b>	<b>23914</b>	<b>30964</b>	<b>33897</b>	<b>46276</b>



**Tabela 7. 2: Struktura e të ardhurave të familjeve shqiptare sipas burimit, vendbanimit, dhe pesëshores së të ardhurave sipas vendndodhjes (Përqindja e totalit të të ardhurave për kategorinë e familjes)**

Burimi i të ardhurave	Total	Urban	Rural	Pesëshoret qytetëse					Pesëshoret fshatare				
				1	2	3	4	5	1	2	3	4	5
Punësimi	31.5	46.4	19.0	49.9	55.3	40.1	46.4	43.5	16.6	21.2	23.1	17.6	16.6
Paga	30.5	44.7	18.6	49.2	53.8	38.7	44.7	40.7	16.3	20.9	22.5	17.2	16.1
Pagë në natyrë	0.1	0.2	0.1	0.3	0.3	0.3	0.2	0.2	0.0	0.1	0.0	0.1	0.0
Shpërblime	0.9	1.5	0.3	0.5	1.2	1.2	1.5	2.6	0.2	0.3	0.5	0.3	0.5
Bujqësi	25.0	1.9	44.3	0.8	1.7	2.2	2.4	1.8	52.4	45.6	42.7	42.6	33.8
Prodhim blegtoral	4.8	0.2	8.7	0.2	0.1	0.2	0.4	0.3	8.3	7.9	7.9	7.5	12.6
Bagëti	4.3	0.1	7.9	0.1	0.0	0.1	-0.4	0.3	11.7	7.4	9.3	5.9	3.5
Të lashta	15.8	1.6	27.7	0.5	1.6	1.9	2.3	1.2	32.4	30.3	25.5	29.2	17.7
Prodhim jobuqjësor	7.3	9.0	5.9	9.1	13.1	21.8	11.0	-7.1	2.6	8.5	6.0	7.8	4.9
Tranfertat private (total)	14.4	16.5	12.6	9.0	7.3	9.9	8.8	40.5	8.8	8.5	12.3	13.1	24.2
Transfertat private (në para)	13.3	15.6	11.4	8.4	6.5	9.1	7.8	39.2	8.0	8.0	11.8	12.7	19.1
Transferta private (in Kind)	1.1	0.9	1.3	0.7	0.8	0.8	0.9	1.3	0.8	0.5	0.4	0.4	5.1
TP – pjesëtarë familjeje në Shqipëri	1.4	1.5	1.2	1.7	1.8	0.8	1.7	1.7	1.5	1.0	1.9	1.0	0.6
TP në para nga familja në Shqipëri	1.1	1.3	1.0	1.6	1.4	0.7	1.5	1.2	1.0	0.8	1.7	0.8	0.6
TP në natyrë – familje në Shqipëri	0.2	0.2	0.2	0.1	0.3	0.2	0.2	0.4	0.4	0.2	0.3	0.2	0.0
TP nga anëtarët e familjes jashtështeti	12.8	14.8	11.1	6.4	5.5	9.1	7.0	38.5	7.0	6.8	10.3	11.9	23.6
TP në para – anëtarë familjeje jashtë	12.0	14.2	10.1	6.1	5.1	8.5	6.3	37.7	6.7	6.5	10.2	11.7	18.5
TP në natyrë – anëtarë familjeje jashtë	0.9	0.6	1.0	0.3	0.4	0.6	0.7	0.8	0.3	0.4	0.2	0.2	5.1
TP nga OJQ (jofamiljare)	0.3	0.2	0.3	0.9	0.0	0.0	0.0	0.4	0.3	0.8	0.0	0.3	0.0
TP në para – OJQ (jofamiljare)	0.2	0.2	0.3	0.6	0.0	0.0	0.0	0.3	0.3	0.7	0.0	0.2	0.0
TP në natyrë – OJQ (jofamiljare)	0.0	0.1	0.0	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transfertat publike (total)	21.3	25.6	17.8	30.5	23.0	24.9	30.7	20.4	19.5	16.1	15.3	17.8	20.2
<i>Ndihme Ekonomike</i>	3.1	3.3	3.0	9.4	5.0	2.9	0.9	0.8	6.5	2.8	2.6	0.9	0.5
Pension qytetës	10.5	17.1	4.9	13.8	11.9	17.9	25.2	14.5	3.6	2.9	5.1	7.3	6.9
Pension fshatar	3.8	1.0	6.2	2.5	1.0	0.7	0.4	0.8	5.6	6.9	4.2	6.6	8.3
Pensione të tjera	2.4	2.3	2.4	2.8	2.3	2.0	2.8	1.9	3.2	2.3	2.7	1.8	1.9
Pagesë papunësie	0.4	0.7	0.2	1.3	1.3	0.6	0.3	0.4	0.2	0.6	0.0	0.0	0.1
Transferta për leje lindjeje	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3	0.2	0.3	0.1	0.1	0.1	0.3	0.6	0.0
Transferta të kujdesjes sociale	0.1	0.1	0.1	0.4	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0	0.2	0.1	0.3	0.0
Transferta të tjera (shtetërore)	0.8	0.9	0.7	0.1	1.1	0.5	0.6	1.9	0.3	0.3	0.3	0.3	2.6
Të ardhura të tjera	0.5	0.7	0.4	0.6	-0.4	1.1	0.7	1.0	0.1	0.0	0.6	1.1	0.3

Totali i të ardhurave	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Tipari më dallues i modelit të transfertave shqiptare në krahasim me ato të vendeve të tjera në tranzicion në rajon është roli i të ardhurave private nga emigracioni kryesisht në formën e parave “cash”. Mesatarisht një në çdo tetë lekë të të ardhurave familjare vijnë nga ky burim. Megjithatë, midis 22 përqind të familjeve që marrin këto transferta, mesatarisht shuma e tyre arrin në 13,600 Lek në muaj. Kjo është e barabartë me 47 përqind të të ardhurave mesatare mujore të një familjeje. Gjithashtu, transfertat private nga jashtë më shumë shkonin tek familjet jo të varfra (23.5 përqind) sesa tek familjet e varfra (16.8 përqind) ose tepër të varfra (10.1 përqind). Po kështu, transfertat përsa i takon shumës së tyre ishin shumë më të mëdha për familjet jo të varfra (14,400 Lek në muaj) sesa për familjet e varfra (8,900 Lek në muaj) apo për familjet tepër të varfra (6,100 Lek në muaj). Ky vëzhgim garantohej deri në atë masë në të cilën marrja e transfertave private nga jashtë shtetit ishin të mjaftueshme në vetvete për t’i nxjerrë familjet nga varfëria dhe/ose për t’i kaluar në pesëshore më të larta të të ardhurave.

Pensionet, *ndihma ekonomike* dhe transferat nga të afërmit shqiptarë si në vend ashtu edhe jashtë vendit përfaqësonin burime disi më të rëndësishme për familjet zonat qytetëse sesa për ato fshatare, ndërsa vetëm pensionet fshatare ishin më të rëndësishme për zonat fshatare sesa për ato qytetëse.

Prova më e drejtpërdrejtë e ndikimit rishpërndarës të këtyre transfertave vjen nga Sondazhi për Matjen e Standardeve të Jetesës për vitin 2002. Nga të gjitha familjet, 25.4 përqind ishin nën nivelin varfërisë, d.m.th kufiri i varfërisë binte brenda pesëshores së dytë të familjeve. Megjithatë, këto familje të varfra kishin shumë më shumë gjasa të merrnin transferta të ardhurash sesa familjet jo të varfra. Kështu p.sh, familjet e varfar përbënin 53 përqind të familjeve që merrnin transferta publike dhe 46 përqind të familjeve që përfitonin transferta private (Tabela 7.3).

**Tabela 7. 3: Shpërndarja e të ardhurave nga transfertat sipas familjeve që siguronin të adhura nga transfertat nga ai burim (përqindja e familjeve që përfitojnë nga ky burim të ardhurash)**

Lloji i programit/transfertës	Pesëshorja					Niveli i varfërisë		Vendbanimi	
	1	2	3	4	5	Jo i varfër	I varfër	Urban	Rural
<i>Ndihme Ekonomike</i>	43.2	23.9	20.4	9.0	3.4	24.1	75.9	47.9	52.1
Pension qytetës	13.6	15.6	20.7	26.4	23.7	62.7	37.3	72.1	27.9
Pension fshatar	25.8	23.9	14.1	18.8	17.4	41.2	58.8	15.1	84.9
Pensione të tjera	22.9	24.8	17.7	18.6	16.1	45.9	54.1	45.5	54.5
Pagesë papunësie	19.6	39.3	10.2	16.5	14.4	55.6	44.4	78.4	21.6
Transferta për leje lindjeje	20.4	22.7	23.4	25.0	8.5	48.0	52.0	57.6	42.4
Transferta kujdesi social	20.7	27.4	19.9	26.9	5.1	53.2	46.8	43.5	56.5
Transferta të tjera publike	10.3	17.4	23.2	26.0	23.2	67.3	32.7	53.0	47.0
Të gjitha/çdo transfertë publike	22.2	20.9	18.9	19.7	18.2	46.7	53.3	50.1	49.9

Të ardhurat nga emigracioni (Shqipëri)	23.3	16.4	23.6	18.8	18.0	44.4	55.6	59.2	40.8
Të ardhurat nga emigracioni (jashtështetit)	15.4	15.0	20.7	22.9	26.0	58.3	41.7	46.9	53.1
Transf. Jopublike/jofamiljare	39.3	25.7	6.2	15.9	12.9	28.4	71.6	46.9	53.1
Të gjitha/çdo transf. Jopublike	17.7	15.7	20.6	22.0	24.1	53.9	46.1	49.0	51.0

Nga familjet që përfitojnë *Ndihmë Ekonomike*, 76 përqind janë të varfra dhe vetëm 24 përqind janë jo të varfra. Për më tepër, 43 përqind e të gjithë familjeve që përfitonin *Ndihme Ekonomike* i takonin kuintilit më të ulët, ku hyjnë katër nga çdo pesë familje të varfra. Një 24 përqindsh tjetër ishte në kuintilin e dytë, ku hyjnë pjesa tjetër e familjeve të varfra. Vetëm 12 përqind e përfituesëve të *Ndihmës Ekonomike* ishin në dy pesëshoret e para. Megjithatë, fakti që dikush është i varfër nuk të siguron përfitimin e *ndihmës Ekonomike*. Vetëm një e katërta e të gjithë familjeve të varfra përfiton *ndihme Ekonomike*; dhe këto familje përfaqësonin tre të katërtat e të gjitha familjeve që përfitojnë *ndihmë*. 69 përqind të familjeve në varfërisë të thellë dhe 75 përqind të të gjitha familjeve të varfra nuk përfitonin *Ndihmë Ekonomike*. Sigurisht që shumë nga këto mund të mos ti kenë plotësuar kushtet e pranueshmërisë.

Pensionet dhe të ardhurat nga emigracioni nga të afërm jashtë shtetit janë burimet më të mëdha të të ardhurave nga transfertat. Pensionet qytetëse merren në mënyrë disproporcionale nga dy pesëshoret e sipërme; por 25 përqind e familjeve që nuk janë të varfra përfaqësojnë 37 përqind të përfituesëve të pensioneve qytetëse. Pensionet fshatare merren në mënyrë disproporcionale nga dy pesëshoret më të ulëta dhe të varfërit. Duhet vënë re se familjet e varfëra marrin një pjesë më të madhe se proporcionalja të çdo forme të ndryshme të ardhure nga transfertat që kemi ekzaminuar.


Burime të rëndësishme të të ardhurave të transfertave sipas gjëndjes së Varfërisë. Të ardhurat nga transfertat mund të analizohen edhe sipas Burimit për të treguar se cilat Burime kanë dhënë kontributet më të mëdha dhe më të vogla në të ardhurat familjare për grupe të ndryshme të të ardhurave. Nuk është çudi që *ndihma ekonomike* ishte I vetmi burim më I rëndësishëm I të ardhurave nga transfertat për familjet e varfëra dhe tejet të varfëra, për të cilat siguronte 25.8 përqind dhe 31.7 përqind respektivisht të të gjitha të ardhurave nga transfertat. (Megjithatë, *ndihma ekonomike* përfaqësonte gjithashtu 8.8 përqind të të ardhurave nga transfertat të marra nga familjet jo të varfëra.) Për familjet e varfëra dhe jo të varfëra, pensionet fshatare dhe qytetëse të pleqërisë qenë dy burimet e tjera më të rëndësishme të të ardhurave nga transfertat. Pensionet qytetëse ishin në mënyrë proporcionale shumë të rëndësishme për familjet jo të varfëra sesa për familjet e varfëra dhe për familjet tejet të varfëra, ndërkohë që pensionet fshatare konsideroheshin më të rëndësishme për familjet e varfëra dhe familjet tejet të varfëra sesa për familjet jo të varfëra. Një divergjencë e ngjashme I pa edhe në lidhje me të të ardhurat nga emigracioni që vinin prej familjarëve jashtë shtetit. Të ardhurat nga emigracioni nga jashtë shtetit ishin shumë më të rëndësishme në mënyrë të konsiderushme për familjet jo të varfëra sesa për familjet e varfëra dhe familjet tejet të varfëra, ndërkohë që grupet e familjeve të varfëra përfitonin më shumë nga të ardhurat nga emigracioni nga familjarët në Shqipëri.

Burimet më të zakonshme të Transfertave sipas gjendjes së varfërisë. Dy nga tre familje kishin marrë asistencë nga të paktën një burim transfertash (Tabela 7.4). Pak më shumë se një të katërtat (28 përqind) e të gjitha familjave kanë marrë transfertat private. Një numër dy here më shumë familjesh mori transfertat publike të ndonjëloj burimi. Familjet e varfëra ishin paksa më të predispozuar sesa familjet jo të varfëra për të marrë transfertat nga ndonjë lloj Burimi privat ose nga burime publike, por kishin më pak gjasa për të marrë transfertat private. Transfertat publike më të zakonshme ishin pensionet qytetëse (25 përqind e familjeve), të ardhura nga transfertat private nga emigracioni nga të afërmit jashtë shtetit (22 përqind), pensionet fshatare (19 përqind), *ndihme Ekonomike* (11 përqind), dhe pensione të tjera (9 përqind). Të gjitha burimet të ardhurave nga transfertat janë marrë në mënyrë disproporcionale nga familjet e varfëra dhe shumë të varfëra.


**Tabela 7. 4: Përqindja tek Familjet e marrjes së të ardhurave nga transfertat, sipas peëshoreve, gjendjes së varfërisë, zones së banimit dhe burimit të të ardhurave nga transfertat (përqindja familjeve brenda kategorive)**



Burimi I të ardhurave nga transfertat	Total	Pesëshore					Gjendja e varfërisë		Vendodhja	
		Një	Dy	Tre	Katë r	Pesë	Jo të varfër	Të varfër	Qytet	Fshat
<b>Ndihme Ekonomike</b>	11.0	23.9	13.2	11.3	5.0	1.9	7.8	24.6	10.5	11.5
Pension qytetës pleqërie	24.6	16.7	19.2	25.5	32.4	29.1	26.6	15.8	36.8	14.3
Rural Old Age Pen	19.0	24.5	22.7	13.4	17.8	16.5	17.6	25.1	5.4	30.4
Pensione të tjera	8.7	10.0	10.8	7.7	8.1	7.0	8.4	9.9	7.9	9.4
Asistencë papunësie	1.2	1.2	2.4	0.6	1.0	0.9	1.3	1.0	2.0	0.5
Leje lindjeje	0.8	0.8	0.9	0.9	0.9	0.3	0.7	0.8	0.9	0.7
Kujdes social	0.4	0.4	0.5	0.4	0.5	0.1	0.4	0.3	0.3	0.4
Transferta të tjera publike	3.0	1.5	2.6	3.5	3.9	3.5	3.3	1.6	3.2	2.8
Të gjitha transfertat publike	57.1	63.5	59.7	54.0	56.4	52.1	55.6	63.5	57.3	57.0
Të ardhurat nga emigracioni (Shqipëri)	4.8	5.6	3.9	5.7	4.5	4.3	4.6	5.7	5.8	4.0
Të ardhurat nga emigracioni (Abroad)	22.2	17.0	16.7	23.0	25.5	28.8	23.5	16.8	20.7	23.4
Transferta jo familjare	1.1	2.2	1.4	0.3	0.9	0.7	0.9	2.2	1.0	1.2
Të gjitha transfertat private	28.1	24.8	22.0	29.0	30.9	33.9	28.9	24.7	27.5	28.6
Të gjitha transfertat	66.9	71.6	66.9	66.0	67.1	62.9	65.9	71.3	65.9	67.8

**Figura 7.1: Shpërndarja e të ardhurave familjare nga transfertat (nga të gjitha burimet, sipas burimeve të të ardhurave)**



**Figure 7.2: Distribution of Non-Poor Household's Transfer Income (from all sources, by source of income)**





*Burimi. Përlllogaritje nga stafi i Bankës Botërore nga Sondazhi për Matjen e Srandarteve të Jetesës në Shqipëri, 2002*

Burimet e shumave më të mëdha të transfertave. Tek ato familje që kanë marrë transferta nga burime të veçanta, të ardhurat nga migrimi me jashtë përbënin fitimet më të mëdha mesatare vjetore (13.000 lekë), të ndjekura nga pensionet në qytet (8.900 lekë), të ardhurat nga migrimi i brendshëm (5.100 lekë), dhe pensionet e tjera (4.900 lekë). *Ndihma ekonomike* është dhënë në një shifër mesatare vetëm prej 2.400 lekësh. Kujdesi shoqëror, shpërblimi për lindjen, transferta të tjera publike dhe përfitimi nga papunësia – të gjitha siguronin fitime në shumën 5.000 lekë në muaj, por ndihmonin shumë pak familje. Përsa i përket *ndihmës ekonomike*, fitimet mesatare për familjet tejet të varfra (2.700 lekë) ishin më të larta se për të gjitha familjet e varfra (2.500 lekë), ndërsa familjet jo të varfra merrnin akoma më pak (2.300 lekë). Kjo mënyrë progresive nuk u përsërit për ndonjë burim tjetër transfertash. Ndonëse mënyra e përkundërt u përdor për pensionet në qytet, “transfertat e tjera shoqërore” dhe të ardhurat private nga migrimi me jashtë.

### **Vlerësimi i ndikimit të transfertave publike tek përqindja e varfërisë**

Njohuritë si funksionon rrjeti i sigurimit shoqëror në Shqipëri mund të shtohen duke analizuar ndikimin e programeve të ndryshme të transfertave publike, veç e veç dhe së bashku, tek përqindja e varfërisë dhe e varfërisë ekstreme në Shqipëri. Sidoqoftë, është e rëndësishme të kuptohet si vlerësohet ky ndikim. Niveli i varfërisë së Shqipërisë përcaktohet më shumë në lidhje me vlerën e konsumit të familjes se sa në lidhje me të ardhurat e saj. Kjo ndodh kryesisht sepse vlera e mallrave dhe e shërbimeve që konsumon një familje, nga pikëpamja konceptuale, mendohet të jetë, si masë e nivelit të saj të jetesës, më e lartë se shuma që merr familja në të ardhura. Kjo ndodh pjesërisht sepse matja e të ardhurave ndikohet ndjeshëm nga deklarimi i shifrave më të vogla në vendet në tranzicion. Ajo çka vëzhgohet dhe matet në sondazhe të tilla si LSMS-ja janë nivelet e konsumit të familjeve “pas transfertave”, që pasqyrojnë marrjen nga ana e tyre e të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë transfertat. Për të vlerësuar ndikimin e të ardhurave nga transfertat tek niveli i jetesës së familjeve dhe niveli i varfërisë, analistët e politikës duhet për këtë qëllim të vlerësojnë sa të ndryshme do të kishin qenë nivelet e konsumit po të mos kishte pasur asnjë (ose më pak) burime të ardhurash nga transfertat. Me fjalë të tjera, analistët duhet të vlerësojnë cilat do të kishin qenë nivelet e konsumit të familjeve “përpara transfertave”. Mënyra më e thjeshtë për ta bërë këtë është që të supozohet se një familje, që ka marrë 100 lekë në të ardhura nga transfertat, i ka harxhuar të gjitha për të konsumuar mallra dhe shërbime shtojcë. Në atë rast, nëse familja nuk do t'i kishte marrë 100 lekët, niveli i konsumit të saj përpara transfertës do të kishte qenë 100 lekë më i ulët se niveli i konsumit të saj pas transfertës. Pra, nëse niveli i vëzhguar i konsumit të kësaj familjeje do të ishte nën nivelin e varfërisë, atëherë të gjithë 100 lekët do të kishin kontribuar për uljen e shkallës së varfërisë së saj.

Sidoqoftë, vërtet është e mundur që të ketë gjasa që, në mungesë të 100 lekëve, familja të mund ta kishte ndryshuar qëndrimin e saj në mënyra që lejonin të pranohej një pjesë e 100 lekëve të fundit të nivelit të saj aktual të konsumit. Për shembull, një anëtar i familjes mund të ketë punuar më gjatë në një punë informale, apo mund të ketë harxhuar më shumë kohë duke kultivuar ushqime në parcelën e perimeve të familjes, apo mund të ketë huajtur ushqim ose veshje, apo mund të ketë pranuar para shtojcë nga farefisi, apo madje mund ta ketë larguar fëmijën nga shkolla që ta ndihmojë për t'i shtrirë veprimtaritë

prodhuese të familjes, apo për të punuar si shitës ambulant. Në shkallën që do të kishin ndodhur këto përshtatje, humbja e 100 lekëve në të ardhura nga transfertat do të kishin çuar në pakësimin e më pak se 100 lekëve në konsumin e familjes. Shkalla në të cilën një familje tipike mund dhe do t'i kishte bërë këto përshtatje në praktikë është e paqartë. Është gjithashtu e paqartë se deri në çfarë shkalle familjet në rrethana të ndryshme do të ndryshonin aftësinë e tyre për ta bërë këtë gjë. Sidoqoftë, duhet pranuar se ndikimi i rrjeteve të sigurimit shoqëror tek varfëria ka të ngjarë të mbivlerësohet nëse supozohet se marrja e 100 lekëve të tjera në të ardhura nga transfertat do t'i shtonin 100 lekë nivelit të konsumit të familjes. Në përputhje me këtë, janë bërë përlllogaritje të tjera për të treguar si do të ndryshonte ndikimi i rrjetit të sigurisë tek përqindja e varfërisë dhe e varfërisë ekstreme sipas proporcionit të të ardhurave të tjera nga transfertat që rezulton në konsumin shtojcë.

Për të gjitha familjet shqiptare të marra si grup, niveli i përgjithshëm i varfërisë prej 25.4 % në 2002 do të kishte qenë 11.8 % pikë më i lartë – pra, 37.2 % - në qoftë se nuk do të kishte pasur programe publike të transfertave (tabela 7.5). Lidhur me këtë nivel më të lartë të nënkuptuar të varfërisë përpara transfertës publike, rrjeti i sigurisë publike e pakësoi pothuajse me një të tretën numrin e familjeve të varfra. Kontributet më të mëdha erdhën nga pensionet në qytet, në fshat dhe pensionet e tjera dhe *ndihma ekonomike* (në atë rend). Programet e tjera publike të transfertave dhanë një kontribut modest shtojcë. Gjithashtu, niveli i varfërisë ekstreme do të kishte qenë 6.46 % pikë më i lartë se niveli i saj aktual prej 4.74 % – dmth 11.2 %. Kështu, lidhur me këtë nivel më të lartë të nënkuptuar të varfërisë ekstreme përpara transfertave publike, rrjeti i sigurisë publike e pakësoi numrin e familjeve tejet të varfra në 58 % (tabela 7.6). Programet individuale kishin të njëjtën rëndësi relative përsa i përket këtij pakësimi, siç ndodhi me nivelin e përgjithshëm të varfërisë. Këto vlerësime supozojnë se të gjitha transfertat kontribuan 100 % për konsumin shtojcë.<sup>68</sup>

*Tabela 7.1: Vlerësimi i ndikimit të transfertave të të ardhurave tek niveli i varfërisë pas transfertës, nëse nuk kanë ekzistuar burime të të ardhurave në transferta, ku burimi i transfertës dhe pjesa e supozuar e transfertës përdoren për të rritur konsumin, për të gjitha familjet në vitin 2002*

<sup>68</sup> Analizat shtojcë planifikohen për të shqyrtuar ndikimet përkatëse të dërgesave nga jashtë dhe nga brenda, të të gjitha transfertave private, dhe të të gjitha transfertave publike dhe private të marra së bashku. Duke pasur parasysh përmasat e mëdha të njohura të dërgesave private, është e arsyeshme të pritet që ato të kontribuojnë ndjeshëm për efektshmërinë e matur të rrjetit shqiptar të sigurisë shoqërore. Në përputhje me këtë, kur të gjitha transfertat publike dhe private merren së bashku, i gjithë hendeku mes nivelit të varfërisë përpara dhe pas transfertave ka të ngjarë të shfaqet po aq më i madh; dhe raporti i atij niveli të nënkuptuar të varfërisë së përgjithshme para transfertës që kompensohet nga sistemi i plotë i transfertave publike dhe private ka gjasa të jetë edhe më i lartë. Analizat e mëtejshme do ta përsërisin këtë lloj analize për nëndarjet e ndryshme të familjeve shqiptare për të parë se për cilat grupe të familjeve rrjeti aktual i sigurisë ka dhënë më shumë ose më pak ndihmesë se sa për familjen mesatare.



Niveli bazë i varfërisë dhe vlerësimi i ndikimit	Të gjitha transfertat publike	Burimi i transfertave në të ardhura							
		Ndihma ekonomike	Pensionet			Përfitim nga papunësia	Shpërblimi për lindjen	Kujdesi shoqëror	Të tjera publike
			Qytet	Fshat	Të tjera				
Niveli bazë i varfërisë pas transfertës (%)	25.39	25.39	25.39	25.39	25.39	25.39	25.39	25.39	25.39
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 100 % të Transfertave</b>									
Ulja e nivelit të varfërisë:									
Përqindja në pikë	11.77	1.07	5.80	2.10	1.65	0.27	0.19	0.50	0.31
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë para transfertës	31.68	1.07	18.59	7.65	6.11	1.05	0.73	0.50	1.23
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 75 % të Transfertave</b>									
Ula e nivelit të varfërisë:									
Përqindja në pikë	8.03	0.73	3.61	1.38	1.29	0.23	0.05	0.13	0.18
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë para transfertës	24.02	2.80	12.46	5.16	4.84	0.90	0.20	0.50	0.70
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 50 % të Transfertave</b>									
Ulja e nivelit të varfërisë:									
Përqindja në pikë	4.78	0.35	2.28	0.91	0.74	0.14	0.05	0.08	0.12
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë para transfertës	15.84	1.35	8.23	3.46	2.83	0.56	0.20	0.32	0.49
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 25 % të Transfertave</b>									
Ulja e nivelit të varfërisë:									
Përqindja në pikë	2.20	0.15	1.12	0.25	0.26	0.14	0.00	0.02	0.05
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë para transfertës	7.97	0.57	4.23	0.98	1.02	0.55	0.00	0.06	0.20

**Burimi: Analiza e Shqipërisë në bazë të Sondazhit për Matjen e Nivelit të Jetesës**

Tabela 7.2: Vlerësimi i ndikimit të transfertave të të ardhurave tek niveli i varfërisë ekstreme pas transfertave, nëse nuk kanë ekzistuar burime të të ardhurave në transfertat, ku burimi i transfertës dhe pjesa e supozuar e transfertës përdoren për të rritur konsumin, për të gjitha familjet në vitin 2002

Niveli bazë i varfërisë ekstreme dhe vlerësimi i ndikimit	Të gjitha transfertat publike	Burimi i transfertave në të ardhura							
		Ndihma Ekonomike	Pensionet			Përfitim et nga papunësia	Shpërblimi për lindjen	Kujdesi shoqëror	
			Qytet	Fshat	Të tjera				

Niveli bazë i varfërisë ekstreme pas transfertave (%)	4.74	4.74	4.74	4.74	4.74	4.74	4.74	4.74
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 100 % të Transfertave</b>								
Ulja e nivelit të varfërisë:								
Përqindja në pikë	6.46	0.75	2.96	1.09	0.86	0.18	0.05	0.04
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë ekstreme pas transfertave	57.67	13.59	38.47	18.76	15.28	3.60	1.00	0.86
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 75 % të Transfertave</b>								
Ulja e nivelit të varfërisë:								
Përqindja në pikë	4.37	0.58	1.76	0.80	0.61	0.17	0.01	0.03
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë ekstreme pas transfertave	47.94	10.91	27.11	14.51	11.44	3.44	0.14	0.58
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 50 % të Transfertave</b>								
Ulja e nivelit të varfërisë:								
Përqindja në pikë	2.62	0.52	0.72	0.56	0.34	0.06	0.01	0.00
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë ekstreme pas transfertave	35.57	9.94	13.19	10.58	6.74	1.31	0.14	0.00
<b>Ndikimi duke presupozuar se konsumi është rritur me 25 % të Transfertave</b>								
Ulja e nivelit të varfërisë:								
Përqindja në pikë	0.82	0.30	0.15	0.18	0.19	0.02	0.00	0.00
Përqindja e nivelit të nënkuptuar të varfërisë ekstreme pas transfertave	14.78	5.92	2.99	3.73	3.78	0.50	0.00	0.00

**Burimi: Analiza e Shqipërisë në bazë të Sondazhit për Matjen e Nivelit të Jetesës**

## Ndihma ekonomike: çështje kyç

Programet e ndihmës sociale kanë objeta të shumëfishtë, por konkurrues: të luftojnë varfërinë nëpërmjet përfitimeve të përshtatshme për njerëzit burimet e të cilëve nuk i përmbushin normat e nevojave të pranuar nga shoqëria; të mbështesin efektshmërinë ekonomike, duke përfshirë stimujt e favorshëm të punës; dhe t'i mbajnë shpenzimet e programit të përballueshme.<sup>69</sup> Balancimi i mjaftueshmërisë së përfitimeve, stimujve për të punuar, vendosjes së barazisë, dhe përballueshmëria e programit në mënyrë të pashmangshme nënkupton harmonizimin mes këtyre objektivave. Harmonizimet shpeshherë shihen sikur nënkuptojnë “efektshmërinë e objektivit” si objektiv i ndërmjetëm. Sidoqoftë, efektshmëria e objektivit nuk nxit përdorimin e burimeve ekonomikisht të efektshme; zakonisht, ajo e përkeqëson këtë. Pra, efektshmëria e objektivit është vetëm tërësia e disa kritereve të funksionimit të mirë. Programet publike të ndihmës sociale plotësojnë transfertat private nga farefisi, miqtë dhe bamirësitë. Programet publike të transfertave potencialisht mund t'i zhvendosin në njëfarë shkalle transfertat private.

### Kutia 7.2: Programet e transferimit të parave në dorë

Nga objektivat brendaqenësisht të përkundërta të programeve të transferimit të parave në dorë lind një dilemë në lidhje me politikën: nivelet e larta të ndihmës për grupet e të varfërve, stimujt e fuqishëm për ta që të punojnë, dhe shpenzimet e përgjithshme të pakta për ndihmën sociale. Ato bien ndesh me njëri-tjetrin sepse nënkuptojnë tre variabla të politikës: fitimin maksimal, përqindjen e taksave të efektshme minimale, dhe nivelin tavan të të ardhurave për përshtatshmërinë fitime; por vetëm dy prej këtyre mund të caktohen në mënyrë të pavarur. Për fat të keq, rritja e shumës bazë të fitimit për dikë pa të ardhura të tjera do të rrisë gjithashtu shpenzimet e përgjithshme të programit, në qoftë se shpenzimet më të larta nuk kompensohen nga një thithje më e shpejtë e fitimeve si rritje e të ardhurave private. Por kjo do të përkeqësonte stimujt për të punuar! Në mënyrë më të përgjithshme, ndryshimet e politikës për të arritur ndonjërin prej këtyre tri objektivave në mënyrë më të plotë do të përkeqësonte arritjen e të paktën njërit prej këtyre dy objektivave të tjera. Kështu që politikëbërësit përballen me harmonizimin e pashmangshëm mes objektivave konkurruese, duke kërkuar që ato të arrijnë një ekuilibër optimal mes mjaftueshmërisë së përfitimeve, stimujve për të punuar, dhe përballueshmërisë së programit.

Politikëbërësit e ndihmës sociale i shqetësojnë afërsisht katër çështje kryesore të programit të *ndihmës ekonomike*. Së pari, sa është e sigurt që ajo përfundon tek personat që duhet ta përfitojnë? Së dyti, a përballen familjet që marrin *ndihmë ekonomike* me stimuj për të punuar? Së treti, në çfarë shkalle familjet që kërkojnë ose marrin ndihmë

<sup>69</sup> Stimujt për të punuar varen nga përqindja e çdo të ardhure shtojcë që një punëtor mund ta mbajë pa ndonjë pakësim reduktues në fitime (ose, në mënyrë ekuivalente, nga shkalla me të cilën thithen fitimet kur të ardhurat private rriten).

nga programi nuk i deklarojnë shifrat e sakta të fitimeve ose të të ardhurave të tjera? Së katërti, a është nevoja për ndryshime në strukturën aktuale të programit?

Janë të përziera të dhënat nëse ndihma me para në dorë ka pasur një objektiv të përcatuar mirë. Ato tregojnë se tri të katërtat e familjeve të përfshira në këtë program janë të varfra, por programi megjithatë nuk mbulon tri të katërtat e të gjitha familjeve të varfra, duke përfshirë dy të tretat e të gjitha familjeve tejet të varfra. Saktësia administrative brenda programit ndoshta ndryshon edhe gjeografikisht sipas zonës së pushtetit vendor. Vlerësimi i programit të *ndihmës ekonomike*, sidoqoftë, kërkon gjithashtu njohjen sa është përqindja e familjeve të varfra që nuk janë të përshtatshme, dhe në mënyrë më të posaçme, nëse ato familje të varfra që nuk marrin përfitime janë vërtet të papërshtatshme. Nëse është kështu, a kryhet në mënyrë të ligjshme përjashtimi i shumë familjeve të varfra nga kriteret e programit kombëtar, apo në mënyrë të kundraligjshme nga ndryshimet mes kriterëve legjislativë kombëtarë dhe kriterëve *de facto* administrative të pushteteve vendore? Nga ana tjetër, mos vallë problemi nënvizon mosmarrjen e *ndihmës ekonomike* nga familjet e varfra thjesht se shkalla e programit është e pamjaftueshme? Në atë rast, rritja e buxhetit për programin a do ta shtonte në mënyrë të ndjeshme përfshirjen e familjeve të varfra – sidomos të atyre që janë tejet të varfra? Në vitin 2002, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale filloi një rishikim të vazhdueshëm administrativ të përshtatshmërisë së përfituesve ekzistues të *ndihmës ekonomike*, që në shkurt 2003 e uli me 8.000 (5.6 %) numrin e përgjithshëm të atyre familjeve në përkujdesje të saj. Përgjithësisht, sfida kryesore në lidhje me këtë program është që të përcaktojë dhe pastaj të kapërcejë pengesat për një synim më të efektshëm dhe për një përfshirje më të plotë të familjeve të varfra.

#### Kutia 7.3: Efektshmëria e objektivit

Efektshmëria e objektivit lidhet me përqindjen e shpenzimeve të një programi që merr një grup i caktuar. Që programi ta zbusë varfërinë, ai lidhet me pjesën e përfitimeve që shkojnë për njerëzit nën nivelin e varfërisë, në vend që të “pikojnë” për individë të cilët, pikë së pari, nuk ishin të varfër, ose “të derdhen” duke i rritur të ardhurat e disa njerëzve të varfër pas transfertës në nivele mbi nivelin e varfërisë. Koncepti tregon gjithashtu harmonizimet mes objektivave konkurruese të mjaftueshmërisë së përfitimeve, stimujve për të punuar, dhe përballueshmërisë së programit. Për shembull, një program i ndihmës sociale pikësynimi i efektshëm i të cilit është përcaktuar në mënyrë të përkryer, pa asnjë rrjedhje dhe pa asnjë derdhje, gjithashtu nuk do të nënkuptonte asnjë stimul për të punuar (ose për të punuar më shumë) mbi shumën e të ardhurave nën nivelin e varfërisë. Analistët fiskalë shpeshherë supozojnë se, në një botë të buxheteve të kufizuara, një program me pikësynim të efektshëm është një program më i mirë. Sidoqoftë, hartimi i një programi të ndihmës sociale me pikësynim më të efektshëm zakonisht do ta bëjë shpërndarjen e burimeve më pak të efektshme nga pikëpamja ekonomike, duke eliminuar stimujt që pjesëmarrësit të rrisin përpjekjen e tyre për punë.

Balancimi i dëshirës për të dhënë një mbështje të mjaftueshme në të ardhura me shqetësimin që të ruhen stimujt e mjaftueshëm për të punuar, është një sfidë tjetër për të gjithë programet e ndihmës sociale. Sigurimi i përfitimeve publike pakëson trysinë e drejtëpërdrejtë mbi familjet që ato të gjurmojnë të gjitha burimet ekzistuese të të ardhurave private apo të ndihmës. Për më tepër, mohimi i përfitimeve nëse merren fitime, apo pakësimi i përfitimeve për të kompensuar plotësisht rritjet në fitime, gjithashtu mund të pakësojë përkatësisht stimulin për të punuar. Shqipëria ka përcaktuar një tavan të pjesshëm të përfitimeve në kuadrin e programit të *ndihmës ekonomike* për familjet me të ardhura të pakta që kanë tokë ose burime të tjera potencialisht produktive. Kjo është e barasvlershme sikur t'u shtojë këtyre familjeve të ardhura nga ato burime. Ky kusht prek familjet që mërgojnë në zonat periferike në afërsi të qyteteve. Një përgjigje e mëtejshme e mundshme ndaj kësaj dileme të brendaqenësishme do të ishte pakësimi i përfitimeve vetëm me përqindjen e çfarëdo rritjeje të fitimeve. Një pakësim i tillë do të diktonte një përqindje të nënkuptuar takse mbi fitimet deri në nivelin tavan të të ardhurave për marrjen e çfarëdo fitimi. (Litania e përdori këtë metodë në fillim të viteve nëntëdhjetë; këtë bën edhe programi amerikan për etiketat e ushqimeve). Vende të tjera janë përgjigjur duke diktuar kërkesa pune tek disa ose të gjithë përfituesit e një kushti për marrjen e përfitimeve. (Reforma shumë e dukshme në ndihmën sociale në SHBA në vitin 1996 e kombinoi këtë metodë me kualifikimin për punë, me subvencionet për kujdesin për fëmijët dhe personat në vartësi, ruajtjen e përfitimeve nga ndihma për sigurimet shëndetsore, dhe me një tavan për kohëzgjatjen e përfitimeve<sup>70</sup>). Politikëbërësit shqiptarë kanë shqyrtuar në mënyrë aktive programe pilot për t'u diktuar përfituesve të *ndihmës ekonomike* kërkesa më të mëdha për të punuar. Ata i kanë vonuar vendimet përkatëse pjesërisht deri në përfundim të rishikimit aktual të programeve të rrjetit të sigurisë, duke mundësuar një diagnozë dhe vlerësim më të plotë të efektshmërisë së programit, dhe pjesërisht për të pasur kohë të mjaftueshme për të përcaktuar dhe mbledhur të dhënat bazë që mund të përdoren për të vlerësuar ndikimin e çfarëdo programi të tillë pilot.

Në të gjitha vendet me ekonomi të mëdha informale dhe të kundraligjshme, mosdeklarimi dhe deklarimi i më pak të ardhurave është një problem kryesor për administratorët e ndihmës sociale të kushtëzuar nga të ardhurat. Kjo është një sfidë serioze edhe për politikëbërësit shqiptarë. Këto sfida kanë përforcuar interesin e politikëbërësve të ndihmës sociale në programe pilot që vënë në provë punën. Kjo ka bërë gjithashtu që disa pushtete vendore të publikojnë listën e familjeve që marrin *ndihmë ekonomike* dhe shumat që ato marrin.

Ky studim pjesërisht synon të përmirësojë bazën e informacionit për të përcaktuar nëse ndryshimet në strukturën e programit janë të garantuara, dhe natyrën e përshtatshme të çdo ndryshimi të tillë. Përveç ndryshimeve të mundshme për të forcuar stimujt për të punuar, zgjedhjet me interes për politikën mund të përqendrohen gjithashtu tek proceset: (a) për të përcaktuar në mënyrë më sistematike nëse, në disa vendodhje shpërndarja e *ndihmës ekonomike* shpërfill ndjeshëm kriteret e pikësnyimit të paramenduar; dhe (b) për të ndërhyrë në ato raste me qëllim që të realizohen praktika të përshtatshme të

---

<sup>70</sup> Kongresi i Shteteve të Bashkuara: Akti për Pajtimin e Përgjegjësive Personale me Mundësinë për Punë, 1996, që zëvendësoi sistemin e vjetër të ndihmës sociale me një program të ri, Ndihmë e Përkohshme për Familjet në Nevojë (TANF).

pikësnyimit. Autoriteti kombëtar aktual që do t'i ndërmarrë ose forcojë këto procese, do të duhet të ruhet ndërsa në politikën e re të Qeverisë për decentralizimin po përfshihen ndryshime të funksioneve kombëtare dhe vendore, në bazë të së cilës Qeveria po u kalon përgjegjësi shtojcë pushteteve vendore. Kështu, këto procese të hartimit të politikës do të duhet të harmonizohen. Diskutimet për rregullimin e kredive në bazë të PRSC-2 parashikuan se kjo do të kryhet duke përgatitur një dokument të politikës nëpërmjet një dialogu transparent, pjesëmarrës dhe me mbështetjen teknike të MoF, MoLSA, MoLG dhe shoqatave të pushteteve vendore, që përcakton autoritetin përkatës të pushtetit qendror dhe pushteteve vendore për ndihmën sociale.

Kjo tregon se shumica, por jo të gjithë përfituesit janë të varfër; shumica e familjeve të varfra nuk e marrin këtë përfitim (ndoshta sepse nuk janë të përshtatshme); dhe burime jo të zyrtare e vënë theksin tek mospajtimi mes kritereve kombëtare të përshtatshmërisë për përfitime dhe kritereve që përdorin pushtetet vendore kur administrojnë programin. Në lidhje me ndihmën sociale, një vlerësim i vitit 1998, i mbështetur në të dhënat e vitit 1996, konstatoi se 36 % e të gjitha shpenzimeve të programit shkonin për familje të ardhurat për frymë të të cilave i rendisnin ato në dhjetëshoret më të ulëta, dhe tri të katërtat shkonin për familje në fund të katër dhjetëshoreve. Sidoqoftë, gjysma e të gjitha familjeve në dhjetëshoren më të ulët nuk merrnin asnjë ndihmë; shpërndarja e fondeve të pushtetit qendror për pushtetet vendore kishte një pikësnyim më të paqartë se shpërndarja nga ana e pushteteve vendore të fondeve për familjet; dhe pushtetet vendore që merrnin nivele relativisht më të larta fondesh i përdornin këto kryesisht për të zgjeruar përfshirjen e familjeve më pak në nevojë se sa për të rritur përfitimet për familjet e varfra.

Sondazhi i vitit 2002 për familjet konstatoi se 31 % e familjeve tejet të varfra dhe 25 % e të gjitha familjeve të varfra e merrnin këtë përfitim, në krahasim me vetëm 8 % të familjeve jo të varfra. Ai gjithashtu konstatoi se *ndihmë ekonomike* merrnin 24 % e familjeve në pesëshoren e varfër, 13 % e atyre në pesëshoren e dytë, dhe 11 % e atyre në pesëshoren e tretë. Pra, mbetet rasti që përfitimi shkon në mënyrë shpërpjestimore për familje të cilat janë të varfra ose tejet të varfra; ai shkon gjithashtu për një numër të ndjeshëm familjesh jo të varfra; dhe atë nuk e marrin fare shumë familje të cilat janë të varfra (por që mund të jenë të papërshtatshme për arsye të tjera). Saktësimi administrativ brenda programit ndoshta ndryshon edhe gjeografikisht sipas zonave të pushtetit vendor. Kërkesat kyç të politikës tani janë proceset (a) për të përcaktuar kur shpërndarja e *ndihmës ekonomike* shpërfill sistematikisht kriteret e paramenduara të përcaktimit të objektivit, dhe (b) për të ndërhyrë që të arrihen praktika të përshtatshme të përcaktimit të objektivit. Këto kërkesa nuk përputhen me politikën e re të Qeverisë për decentralizimin, në bazë të së cilës ajo po u kalon përgjegjësi të tjera pushteteve vendore. Në vitin 2002, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale filloi një rishikim të vazhdueshëm administrativ të përshtatshmërisë së përfituesve ekzistues të *ndihmës ekonomike*, që në shkurt 2003 e uli me 8.000 (5.6 %) numrin e përgjithshëm të atyre familjeve në përkujdesje të saj.

## KAPITULLI VIII: PËRBALLJA E VARFËRISË – ROLI I MIGRIMIT TË BRENDSHËM DHE MIGRIMIT TË JASHTËM

### Hyrje

Migrimi mbetet ndoshta fenomeni më i rëndësishëm politik, shoqëror dhe ekonomik i Shqipërisë pas shembjes së komunizmit, dhe ka qenë një fakt mbizotërues në jetën e përditshme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Qysh nga viti 1990, afërsisht një e pesta e të gjithë popullsisë së vendit është larguar dhe jeton jashtë shtetit, dhe Shqipëria është përballur me një lëvizje në shkallë të gjerë nga zonat fshatare drejt zonave qytetëse. Migrimi, qoftë ky nga zonat fshatare drejt atyre qytetëse, qoftë ky ndërkombëtar drejt Italisë apo Greqisë, shpeshherë është strategjia më e rëndësishme e jetesës së familjeve fshatare dhe shërben si një valvul e rëndësishme shpëtimi për papunësinë dhe vështirësitë e tjera ekonomike që lindin nga kalimi në ekonominë e tregut. Sipas të dhënave zyrtare, të ardhurat nga migrimi përbëjnë burimin më të madh të valutës, madje më të madh se vlera e kombinuar e eksporteve dhe intesimeve të huaja të drejtpërdrejta, dhe aktualisht përbëjnë 14 % të PBB-së.

Sidoqoftë, migrimi është thikë me dy presa, dhe ndërsa në të kaluarën migrimi nga zonat fshatare drejt atyre qytetëse shihej si një zgjidhje e mundshme e problemit të varfërisë fshatare në Shqipëri,<sup>71</sup> migrimi po shihet gjithmonë e më shumë si një element që po kontribuon në zhvendosjen sociale, mungesën e krahut të punës në bujqësi dhe rënien e ndjeshme të shërbimeve sociale që ofrohen në zonat qytetëse. Për më tepër, migrimi i ligjshëm dhe i kundraligjshëm, në shkallë të gjerë, i shqiptarëve në vende të tjera të Evropës, është një sfidë e rëndësishme politiko-shoqërore për qeveritë dhe qytetarët e Bashkimit Evropian. Ligjet më të rrepta për migrimin, kostot në rritje dhe rreziqet shoqëruese gjithashtu e bëjnë migrimin më pak një zgjidhje të frytshme, sidomos për familjet më pak të pajisura. Dhe më së fundi, ndonëse migrimi dhe të ardhurat që rezultojnë nga migrimi kanë të ngjarë të vazhdojnë të jenë një element i domosdoshëm i recetës shqiptare për zhvillimin e fshatit, nuk mund të mbitheksohet nevoja dhe domosdoshmëria për të hartuar strategji më të përshtatshme, të qëndrueshme për t'i nxjerrë familjet fshatare nga varfëria dhe për të nxitur zhvillimin e vendit.

Ky kapitull i përdor të dhënat mbi përqindjen dhe modelet e migrimit të përfuara nga Sondazhi për Matjen e Nivelit të Jetesës (LSMS) i vitit 2002, dhe nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave (RePoBa) në vitin 2001, për të dokumentuar ndryshimin demografik në Shqipëri, dhe analizon vendimet e familjeve për të mërguar. Pjesa 2 shkurtimisht rishikon historikun e migrimit në Shqipëri, merr në diskutim faktorët kryesorë që kanë ndikuar në migrimin ndërkombëtar, dhe përcakton rëndësinë e migrimit dhe të të ardhurave nga migrimi në strategjitë për të ardhurat dhe jetesën e familjeve fshatare. Pjesa 3 bën një përshkrim të migrimit të brendshëm dhe migrimit ndërkombëtar, dhe paraqet përqindjen, kohëzgjatjen dhe pikëmbërritjen e migrimit. Pjesa 4 shqyrton të

<sup>71</sup> Shqipëria: “Duke dalë nga varfëria”, Banka Botërore, 1997.

ardhurat nga migrimi, duke u përqendruar tek vendi burim i të ardhurave nga migrimi, dhe karakteristikat e familjeve që marrin të ardhura nga migrimi, dërguesit dhe jo dërguesit individualë. Pjesa 5 jep përfundimet.

## Historiku

Në historinë moderne, Shqipëria ka përjetuar dy valë të mëdha mërguese. Mërgimtarët më të hershëm shqiptarë në Itali në vitin 1448 ishin ushtarë që i dërgoi Mbretit të Napolit Skënderbeu, komandanti ushtarak i Aleancës Shqiptare të fisnikëve dhe heroit kombëtar i Shqipërisë, me qëllim që të nënshtronte një rebelim të brendshëm. Pas vdekjes së Skënderbeut në vitin 1468, që kishte drejtuar qëndresën gjatë zgjerimit të Perandorisë Otomane në Shqipëri, deri në vitet e para të shekullit të 16-të, afërsisht një e katërta e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë iu shmang zgjerimit otoman. Shumica mërguan në Italinë e Jugut, ku themeluan shumë nga qytetet e sotme në Pulia, Molize dhe Kalabri (Piperno, 2002).

Vala e dytë e madhe mërguese filloi në vitin 1990, dhe vazhdon akoma. Të provokuara nga rënia e qeverisë komuniste të Enver Hoxhës, që e kishte qeverisur Shqipërinë qysh nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, mosekzistenca e kontrollit për migrimin e brendshëm dhe migrimin jashtë vendit, dhe shpërbërja e ekonomisë së centralizuar shkaktuan një lëvizje demografike teksa individët dhe familjet mërguan në qytete dhe/ose u larguan nga vendi. Paqëndrueshmëria fillestare politike, trazirat sociale, dhe ndryshimi ekonomik i shoqëruar me ndryshimin e qeverisë çuan në valën më të madhe të migrimit të kohëve të fundit, gjatë të cilës është vlerësuar se, gjatë periudhës 1991-1992, 300.000 persona kanë lënë vendin dhe janë larguar kryesisht për në Greqi dhe Itali (Piperno, 2002; Pastore, 1998).

Stabilizimi i gjendjes politike dhe ekonomike pas vitit 1992 solli stabilizim edhe në rrjedhjen mërguese. Në vitin 1995, inflacioni u ul në më pak se 10 % nga 226 % që kishte qenë kjo shifër në vitin 1992, papunësia u ul nga 28 % në 12 %, dhe në periudhën 1993-1996 rritja reale e PBB-së bëri një kthesë nga -7.2 % në afërsisht 9 % në vit. Kaosi nga tronditja që shkaktoi migrimi fillestar i hapi rrugën migrimit të kundraligjshëm ndonëse në shkallë më të vogël por të vazhdueshëm ndërsa kontrabandistët e mirëorganizuar filluan të transportonin në mënyrë të kundraligjshme mërgues të mundshëm përtej kanalit drejt Italisë dhe përmes maleve drejt Greqisë (Pastore, 1998). Të ardhurat nga migrimi menjëherë u shndërruan në një element tejet të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, ndërsa transfertat private shpejt po i zvogëlonin të ardhurat nga eksporti dhe po përbënin një përqindje në rritje të PBB-së.

Shembja e skemave piramidale aty nga fundi i vitit 1996 sollën një kulm tjetër në migrim. Skemat piramidale e kishin origjinën tek sistemi i dobët formal i kreditimit dhe tregu informal në lulëzim, i parregulluar nga Qeveria dhe i nxitur në një pjesë të mirë nga të ardhurat nga migrimi. Në kulmin e lulëzimit të skemave piramidale, numri i depozitave i kaloi 2 milionët, dhe në vitin 1996 përfaqësonte më shumë se gjysmën e PBB-së, ndërsa njerëzit shitën shtëpitë, bagëtinë dhe pasuri të tjera për t'i investuar me premtimin se do të merrnin 40 % në muaj për atë investim. Shembja nisi më datë 19 nëntor 1996 dhe



përfundoi brenda katër muajsh, duke sjellë rënien e qeverisë dhe duke nxitur trazira gjatë të cilave u vranë mbi 2.000 vetë. Vendi ra në anarki ndërsa ushtria dhe policia e humbi kontrollin, depot e armëve u plaçkitën dhe qytetarët e huaj u evakuan (Jarvis, 1999). Dhjetra mijëra shqiptarë u larguan nga vendi, duke u nisur fillimisht nga rajoni i Vlorës ku shpërthyen trazirat e para, dhe pastaj duke u përhapur në mbarë vendin deri në mars të vitit 1997. Shumë u riatdhësuan, dhe një forcë shumëkombëshe e udhëhequr nga Italia ndihmoi për të rivendosur rendin dhe për të parandaluar një eksod më të madh (Pastore, 1998). Përtej ndikimit tronditës politik dhe shoqëror të kësaj krize, pasojat ekonomike ishin relativisht jetëshkurtër. Ndërsa në vitin 1997 inflacioni u rrit dhe PBB-ja u ul 7 %, në vitin 1998 ekonomia filloi të rimëkëmbej. Kthimi i stabilitetit politik dhe zhvillimi ekonomik përsëri shërbyen për të stabilizuar rrjedhjen mërguese, dhe mbeten të tilla edhe sot.

Qysh nga viti 1990 mund të dallohen katër lloje migrimi. Së pari, një krahasim i regjistrimeve të popullsisë në vitin 1989 dhe 2001 tregon një migrim në shkallë të gjerë nga zonat fshatare në zonat qytetëse, dhe nga fshatrat dhe qytetet e vogla në qytete më të mëdha, veçanërisht në Tiranë. Së dyti, migrimi afatshkurtër ndërkombëtar (për periudha ditore, javore ose mujore) është shumë i zakonshëm, pothuajse vetëm në Greqi, sidomos nga rajonet në kufi me Greqinë. Së treti, është lloji më i zakonshëm i migrimit afatgjatë ndërkombëtar në Greqi dhe Itali, si dhe në vende të tjera të Bashkimit Europian. Dhe së fundi, kohët e fundit ka filluar migrimi i ligjshëm afatgjatë ndërkombëtar në SHBA dhe Kanada.<sup>72</sup>

Sipas shifrave zyrtare, në vitin 2000 shqiptarët përbënin 10 % të 1.388 milion mërguesëve me leje qëndrimi në Itali, duke u bërë burimi më i madh i mërguesve nga një vend i vetëm. Afërsisht 63 % e këtyre kanë edhe leje pune. Lejet për bashkim familjar zinin 26 % të të gjitha lejeve të qëndrimit, dhe shqiptarët ishin përsëri grupi më i madh (OECD, 2002). Nga 271.517 lejet e dhëna në vitin 2000, 31.185 (mbi 11 %) u dhanë për shqiptarët. Mbështetur në këto shifra, dhe duke përfshirë përshtatjen e sugjeruar nga CARITAS, në vitin 2000 vetëm në Itali ndodheshin ndoshta 170.000 shqiptarë me qëndrim të ligjshëm.

Numri i shqiptarëve në Greqi duket se është shumë më i madh. Dy programet e mëdha të rregullimit të vitit 1998 dhe 2001 çuan në një numër të përgjithshëm kërkesash prej 720.000, afërsisht 60 % ose 430.000<sup>73</sup> të të cilave ishin bërë nga shqiptarët. Regjistrimi i popullsisë në mars 2001 nxjerr 655.000 banorë të huaj, ndonëse kritikët kundërshtojnë se numri ka më shumë të ngjarë të jetë nga 800.000 në 1 milion (OECD, 2002). Duke pasur parasysh se 720.000 mërgues kishin bërë kërkesë për qëndrim të ligjshëm dhe se, deri në fund të vitit 2001, 585.000 mërgues kishin leje pune, vlerësimet e kritikëve ka më shumë të ngjarë që të jenë të sakta.

<sup>72</sup> Duke pasur parasysh natyrën e LSMS-së dhe përqindjen relativisht të vogël të migrimit në Amerikën e Veriut, nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të analizuar këtë lloj migrimi.

<sup>73</sup> OECD (2002) deklaroi se 65 % e 370.000 kërkesave në vitin 1998 ishin bërë nga shqiptarët. Në vitin 2001, kjo solli zvogëlimin e numrit absolut në 351.000 kërkesa, por përqindja nuk dihet. Po të supozojmë se përqindja në vitin 2001 është 55 %, mesatarja e dy viteve do të arinte në 60 %. Në vitin 2001, ishin deklaruar afërsisht 300.000 mërgues të kundraligjshëm, por nuk u dha asnjë informacion përse i përket origjinës së tyre.

Kështu, deri në vitin 2001 numri i shqiptarëve me qëndrim të ligjshëm në Greqi dhe Itali ishte afërsisht 600.000, ose afërsisht një e pesta e popullsisë së sotme të Shqipërisë.<sup>74</sup> Kjo nuk përfshin numrin e shqiptarëve që qëndrojnë në mënyrë të kundraligjshme në Greqi dhe Itali. Kjo nuk përfshin as numrin e shqiptarëve me qëndrim të rregullt në vende të tjera të Europës ose Amerikës së Veriut, por ky numër ka të ngjarë të shkojë deri në disa dhjetra mijë.

Përtej dy shkaqeve të mëdha që “nxitën” migrimin në vitin 1990 dhe 1997, shkaktuar nga paqëndrueshmëria politike dhe shoqërore dhe kriza ekonomike, varfëria dhe papunësia e vazhdueshme ndërsa Shqipëria kalon në ekonominë e tregut, shërbejnë si faktorë të vazhdueshëm shtytës për migrim. Afërsisht 25 % e shqiptarëve, dhe 30 % e shqiptarëve fshatarë jetojnë në varfëri. Përsa i përket vendeve të punës, në vitin 1990 sektori publik u rruadh në më pak se një të katërtën e vet, ndërsa sektori privat vetëm sa ka kompensuar në mënyrë të ngadaltë humbjen e vendeve të punës në shtet. Rritja e punësimit në bujqësi duket se është më tepër pasqyrim i një strehstre se sa i prodhimitarisë. Qysh nga viti 1992, niveli i papunësisë ka mbetur një numër me dy shifra, dhe vetëm në vitin 2001 pagat reale arritën nivelin e tyre përpara krizës së vitit 1995. Përdorimi i dobët i shërbimeve bazë është një faktor tjetër shtytës, sidomos në zonat fshatare. Më pak se gjysma e familjeve fshatare kanë ujë brenda ose jashtë banesës, vetëm 40 % kanë tualet brenda banesës, dhe vetëm 14 % e të gjithë shqiptarëve kanë energji elektrike të pandërprerë (Banka Botërore dhe INSTAT, 2003).

Faktorët tërheqës kanë qenë gjithashtu të rëndësishëm. Shikimi i televizionit italian gjatë periudhës komuniste ndihmoi për ta shndërruar atë vend në Shangri-La të mërguesve të mundshëm shqiptarë në fillim të viteve nëntëdhjetë. Përtej joshjes nga kamja dhe mënyra italiane të jetesës e dhënë përmes televizionit, ndryshimet e rëndësishme të pagave dhe pasurisë mes Shqipërisë dhe fqinjëve të saj të Bashkimit Europian kishin qenë forca tërheqëse të dukshme. Në vitin 2001, për shembull, PBB-ja për frymë në Itali ishte 16 herë më e lartë dhe në Greqi 9 herë më e lartë se sa PBB-ja për frymë në Shqipëri.

Në të njëjtën kohë, disa faktorë e kishin pakësuar joshjen e migrimit jashtë shtetit, duke përfshirë sulmet dhe damkosja në mediat italiane dhe greke; prirja për të fajësuar mërguesit për krime dhe të këqija të tjera shoqërore; shqetësimi në rritje i Europës në lidhje me migrimin, që ka çuar në politika gjithnjë e më kufizuese përsa i përket migrimit; dhe rreziku fizik i natyrshëm për migrimin e kundraligjshëm. Kjo balancohet pjesërisht nga suksesi relativ i mërguesve shqiptarë në Itali dhe Greqi, të cilët kanë marrë status ligjor në këto vende.

Së fundi, në Shqipëri funksionojnë proceset e tjera të migrimit. Së pari, Shqipëria ishte pritësja kryesore e migrimit gjatë krizës kosovare të vitit 1999, duke pritur faktikisht deri në 450.000 refugjatë, dhe në një shkallë shumë më të vogël gjatë konfliktit në Maqedoni në vitin 2001 (Piperno, 2002). Së dyti, Shqipëria shërben si një vend i rëndësishëm tranzit për migrimin e kundraligjshëm nga Azia Juglindore dhe Lindore (Piperno, 2002).

---

<sup>74</sup> Mbështetur në Regjistrimin më të fundit të Popullsisë dhe Familjeve që është bërë në Shqipëri, në prill 2001 popullsia ishte veçse pak mbi 3.069 milion.

Së treti, Shqipëria gjithashtu shërben si një lidhje e rëndësishme në trafikimin e grave për prostitucion. Një numër i madh grash janë marrë nga vendet e Europës Lindore – si dhe nga Shqipëria – dhe janë shitur ose janë detyruar të punojnë si punëtore seksi në Itali dhe vende të tjera europiane.<sup>75</sup>

### 3. Llojet e migrimit

#### (i) Lëvizshmëria e brendshme demografike

Tabela 8.1 jep informacion për familjet klasifikuara sipas kriterit kur të gjithë, disa ose asnjë anëtar i tyre nuk ka lindur në bashkinë kur aktualisht jetojnë. Gjithsej, 12 % e familjeve përbëhen nga individë të lindur në bashki të tjera. Ky tregues i mërgimit ardhës është shumë më i lartë në Tiranë (28 % e familjeve) dhe në qytetet në zonat bregdetare (20 %), por pothuajse nuk ekziston në zonat fshatare malore (1 %).


**Tabela 8. 1: Lëvizshmëria e brendshme: anëtarët e familjeve që kanë lindur në bashkinë aktuale**

Përqindja e anëtarëve të familjeve që kanë lindur në bashkinë aktuale	Asnjë	Disa	Të gjithë	Gjithsej
Tiranë	0.28	0.41	0.32	1.00
Bregdet, qytet	0.20	0.46	0.34	1.00
Bregdet, fshat	0.06	0.54	0.40	1.00
Qendër, qytet	0.10	0.41	0.49	1.00
Qendër, fshat	0.08	0.50	0.42	1.00
Malore, qytet	0.14	0.70	0.17	1.00
Malore, fshat	0.01	0.49	0.51	1.00
<b>Gjithsej</b>	0.12	0.48	0.40	1.00
Madhësia e familjes	3.38	4.64	4.12	4.28
Arsimi mesatar i të rriturve (vite)	8.46	8.78	8.51	8.64
Përqindja e familjeve që marrin pjesë në				
- punë të varur	0.49	0.49	0.39	0.45
- biznes bujqësor	0.24	0.57	0.56	0.52
- biznes jobujqësor	0.10	0.15	0.16	0.15
Numri i vëzhgimeve	429	1773	1397	3599
Konsumi për frymë (lekë/muaj)	8520	7662	7818	7801
Përqindja e varfërisë	0.21	0.26	0.25	0.25

<sup>75</sup> Për informacion shih faqet e internetit: *Human Rights Watch*, [www.hrw.org](http://www.hrw.org) dhe International Catholic Migration Commission, [www.icmc.net](http://www.icmc.net)

Gjithsej, të gjithë anëtarët e 40 % e familjeve kanë lindur në të njëjtën bashki ku jetojnë aktualisht. Kjo shifër është më e lartë për zonat fshatare malore dhe më e ulët për Tiranën dhe për qytetet në brezin bregdetar. Në të njëjtën kohë, vetëm 17 % e familjeve në zonat qytetëse malore përbëhen nga vendas, që tregojnë një migrim të konsiderueshëm nga fshati në qytet brenda rajonit malor. Nuk është për t'u çuditur që familjet e përbëra krejtësisht nga anëtarë që kanë lindur në bashki të tjera, kanë më pak të ngjarë të merren me bujqësi dhe më shumë të ngjarë të merren me punë me pagesë. Këto familje kanë gjithashtu përmasa më të vogla.

Përsa i përket kryefamiljarëve, dy të tretat e të gjithë kryefamiljarëve aktualisht jetojnë në të njëjtin vend ku kanë lindur, ndërsa 22 % janë vendosur në vendin ku jetojnë aktualisht përpara vitit 1990, dhe 12 % pas vitit 1990. Gjithsej, 34 % e kryefamiljarëve jetojnë në një bashki të ndryshme nga ajo ku kanë lindur. Ndër rajonet, kryefamiljarët janë vendosur kryesisht në Tiranë (60 %), në qytete në brezin bregdetar (53 %), dhe në zonat qytetëse në rajonin malor (69 %).



Shifrat tregojnë një migrim ardhës drejt Tiranës pas vitit 1990 prej 29 % në krahasim me mesataren e vendit prej 12 % pas vitit 1990, dhe 31 % në krahasim me mesataren e vendit prej 22 % përpara vitit 1990, dhe që arrin kulmin pas vitit 1995. Migrimi i brendshëm drejt qyteteve qendrore (me përjashtim të Tiranës), përkundrazi, u ngadalësua pas vitit 1990 në gjysmën e mesatares së vendit në krahasim me nivelet përpara vitit 1990 që ishin 50 % më të larta se mesatarja. Është e qartë se Tirana është qyteti që shumica e mërguesve zgjedhin si pikëmbërritje të tyre.

**Tabela 8. 2: Lëvizja e kryefamiljarëve në vitet nëntëdhjetë**


Nga					
Në	Bregdet	Qendër	Malore	Tirana	Gjithsej

Bregdet	63	59	38	1	161
Qendër	9	89	48	2	149
Malore	0	1	22	0	23
Tiranë	23	84	30	6	142
Gjithsej	95	233	138	9	475

Tirana është zona më *tërheqëse*, me një bilanc neto prej 133 (142-9) kryefamiljarësh ardhës, e ndjekur nga rajoni bregdetar (me një bilanc neto prej 66 kryefamiljarësh ardhës). Rajonet malore dhe qendrore, nga ana tjetër, janë zona të fuqishme *shtytëse*, me bilanc neto, përkatësisht, prej 115 dhe 84 kryefamiljarë që largohen. Është shumë interesante se dyndja më e rëndësishme e mërguesve të brendshëm është nga qendra (fshati) në qendër (qyeti), i ndjekur nga kalimi nga qendra në Tiranë.

Të dhënat tregojnë një popullsi shumë të lëvizshme, me një përqendrim në rritje të mërguesve drejt Tiranës. Qytetet e tjera, që në të kaluarën kanë qenë pikëmbërritja që zgjidhnin shumë mërgues të brendshëm, nga ana tjetër, nga fundi i viteve nëntëdhjetë po përjetojnë tendenca të kundërta dhe prurje që janë ndjeshëm më të ulta se në vitet e mëparshme. Një tjetër përfundim interesant është dinamizmi i dukshëm në kuptimin e migrimit fshat-qytet brenda rajoneve më të largëta në verilindje të vendit, që duket se mbështet përshtypjen se familjeve të varfra fshatare nga rajoni malor shpeshherë mund t'i mungojnë mjetet ekonomike për të bërë përpjekje që të mërgojnë në vende më të largëta, me shumë mundësi.

Krahasimi me të dhënat e PHC-së të vitit 2001 dhe të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 1989 mundëson shpërndarjen e dyndjeve mërguese në nivelin e rretheve. Për këtë




qëllim, rrethet klasifikohen si rrethe “dëbuese” dhe “thithëse”, dhe janë krijuar dy tregues: (i) për rrethet dëbuese: pjesa e popullsisë që jeton në çdo rreth në vitin 1989 të cilët nuk jeton më atje në vitin 2001<sup>76</sup>; dhe (ii) për rrethet thithëse: pjesa e popullsisë që jeton në rreth në vitin 2001 që nuk jetonte atje në vitin 1989.<sup>77</sup> Tre rrethet kryesore dëbuese gjenden në rajonin malor verior (Tropoja, Puka dhe Kukësi), me më pak se dy të tretat e banorëve të vitit 1989 që ende jetonin atje në vitin 2001 (ngjyra më e errët në hartën e parë). Në shifra absolute, tre rrethet veriore (Dibra, Kukësi dhe Puka) janë tre dëbuesit kryesorë në 12 vitet mes regjistrimeve të popullsisë.

<sup>76</sup> Një vlerë më e ulët e secilit prej treguesve tregon nivele më të larta të migrimit ardhës/largues.

<sup>77</sup> Njerëzit e lindur në periudhën 1989-2001 llogariten se janë vendosur në vendin e banimit qysh në lindje.


Ndër pikëmbërritjet kryesore janë, sigurisht, Tirana dhe Durrësi, por edhe qendra më të vogla qytetëse të tilla si Lushnja, Fieri dhe Vlora.

Ndër rrethet thithëse, Tirana është magneti kryesor, ku vetëm 69 % e banorëve aktualë jetonin atje në vitin 1989 (ngjyra më e errët në hartën e dytë). Në shifra absolute, rrethi i Tiranës në 12 vitet e fundit ka qenë pikëmbërritja që kanë zgjedhur mërguesit e brendshëm në pothuajse gjysmën e rasteve, dhe që ka pranuar afro 160,000 banorë të rinj. Shpërndarja e mëtejshme në nivelin e minibashkive tregon se ardhja më e madhe e mërguesve në dhjetëvjeçarin e kaluar ka qenë drejt minibashkive 11 dhe 6 në Tiranë, që përfaqësojnë afërsisht gjysmën e popullsisë që jeton aktualisht në ato zona. Me fjalë të tjera, popullsia banuese në minibashkitë 6 dhe 11 pothuajse është dyfishuar gjatë 12 viteve mes dy regjistrimeve të popullsisë. Këto dy zona periferike të Tiranës janë gjithashtu dy minibashki të varfra, ku përqindja e varfërisë është mbi mesataren e qytetit. Minibashkitë 4 dhe 7 janë dy të tjera me migrim të madh ardhës.



Rrethi i Durrësit është pikëmbërritja e dytë më e madhe e largët për mërguesit e brendshëm. Pothuajse 72 % e banorëve aktualë jetojnë atje qysh prej vitit 1989 (gjithashtu, ngjyra më e errët në hartën e dytë), dhe numri i përgjithshëm i mërguesve gjatë të njëjtës periudhë arriti në mbi 50.000. Ndonëse jo shumë në shifra absolute, gjatë të njëjtës periudhë, rrethi i Mallakastrës ka shifrën e tretë më të lartë të banorëve aktualë të cilët nuk banonin aty në vitin 1989, dhe është një nga rrethet e pakta shqiptare që gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar ka përjetuar një vërshim neto mërguesish. Thithësit e tjerë kryesorë neto, në kuptimin e numrit absolut të mërguesve, janë rrethi i Lushnjës (mbi 14.000), Lezha, Fieri dhe Vlora (të gjithë me afro 10.000 mërgues secili).

Përsa i përket ndryshimeve neto të popullsisë, gjashtë rrethet kryesore në kuptimin e dyndjeve neto ndodhen të gjitha në rajonet qendrore dhe bregdetare (ngjyra më e errët në hartë). Përveç Tiranës dhe Durrësit, është edhe Lezha, Lushnja dhe Vlora. Në kuptimin e vërshimeve neto (ngjyra me ngjyrë më të çelët në hartën më poshtë), mbizotëron rajoni malor verilindor, ku vetëm Kukësi, Puka, Dibra, Mati dhe Tropoja kanë përjetuar një dyndje të përgjithshme neto prej pothuajse 100.000 personash gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar.



Nuk është për t'u çuditur që shumica e dyndjes jashtë rretheve vjen nga zonat fshatare. Pavarësisht nëse matet në shifra relative ose absolute, zonat fshatare kryesore dëbuese ndodhet të gjitha në rrethet në rajonin verior. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, afërsisht 75.000 veta janë larguar vetëm nga zonat fshatare të Dibrës, Kukësit dhe Matit. Migrimi nga zonat

fshatare është, sigurisht, drejt Tiranës dhe Durrësit, por edhe drejt zonave qytetëse në të njëjtat rrethe (në Mat, mbi 36 % e njerëzve që janë larguar nga zonat fshatare kanë qëndruar në këtë rreth).

Si zonat qytetëse ashtu edhe ato fshatare të rretheve Tiranë dhe Durrës mbeten në shifra absolute pikëmbërritjet kryesore për shqiptarët. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, vetëm Bashkia e Tiranës ka thithur mbi 100.000 mërgues. Një në tre nga të ardhurit rishtazi vjen nga 5 rrethe të Veriut të vendit (Dibër, Tropojë, Kukës, Mat dhe Korçë). Një 10 % tjetër vjen nga zonat qytetëse në qendër të Shqipërisë (Berat, Lushnje, Fier dhe Elbasan), ndërsa një 11 % tjetër ka ardhur nga zonat fshatare të të njëjtit rreth.

Mbështetur në këtë tregues, zona fshatare e rrethit të Kurbinit renditet e dyta ndër rrethet thithëse, mes Tiranës dhe Durrësit. Ndonëse me madhësi të vogël, në shifra relative, zonat qytetëse të Matit, Mallakastrës dhe Hasit kanë përjetuar dyndjet më të mëdha në vitet nëntëdhjetë. Pothuajse i gjithë migrimi drejt këtyre qendrave qytetëse provinciale vjen nga zonat fshatare përreth.

Tre përfundime për lëvizshmërinë e brendshme janë veçanërisht të rëndësishme. Së pari, Shqipëria po kalon një tranzicion thelbësor demografik, nga fshati në qytet, dhe nga zona verilindore malore drejt rretheve të bregdetit dhe Tiranës. Së dyti, Tirana është ku e ku pikëmbërritja kryesore e mërguesve të brendshëm, një proces që duket se është përshpejtuar gjatë gjysmës së dytë të viteve nëntëdhjetë. Së treti, ka të dhëna për një migrim vendor fshat-qytet brenda rajonit verilindor. Nëse këto qendra qytetëse në veri janë veçse parantezë për lloje migrimi më të largta dhe më fitimprurëse për këto familje mbetet e paqartë, ndonëse numri i madh i mërguesve nga këto qendra qytetëse provinciale të veriut drejt Tiranës duket se tregon se, në të vërtetë, shumë po lëvizin.

Duke pasur parasysh migrimin e brendshëm drejt zonave qytetëse të bregdetit, si dhe migrimin vendor fshat-qytet, krijimi i mundësive ekonomike në zonat qytetëse përveç Tiranës mund të ndihmojë për të krijuar një vërshim më të qëndrueshëm fshat-qytet, meqenëse vetëm Tirana po përpiqet të presë dhe t'i shërbejë numrit në rritje të mërguesve që grumbullohen në lagjet e saj të varfra.

## (ii) Migrimi i përkohshëm

*2001-2002: të gjitha llojet e migrimit të përkohshëm*

Të dhënat e LSMS-së japin gjithashtu informacion për të rriturit që e kanë kaluar të paktën një muaj jashtë shtëpisë gjatë 12 muajve të fundit.<sup>78</sup> Nga një numër i përgjithshëm prej mbi 10.000 të rriturish, më shumë se 4 % janë larguar përkohësisht nga shtëpia gjatë 12 muajve të fundit, dhe afërsisht 10 % e familjeve kanë të paktën një të rritur që ka munguar për të paktën një muaj në vitin përpara vëzhgimit. Shumica e këtyre llojeve të mërguesve afatshkurtër janë kryefamiljarë (53 %) ose fëmijët e tyre (36 %). Mesatarisht, ata kanë qëndruar 3.5 muaj jashtë shtëpisë (3.75 po te jene meshkuj, 2.44 po te jene femra). Mesatarisht, ata janë më të rinj se mesatarja e të rriturve (35 vjeç kundrejt 41 vjeç), shumica ka të ngjarë të jenë meshkuj (85 %), dhe me pak më shumë shkollë (9.3 vite shkolle kundrejt mesatares prej 8.5).

**Tabela 8. 3: Karakteristikat e familjes së mërguesve të përkohshëm të kohëve të fundit**

Familje me një anëtar të rritur të larguar të paktën 1 muaj	Jo	Po	Gjithsej
Numri i vëzhgimeve	359	3240	3599
Përqindja e familjeve	0.90	0.10	1.00
Sipas vendndodhjes:			
Tiranë	0.96	0.04	1.00
Bregdet, qytet	0.94	0.06	1.00
Bregdet, fshat	0.90	0.10	1.00
Qendër, qytet	0.92	0.08	1.00
Qendër, fshat	0.86	0.14	1.00
Malor, qytet	0.89	0.11	1.00
Malor, fshat	0.83	0.17	1.00
Madhësia e familjes	4.24	4.61	4.28
Arsimi mesatar i të rriturve (vjet)	8.68	8.45	8.64
Përqindja e familjeve që marrin pjesë në			
- punë të varur	0.46	0.35	0.45
- biznes bujqësor	0.50	0.71	0.52
- biznes jobujqësor	0.15	0.11	0.15
Konsumi për frymë (lekë/muaj)	7890	7069	7801

<sup>78</sup> Sidoqoftë, nuk ka asnjë informacion për pikëmbërritjen.



Përqindja e varfërisë	0.25	0.33	0.25
-----------------------	------	------	------


Sic e tregon Tabela 8.3, fenomeni i migrimit të përkohshëm është më i përqendruar në zonat fshatare, ku pjesa më e madhe ndodhet në rajonet fshatare malore (17 % e familjeve) dhe në zonat fshatare qendrore (14 %), dhe pjesa më e vogël në Tiranë (4 %) dhe në zonat qytetëse bregdetare (6 %). Familjet që i kanë anëtarët larg për një pjesë të vitit janë paksa më të mëdha, kanë më shumë të ngjarë të punojnë në bujqësi, dhe më pak të ngjarë të angazhohen në punë me pagesë dhe në biznes jobujqësor. Këto familje karakterizohen gjithashtu nga nivele më të ulta të konsumit dhe përqindje më e lartë varfërie (33 %). Përmbledhtas, familjet që përdorin migrimin aftatshkurtër janë më të varfra, jetojnë kryesisht në zona fshatare, dhe angazhohen kryesisht në prodhimin bujqësor. Kjo tregon se familjet përdorin migrimin afatshkurtër për të plotësuar të ardhurat e vogla nga bujqësia.

### ***1997-2001: migrimi i përkohshëm jashtë vendit***

LSMS-ja mblodhi histori migrimi të individëve të cilët kishin qenë jashtë shtetit për të paktën 3 muaj në një kohë të caktuar qysh nga viti 1997. Të dhënat tregojnë se mes të rriturve, 7 % (që i përket 18 % të familjeve) thuhet se kanë kaluar të paktën tre muaj jashtë shtetit qysh nga viti 1997.<sup>79</sup> Mërguesit e përkohshëm jashtë vendit janë në moshë më të re se të rriturit e tjerë (36 vjeç krahasuar me mesataren prej 41 vjetësh) dhe ka shumë më tepër të ngjarë të jenë meshkuj (83 % kundrejt 44 % tek të rriturit e tjerë). Nga numri i përgjithshëm i mërguesve, 43 % kanë qenë jashtë shtetit vetëm një vit gjatë periudhës 1997-2001, ndërsa 15 % kanë qenë jashtë vendit çdo vit gjatë të njëjtës periudhë. Përqindja e migrimit është më e larta tek njerëzit aktualisht me moshë 25-34 vjeç (14 %) dhe 35-44 vjeç (10 %), dhe më e ulët se mesatarja tek të rriturit me moshë të re (15-24 vjeç) dhe tek personat mbi 45 vjeç. Është tipike se mërguesit janë kryefamiljarë (51 %) ose fëmijët e tyre (36 %).

<sup>79</sup> Shpeshësitë e deklaruara nënvleftësojnë shkallën e plotë të migrimit të përkohshëm jashtë vendit meqenëse ato i përjashtojnë individët të cilët kanë qenë jashtë shtetit për më pak se 3 muaj radhazi në një kohë të caktuar.

Figura 8.5: Migrimi i jashtëm i përkohshëm



Ata që mërgojnë përkohësisht jashtë shtetit vijnë nga familje paksa më të mëdha, me një pjesëmarrje më të ulët në punën me pagesë dhe me pjesëmarrje më të lartë në punët bujqësore. Numri i familjeve në punën me pagesë ulet me rritjen e numrit të rasteve të migrimit, nga 0.44 (1 rast) në 0.33 (5 raste). Përkundrazi, numri i familjeve me veprimtari bujqësore rritet me shtimin e numrit të rasteve të migrimit – nga 0.62 (1 rast) në 0.74 (5 raste). Asnjë ndryshim nuk ekziston mes familjeve me një mërgues të përkohshëm jashtë shtetit dhe familjeve me asnjë mërgues të përkohshëm jashtë shtetitpërsa i përket arsimit mesatar, konsumit për frymë dhe përqindjes së varfërisë (ndonëse përqindja e varfërisë është më e ulët tek familjet me një numër më të lartë të rasteve të migrimit).

Greqia është ku e ku pikëmbërritja më e rëndësishme për migrimin e përkohshëm (afërsisht 80 % e rasteve), e ndjekur nga Italia, rëndësia e të cilës u rrit ndjeshëm në periudhën 1997-2001, nga 12 % në 22 % të rasteve (gjatë kësaj kohe përqindja e mërguesve për në Greqi u ul nga 84 % në 74 %).

Në përgjithësi, mërguesit për në pikëmbërritje më të afërta si Greqia dhe Italia janë më të rinj në moshë se të rriturit jomërgues. Gratë sërisht kanë më pak të ngjarë se burrat që të mërgojnë, por ato janë relativisht në numër më të madh mes atyre që mërgojnë për në vende më të largëta, meqenëse ato ka më shumë të ngjarë të jenë pjesë e familjeve të tëra mërguese. Mesatarisht, mërguesit në Europë kanë paska më shumë shkollë se homologët e tyre që shkojnë në Greqi ose jomërguesit, dhe gjithashtu përfshijnë një numër më të madh grash. Përqindja e varfërisë mes mërguesve për në Europë është paksa më e ulët (17 %).

Mërguesit në Greqi më shpesh vijnë nga zonat fshatare të pjesës veriore dhe qendrore të vendit, ndërsa në migrimin në Italy dhe në pjesën tjetër të Europës mbizotërojnë më shumë të ardhur nga zonat qytetëse dhe fshatare bregdetare. Siç pritet, në përgjithësi

largimet më të mëdha të mërguesve të përkohshëm që dalin jashtë vendit. janë nga zonat fshatare të rajoneve malore dhe qendrore. Bashkia e Tiranës ka përqindjen më të vogël të mërguesve të përkohshëm që shkojnë jashtë shtetit.

### (iii) Migrimi i përhershëm

Të dhëna të mëtejshme për migrimin vijnë nga pjesa për pjellorinë e LSMS-së, ku gratë janë pyetur për fëmijët e tyre se kur janë larguar nga shtëpia dhe ku jetojnë. Të dhënat tregojnë se nga 6,065 fëmijët anëtarë të familjeve që janë larguar nga shtëpia në një pikë të caktuar dhe janë ende gjallë në kohën e sondazhit, një 35 % e habitshme e tyre jetojnë jashtë shtetit. Numri i fëmijëve që jetojnë jashtë shtetit, është edhe më i lartë përse i përket fëmijëve që janë larguar nga shtëpia pas vitit 1990 (48 % kundrejt 15 % të fëmijëve që janë larguar nga shtëpia përpara vitit 1990 – të padeklaruar). Me fjalë të tjera, pothuajse gjysma e të gjithë fëmijëve të cilët janë larguar nga shtëpia qysh nga viti 1990 jetojnë jashtë shtetit. Pikëmbërritjet kryesore për këta mërgues të përhershëm janë Greqia (49 %) dhe Italia (35 %).

Në nivel individual, këta mërgues kanë prirje të jenë më të rinj në moshë se ata që kanë mbetur në Shqipëri, dhe janë kryesisht meshkuj. Pjesa më e madhe (65 %) e atyre që kanë mbetur në Shqipëri janë gra. Nivelet arsimore janë të njëjta, ndonëse mërguesit që jetojnë në Europë dhe në vende të tjera (kryesisht Amerika e Veriut) kanë më shumë shkollim.

**Tabela 8. 4: Karakteristikat individuale dhe familjare të fëmijëve që janë larguar nga shtëpia**

	Shqipëri	Greqi	Europë	Të tjera	Gjithsej
<b>Karakteristika individuale</b>					
Numri i vëzhgimeve					
Përqindja	0.65	0.17	0.15	0.03	
Mosha (vjeç)	38.1	31.6	30.12	32.83	35.62
Sa përqind ishin femra	0.64	0.38	0.31	0.43	0.54
Arsimi (vite shkollimi)	9.68	9.83	10.04	11.63	9.81
<b>Karakteristika familjare</b>					
Numri i vëzhgimeve					1343
Përqindja e familjeve (migrimi më i largët)	0.35	0.27	0.31	0.07	1.00
Madhësia e familjes	4.53	3.57	3.43	3.47	3.86
Arsimimi mesatar i të rriturve (vite shkollimi)	7.73	7.32	7.8	9.73	7.79
Konsum për frymë	7234	9155	9385	9867	8472
Përqindja e familjeve në punë të varur	0.36	0.28	0.32	0.50	0.34
Përqindja e familjeve në biznes bujqësor	0.62	0.66	0.53	0.32	0.58
Përqindja e familjeve në biznes jobujqësor	0.13	0.09	0.12	0.22	0.12
Përqindja e varfërisë	0.31	0.17	0.12	0.18	0.21

Duke parë karakteristikat e nivelit familjar, ne vërejmë se në 35 % të rasteve, të gjithë fëmijët që janë larguar nga shtëpia aktualisht jetojnë në Shqipëri.<sup>80</sup> Këto familje janë më të mëdha (4.5 anëtarë krahasuar me 3.5) dhe ka më shumë të ngjarë të jenë më të varfra se familjet me disa fëmijë jashtë shtetit (31 % kundrejt 12-17 %, në vartësi të vendit të migrimit). Nivelet mesatare të arsimimit të familjeve janë të ngjashme, me përjashtim të kategorisë “Të tjerë”, ku familjet kanë një nivel arsimor ndjeshëm më të lartë. Sidoqoftë, në përgjithësi, nivelet arsimore të familjeve me fëmijë që janë larguar nga shtëpia, janë më të ulta se nivelet arsimore të familjeve fëmijët e të cilave nuk janë larguar nga shtëpia. Përsa i përket veprimtarive të punës, numri i familjeve me punë me pagesë dhe me biznes jobujqësore është më i lartë sa më e largët të jetë pika e migrimit, ndërsa numri i familjeve në bujqësi ulët. Përqindja e varfërisë është më e ulët për të gjitha kategoritë e familjeve mërguese (12-18 %), në krahasim me familjet me fëmijët në Shqipëri (31 %).


Mbështetur në sa më sipër, numri i qytetarëve shqiptarë citizens që jetojnë aktualisht jashtë shtetit vlerësohet të jetë afërsisht 458.000. Ky është një vlerësim i një kufiri më të ulët, sepse ai përjashton familje të tëra që u larguan jashtë shtetit përpara vitit 2001, fëmijët e fëmijëve dhe fëmijët e bashkeshorteve që nuk jetojnë më. Për më tepër, ai nuk merr parasysh njerëzit që jetojnë në Shqipëri – qofshin ende me familjet e tyre ose jo – të cilët shkojnë jashtë shtetit çdo vit vetëm përkohësisht.

### **Të ardhurat nga migrimi**

Të ardhurat nga migrimi luajnë një rol shumë të rëndësishëm në strategjinë për të ardhurat e familjeve shqiptare. Mesatarisht të ardhurat nga migrimi përfaqësojnë 13 % të familjeve shqiptare (14 % për jo të varfërit, 8 % për të varfërit). Ato janë më të larta për qytetarët (16 %) në krahasim me fshatarët (11 %), dhe ka të ngjarë të pasqyrojnë dallimet në mënyrat e migrimit.

---

<sup>80</sup> Në nivelin familjar, nëse një familje ka pasur pikëmbërritje të shumëfishta, ne e vendosëm atë familje në kategorinë që përkon me pikëmbërritjen më të largët, në këtë rend: Greqi, Europë dhe Të tjera.



Të dhënat nga LSMS-ja tregojnë se gjatë 12 muajve përpara sondazhit, 28 % e familjeve merrnin njëfarë forme transfertash private qoftë nga individë apo nga institute. Shumica më e madhe e dërguesve individualë janë ose fëmijë të kryefamiljarit (55 %) ose fëmijë të një barku (25 %, duke përfshirë kuneterit dhe kunatat). Afërsisht 80 % e dërguesve jetojnë jashtë shtetit, kryesisht në Greqi (42 % e atyre jashtë shtetit) dhe në Itali (40 %). Pothuajse të gjithë dërguesit (98 %) kanë jetuar jashtë shtetit qysh pas vitit 1990 (38 % qysh përpara vitit 1997, 60 % qysh nga viti 1997). Nga ata që janë larguar pas vitit 1990, 90 % kanë jetuar vazhdimisht jashtë shtetit. Më shumë se gjysma (55 %) e familjeve që marrin dërgesa, jetojnë në zonat fshatare.

**Tabela 8. 5: Vendndodhja e dërguesve dhe e marrësve të dërgesave**

<b>Individët jetojnë në Shqipëri?</b>	Po	Jo	Gjithsej		
Përqindja	0.21	0.79	1.00		
N (të paponduara)	283	1070	1353		
<b>Vendndodhja e dërguesve</b>	%	%	%	Sasia	Për frymë
Shqipëri	1.00		0.21	38,151	11,700
Greqi		0.42	0.33	70,095	24,036
Itali		0.40	0.32	121,211	37,782
Vende të tjera europiane		0.10	0.08		
Të tjera		0.08	0.07	146,905	44,142
Gjithsej		1.00	1.00	88,602	28,199
<b>Vendndodhja e marrësit të dërgesave - Fshat/Qytet</b>			%	Amount	Per-capita
Qytet			0.45	68,902	22,799
Fshat			0.55	104,400	32,529
<b>Vendndodhja e marrësit të dërgesave – Shtresa</b>			%	Amount	Per-capita
Bregdet			0.40	78,611	26,534
Qendër			0.49	91,703	28,039

	Malore		0.04	138,334	37,135
	Tiranë		0.07	92,039	33,426
<b>Të ardhurat nga migrimi të përdorura për</b>			%	Amount	Per-capita
	Blerjen e ushqimeve dhe sendeve bazë		0.33	74,249	24,438
	Investime/Blerjen e mallrave me përdorim afatgjatë		0.12	221,214	70,785
	Shpenzime mjeksore		0.09	57,390	18,254
	Të tjera		0.09	81,845	25,965
	Asnjë arsye e veçantë		0.37	68,293	20,920
Gjithsej			1.00	88,602	28,199
Viti nga i cili dhuruesi jeton jashtë shtetit			%		
	Përpara vitit 1990		0.02		
	Në vitet 1990-1996		0.38		
	Pas vitit 1996		0.60		
	Gjithsej		1.00		
<b>Nëse kanë mërguar pas vitit 1990, kanë jetuar vazhdimisht jashtë shtetit</b>			%		
	Po		0.90		
	Jo		0.10		

Shqyrtimi i mënyrave të migrimit tregon se individët që shkojnë në Greqi janë përgjithësisht nga familje fshatare dhe më të varfra, ndërsa ata që shkojnë në Itali dhe në pikëmbërritje të tjera europiane janë përgjithësisht nga familje me gjendje më të mirë. Njëkohësisht, shqyrtimi i të ardhurave nga mënyrat e migrimit tregon se të ardhurat nga migrimi në Greqi janë më të pakta krahasuar me të ardhurat nga migrimi në Itali. Kjo do të dukej se tregonte se ekziston një si gracke e varferise nga migrimi, cka duket në faktin se banoret me pak në gjendje nga zonat fshatare që shkojnë në Greqi, dërgojnë më pak dhe familjet e tyre mbeten të varfra, ndërsa presonat nga zonat bregdetare dhe qytetëse që janë në gjendje paksa më të mirë shkojnë në Itali, dërgojnë më shumë dhe janë në gjendje më të mirë.

Të ardhurat nga migrimi zakonisht nuk dërgohen për ndonjë përdorim ose qëllim të veçantë (37 % e rasteve). Kur familjet deklarojnë një arsye, arsyeja kryesore është për të blerë ushqime dhe për të permbushur nevojat bazë (33 %), e ndjekur nga arsyeja për investime dhe për të blerë mallra të përdorimit afatgjatë (12 %) dhe për shpenzime mjeksore (9 %). Shuma mesatare e të ardhurave nga migrimi është 88.600 lekë<sup>81</sup> në vit (afërsisht 670 dollarë amerikanë). Shuma është më e lartë kur shkon për familje në zonat fshatare (104.400 lekë krahasuar me 68.900 lekë), dhe rritet në përputhje me largësinë e dërguesve (më e lartë kur vjen nga jashtë shtetit, veçanërisht nëse vjen nga Italia ose më tej). Të ardhurat nga migrimi janë ndjeshëm më të larta kur dërgohen posaçërisht për fond investimi (për biznes ose për restaurim shtëpie) ose për të blerë mallra të përdorimit afatgjatë (mbi 220.000 lekë në vit).

<sup>81</sup> Një dollar amerikan = 132 lekë.

Familjet që marrin të ardhura nga migrimi janë më të vogla (3.8 anëtarë kundrejt 4.5), karakterizohen nga një nivel më i ulët arsimor i të rriturve (7.9 vite shkollimi kundrejt 8.9), dhe ka më pak të ngjarë të angazhohen në punë të varur dhe në biznes jobujqësore. Ato karakterizohen nga nivele më të larta konsumi dhe përqindje më e ulët e varfërisë.

Gjatë 12 muajve përpara sondazhit, familjet shqiptare merrnin të ardhurat nga migrimi afërsisht në vlerën 227 milion dollarë amerikanë. Prej këtyre, 203 milion dollarë amerikanë vinin nga individë që jetojnë jashtë shtetit, 193 milion dollarë amerikanë nga të cilat ishin me para në dorë. Ky është një vlerësim më i vogël i të ardhurave të përgjithshme nga migrimi jashtë vendit, sepse ai nuk merr parasysh shumën që sjellin anëtarët e familjeve të cilët kanë mërguar gjatë vitit. Për të vlerësuar këtë pjesë tepërisht, me vlerësojmë sasinë e përgjithshme të muajve që kanë kaluar jashtë shtetit anëtarët e rritur të familjeve në vitin 2001 dhe e shumëzojmë atë me një fitim të pritshëm për secilin nga pikëmbërritjet kryesore.<sup>82</sup> Duke supozuar një nivel kursimi prej 50 %, të ardhurat e përgjithshme nga migrimi i mërguesve të përkohshëm vlerësohet të jetë 156 milion dollarë amerikanë. Duke i mbledhur të dyja shifrat (të ardhurat nga migrimi jashtë shtetit dhe fitimet që sjellin anëtarët e familjeve nga jashtë shtetit), shuma e përgjithshme e të ardhurave vjetore nga migrimi është afërsisht 359 milion dollarë amerikanë. Edhe kështu ky numër është ndoshta një vlerë më e vogël (vlerësimi zyrtar është 543 milion dollarë amerikanë), meqenëse ka të ngjarë që të deklarohen më pak shuma transfertash.

### **Vërejtje përmbyllëse dhe sugjerime për politikat që duhet të ndiqen**

Thuajse nuk ka dyshim se Shqipëria është një vend në lëvizje, si brendapërbrenda ashtu dhe në plan ndërkombëtar. Kjo lëvizshmëri e habitshme shpeshherë është pjesë e strategjisë në nivelin e familjeve që t'i përballojnë vështirësitë ekonomike të tranzicionit. Siç e tha me elokuencë Adriana nga Gramshi: “Familje e varfër konsiderohet ajo familje që nuk ka ndonjë anëtar që mund të mërgojë jashtë shtetit.”<sup>83</sup> Përdorimi i rritjes të migrimit dhe përdorimi i migrimit shihet nga shumë familje si e vetmja rrugë e frytshme për të dalë nga varfëria.

Në lidhje me lëvizshmërinë e brendshme, tre përfundime dalin në pah. Së pari, gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar Shqipëria përjetoi një shndërrim demografik nga fshahti në qytet, dhe nga rrethet malore të verilindjes në rrethet e bregdetit dhe në Tiranë. Së dyti, Tirana është ku e ku pikëmbërritja kryesore e mërguesve të brendshëm, një proces që duket se është përshpejtuar dhe është përqendruar gjithnjë e më shumë në gjysmën e dytë të viteve nëntëdhjetë. Migrimi në Tiranë është më i fuqishëm drejt zonave të varfra periferike, duke përfocuar ciklin vicioz të varfërisë dhe duke i tendosur shërbimet bashkiake tashmë tejte të sforcuara. Së treti, ka të dhëna për migrim fshat-qytet brenda rajonit verilindor. Nëse këto qendra qytetëse në veri janë veçse parantezë për lloje migrimi më të largëta dhe më fitimprurëse për këto familje mbetet e paqartë, ndonëse

---

<sup>82</sup> Duke supozuar se paga mesatare ditore në Greqi është 30 dollarë amerikanë, dhe në Itali dhe Europë 40 dollarë amerikanë.

<sup>83</sup> *Albania Qualitative Poverty Assessment* (“Vlerësim cilësor i varfërisë në Shqipëri”), Banka Botërore, 2002.

numri i madh i mërguesve nga këto qendra qytetëse provinciale të veriut drejt Tiranës duket se tregon se, në të vërtetë, shumë po lëvizin. Duke pasur parasysh migrimin e brendshëm drejt zonave qytetëse të bregdetit, si dhe migrimin vendor fshat-qytet, krijimi i mundësive ekonomike në zonat qytetëse përveç Tiranës mund të ndihmojë për të krijuar një vërshim më të qëndrueshëm fshat-qytet, meqenëse vetëm Tirana po përpiqet të presë dhe t'i shërbejë numrit në rritje të mërguesve që grumbullohen në lagjet e saj të varfra.

Mund të identifikohen mënyra të qarta migrimi të përkohshëm. Shumica dërrmuese e mërguesve të përkohshëm, kryesisht nga zonat fshatare të pjesës qendrore dhe verilindore të vendit, udhëtojnë në Greqi për të kërkuar mundësi punësimi afatshkurtër për të plotësuar fitimin e paktë nga veprimtaritë bujqësore. Pavarësisht nga shpenzimet më të larta të veprimeve, vitet e fundit dyndja e mërguesve të përkohshëm në pikëmbërritje më të largëta si Italia dhe Gjermania është rritur ndjeshëm. Migrimi i përkohshëm duket se lë një gjurmë në nivelin e mirëqenies së familjes vetëm nëse përsëritet vit pas viti. Të dhënat tregojnë se mes jomërguesve, një numër i madh ka marrë në konsideratë mundësinë e mërgimit, dhe shumë janë përpjekur dhe kanë dështuar.

Një 35 % i habitshëm i fëmijëve të anëtarëve të familjeve aktualisht jetojnë jashtë shtetit. Për fëmijët të cilët janë larguar nga shtëpia në vitet nëntëdhjetë, numri arrin përmasat e eksodit, ku një në dy fëmijë aktualisht jeton jashtë vendit. Përqindja e varfërisë për familjet me fëmijë jashtë shtetit është ndjeshëm më e ulët (12-18 %, në vartësi të pikëmbërritjes), krahasuar me familjet me fëmijë në Shqipëri (31 %). Shuma e të ardhurave nga migrimi nga fëmijët që jetojnë jashtë shtetit vlerësohet të jetë mbi 200 milion dollarë amerikanë në vit. Pothuajse gjysma e familjeve shqiptare mund t'i përdorin rrjetet e migrimit, qoftë nga migrimi i drejtëpërdrejtë i një anëtarit të familjes ose nëpërmjet fëmijëve të tyre që jetojnë jashtë vendit. Madje ka shumë të ngjarë që kjo shifer të jetë me e lartë, dhe është e krahueshme me një vend të tillë si Meksika, që ka mbi 100 vjet traditë dhe përvojë migrimi, krahasuar me pak më shumë se dhjetë vjet që ka Shqipëria.

Të dhënat e LSMS-së në mënyrë të kujdesshme vlerësojnë se jashtë shtetit jetojnë aktualisht 458.000. Informacioni nga dy vendet kryesore pritëse e vendos afërsisht në 600.000 numrin e banorëve të ligjshëm në këto vende për periudhën 2000-2001, ose 1/6 e popullsisë shqiptare. Tipike është se ky numër citohet edhe në Burime të tjera.

Ndonëse migrimi, dhe të ardhurat që vijnë nga migrimi, ka të ngjarë të sigurojë një element përbërës të domosdoshëm të recetës shqiptare për zhvillimin (fshat), ekziston një konsensus në rritje përse i përket domosdoshmërisë për të hartuar strategji më të përshtatshme, të qëndrueshme për t'i nxjerrë familjet fshatare nga varfëria dhe për të nxitur zhvillimin e vendit, meqenëse fenomeni po kontribuon gjithashtu gjithnjë e më shumë për zhvendosjen shoqërore, mungesat e punës bujqësore dhe përkeqësimin e shpejtë të sigurimit të shërbimeve sociale in zonat qytetëse.

Ndërsa të ardhurat nga migrimi aktualisht po mbajnë ekonominë, duke kontribuar afërsisht në 14 % të PBB-së, kjo ka pak gjasa të jetë një zgjidhje të përhershme dhe afatgjatë. Në mënyrë të pashmangshme tendencat demografike do t'i pakësojnë të



ardhurat nga migrimi kur mërguesit të vendosen. Sidoqoftë, e rëndësishme në këtë kuadër është që Shqipëria të jetë në gjendje që gjithnjë e më shumë t'i shndërrojë të ardhurat nga migrimi në investime. Roli i politikëbërësve është të sigurojnë kushtet e duhura që kjo të ndodhë. E para dhe më e rëndësishme është që të përmirësohet klima e biznesit në vend. Së dyti, duhet të jepet kontribut për legalizimin dhe rregullimin e fluksit të migrimit në vendet evropiane, duke siguruar në të njëjtën kohë mundësi për ata që mbeten pas. Së fundi, duhet të mundësojë të ardhurat nga migrimi dhe të pakësojë shpenzimet e veprimeve dhe shpërndarjet e transfertave. Shqipëria nuk mund të përballet më me një dhjetëvjeçar tjetër të hemorragjisë së trurit. Për më tepër, ndikimi i migrimit tek struktura sociale e popullsisë dhe tek marrëdhëniet me fqinjët po bëhet shumë i qartë. Gjithashtu, shpopullimi i fshatrave dhe trysnia e papërbalueshme demografike në qytete si Tirana po krijojnë qysh tani pengesa në procesin e balancuar dhe të barabartë të zhvillimit ekonomik.

## KAPITULLI IX: PAMJA PER TE ARDHMEN

### 1. Ulja e varfërisë

Shqipëria ka pasur një veprimtari të fuqishme ekonomike gjatë pesë viteve të fundit dhe rritja ekonomike ka qenë mesatarisht mbi 7 % në vit. Inflacioni është mbajtur në nivele të ulta prej 4 % ose më pak gjatë në një pjesë të mirë të kësaj periudhe, gjatë të cilës si eksportet ashtu edhe importet janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, dhe e njëjta gjë mund të thuhet edhe për bilancin e llogarisë rrjedhëse. Sidoqoftë, pavarësisht nga veprimtaria mbresëlënëse e ekonomisë, varfëria në Shqipëri mbetet në nivele të larta dhe të ardhurat për frymë në vitin 2001 ishin afërsisht 1,230 dollarë amerikanë, duke qenë një nga më të ultat në ekonominë në tranzicion, dhe aktualisht një e katërta e popullësisë shqiptare ose afërsisht 780.000 persona jetojnë nën nivelin e varfërisë. Një numër i madh njerëzish janë shumë pranë nivelit të varfërisë, kështu një luhatje e vogël të ardhurash nga jashtë mund t'i zhysë në varfëri një numër shpërpjestimisht të madh njerëzish. Varfëria në Shqipëri ka një dimension të theksuar hapsinor dhe rajonal. Zonat fshatare dhe rajonet malore janë shumë më të varfra se pjesa tjetër e vendit. Modernizimi i vendit i nxitur nga reformat e tranzicionit dhe periudha e fundit e rritjes ekonomike të qëndrueshme po kontribuojnë për përmirësimin e nivelit të përgjithshëm të jetesës në Shqipëri, por këto përfitime janë më shumë për zonat qytetëse, sidomos për Tiranën, ndërsa zonat fshatare dhe zonat e largëta malore kanë mbetur pas. Nuk ka dyshim se pa veprimet e drejtpërdrejta të politikave të përqendruara dhe të përcaktuara mirë dhe pa mbështetjen e qeverisë, mundësia që shumë të varfër në zonat fshatare dhe të varfërit e paarsimuar të zonave qytetëse të shpëtojnë nga kthetrat e varfërisë, duke u përfshirë me procesin e rritjes ekonomike, është shumë e largët.

Analiza e kapitujve të mëparshëm e vë theksin tek disa fusha që kërkojnë vëmendjen e menjëhershme të shtetit dhe përqëndrimin e përpjekjeve të tij për të ulur varfërinë dhe për t'i nxjerrë njerëzit nga gjendja në të cilën ndodhen ku ata janë të ndjeshëm edhe ndaj luhatjeve të vogla nga jashtë. Fusha e parë përparësore në këtë kontekst është sigurimi i vendeve të reja të punës, duke qenë se ekziston një lidhje e fortë mes papunësisë dhe të qenit i varfër. Kujtoni se vetëm 33 % e individëve nga 15 vjeç e lart kanë punë me orar të plotë, ndërsa 21 % bëjnë punë me orar të shkurtuar, duke e çuar numrin e përgjithshëm të të punësuarve në 53.9 %. Pavarësisht nga mënyra si përkufizohet punësimi, nivelet e papunësisë në radhët e të varfërve janë shumë më të larta krahasuar me jo të varfërit, dhe janë pothuajse dyfish në radhët e jo të varfërve. Në radhët e personave në varfëri ekstreme, përqindja e papunësisë është më e lartë se trefishi. Tek të varfërit është konstatuar një përqindje ndjeshëm më e lartë e punëtorëve të marginalizuar (ata që klasifikohen si punëtorë të shkurajuar, stinorë dhe të pushuar nga puna).

Shqipëri ka një përqindje të lartë të pjesëmarrjes së krahut të punës (66 %), por çështja qëndron në faktin se niveli i aftësive është i ulët, dhe pothuajse dy të tretat e krahut të punës janë me arsim tetëvjeçar dhe në disa raste nuk e kanë as atë. Pothuajse dy të tretat e popullsisë janë në marrëdhënie pune, ose janë të vetëpunësuar, ose punojnë si punëtorë pa pagesë në fermën e familjes ose në një ndërmarrje jobujqësore. Fenomeni i

vetëpunësimi ndeshet kryesisht në bujqësi dhe vetëm një e treta e të punësuarve marrin pagë. Afërsisht 10 % e të punësuarve në Shqipëri punojnë në sektorin informal dhe kjo përqindje arrin afërsisht 24 % in zonat qytetëse. Në sektorin informal janë punësuar më shumë burra se gra. Ka të dhëna të punësimi afatgjatë në sektorin informal, ku pothuajse 75 % e individëve janë të punësuar në veprimtari informala prej më shumë se 3 vjetësh, dhe afërsisht 10 % prej më shumë se 10 vjetësh. Papunësia ende mbetet një fenomen i shumëpërhapur dhe përqindja e papunësisë është veçanërisht e lartë në zonat qytetëse. Në këtë kategori mbizotëron papunësia afatgjatë – zakonisht duhet mesatarisht më shumë se një vit për të gjetur punë. Tirana ka përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes së krahut të punës dhe përqindjen më të lartë të papunësisë në krahasim me zonat e tjera gjeografike të vendit.

Çështja mbizotëruese e tregut të punës dhe varfërisë në Shqipëri është si të përballohet oferta e madhe me tepri e punës, duke parasysh mekanizmat e kufizuara që ekzistojnë në treg. Qeveria nuk është më në gjendje ta mbajë kërkesën për punë të rritur artificialisht, ndërsa mekanizmat e tregut të krijuara rishtazi janë tepër të dobët që të kompensojnë humbjet e punësimi. Përpos kësaj, pagat janë të ulta dhe nuk ka shumë vend për rregullime të çmimeve. Oferta me tepri e forcave të punës ka çuar në nivele të larta të papunësisë, të papunësisë së fshehtë, dhe të një sektori informal që mbështetet gjerësisht tek ndihma për nivelin minimal të jetesës. Si rezultat, segmente të mëdha të forcave të punës si të rinjtë, të sapodiplomuarit, gratë, dhe njerëzit përpara moshës së pensionit nuk marrin pjesë në tregun e punës. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Shoqëror, e miratuar kohët e fundit, e sheh zhvillimin dhe nxitjen e punësimi si një nga elementet kryesorë të politikave për uljen e varfërisë. Dokumenti parashikon përgatitjen e legjislacionit përkatës për tregun e punës për të siguruar kualifikimin profesional dhe zhvillimin e forcave të punës, formalizimin e tregut të punës, dhe nxitjen e punësimi. Këto objektiva, sidoqoftë, mund të jenë të vështira për t'u arritur nëse nuk shoqërohen me reforma strukturore që synojnë të përmirësojnë hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për bizneset.

### **Tabela 9.1: Klima për investimet në Shqipëri**

Një studim që kanë bërë kohët e fundit Shërbimi Këshillimor për Investimet e Huaja (FIAS) i IFC-së dhe Banka Botërore për klimën e investimeve në Shqipëri rendiste pengesat burokratike, zbatimin e dobët të ligjit dhe korrupsionin e madh si pengesat kryesore për rritjen e investimeve private, dhe nënvizonte nevojën për heqjen e pengesave administrative si çelësin për të inkurajuar investime të reja. Studimi vinte në përfundimin se procedurat e investimeve në Shqipëri paraqesin mangësi serioze dhe janë tejet të ndërlikuara, kanë mungesë qartësie dhe transparence, dhe nuk janë të përshtatshme për investuesit. Veprimtaria tregtare private has në vonesa burokratike, në trajtim subjektiv dhe arbitrar, dhe shpenzime të larta, duke përfshirë pagesat e shpeshta “jozyrtare”, që të gjitha rrisin shpenzimet e investimit.

Duke radhitur çështjet kryesore, studimi vëren mungesën sistematike të zbatimit të rregullave dhe udhëzimeve operative. Është tipike që ligjet e miratura rishtazi të mos

mbështeten nga përpjekjet për të përcaktuar procedurat, kriteret, normat dhe përgjegjësitë e nevojshme. Kjo çon në mungesën e plotë të transparencës në zbatim, dhe lë hapësirë për subjektivizëm të konsiderueshëm operacional. Në mungesë të strukturave të efektshme institucionale, nuk ka një përcaktim të qartë të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së agjencive të caktuara, dhe investuesit shpeshherë nuk e dinë me saktësi ku duhet të shkojnë dhe për çfarë. Zbatimi i ligjit dhe i rregullave është i dobët, dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si në administratën publike ashtu edhe në sistemin gjyqësor, synojnë të jenë të paefektshme. Fushat që përbëjnë shqetësim përfshijnë procedurat e doganave, administrimin e tatimeve, të drejtat e tokës dhe pronës, lejet e ndërtimit, dhe dhënie e licencave për sektor/veprimtari, që të gjitha këto karakterizohen nga një nivel i lartë burokracie, mungesa e transparencës, zbatimi i dobët i ligjit, dhe praktika të përhapura korrupsioni. Administrata është dobësuar më tej nga mungesa e zhvillimit të mënyrës së duhur të menduarit dhe aftësive të zyrtarëve në të gjitha nivelet. Në përgjithësi, zyrtarët rregullatorë nuk u besojnë bizneseve, dhe synojnë ta shohin veten si policë, jo si ofrues shërbimesh. Në kuadrin e këtij mosfunksionimi të përhapur, nuk është fare e çuditshme që korrupsioni të dallohet si faktori më serioz që pengon përpjekjet e reformave.

Përvoja në shumë vende tregon se qeveritë mund të përparojnë në luftën kundër korrupsionit duke thjeshtëzuar procesin e investimeve dhe duke eliminuar fushën e veprimit të subjektivizmit. Qeveria shqiptare duhet të bëjë një sërë përpjekjesh për të sqaruar përgjegjësitë institucionale dhe për të rritur përgjegjshmërinë e agjencive, për të zbatuar ligjet dhe rregullat, dhe për të edukuar nëpunësit e përgjithshëm publikë dhe civilë në të gjithë nivelet drejtuese me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Në të njëjtën kohë, duhet të rritet efektshmëria dhe besueshmëria e ligjeve dhe rregullave që synojnë të mbrojnë interesin publik legjitim. Pa dyshim, këto nisma do të kërkojnë një vullnet politik të fortë dhe angazhim afatgjatë.

### *Nxitja e një klime të favorshme për biznesin*

Zhvillimi i sektorit privat është i rëndësishëm për të nxitur zhvillimin ekonomik në vend dhe për të siguruar mundësitë për punësim. Krijimi i një mjedisi të favorshëm për bizneset për zhvillimin e sektorit privat duhet të jetë një përparësi për qeverinë, e cila duhet të marrë masa për t'i zyrtarizuar bizneset informale, për të rritur nivelin e konkurrencës së ekonomisë, për të fuqizuar kuadrin ligjor dhe institucional, si dhe për të inkurajuar hyrjen e kapitalit në ekonomi.

Praktikisht, bashkë me mbështetjen e nismave të reja të bizneseve, qeveria duhet të marrë masa për të hequr pengesat aktuale që të sigurojë krijimin dhe rritjen e firmave. Ndër pengesat kryesore për zhvillimin e biznesit privat në Shqipëri janë korrupsioni, zbatimi i dobët i ligjit, të drejtat e pasigurta të pronës, bezdisja burokratike e firmave të vogla (inspektimet e shpeshta, revizionimet etj.) dhe procedura të tjera të gjata administrative dhe rregullatore.

### *Reformimi i institucioneve të tregut të punës*

Ashtu si edhe ekonomitë e tjera në tranzicion, Shqipëria ka trashëguar rregullore të tregut të punës të hartuara në kuadrin e planifikimit qendror, të cilat kanë treguar se janë të papërshtatshme për nevojat e ekonomisë së tregut. Kjo trashëgimi rregulloresh të ngurta ka krijuar një pengesë e konsiderueshme për veprimtarinë e tregut të punës në vend. Reformat e tregut të punës në Shqipëri duhet të synojnë (a) përmirësimin e fleksibilitetit të punësimit nëpërmjet pakësimit të shpenzimeve të largimit nga puna (psh duke ulur pagesën e shkëputjes, duke përfshirë kontratat e përkohshme të punësimit); (b) rritjen e fleksibilitetit të kohës së punës (psh nëpërmjet parashikimit të riplanifikimit të orëve të punës); (c) rritjen e fleksibilitetit të pagave (psh nëpërmjet eliminimit të rrjetave të ngurta të pagave); dhe (d) pakësimin e disa përfitimeve jo me para në dorë. Krahas çlirimit të marrëdhënieve të punës nga rregulloret, reformat duhet të mbështesin shndërrimin e tyre nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve në zhvillimin e bisedimeve kolektive.

#### Box 9.2: Korrupsioni administrativ në Shqipëri

Shqipëria shënon nivele të larta të korrupsionit administrativ, që shihet tek shembulli i dyqanxhiut që është i detyruar t'u paguajë rryshfet një liste të pafund zyrtarësh, tek syri qorr i disa zyrtarëve të doganave në trafikimin e mallrave apo të qenieve njerëzore, apo tek procedurat mashtruese të tenderave në disa kontrata publike. Sondazhi i Mjedisit të Biznesit dhe Veprimtarisë së Ndërmarrjeve (BEEPS), i kryer në vitin 1999, nxjerr se Shqipëria, me 4.0 pikë (rryshfetet si pjesë e të ardhurave vjetore, në një shkallë në rritje nga 0 në 7), ka korrupsionin më të lartë administrativ ndër vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (pika mesatare 2.2) dhe të barabartë me nivelet e korrupsionit administrativ në vendet e CIS (mesatarja 3.7). Sondazhi BEEPS i rendit pengesat kryesore ndaj sektorit të biznesit në Shqipëri si më poshtë: krimi i organizuar/mafia, paqëndrueshmëria politike dhe financiare, krimi i rrugës /vjedhja/prishja e qetësisë publike dhe mosfunksionimi i gjyqsorit. Kostoja e bërjes biznes në Shqipëri është e lartë: sigurimi i librezës shëndetësore për të bërë biznes, sigurimi i tapive të tokës ose kontratave të qiradhënies, pajtimi i punonjësve, respektimi i ligjeve dhe rregullave të qeverisë, lidhja dhe mbajtja e shërbimeve të elektrikut dhe telefonit – të gjitha këto veprimtari janë të kushtueshme dhe kërkojnë kohë për komunitetin e biznesit shqiptar.

#### *Punësimi në zonat fshatare*

Duke qenë se një numër i madh i të varfërve jeton në zonat fshatare del si domosdoshmëri absolute që qeveria të hartojë një strategji të zhvillimit të fshatit që të përqëndrohet në uljen e varfërisë në periudhën afatshkurtër. Një pjesë e madhe e popullsisë punon në bujqësi, por përmasat e fermës, në shumë raste, janë tepër të vogla dhe nuk lejojnë që ajo të jetë një mundësi e frytshme tregtare, ose thjesht një mundësi që një familje të ketë mundësi t'i shpëtojë varfërisë. Duke qenë se sektori i bujqësisë siguron pjesën më të madhe të të ardhurave për të varfrit në zonat fshatare, zgjidhja e faktorëve që pengojnë zhvillimin e këtij sektori duhet të jetë një element thelbësor i çfarëdo kombinimi të politikës që ka si synim uljen e varfërisë në fshat.

Bujqësia është një veprimtari kyç që sjell të ardhura në zonat fshatare, dhe madje edhe familjet më të pasura mbështeten fort tek bujqësia si burimi i tyre kryesor i të ardhurave. Shitja e bagëtive është më e rëndësishme për familjet më të varfra dhe për familjet që jetojnë në zonat malore. Masat që mundësojnë përpunimin më të mirë në shkallë të vogël potencialisht mund të ndihmojnë të varfrit dhe bujqit në zona më të largëta dhe të rrisin sigurimin e të ardhurave të tyre nga bagëtia.

**Tabela 9. 1: Sasia e të ardhurave sipas burimeve të të ardhurave (në përqindje, vetëm popullsia fshatare)**

Peseshorja	Jobujqësori	Punë	Bujqësi	Shitja e produkteve blegtorale	Shitje e bagëtisë	Shitje e të lashtave
1	2.6	27.7	52.4	8.3	11.7	32.4
2	8.5	34.5	45.6	7.9	7.4	30.3
3	6.0	31.3	42.7	7.8	9.3	25.5
4	7.8	32.4	42.6	7.5	5.9	29.2
5	4.9	31.5	33.8	12.6	3.5	17.7

Vetë toka nuk është përcaktuese e kamjes së familjes bujqësore, dhe 15 % e familjeve me më shumë se 2.5 hektarë i përkasin peseshores së të varfërve.<sup>84</sup> Kostot e prodhimit ndryshojnë ndjeshëm mes fermave, ku fermat më të vogla dhe më të varfra shpenzojnë më shumë për hektar për investimet në fermë. Një pjesë e madhe e këtyre dallimeve buron nga shpenzimet më të larta për plehrat. Përdorimi i makinerive bujqësore për punimin e tokës është shumë i kufizuar tek familjet bujqësore. Të pakta janë familjet që kanë madje traktorë të vegjël dhe plugjet e tërhequra nga kafshët janë të zakonshme për parcelat e tokës me përmasa më të vogla. Përdoren shumë pak makineri të tjera – si rimorkio, smakinë mbjellëse drithërash, spërkatës pecticidesh etj. – pavarësisht nga përmasat e tokës. Serat ekzistojnë në rajonin bregdetar dhe qendror, por jo në zonat malore.

Bujqësia është gjithashtu një burim i rëndësishëm të ardhurash me para në dorë. Ndërsa një pjesë e madhe e bujqve ka prirje të prodhojë për konsum për vete, bujqit të cilët mund t'i shesin disa nga produktet e tyre kanë tendencë të mbështeten fort tek bujqësia edhe si një burim i të ardhurave me para në dorë. Për disa nga familjet më të varfra, të ardhurat me para në dorë nga bujqësia mund të jenë një nga burimet e pakta të të ardhurave me para në dorë që ata kanë. Duke pasur parasysh se të varfrit kanë gjithashtu transferta përgjithësisht më të vogla parash që nuk janë të ardhura, të ardhurat nga bujqësia janë tejet të rëndësishme.

Pa dyshim, bujqësia është e rëndësishme për të gjithë ekonominë e Shqipërisë, dhe një pjesë e madhe e popullsisë mbështetet tek bujqësia si një nga burimet e tyre kryesore të të ardhurave. Deri në kohën kur mundësitë e të ardhurave të ekzistojnë në sektorë të tjerë të ekonomisë, sektori bujqësor do të mbetet shumë i rëndësishëm. Bujqësia ka një ndikim të

<sup>84</sup> Sigurisht, edhe cilësia e tokës është e rëndësishme, por sondazhi i LSMS-së nuk jep informacion për cilësinë e tokës.

fuqishëm tek siguria ushqimore që nuk duhet nënvleftësuar. Familjet më të varfra mbështeten në shkallë të madhe të konsumi i produkteve të veta dhe bujqësia shërben gjithashtu si amortizator. Për aq kohë sa mundësitë e tyre për të ardhura të tjera mbeten të kufizuara, bujqësia u siguron familjeve një mjet për të mbijetuar, si dhe për të krijuar disa të ardhura me para në dorë.

Shërbimi i shtrirë në fshat, fleksibël dhe i përshtatur sipas vendit, mund të bëjë shumë për të përmirësuar mënyrat aktuale të prodhimit. Bujqit më të varfër kanë shpenzime më të mëdha prodhimi dhe më pak të ardhura. Ata nuk ndryshojnë shumë dhe kanë tendencë të angazhohen më pak në procesin e përpunimit. Të gjitha këto janë çështje që mund të zgjidhen duke zgjeruar shërbimet që marrin parasysh kushtet vendore dhe këshillojnë bujqit që mbështeten tek mundësitë e tregut. Rritja e cilësisë dhe sasisë ndoshta do të përdoret nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që fillojnë veprimtari përpunimi në zonat fshatare dhe kështu mund të jenë një zgjidhje e mundshme për bujqit e varfër.

Tregjet e tokës dhe ndryshimi strukturor janë të rëndësishme për zhvillimin e zonave fshatare. Mesatarisht, përmasat e tokës janë aq të vogla sa që është e vështirë të vlerësohen tregjet, nëse bujqit nuk janë të organizuar. Duket se është e rëndësishme që të sigurohet që tregjet e tokës të funksionojnë si duhet në mënyrë që, kur njerëzit vendosin të mërgojnë dhe arrijnë të sigurojnë të ardhura diku gjetkë, toka të mund të vihet pa vështirësi në treg. Sidoqoftë, një parakusht për ndryshimet strukturore është që mundësitë e punësimit të rriten në mënyrë që familjet të ndjehen të sigurta që të mos mbajnë bagëti si një mekanizëm sigurie dhe mbrojtje për kohë të këqija. Migrimi po i ndryshon dhe është e qartë se do t'i ndryshojë zonat fshatare; megjithatë, njerëzit do të qëndrojnë në zonat fshatare dhe nuk do të largohen që andej për aq kohë sa në zonat fshatare të ekzistojnë mundësitë për të ardhura. Vëmendja për përmirësimin e bujqësisë që krijon të ardhura do të bëjë të mundur që disa zona fshatare të lulëzojnë.

#### *Punësimi në ekonomitë fshatare jobujqësore*

Me prishejn në Shqipëri të ndërmarrjeve fshatare të financuara dhe të drejtuara nga shteti, ekonomia fshatare jobujqësore (NFRE) u shpërbë pothuajse plotësisht, ku ndërmarrjet e përpunimit të produkteve bujqësore dhe minerare përbënin humbje shumë të mëdha. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, punësimi pësoi rënie shumë të madhe nga 38.000 në vetëm 4.800 vetëm në sektorin e minierave. Këto ndërmarrje nuk ishin konkurrese në mjedisin e ri të ekonomisë së tregut, dhe tërheqja e tyre për investuesit u pakësua nga vështirësitë e ripërtëritjes së infrastrukturës fizike dhe shërbimeve publike të nevojshme për rigjenerimin e tyre fitimprurës.

Aktualisht NFRE është e kufizuar në ndërtimet e shkallës së ulët, shërbimet e vogla teknike dhe personale, dhe tregtinë e vogël. Punëdhënësit në sektorin e shërbimeve janë zakonisht bizneset familjare që janë të vogla dhe nuk krijojnë shumë vende të reja pune. Për më tepër, puna ka prirjen të jetë e rastësit, me hope, dhe e paguar pak. Vendet e pakta të punës që janë krijuar kanë tendencë të krijojnë pak ose asnjë mundësi për të mësuar profesione të reja, duke i dëmtuar edhe më tej forcat e punët në fshat tashmë të dobta. Përpos kësaj, NFRE siguron vetëm mallrat dhe shërbimet më të nevojshme për të jetuar,

dhe mbështetet më shumë tek farefisi dhe kodet tradicionale të reciprocitetit mes njerëzve se tek praktika kontraktuale moderne. NFRE vuan gjithashtu nga investimet dhe nismat e nevojshme, që tani drejtohen nga zonat qytetëse fushore dhe zonat periferike, ku nivelet më të larta të zhvillimit u shënuan gjatë viteve nëntëdhjetë. Kjo ka shkaktuar migrimin në shkallë të gjerë me drejtim nga zonat fshatare, kryesisht nga anëtarët më aktivë meshkuj të forcës së punës në fshat, të cilët tërhiqen nga mundësitë për punë në zonat qytetëse dhe jashtë shtetit. Si pasojë, popullsia fshatare po përbëhet gjithnjë e më shumë nga gratë, të moshuarit dhe të kualifikuarit, duke e ngushtuar në mënyrë të ndjeshme bazën e burimeve njerëzore për zhvillimin e NFRE.

NFRE në Shqipëri ka vuajtur gjithashtu nga një mungesë e theksuar e organizimit institucional i nevojshëm ky për zhvillimin. Boshllëqet kryesore institucionale janë në arsim dhe në kualifikimin e aftësive teknike dhe të biznesit, në përdorimin e shërbimeve financiare, në komunikimin me qeverisjen vendore dhe organizatat e shoqërisë civile; dhe në nxjerrjen, përhapjen dhe zbatimin e një tërësie ligjesh të përshtatshme për tregtinë. Ka pasur një rënie të vazhdueshme të aftësive të forcave të punës në fshat për shkak të migrimit, mplakjes dhe mungesës së shkollimit dhe kualifikimit të fillestarëve.

### *Spektori i prodhimit*

Përsa i përket zhvillimit në të ardhmen, vëmendja domosdoshmërisht duhet të zhvendoset tek sektori i prodhimit industrial, që aktualisht kontribuon vetëm 11.6 % të PBB-së së vendit, dhe përdor vetëm 4 % të forcave të punës në vend, duke u bërë punëdhënësi i katërt më i madh, pas bujqësisë, shitjes me shumicë dhe shitjes me pakicë, riparimeve, dhe ndërtimit. Sektori i bujqësisë punëson më shumë se gjysmën e forcave të punës, por shumica e tyre janë të pakualifikuara dhe me kualifikim të ulët, dhe mbi 15 % punojnë me orar të shkurtuar. Shkalla e punësimit të fshehur në bujqësi nuk kuptohet mirë, por ekziston gjithmonë mundësia që konsolidimi i tokës dhe teknologjia mund të largojnë një numër të madh të njerëzve relativisht të pakualifikuar nga sektori bujqësor. Ashtu siç është, migrimi efektivisht po largon një numër të madh njerëzish nga zonat fshatare në qendrat qytetëse dhe periferike të vendit. Punësimi në ndërtim është tashmë shumë i lartë. Në të njëjtën kohë, ka një kufi përse i përket shkallës që veprimtaritë ndërtimore priten të rriten, dhe nuk duket se ka gjasa që sektori i ndërtimeve do të jetë katalizatori për krijimin e veprimtarive të reja për krijimin e të ardhurave.

Stimulimi i sektorit të prodhimit industrial ndoshta mund të krijojë disa mundësi punësimi. Brenda sektorit të prodhimit industrial ekzistojnë disa industri që ndoshta mund ofrojnë mundësi të ndryshme punësimi, dhe mund të jetë e mundur që të përcaktohen më tej industritë me potencialin më të madh të zhvillimit. Mërrni në shqyrtim, për shembull, prodhimin e tekstileve, që është punëdhënësi më i madh në sektorin e prodhimit industrial, që ka gjithashtu pagat më të ulta. Një sektor tjetër është ai i prodhimit të mallrave prej lëkure që, duke pasur parasysh afërsinë e Shqipërisë me Italinë dhe njohjen e mirë të gjuhës kombinuar me prirjet e kohëve të fundit në shpërndarjen e prodhimit industrial, fare mirë mund t'i ofronte Shqipërisë mundësinë për të kaluar në prodhim. Kjo krijon zgjedhje intriguëse tërheqëse, dhe është një fushë që ka nevojë të hulumtohet në mënyrë të thellë.



## 2. Fushat e kërkimeve në të ardhmen

Janë të paktën pesë fusha të cilat kanë nevojë të studjohen më tej dhe në mënyrë më të hollësishme:

### *Krijimi i dinamizmit në zonat fshatare*

Përballë një ekonomie që po kalon ato lloj ndryshimesh rrënjësore që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, bëhet pyetja si mund të krijohet dinamizmi në zonat fshatare nga i cili të përfitojnë të varfrit. Siç u tha më sipër, në Shqipëri ka qenë prirja që përfitimet e procesit të zhvillimit t'i merrnin kryesisht zonat qytetëse, dhe zonat fshatare po lihen pas. Pa një veprim politik të drejtëpërdrejtë, të përqendruar dhe të përcaktuar mirë dhe pa mbështetjen e Qeverisë, mundësia që shumë nga varfrit në fshat, dhe të varfrit e paarsimuar në qytet, t'i shpëtojnë varfërisë duke u përfshirë me procesin e zhvillimit ekonomik duket e largët. Njerëzit e varfër kanë prirjen që të përqendrohen në mikro-firma, dhe kanë tendencë që të jenë më pak të përfaqësuar në sektorin publik dhe shumë të përfaqësuar në bujqësi. Sidoqoftë, tendenca është që parcelat e tokës të jenë të vogla, kështu që prodhimet nga bujqësia për të varfrit janë të prirura të jenë të ulta. Në të njëjtën kohë, në zonat fshatare, jo të varfrit kanë tendencë të jenë të përfaqësuar mirë në sektorin jobujqësor, dhe për shumë arsye – që lidhet, ndër të tjera, me arsimin, gjininë, dhe madhësinë e familjes – pjesëmarrja e të varfërve në veprimtaritë e sektorit privat jobujqësor në fshat ka tendencë të jetë e ulët. Si rezultat, të varfrit kanë tendencë të punësohen në firma më pak fitimprurëse, më pak tërheqëse. Prandaj, në këtë situatë është e nevojshme që të studjohet si mund të krijohet dinamizmi në zonat fshatare që do të siguronte shtysën e nevojshme që njerëzit e varfër të dilnin nga – dhe mundësisht të mbeteshin jashtë – varfërisë.

### *Roli i sipërmarrjes në uljen e varfërisë*

Roli i veprimtarisë sipërmarrëse dhe vetëpunësimit në lëvizshmërinë në rritje të të ardhurave dhe shpëtimit nga varfëria ka nevojë të shqyrtohet më tej. Në përgjithësi, sipërmarrësit ka më shumë ngjarë të provojnë një lëvizshmëri në rritje të të ardhurave lidhur me pjesën tjetër të popullsisë, dhe është e rëndësishme që të studjohet dhe përcaktohet roli i veprimtarisë sipërmarrëse tek ata të cilët nuk ia dolën në krye t'i shpëtonin varfërisë. Në të njëjtën kohë, ndërveprimi mes sipërmarrjes dhe klimës për investimeve duhet të kuptohet më mirë duke qenë se sipërmarrja dhe punësimi në ndërmarrjet e vogla ka më shumë gjasa të shoqërohet me një lëvizshmëri në rritje të të ardhurave nëse përmirësohet klima për investimet. Studimi i këtyre çështjeve mund të ndihmojë për t'i dhënë përgjigje pyetjes si mund të ndikojë sipërmarrja për uljen e varfërisë – nëpërmjet një efekti të drejtëpërdrejtë si psh aty ku të varfërit nisin një biznes të vogël dhe shpëtojnë nga varfëria, apo në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë, psh të pasurit dhe të arsimuarit kanë më shumë gjasa të jenë sipërmarrës dhe të kenë firma të vogla dhe pastaj të punësojnë në to individë të varfër.

### *Migrimi and kthimi i mërguesve*

Nga çështjet e shumta që lidhen me migrimin, dy çështjet që kërkojnë shqyrtim të menjëhershëm kanë të bëjnë me konsolidimin e tokës dhe mërguesit e kthyer. Së pari, migrimi në zonat qytetëse dhe periferike nuk ka çuar në konsolidimin e tokës në zonat fshatare. Është e qartë se parcelat ekzistuese të tokës nuk janë të mjaftueshme për një bujqësi të efektshme, e megjithatë, edhe pas migrimit madh që ka kaluar Shqipëria, nuk ka pasur pothuajse asnjë efekt pozitiv për konsolidimin e tokës. Kjo është një çështje që duhet të kuptohet më mirë. Së dyti, nuk ka asnjë të dhënë se ka filluar kthimi i mërguesve. Kthimi i mërguesve në vendlindje ka një shumëllojshmëri përfitimesh afatgjatë në kuptimin e FDI-së, investimeve vendore, sipërmarrjes, kapitalit të investimeve, etj. Niveli i lartë i migrimit me jashtë mund të jetë i lidhur gjithashtu me disa nga të njëjtat probleme të korrupsionit publik, të drejtimit të paefektshëm dhe të pengesave për sipërmarrjen. Vende si Irlanda dhe Taivani kanë pasur një shkallë të lartë të kthimit të mërguesve, dhe ndoshta mund të ishte e dobishme të shqyrtoheshin masat e heshtura dhe të hapura të politikës që kanë ndjekur këto vende për të mbështetur këtë prirje.

#### *Zhvillimi ekonomik dhe varfëria*

Duke pasur parasysh numrin e madh të personave që janë nën kufirin e varfërisë, zhvillimi ekonomik ka gjasa të ketë efekte shpërprjestimisht më të mëdha tek varfëria. Në mungesë të të dhënave të hapura, lidhjet mes zhvillimit ekonomik dhe varfërisë nuk mund të analizohen në këtë vlerësim, duke e bërë këtë një fushë që mund të përfitonte nga kërkimet në të ardhmen.

#### *Mundësia e turizmit si motor për zhvillimin ekonomik*

Një fushë tjetër që ka nevojë për më shumë vëmendje është turizmi. Shqipëria është një vend me bukuri të mëdha natyrore, rrethuar nga malet në Veri dhe deti në Perëndim. Në të njëjtën kohë, Shqipëria është afër Greqisë dhe Italisë, që janë vende që tërheqin shumë turistë nga Evropa dhe jashtë saj. Zhvillimi i turizmit në Shqipëri do të ishte një zgjedhje tërheqëse dhe një zgjedhje që duhet të studjohet dhe shfrytëzuar në mënyrë më agresive.